Nga ana e blesesit eshte paguar totalisht çmimi i blerjes se aksioneve, sipas menyres se percaktuar ne nenin 3.1 dhe 3.2 te Kontrates se Shitjes se Aksioneve të dates 20 - 21 Dhjetor 2006, si dhe jane plotesuar kushtet e percaktuara ne Seksionin IV te Kontrates se Shitjes se Aksioneve. Per kete arsye, ne Daten e Mbylljes 29.06.2007, palet kane nenshkruar Deklaraten e Mbylljes [parashikuar ne nenin 6.1 (ix)], nepermjet se ciles provohet plotesimi i kushteve per transferimin e pronesise mbi aksionet – objekt kontrate.

**II.** Me date 29.06.2007 eshte thirrur dhe mbajtur rregullisht mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise" SH.A, ne te cilen ishin te pranishem te dy Aksioneret, konkretisht:

- a) "Albanian - American Enterprises Fund" aksioner zoterues i 20% te te gjitha aksioneve ne te cilat shprehet kapitali i "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise" SH.A perfaqesuar nga Z. Jeffrey Griffin.
- b) "INTESA SANPAOLO" S.p.A, aksioner zoterues i 80 % (tetedhete perqind) te te gjitha aksioneve ne te cilat shprehet kapitali i "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise" SH.A, perfaqesuar nga Z. Giovanni Boccolini.

Ne perfundim, Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve ne unanimitet ka vendosur:

➤ ***Te ndryshohet Statuti i "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise" SH.A sipas ndryshimeve te percaktuara ne vijim:***


- i) Ne nenin 1, shtohet nje paragraf i ri me formulimin e meposhtem:

*"Banka perfshihet ne grupin bankar Intesa Sanpaolo. Banka detyrohet te zbatoje te gjitha direktivat te cilat Intesa Sanpaolo S.p.A, si kreu i Grupit Bankar Intesa Sanpaolo dhe si shoqeri e listuar adopton me qellim perputhjen me dispozitat urdheruese qe lidhen me mbikqyrjen mbi baza te konsoliduara dhe detyrimet e publikimit per sa i perket tregut, te percaktuara nga legjislacioni Shqiptar i aplikueshem".*

- ii) Neni 6.1 ndryshon si me poshte vijon:

*"Kapitali i paguar i Bankes eshte USD 33,400,000 (tridhete e tre milion e katerqind mije dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) dhe numri i aksioneve te nenshkruara dhe paguara teresisht eshte 15,000,000 (pesembedhete milion) aksione, me vlere nominale USD 2,2266 (dy presje dymije e dyqind e gjashtedhete e gjashte dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) per cdo aksion."*

- iii) Neni 6.2 shfuqizohet, pasi te gjitha aksionet ne te cilat ndahet kapitali i Bankes jane nenshkruar dhe paguar teresisht nga ana e aksionereve.



iv) Fjalja e pare dhe e dyte e Nenit 8.1 te Statutit te "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise" SH.A zevendesohen me fjalite e formuluar si me poshte vijon

*"Punet dhe biznesi i Bankes drejtohen nga Keshilli Drejtues, i cili perbehet nga nje numer tek anetaresh, jo me pak se 5 (pese) dhe jo me shume se 9 (nente) persona. Anetaret e Keshillit Drejtues zgjidhen nga Asambleju e Aksionereve per nje afat jo me te gjate se kater vjet dhe secili anetar ka te drejte te zgjidhet per te njejtin mandat pa kufizim".*

v) Neni 8.4 ndryshon si me poshte vijon:

*"Vendimet e Keshillit Drejtues te Bankes jane te vlefshme kur ne mbledhje jane te pranishem te pakten gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem, pervec kur ligji parashikon ndryshe. Ne rast se quorumi i nevojshem per vlefshmerine e mbledhjes nuk arrihet, anetaret e pranishem mund ta shtyjne mbledhjen pa njoftim derisa te arrihet quorumi.".*

Shoqeria anonime "American Bank of Albania – Banka Amerikane e Shqiperise" SHA kerkon depozitim ne Regjistrin Tregtar te Kontrates se Shitjes se Aksioneve te datës 20 – 21 Dhjetor 2006, vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise" SH.A, date 29.06.2007, si dhe dokumentacionit shoqerues:

1. Miratimi i Bankes se Shqiperise per transferimin e aksioneve nr.3269 prot. date 14.06.2007,
2. Miratimi i Autoritetit te Konkurrences per transferimin e aksioneve me vendimin nr.51, date 09.05.2007,
3. Miratimi i Bankes se Italise per blerjen e aksioneve me autorizimin nr.498913, date 17.05.2007,
4. Miratimi i Bankes se Shqiperise per kryerjen e ndryshimeve ne statut me nr.3089/1 prot. date 21.06.2007.

Kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe ne dokumentacionin bashkangjitur;


### **PER KETO ARSYE**

Bazuar ne nenet 128-149, 198 te Ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"; nenin 24 paragrafi 1 germa b) te Ligjit nr.9662, date 18.12.2006 "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise"; nenet 18, 33 te Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare", si dhe Statutin e "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise" SH.A.

### **V E N D O S A:**

Pranimin e kerkeses.

- Depozitim ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane te Kontrates se Shitjes se Aksioneve date 20 – 21 Dhjetor 2006 per kalimin e pronesise se 80 % (tetedhete perqind) te aksioneve te zoteruara nga "Albanian -



American Enterprise Fund" tek banka "INTESA SANPAOLO" S.p.A. se bashku me dokumentacionin shoqerues (Deklarate Mbyllje date 29.06.2007; miratimi i Bankes se Shqiperise per transferimin e aksioneve nr.3269 prot. date 14.06.2007; miratimi i dhene nga Autoriteti i Konkurrences per transferimin e aksioneve me vendimin nr.51, date 09.05.2007; miratimi i Bankes se Italise per blerjen e aksioneve me autorizimin nr.498913, date 17.05.2007)

- Depozitimim e Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise" SH.A. date 29.06.2007, ne baze te te cilit eshte vendosur:

Te ndryshohet Statuti i "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise" SH.A sipas ndryshimeve te percaktuara ne vijim:

- i) Ne nenin 1, shtohet nje paragraf i ri me formulimin e meposhtem:

*"Banka perfshihet ne grupin bankar Intesa Sanpaolo. Banka detyrohet te zbatoje te gjitha direktivat te cilat Intesa Sanpaolo S.p.A, si kreu i Grupit Bankar Intesa Sanpaolo dhe si shoqeri e listuar adopton me qellim perputhjen me dispozitat urdheruese qe lidhen me mbikqyrjen mbi baza te konsoliduara dhe detyrimet e publikimit per sa i perket tregut, te percaktuara nga legjislacioni Shqiptar i aplikueshem".*

- ii) Neni 6.1 ndryshon si me poshte vijon:

*"Kapitali i paguar i Bankes eshte USD 33,400,000 (tridhjetë e tre milion e katerqind mije dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) dhe numri i aksioneve te nenshkruara dhe paguara teresisht, eshte 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) aksione, me vlere nominale USD 2,2266 (dy presje dymije e dyqind e gjashtedhjetë e gjashtë dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) per cdo aksion".*

- iii) Neni 6.2 shfuqizohet, pasi te gjitha aksionet ne te cilat ndahet kapitali i Bankes jane nenshkruar dhe paguar teresisht nga ana e aksionereve.

- iv) Fjalja e pare dhe e dyte e Nenit 8.1 te Statutit te "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise" SH.A zevendesohen me fjalite e formuluar si me poshte vijon:

*"Punet dhe biznesi i Bankes drejtohen nga Keshilli Drejtues, i cili perbehet nga nje numer tek anetaresh, jo me pak se 5 (pese) dhe jo me shume se 9 (nente) persona. Anetaret e Keshillit Drejtues zgjidhen nga Asambleja e Aksionereve per nje afat jo me te gjate se kater vjet dhe secili anetar ka te drejte te zgjidhet per te njejtin mandat pa kufizim".*

- v) Neni 8.4 ndryshon si me poshte vijon:

*"Vendimet e Keshillit Drejtues te Bankes jane te vlefshme kur ne mbledhje jane te pranishem te pakten gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem, pervec kur ligji parashikon*

*Carver*

*ndryshe Ne rast se quorumi i nevojshem per vlefshmerine e mbledhjes nuk arrihet, anetaret e pranisem mund ta shtyjne mbledhjen pa njoftim derisa te arrihet quorumi.*


- Depozitim in ne Regjistrin Tregtar te miratimit te Bankes se Shqiperise per kryerjen e ketyre ndryshimeve ne statut me nr.3089/1 prot. date 21.06.2007.
- Depozitim in e akteve te perfaqesimit te aksionereve.

Te urdheroj regjistrimin e ndryshimeve ne kolonat perkatese te skedes se Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kunder ketij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.

**GJYQTARE**

**Enkela BAJO**



Uncler me just a un'

1946

"American Bank of America" S.H.A.  
Bank American "Supper"

Supper, Turco Pr "Vaso" Toledo  
P. II vol II last part 8319.

From Egyptian, Arabic credit, his-  
tory law, Egypt. Merit to papers,  
ambassadors, also to understand Egypt to  
papers, note system for operation to  
papers, language papers, Kalam of  
Egyptian papers.

(9) Kopala fillet; Egyptian 87.500. ecc.  
(file Egypt) state in law of Egyptian  
with American - American Enterprises Co  
Fund Egyptian currency

- 3. U.S. (Hinterland) papers to Bank
- 1. Domenico G. Sapienza 2. Thomas D.
- 3. James H. Duffy 4. Michael P. Grano
- 5. Charles A. Mainucco.

State and news with (10)  
Bank to papers to Fund (11)  
American to Mainucco Domenico (12)

*Handwritten signatures and notes at the top right of the page.*

**KËRKESË**

**GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË  
SEKSIONIT TREGTAR**

*Handwritten notes on the left side:*  
19.05.1998  
OBJEKTI  
BAZA LIGJORE:  
*Other illegible handwritten notes.*

**KËRKUESI:**

Peter Nice, lindur më datë 3 July 1934, në Danham, Mbretëria e Bashkuar, dhe me numër pasaporte angleze B 379298.

**OBJEKTI:**

Regjistrim në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate, Shoqërisë "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë ShA."

**BAZA LIGJORE:**

Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar",  
Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare" dhe Ligji Nr. 8075, "Për Sistemin Bankar të Republikës së Shqipërisë", datë 22.02.1996.

Sot më datë, \_\_\_/\_\_\_/1998, Unë Peter Nice, duke u bazuar në kompetencat që më jepen nëpërmjet prokurës së përgjithshme të lëshuar më datë 10 Dhjetor 1997, nga kryetari i Bordit të Drejtorëve Domenick G. Scaglione, në përputhje me vendimin e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më datë 9 Dhjetor 1997, dhe duke u mbështetur në Nenin 8 të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare", i kërkoj Gjykatës së Rrethit Tiranë të regjistrojë në Regjistrin Tregtar të kësaj gjykate shoqërinë "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë ShA" (më poshtë referuar edhe si "Shoqëria").

Emri i Shoqërisë është "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë Sh.A".

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë Sh.A." është e pakufizuar.

Objekti i Shoqërisë është kryerja e aktivitetit të shërbimeve bankare dhe financiare në përputhje me Ligjin Nr. 8075 (datë 22.02.1996) "Mbi Sistemin Bankar të Republikës së Shqipërisë" në formën aktuale dhe me të gjitha ndryshimet që mund t'i bëhen. Specifikisht, Shoqëria mund të kryejë këto aktivitete: (a) pranimin e depozitave (në formën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes; (b) Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun, me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare; (c) marrje hua të fondeve dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve të instrumenteve të tregut monetar (duke përfshirë ndër të tjera çeqet kambialet dhe çertifikatat e depozitave), të letrave me vlerë të borxhit; të kontratave të së ardhmes dhe kontartat "e mudësive", që lidhen me kryerjen e shërbimeve të pagesës; (e) emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (d) përfshirë ndër të tjera, pagesat me kartë, me çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankierit ndërmjetësin për operacione monetare duke përfshirë valutat; (g) lisingun financiar; dhe kryerjen e shërbimeve si agent financiar, ose këshilltar financiar (jo për shërbim përshkruara në pikën 3/a dhe 3/b) si dhe të gjitha aktivitetet financiare që do të përca në licensënpërfundimtare të e Bankës së Shqipërisë.

*Handwritten mark or signature at the bottom left.*

Adresa e selisë së Shoqërisë është: Rr.

Vaso Pasha Nr. \_\_, Tiranë, Shqipëri.


Kapitali total i Shoqërisë është treqind e pesëdhjetë milion (350,000,000) lek, dhe numri i aksionerëve të autorizuar në të cilën do të ndahet ky kapital është tre milionë e pesëqind mijë aksione me një vlerë nominale prej njëqind (100) lek për aksion. I gjithë kapitali aksioner i Shoqërisë i përket plotësisht Aksionerit Themelues që është Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndërmarrjeve. Kapitali fillestar i paguar i Bankës është tetëdhjetë e shtatë milion e pesëqindmijë (87,500,000) lek, dhe paguhet prej Aksionerit Themelues në para, i shkëmbyeshëm me tetëqind e shtatëdhjetë e pesë (875,000) aksione me një vlerë nominale prej njëqind (100) lek për aksion.

Këshilli i Drejtuesve të Shoqërisë “American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë ShA.” përbëhet nga këta anëtarë:

1. Domenic G. Scaglione, lindur më 24 Maj 1993 në Itali;
2. Thomas Lambert Cranmer, lindur më 14 Qershor në USA;
3. James Henry Duffy, lindur më 3 Shkurt 1938 në USA;
4. Michael D. Granoff, lindur më 3 Korrik 1958 në USA;
5. Charles Linderberg Marinaccio, lindur më 10 Dhjetor 1933 në USA.

Bashkangjitur do të gjeni të gjitha materialet e mëposhtëme:

- ◆ Statuti i Shoqërisë “American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë ShA.”;
- ◆ Akti i Themelimit të Shoqërisë “American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë ShA.”
- ◆ Vendimi i Bordit të Drejtorëve të Fondit Shqiptaro Amerikan të Ndërmarrjeve për krijimin e Shoqërisë “American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë ShA.”;
- ◆ Prokura për Z. Peter Nice nga Domenic G. Scaglione, me cilësinë e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të Fondit të Shqiptaro Amerikan të Ndërmarrjeve”;
- ◆ Vërtetimi i Zyrës së Sekretarit të Shtetit për egzistencën e “Fondit Shqiptaro Amerikan të Ndërmarrjeve”;
- ◆ Akti i Themelimit i Fondit Shqiptaro Amerikan të Ndërmarrjeve;
- ◆ Statuti i Fondit Shqiptaro Amerikan të Ndërmarrjeve;
- ◆ Licensa e Përkohëshme e Lëshuar nga Banka e Shqipërisë për “American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë”;
- ◆ Kopjen e Certifikatës së Depozitimit të Kapitalit Fillestar për Shoqërinë.




PETER NICE

Nr. 3524 Rep.  
Nr. \_\_\_\_\_ Col.

## VËRTETIM

Sot, më datë 06/04.1998, në Zyrën e Noterisë, para meje Notes, u paraqit personalisht **Z. Peter Nice**, Qytetar Anglez me Nr. Pas. B379298, me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u binda pasi verifikova letërnjoftim e tij, i cili më deklaroi se e ka përpiluar këtë Kërkesë jashtë Zyrës së Noteres, me vullnetin e tij të lirë, Kërkesë të cilën e nënshkroi përpara meje, dhe unë e vërtetoj atë sipas kërkesave të ligjit.





# ALBANIAN-AMERICAN ENTERPRISE FUND

14 EAST 60<sup>TH</sup> STREET, NEW YORK, N.Y. 10022, Tel: (212) 702-9102; Fax: (212) 702-0854

New York, December 10, 1997

## POWER OF ATTORNEY TO

MR. PETER J.E. NICE

## TO WHOM IT MAY CONCERN

### LET IT BE KNOWN THAT:

The Board of Directors of the Albanian-American Enterprise Fund (or the "AAEF"), at a meeting held in New York on December 9, 1997 unanimously approved the incorporation of a bank in Albania to be named the "American Bank of Albania". At that time, the Chairman and the Board of Directors **delegated their power and authority to Mr. Peter J.E. Nice**, Chief Executive Officer of the proposed American Bank of Albania, to proceed with the incorporation of the bank company.

To form this bank, Mr. Peter J.E. Nice is authorized to:

- Sign all documents in the name of the "American Bank of Albania"
- Represent the "American Bank of Albania" before all public and private entities
- Organize the "American Bank of Albania" in the name of the AAEF
- Perform all necessary actions to incorporate the "American Bank of Albania" and make the bank operational
- Delegate power of attorney to other persons

No time limitation is imposed upon the position of Mr. Peter J.E. Nice or his assigns.

Very Truly Yours,

The Albanian-American Enterprise Fund

By *Domenick G. Scaglione*  
Domenick G. Scaglione, Chairman of the Board of Directors

State of New York)

County of ~~Kings~~  
*New York*

On this 10th day of December, 1997, before me came Mr. Domenick G. Scaglione, to me known to be the Chairman of the Board of Directors of the Albanian-American Enterprise Fund, who being sworn before me, deposes and says that the above Power of Attorney fully reflects the resolution of the Board of Directors of said Fund and that he has transcribed the same to the best of his knowledge and belief.

By *Miriam Camerini*  
Notary Public



MIRYAM CAMERINI  
NOTARY PUBLIC, State of New York  
No. 31-4783081  
Qualified in New York County  
Commission Expires June 30, 1998

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE  
Nr. 3546 Dt. 06.05.1998  
VERTETOHET FOTOKOPJA E  
NJËJTË ME ORIGINALIN





# ALBANIAN-AMERICAN ENTERPRISE FUND

14 EAST 60<sup>TH</sup> NEW YORK, N.Y. 10022, Tel: (212) 702-9102; Fax: (212) 702-0854

New York, 10 Dhjetor 1997

## PROKURË PËR

Z. PETER J. E. NICE

### PËR TË GJITHË TË INTERESUARIT

#### U BËJMË TË NJOHUR SE:

Bordi i Drejtorëve i Albanian-American Enterprise Fund (ose "AAEF"), më mbledhjen e mbajtur më datë 9 Dhjetor 1997, miratoi unanimitisht krijimin në Shqipëri të një banke e cila do të emërtohet "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë". Në të njëjtën kohë, Kryetari si dhe Bordi i Drejtorëve i deleguan Z. Peter J. E. Nice, me Cilësinë e Zyrtarit të parë Ekzekutiv të shoqërisë së propozuar "American Bank of Albania -69Banka Amerikane e Shqipërisë", kompetencën dhe autoritetin e tyre për të ndërmarrë procedurat e krijimit të shoqërisë bankare.

Për të bërë të mundur krijimin e kësaj Banke, Z. Peter J. E. Nice është i autorizuar të:

- Nënshkruajë të gjitha dokumentat në emër të "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë"
- Përfaqësojë "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë" përpara të gjitha organizmave publike dhe private
- Të organizojë "American Bak of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë" në emër të AAEF
- Të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të krijuar dhe regjistruar "American Bank of Albania j- Banka Amerikane e Shqipërisë" dhe ta bëjë atë funksionale
- T'i delegojë kompetenca me anë të prokurës personave të tjerë.

Nuk ka asnjë kufizim ndaj pozicionit të Z. Peter J. E. Nice ose të deleguarve të tij.

I Juaji Sinqerisht  
Albanian American Enterprise Fund

Prej: *Nëshkrimi*

---

Domenick G. Scaglione, Kryetari i Bordit të Drejtorëve

Shteti New York  
Distrikti New York

Sot më datë 10 Dhjetor 1997, përpara meje u paraqit Domenick G. Scaglione, i njohur prej meje, i cili është Kryetari i Bordit të Drejtorëve të Albanian American Enterprise Fund, i cili duke u betuar përpara meje, deklaroi se Prokura e mësipërme reflekton plotësisht vendimin e Bordit të Drejtorëve të këtij Fondi dhe se ajo e ka përgatitur atë në mënyrën më të mirë dhe të vërtetë të mundshme.

Prej: *Nënshkrimi*

Noter Publik

### Vula e Noteres

MIRYAM CAMERINI  
NOTER PUBLIK, Shteti New York  
Nr. 31-4763081  
E kualifikuar në Distriktin New York  
E Drejta e Ushtrimit të Profesionit përfundim më 30 Qershor 1998

### VËRTETIM I PËRKTHIMIT

Unë vërtetoj se sot, më datë 06.05.1998, deklarova se versioni shqip i Prokurës lëshur Z. Piter J. E. Nice prej Albanian American Enterprise Fund është një përkthim i saktë i versionit anglisht të këtyre dokumentave.

**PËRKTHYESE**


*Loreta Mengri*  
**Loreta Mengri**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**NOTERIA TIRANË**  
Nr. 3647 Rep.

### VËRTETIM

Vërtetoj se sot më datë 06 /05/1998, para meje Noteres, u paraqit Loreta Mengri me Nr. Pas. 0916295, e njohur prej meje si përkthyes e Anglishtes, e cila më deklaroi se përktheu nga Anglishtja në Shqip, njëllor me origjinalin Prokurës lëshur Z. Piter J. E. Nice prej Albanian American Enterprise Fund dhe i firmosi këto dokumenta sipas rregullave.

\\ESTER\SHARE\CLIENT\0020\AAEFPN.poa.doc  
06/05/98




Per: Banka Amerikane e Shqiperise

03/04/1998

## KONFIRMIM BANKAR

Sipas kerkeses tuaj, konfirmojme se ne llogarine ne LEK , Nr.  
50.04.01.00-001228..01/"Banka Amerikane e Shqiperise"(ne formim e  
siper), keni gjendje prej 87.500.000 Lek, me 03/04/1998.


BANKA E TIRANES



Takis Kazatzoglou

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
NOTERIA TIRANE  
Nr. 3586 D. 06.05 1998  
VËRTETOHET FOTOKOPIA E  
NJËJTË ME ORIGINALIN

NOTERE  
ARIANA MAJLKUCI  
RR. DURRESIT P11  
TIRANE - ☎ 425-74





BANKA E SHQIPERISE  
Departamenti i Supervizionit  
Sektori i Licensimit dhe Metodologjise  
2262

Albanian-American Enterprise Fund  
Rruga "Islam Alla", No 70, Tirana  
Tel/fax 355-42-34224

Tirane 18 Gusht 1997


Lenda: Ne lidhje me kerkesen per license per banke.

Fondit Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve

Tirane

I nderuar Z. Gentry

Bashkengjitur Ju dergojme Vendimin e Keshillit Mbikeqyres te Bankes se Shqiperise nr. 19/3/97, date 08.08.1997, lidhur me miratimin paraprak dhe me kusht te kerkeses per licensimin e "ALBANIAN-AMERICAN BANK CORPORATION" ( ne shqip dhe ne anglisht ).  
Ju urojme suksese ne punen tuaj te metejshme.



Miranda RAMA  
DREJTORE

E peraqit  
Korçeqit  
Gjendje Shklic



989<sup>12</sup>  
off 15.08.97



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
Këshilli Mbikëqyrës

VENDIM

Nr. 19/3/97, datë 08 gusht 1997


MBI

"DHENIEN E MIRATIMIT PARAPRAK ALBANIAN-AMERICAN BANK  
CORPORATION PER TE VEPRUAR SI BANKE NE TERRITORIN E  
REPUBLIKES SE SHQIPERISE"

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në mbledhjen e tij të datës 08.08.1997, në bazë të ligjit nr.8076, datë 22.02.1996 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 16, të ligjit nr. 8075, date 22.02.1996 "Per sistemin bankar ne Republikën e Shqiperise", neni 10/1, pasi shqyrtoi dhe analizoi materialet sipas rendit të ditës :

VENDOSI:

1. T'i jape miratimin paraprak me kushte Albanian-American Bank Corporation per te vepruar si banke ne territorin e Republikës se Shqiperise.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikeqyrjes per zbatimin e ketij vendimi.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.



Qafin TUSHA  
GUVERNATOR

*E paraqiti dhe ulet*  
*Orgazuela Gjarp Shkoll*



**BANKA E SHQIPERISE**  
*Departamenti i Mbikeqyrjes*  
Sektori i Licensimit dhe Metodologjise



Tirane 15 Gusht 1997

**Lenda:** Mbi kerkesen per license per te vepruar si banke.

Fondit Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjes

Tirane

I nderuar Z. Gentry

Keshilli Mbikeqyres i Bankes se Shqiperise me Vendimin Nr. 19 /3/1997, date 08.08.1997, pasi shqyrtoi kerkesen tuaj per hapjen e nje banke ne Tirane vendosi:

**T'i jape miratimin paraprak me kusht "ALBANIAN-AMERICAN BANK CORPORATION" per te vepruar si banke ne territorin e Republikes se Shqiperise**

Duke aprovuar kerkesen tuaj Keshilli Mbikeqyres ka besim se "Albanian-American Bank Corporation" me aksioner te vetem Fondin Shqiptaro-Amerikan te Ndermarrjes do te jape ndihmese pozitive ne Sistemin Bankar Shqiptar.

Keshilli Mbikeqyres kerkon qe Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjes dhe Albanian-American Bank Corporation te percaktojne dhe te zbatojne praktikat dhe procedurat qe plotesojne :

1. sigurimin e menaxhimit sa me te pershtatshem te çdo konflikti interesash kur midis Bankes dhe Fondit ka marrëdhënie biznesi ose financiare dhe midis Bankes dhe kompanive ne te cilat Fondi ka ose propozon te kete nje interes te konsiderueshem financiar apo interes drejtimi;

2. parandalimin e fluksit te informacionit konfidencial te klientit midis Bankes dhe Fondit; dhe


3. sigurimin e faktit qe klientet e Fondit jane ne dijeni se ata nuk jane te detyruar te veprojne me Banken dhe anasjelltas.


Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjes do te percaktoje praktikat dhe procedurat qe do te specifikohen ne statutin dhe rregulloret e Albanian-Amerikan Bank Corporation per te permbushur kerkesat e mesiperme. Keto praktika dhe procedura si dhe menyra e zbatimit te tyre duhen te aprovohen nga Banka e Shqiperise.

Brenda nje (1) viti nga data e mesiperme, Fondi duhet te plotesoje kushtin e mesiperme si dhe kushtet e specifikuar ne Ligjin Numer 8075, date 22 Shkurt, 1996 "Per Sistemin Bankar ne Republiken e Shqiperise" ne menyre qe te merret licensa perfundimtare e cila do te lejoje Albanian American Bank Corporation per te filluar aktivitetin bankar.


Perfitoj nga ky rast qe ne emrin tim dhe te Keshillit Mbikeqyres, t'i uroj suksese bankes tuaj te re.

Sinqerisht,

  
Qamil Tusha  
GOVERNATOR



*E percaktuar rregullat e  
Keshillit Gjane Shillo.*







BANK OF ALBANIA  
*Supervision Department*  
Licensing and Methodology Division

989 R 2

Tirana August 15, 1997

**Subject:** On the request for a bank license .

**To:** Albanian-American Enterprise Fund



Tirana

Dear Mr. Gentry,

The Supervisory Council of the Bank of Albania with decision Number 19/3/97 dated August 8, 1997 has considered your application to open a bank in Tirana and decided the following:

**To give, subject to condition, preliminary approval for "Albanian-American Bank Corporation" to operate as a bank in the Republic of Albania**

In approving your application, the Supervisory Council is confident that "American-Albanian Bank Corporation" with the unique shareholder Albanian-American Enterprise Fund will make a positive contribution to the banking system of Albania.

The condition determined by the Supervisory Council is that the Albanian-American Enterprise Fund and the Albanian-American Bank Corporation must specify and commit to introducing practices and procedures which will satisfactorily:

1. ensure the appropriate management of any conflicts of interest when there are financial or business dealings between the Bank and the Fund and between the Bank and companies in which the Fund has or proposes to have a significant financial or management interest (self-dealing);

2. prevent the flow of confidential client information between the Bank and the Fund; and


3. ensure that the clients of the Fund are aware that they are not obliged to deal with the bank and vice versa.

The Albanian-American Enterprise Fund shall determine the practices and procedures that must be specified in its legal arrangement and by-laws and in those of the American-Albanian Bank Corporation to satisfy the above concerns. These practices and procedures and their manner of implementation must be approved by the Bank of Albania

Within one (1) year from the above date, the Fund will need to fulfill the above conditions as well as the conditions specified in Law Number 8075 dated February 22, 1996, entitled "On Banking System in the Republic of Albania" in order to obtain the final license which allow the Albanian-American Bank Corporation to begin conducting banking activities.

I take this opportunity to wish on my name and that of the Supervisory Council, very successes to your new bank.

Sincerely,

  
Qamil Tusha  
GOVERNOR

2678 10 01/98  
F. P. ...  
e. ...  
...  
MIMOZA SABUNI  
TEL = 348-ES  
PULJE TAKSE

## RRËGULLORE

2005 JUN -3 P 4: 10

Nr.9/1 datë 30.10.2001

### MBI LIÇENCIMIN E REGJISTRUESVE TE LETRAVE ME VLERE

Ne mbeshtetje te nenit 66, pika 2 te ligjit nr. 8080, date 1.3.1996  
"Per Letrat me Vlere", ndryshuar me ligjin nr.8168, date 5.12.1996 dhe me  
ligjin nr.8745, date 22.02.2001,

### KOMISIONI I LETRAVE ME VLERE,

#### MIRATON:

#### KREU I TE PERGJITHSHME

##### Neni 1

##### Objekti

Kjo Rregullore ka per objekt përcaktimin e kerkesave, procedurave  
dhe afateve te licencimit te personave qe aplikojne per t'u pajisur me  
Liçence për të kryer veprimtari si regjistruer te letrave me vlere.

##### Neni 2

#### Regjistruesi dhe Regjistri i Letrave me Vlere

"Regjistruesi i letrave me vlere", ose shkurt "Regjistruesi", eshte  
personi juridik i licencuar nga Komisioni qe ka per objekt te aktivitetit,  
organizimin dhe administrimin e regjistrave te letrave me vlere. Regjistruesi  
i Letrave me Vlere, me perjashtim te rasteve kur Komisioni vendos ndryshe,

Bankat mund të kryejnë aktivitetet tjera, të ndryshme nga aktivitetet për të cilat licënohet nga Komisioni. Bankat e nivelit të dytë, të licënuara nga Banka e Shqipërisë, mund të ushtrojnë aktivitet si regjistruar të letrave me vlerë të qeverisë, pasi të jenë pajisur me licencën perkatese nga Komisioni. \*\*

\* "Regjistri i letrave me vlerë", ose shkurt "Regjistri", është dokumenti zyrtar dhe ligjor i mbajtur në një formë të caktuar, i cili përmban të dhëna në lidhje me pronësinë mbi letrat me vlerë, me transaksionet e kryera në lidhje me këto letra me vlerë apo të dhëna në lidhje me vendosjen e letrave me vlerë si garanci.

— Regjistri i veçantë do të emërtohet në varësi të llojit të letrës me vlerë, për regjistrimin e të cilit do të synojë aktiviteti i Regjistruesit.

Regjistruesi mund të licënohet për të regjistruar një ose më shumë letra me vlerë të percaktuara.

Në emërtimin e Regjistruesit të Letrave me vlerë vendoset në kllapa emërtimi i letrës, apo letrave me vlerë mbi të cilat është licënuar për të operuar.

### Neni 2/a \*\*

Në rastin kur licenca për të ushtruar aktivitet si Regjistruar i Letrave me Vlerë, kërkohet nga një Bankë, ateherë brenda strukturës së bankës ngrihet një njësi, aktiviteti i të cilit nga ana operacionale dhe drejtuese, të jetë i ndarë në mënyrë të dukshme nga aktiviteti kryesor si bankë.

### Neni 3

#### Transaksionet mbi letrat me vlerë

Transaksion mbi letrat me vlerë, quhet akti i transferimit të pronësisë mbi letrat me vlerë, me apo pa shpërblim. Me pashtë do të quhet thjesht transaksion.

### Neni 4

#### Drejtesit e Regjistruesit të Letrave me Vlerë

Drejtor apo Drejtues, nënkupton individin që pavarësisht nga emërtimi që mban në shoqëri, ushtron funksione drejtuese me përgjegjësi për administrimin e aktivitetit të Regjistruesit, marrjen e vendimeve në lidhje me

aktivitetin, vendosjen e procedurave dhe politikave të administrimit, vendosjen dhe nenshkrimin e marrveshjeve me të treta etj

Per te tjera perkufizime, interpretimi eshte i njejte me ato te nenit 2 te ligjit nr.8080, date 1.3.1996 "Per letrat me vlere".

Ne rastet kur nje Banke, kerkon te pajiset me licence per ushtrimin e aktivitetit si Regjistruesi i Letrave me Vlere te Qeverise, drejtor apo drejtues i regjistruesit, do te nenkuptoje, individim qe pavaresisht nga emertimi qe mban, ushtron funksione drejtuese me pergjegjesi ne administrimin e aktivitetit te njesise se permendur ne nenin 2/a te Rregulores.\*\*

## Neni 5

### Funksionet e Regjistruesit te Letrave me Vlere

Regjistruesi, ne vartesi te llojit te letres me vlere per te cilen eshte licencuar si Regjistruesi i Letrave me Vlere, ka si funksion te vetin ofrimin e sherbimit te regjistrimit te letrave me vlere nepermjet organizimit te menyres se mbajtjes se regjistrimit te letrave me vlere, ne menyre te tille qe te sigurohen ne çdo kohe te dhena te plota ne lidhje me pronesine mbi letrat me vlere dhe kufizimeve te te drejtave te pronesisë mbi keto letra.

Per realizimin e funksioneve te veta Regjistruesi ka per detyre:

- 1- Te organizoje regjistrimin e transakcioneve dhe te ndryshimeve perkatese ne regjistra, ne menyre qe te evidentoje ne çdo kohe te dhena mbi zoteruesin e fundit te letres me vlere dhe kushte qe çojne ne kufizim te te drejtave te pronesisë mbi letrat me vlere;
- 2- Te lidhe kontrata dhe bashkepunoje me emertuesit e letrave me vlere;
- 3- Te lidhe kontrata dhe bashkepunoje me agjencite e pastrimit dhe rregullimit te llogarive (nese ka te tilla).
- 4- Te siguroje konfidencialitetin e te dhenave te regjistruara ne regjister, me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga dispozitat ligjore ne fuqi;
- 5- Te tjera funksione, te parashikuara ne statutin dhe rregullat e regjistruesit dhe qe kane lidhje me funksionet kryesore te tij.

## KREU II LIÇENCIMI

### PJESA I

## MIRATIMI I STATUTIT

### Neni 6

#### Kerkesa per miratimin e statutit

Projektstatuti i nje shoqerie qe ka per objekt te aktivitetit te saj, aktivitetin si regjistrues i Letrave me vlere, perpara se te depozitohet ne Regjistrin Tregtar, duhet t'i paraqitet Komisionit te Letrave me Vlere.

Projekti shoqerohet me nje kerkese zyrtare, me ane te te ciles kerkohet miratimi nga Komisioni.

Ne rastet kur ne Statutin e Bankes, nuk eshte parashikuar aktiviteti si Regjistrues i Letrave me Vlere te Qeverise, miratohet shtesa ne Statut, ne nenin qe percakton objektin e aktivitetit te shoqerise. Ky ndryshim, miratohet nga Komisioni i Letrave me Vlere me te njejten procedure qe ndiqet per miratimin e statutit, te parashikuar ne paragrafin e pare dhe te dyte te ketij neni. \*\*

### Neni 7

#### Shqyrtimi i kerkeses per Miratimin e statutit

Perpara mberritjes ne Komision, praktika i nenshtrohet te njejtes procedure te parashikuar ne nenin 10 te kesaj Rregulloreje.

Komisioni ne mbledhjen e tij me te pare, shqyrton kerkesen dhe projektin e marre, perputhjen e permbajtjes se statutit me aktivitetin per te cilin do te kerkohet licencim dhe merr vendim per miratimin apo udhezoi ndryshime ne te dhenat e statutit,

Regjistruesi i Letrave me Vlere eshte i detyruar te zbatoje udhezimet e Komisionit.

Vendimi, i dergohet kerkuesit, brenda pese dite pune dhe eshte pjese e praktikes qe depozitohet ne Regjistrin Tregtar,

Miratimi i statutit, nuk kushtezon Komisionin, ne marrjen e vendimeve te mevonshme, ne lidhje me licencimin e te njejtit subjekt si Regjistrues i letrave me vlere.

## PJESA II APLIKIMI PER LICENCIM

## Neni 8

### Forme-Kerkesa

Kerkuesi ploteson Forme-Kerkesen e miratuar nga Komisioni me rregulloren nr. 1, date 28.03.1997.

Forme-Kerkesa shoqerohet nga kerkesa me shkrim për marrjen e licencës për të vepruar si regjistruer i letrave me vlere, nga dokumentacioni i pershkruar sipas nenit 9 te kesaj rregulloreje si dhe pagesa e kuotes perkatese te parashikuar ne nenin 18 te kesaj Rregulloreje.

## Neni 9

### Dokumentacioni qe shoqeron Forme-Kerkesen

Dokumentacioni qe shoqeron Forme-Kerkesen per licencim si Regjistruer i letrave me vlere do te permbaje:

- 1- statutin dhe aktin e themelimit te shoqerise; *redia*
- 2- vendimin e gjykates per regjistrimin si person juridik prane Regjistrat Tregtar te Gjykates se Rrethit, Tirane;
- 3- certifikaten e regjistrimit ne Zyren e tatim-taksave; -
- 4- te dhena ne lidhje me ortaket e shoqerise dhe aktivitetin e tyre per tre vitet e fundit;
- 5- nese nje ose disa ortake, jane persona juridike, paraqiten dokumentat themeltare, vendimi i regjistrimit ne regjistrin Tregtar si dhe te dhena ne lidhje me rezultatin financiar te tre viteve te fundit. *neuka*
- 6- te dhena ne lidhje me personelin drejtues dhe eksperiencen e punes se tyre gjate tre viteve te fundit;
- 7- te dhena te detajuara per pajisjet dhe hapesirat qe do te perdoren per organizimin dhe administrimin e regjistratit te letrave me vlere si kompjuter, telefona, fakse, per shkallen e automatizimit te veprimtarise se regjistratit etj; *Picrs*
- 8- dokumentin qe verteton pronesine, marrjen me qira, apo forme tjeter te zoterimit te ambjenteve, ku do te kryeje veprimtarine Regjistruesi; *Aikeda*
- 9- kopje te dokumentit te leshuar nga institucioni perkates per sigurimin e ambjenteve nga zjarri; *Lorenz*
- 10- te dhena mbi masat e marra per sigurimin e objektit; ✓
- 11- Curriculum Vitae, te Drejtuesit apo Drejtuesve te shoqerise ✓

12- deklaratë personale të Drejtuesve që ata dhe personeli i administratës së Regjistruesit, plotesojnë të gjitha kushtet e parashikuara në nenin 13 dhe 14 të kësaj Rregulloreje. ✓

13- Rregullat e Brendshme të funksionimit, në të cilat bëjnë pjesë:

- Rregulla për organizimin e Regjistrimit në vartësi të llojit të letres me vlerë për të cilën është marrë licenca si Regjistrues;
- Rregulla në lidhje me procedurat e transferimit të pronësive mbi leterën me vlerë për të cilën është marrë licenca si Regjistrues;
- Rregulla në lidhje me dhenien e informacionit dhe ruajtjen e konfidencialitetit;

① Kontrata me emetuesin dhe me agjencitë e pastrimit dhe rregullimit të llogarive (nese ka të tilla):

- Rregulla në lidhje me procedurat dhe masat, në rast të pezullimit ose mbylljes së veprimtarisë me vendimin e organeve drejtuese të Regjistruesit;

② Rregulla në lidhje me procedurat dhe masat, në rast të pezullimit ose mbylljes së veprimtarisë, me Vendim të Komisionit;

14- Dokumenta të tjera shtesë që mund të kërkojnë nga Departamenti përkatës pranë Komisionit të Letrave me Vlerë.

Dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal ose fotokopje e noterizuar e tij.

Perveç Rregullave të parashikuara në pikën 13 të këtij neni, Regjistruesi mund të hartojë rregulla të tjera që mund të gjykohen nga ai si të nevojshme apo të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë. Nese keto Rregulla nuk janë gati në momentin e paraqitjes së praktikës për licencim, ato behen objekt i miratimit nga Komisioni në momentin që do të jete gati.

## Neni 10

### Dorezimi Forme-Kerkeses dhe dokumentacionit shoqerues

Dorezimi i Forme-Kerkeses së plotësuar dhe i dokumentacionit shoqerues, behet pranë Sekretarise së Komisionit.

Deri në plotësimin perfundimtar të dokumentacionit, kerkuesi kontakton me Departamentin e Licencimit, i cili i paraqet rast pas rasti nevojën për plotësim me dokumentacion sipas kësaj rregulloreje, me dokumentacion shtesë të nevojshëm për kushtet specifike të kerkuesit, apo e



udhezon për të bërë korrigjimet e nevojshme në projekt-Rregullat e brendshme të funksionimit si Regjistruar.

Departamenti i Liçencimit, brenda 30 ditëve nga dorëzimi i Forme-Kerkeses dhe dokumentacionit shoqëruar të plotë, merr të gjitha masat që praktika të jetë gati për t'ju paraqitur Komisionit.

## **Neni 11**

### **Shqyrtimi i praktikës nga Komisioni**

Pas plotësimit të praktikës sipas paragrafit të tretë të nenit 10, Komisioni i Letrave me Vlerë merr në shqyrtim praktiken në mbledhjen e tij me të afert.

Komisioni i Letrave me Vlerë, gëzon të drejtën e verifikimit në vend të të dhënave të parashikuara në pikat 7, 9 dhe 10 të nenit 9 të kësaj rregulloreje.

## **Neni 12**

### **Dhënia e përgjigjes mbi vendimin e marrë**

Komisioni i Letrave me Vlerë, merr vendim në lidhje me miratimin ose refuzimin e dhënies së licencës dhe brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit, njofton me shkrim kërkuesin për vendimin e vet.

Komisioni mund të shtyje marrjen e vendimit deri në mbledhjen e tij të mëvoshme, në rast se konstaton se kërkuesi, në vartësi të kushteve të tij specifike, duhet të paraqesë dokumenta shtesë.

Liçenca si regjistruar i letrave me vlerë, leshohet sipas modelit të miratuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë në Aneksin 1 bashkëngjitur.

## **KREU III TE NDRYSHME**

## **Neni 13**

## **Kerkesa dhe Kufizime per Drejtoret e Regjistruesis**

### Drejtoret e shoqerise duhet te plotesojne keto kerkesa:

- te kete arsimin e larte perkates sipas pozicionit te punes se parashikuar;
- te kene eksperience pune te pakten tre-vjeçare, ne perputhje me specialitetin per te cilin eshte diplomuar;
- te kene punuar me pare ne poste drejtuese;
- te jene te pajisur me te pakten 3 referenca pozitive nga punedhenes kaluar.

Nuk mund te punesohet me cilesine e Drejtorit prane nje shoqerise qe cila synon te ushtroje aktivitet si Regjistrues i Letrave me Vlere, ose ushtroje aktivitet si e tille, personi qe:

- eshte denuar per vepra penale kunder pasurise dhe ne sferen ekonomike, te parashikuara nga Kodi Penal;
- i eshte hequr e drejta per te ushtruar detyra shteterore;
- i eshte hequr e drejta per te ushtruar detyra drejtuese;
- eshte shpallur i falimentuar;
- gjykata ka vendosur nxjerrjen jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

## **Neni 14**

### **Detyrimi per te informuar kur ka ndryshime ne dokumentacion**

Personi juridik i licencuar per te vepruar si Regjistrues i letrave me vlere, i paraqet Komisionit informacion te plote ne lidhje me ndryshimet e ndodhura ne te dhenat e paraqitura ne momentin e licencimit.

Ky informacion i paraqitet Komisionit brenda nje muaji nga ndodhja e ndryshimit se bashku me arsyet te cilat çuan ne kete ndryshim.

## **Neni 15**

### **E drejta e Komisionit per t'u informuar dhe per te kerkuar informacion**

Regjistruesi i letrave me vlere i paraqet Komisionit raporte mujore mbi mbarevajtjen e aktivitetit te tij te miratuara nga Drejtori Ekzekutiv i Komisionit.

shoqerise. Ky raport duhet te paraqitet brenda 1 jave nga mbarimi i muajit per te cilin raportohet.\*

Regjistruesi i letrave me vlere i paraqet Komisionit raporte gjashte mujore dhe vjetore mbi mbarevajtjen e aktivitetit te tij te miratuara nga Kehsilli Mbikqyres i Regjistruesit te letrave me vlere. Ky raport duhet te paraqitet brenda 2 muajve nga mbarimi i periudhes per te cilen raportohet.\*

Regjistruesi i Letrave me Vlere, çdo fillim viti i paraqet Komisionit kopje te dokumentit te regjistrimit prane zyres se tatim-taksave.

Komisioni, ne çdo rast mund t'i kerkoje te licencuarit informacion te pergjithshem ose te dhena per çeshtje te veçanta te lidhura me aktivitetin e te licencuarit si Regjistruesi i Letrave me Vlere.

## Neni 16

### Pezullimi dhe Heqja e licences

Komisioni mund te heqe licencen e dhene nje shoqerie sipas kesaj rregulloreje kur:

- 1- Regjistruesi nuk e fillon aktivitetin brenda gjashte muajve qe prej dates se leshimit te licences
- 2- I licencuari ndërpret veprimtarinë për të cilën ka marrë licencë;
- 3- I licencuari eshte bere objekt i procedurave te falimentimit apo likujdimit;
- 4- I licencuari vihet ne kushte te administrimi te kontrolluar;
- 5- Komisioni ka arsye për të besuar se i licencuari, apo ndonjë drejtues ose punonjës i saj, nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre me efektivitet dhe ndershmëri, ne dem te investitoreve;
- 6- I licencuari shkel ndonje nga dispozitat detyruese te parashikuara ne ligj apo ne kete Rregullore;
- 7- I licencuari shkel ndonje kusht apo kufizim te zbatueshem nga momenti i dhenies se licences;
- 8- Me kërkesën e të licencuarit.

Komisioni, nëse e shikon të përshtatshme, mundet që në vend të heqjes së licencës, ta pezullojë atë për një periudhë të caktuar, ose derisa të behet rregullimi perkates.

Shoqeria, të ciles i është hequr apo pezulluar licenca sipas këtij neni, konsiderohet si e palicencuar që nga data që Komisioni i heq licencen, ose per te gjithe periudhen ne te cilen i eshte pezulluar licenca.



REPUBLIKA e SHQIPERISE  
KOMISIONI I LETRAVE ME VLERE

Bul. "Deshmoret 4 Shkurtit", Tirana, Albana  
P.O.Box 8363

Tel. 355 4 251355/56 Fax:+355 4 228260  
email: asc@asc.gov.al

Tirane me, 27.05.2005

**VENDIM**  
NR. 6/4, date 27.05.2005

**"Mbi disa ndryshime ne Rregulloren Nr. 9/1, date 30.10.2001 "Mbi Licencimin e Rregjistruesve te Letrave me vlere".**

**Ne paragrafin e pare te nenit 2, shtohet nje fjali me kete permbajtje:**  
Bankat e nivelit te dyte, te licencuara nga Banka e Shqiperise, mund te ushtrojne aktivitet si regjistruer te letrave me vlere te Qeverise, pasi te jene pajisur me licencen perkatese nga Komisioni.

**Pas nenit 2 shtohet neni 2/a, me kete permbajtje:**  
Ne rastin kur licenca per te ushtuar aktivitet si Regjistruer i Letrave me Vlere, kerkohet nga nje Banke, atehere brenda struktures se bankes ngrihet nje njesi, aktiviteti i te ciles nga ana operationale dhe drejtuese, te jete i ndare ne menyre te dukshme nga aktiviteti kryesor si banke.

**Ne fund te nenit 4, shtohet nje paragraf me kete permbajtje:**  
Ne rastet kur nje Banke, kerkon te pajiset me licence per ushtimin e aktivitetit si Regjistruer i Letrave me Vlere te Qeverise, Drejtor apo Drejtues i Regjistruerit, do te nenkuptoje, individin qe pavaresisht nga emertimi qe mban, ushtron funksione drejtuese me pergjegjesi ne administrimin e aktivitetit te njesie se permendur ne nenin 2/a te Rregullores.

**Ne fund te Nenit 6, shtohet nje paragraf me kete permbajtje:**  
Ne rastet kur ne Statutin e Bankes, nuk eshte parashikuar aktiviteti si Regjistruer i Letrave me Vlere te Qeverise, miratohet shitesa ne Statut, ne nenin qe percakton objektin e aktivitetit te shoqerise. Ky ndryshim, miratohet nga Komisioni i Letrave me Vlere me te njejten procedure qe ndiqet per miratimin e Statutit, te parashikuar ne paragrafin e pare dhe te dyte te ketij neni.

**Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.**

Elisabeta GJONI

Nen/Kryetare 

**KREU IV**  
**DISPOZITA TE FUNDIT**

**Neni 17**

**Kuotat dhe Komisionet**

Ne momentin e paraqitjes se Forme-Kerkeses dhe dokumentacionit shoqerues, kerkuesi per licencim si Regjistrues, paguan nje shume prej 10.000 leke;

Ne momentin e dhenies se licences, Regjistruesi i letrave me vlere paguan nje shume prej 50.000 leke;

Regjistruesi i letrave me vlere paguan nje kuote prej 100.000 leke per cdo vit ushtrimor te aktivitetit. Pagesa e kesaj kuote do te behet brenda muajit qe i eshte licensa dhe ne po kete muaj te cdo viti ne vazhdim.\*

**Neni 18**

**Hyrja ne fuqi**

Kjo rregullore hyn ne fuqi, ne ditën e miratimit te saj nga Komisioni i Letrave me Vlere.

**Kryetari**

**FATOS RECA**

\*Ndryshuar me Vendimin Nr. 9/2 date 08.09.2003 te Komisionit te Letrave me Vlere.

\*\*Ndryshuar me Vendimin Nr.5/4, date 27.05.2005 te Komisionit te Letrave me Vlere.

# Akti i Themelimit i

“American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë” Sh.A.



Unë, i nënshkruari Domenick. G. Scaglione, në cilësinë time si Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Albanian American Enterprise Fund, një fond i krijuar në dhe që funksionon sipas legjislacionit të Shtetit të Delaware, USA, në përputhje me vendimin e këtij Bordi marrë më datë 10 Dhjetor 1997, themeloj shoqërinë “American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë” Sh.A. me antë të nënshkrimit të këtij Akti Themelimi.

## NENI 1

Shoqëria “American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë” Sh.A. (më poshtë ‘Banka’) është shoqëri anonime selia e së cilës është në Tiranë, Shqipëri me adresë: Rr. Vaso Pasha, Pall. 11 Katsh, Kati II, Kutia Postare 8319. Afati i veprimtarisë së Bankës është i pakufizuar

## NENI 2

Objekti i Bankës është kryerja e aktivitetit të shërbimeve bankare dhe financiare në përputhje me Ligjin Nr. 8075, datë 22.02.1996, “Mbi Sistemin Bankar të Republikës së Shqipërisë” në formën aktuale dhe me të gjitha ndryshimet që mund t’i bëhen. Specifikisht, Shoqëria mund të kryejë këto aktivitete: (a) pranimin e depozitave (në formën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes; (b) Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun, me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare; (c) marrje hua të fondeve dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve të instrumenteve të tregut monetar (duke përfshirë ndër të tjera çeqet kambialet dhe çertifikatat e depozitave), të letrave me vlerë të borxhit; të kontratave të së ardhmes dhe kontartat “e mudësive”, që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit; të instrumentave të normës së interesit; (d) kryerjen e shërbimeve të pagesës; (e) emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (duke përfshirë ndër të tjera, pagesat me kartë, me çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankierit); (f) ndërmjetësin për operacione monetare duke përfshirë valutat; (g) lisingun financiar; dhe (h) kryerjen e shërbimeve si agjent financiar, ose këshilltar financiar (jo për shërbime të përshkruara në pikën 3/a dhe 3/b) si dhe të gjitha aktivitetet financiare që do të përcaktohen në licensënpërfundimtare të e Bankës së Shqipërisë.

## NENI 3

Themeluesi i vetëm i Shoqërisë është Albanian American Enterprise Fund, një fond i krijuar sipas legjislacionit të Shtetit Delaware, USA, me seli në 14 East 60<sup>th</sup> Street, Suite 407, New York, N.Y. 10022.

## NENI 4

Kapitali total i Bankës është treqind e pesëdhjetë milion (350,000,000) lek, dhe numri i aksioneve të autorizuara në të cilën do të ndahet ky kapital është tre milionë e pesëqind mijë aksione më një vlerë nominale prej njëqind (100) lek për aksion. I gjithë kapitali aksioner i Shoqërisë i përket plotësisht Aksionerit Themelues që është

Albanian American Enterprise Fund. Kapitali fillestar i paguar i Bankës është tetëdhjetë e shtatë milion e pesëqindmijë (87,500,000) lek, dhe paguhet prej Aksionerit Themelues në para.



#### NENI 5

Këshilli i Drejtuesve i Bankës përbëhet nga këta anëtarë:

- |    |                              |   |
|----|------------------------------|---|
|    | Domenick G. Scaglione:       | lindur më 24 Maj 1993 në Itali;<br>Shtetësia: Amerikane<br>Nr. Pas. : Z72023572   |
| 2. | Thomas Lambert Cranmer:      | lindur më 14 Qershor 1938 në USA;<br>Shtetësia: Amerikane<br>Nr. Pas. : O15401212 |
| 3. | James Henry Duffy:           | lindur më 3 Shkurt 1938 në USA;<br>Shtetësia: Amerikane<br>Nr. Pas. : D1765414    |
| 4. | Michael D. Granoff           | lindur më 3 Korrik 1958 në USA;<br>Shtetësia: Amerikane<br>Nr. Pas. : O54952705   |
| 5. | Charles Lindberg Marinaccio: | lindur më 10 Dhjetor 1933 në USA.<br>Shtetësia: Amerikane<br>Nr. Pas.: O15502997  |

Bordi i Drejtorëve i American Albanian Enterprise Fund emëron Z. Peter Nice Drejtor Ekzekutiv të bankës dhe i delegon atij të gjitha kompetencat për të bërë regjistrimin e Bankës.

#### NENI 6

Veprimtaria e brendëshme e Bankës rregullohet nga Statuti i cili i bashkangjitet këtij Akti Themelimi.

Viti i Parë Fiannciar i Bankës fillon në datën e lëshimit të licensës përfundimtare nga Banka e Shqipërisë dhe mbaron më 31 Dhjetor 1998.

Ky Akt Themelimi është përgatitur në gjuhën shqipe dhe angleze, në tre kopje dhe është nënshkruar prej Domenick G. Scaglione, në cilësinë e kryetarit të Bordit të Drejtorëve të Albanian American Enterprise Fund, në emër dhe për llogari të Albanian American Enterprise Fund.

Për Themeluesit e Shoqërisë

Domenick G. Scaglione

Në cilësinë e Kryetarit të Bordit të Drejtuesve të Albanian American Enterprise Fund

MIRYAN CAMERINI  
Notary Public, State of New York  
No. 31-4763081  
Qualified in New York County  
Commission Expires June 30, 1998

**Nënshkrimi i Noteres**

**Vula e Noteres**

MIRYAM CAMERINI  
NOTER PUBLIK, Shteti New York  
Kryetari i parë do të jetë Domenick G. Scaglione, i cili do të shërbejë në këtë pozitë deri në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve e cila do të thirret jo më vonë se 28 Prill, 1995, kohë në të cilën Bordi i Drejtorëve do të zgjedhë një Kryetar dhe mund të zgjedhë një Nën-Kryetar, sipas këtij Statuti, i cili do të shërbejë deri në fund të Mbledhjes Vjetore të vitit 1998. Me përjashtim të Domenick G. Scaglione, Kryetari do të zgjidhet me këshillën e Presidentit të Shteteve të Bashkuara ose të caktuarit të tij (këtej e tutje të quajtur si "Presidenti i Shteteve të Bashkuara"), këshillë e cila do t'i kërkohet edhe Kryetarit aktual, Nën-Kryetarit (në rast mungese ose paaftësie të Kryetarit) ose Kryetarit të përkohshëm, (në rast mungese ose paaftësie të Kryetarit dhe Nën-Kryetarit) jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para kësaj zgjedhjeje. Kryetari dhe Nën-Kryetari i zgjedhur në këtë mënyrë do të shërbejnë si zyrtarë të Bordit të Drejtorëve deri në fund të mbledhjes së tretë vjetore të Bordit të Drejtorëve pas zgjedhjes së tyre respektive, ose deri në dorëheqjen ose largimin e tyre nga posti, kohë në të cilën Bordi i Drejtorëve do të zgjedhë një Kryetar ose Nën-Kryetar pasardhës, sipas rastit.

3.8. Agjentët, Financierët dhe Avokatët. Bordi i Drejtorëve do të punësojë agjentë, financierë dhe avokatë sipas nevojës për të ndihmuar Bordin e Drejtorëve në përmbushjen e detyrimeve dhe kryerjen e detyrave që u janë besuar atyre.

3.9. Dorëheqja. Një drejtor mund të japë dorëheqje në çdo kohë duke i dhënë Bordit të Drejtorëve një njoftim me shkrim. Përderisa nuk është specifikuar ndryshe në njoftim, dorëheqja do të hyjë në fuqi pas marrjes nga Bordi i Drejtorëve, dhe pranimi i dorëheqjes nuk do të jetë i nevojshëm për ta bërë atë efektive.

3.10. Delegimet Komiteteve. Me rekomandim të Kryetarit, Bordi i Drejtorëve, me rezolutë të miratuar nga shumica e gjithë drejtorëve të Bordit, mund (i) të zgjedhë ose krijojë një komitet të qëndrueshëm ose të veçantë për qëllimet dhe me kompetencat dhe kushtet e përcaktuara në rezolutën përkatëse, (ii) të delegojë kompetenca të tilla tek Kryetari ose të Nën-Kryetari ose tek zyrtarët e Shoqërisë sipas nevojës për kryerjen e punëve të Shoqërisë, dhe (iii) të caktojë numrin e anëtarëve dhe përbërjen e çdo komiteti. Me përjashtim të rasteve të përcaktuara ndryshe me ligj, delegime të tilla do të bëhen për qëllimet, kompetencat dhe kushtet e përcaktuara në rezolutën përkatëse.

3.11. Shpërblimi i Drejtorëve. Në përputhje me Aktin e MDEL, dhe subjekt i Seksionit 501(c)(3) të Kodit, drejtorët do të kenë të drejtë të kompensohen në mënyrë të arësyeshme për shërbimet e tyre dhe të paguhen ose rimbursohen për shpenzimet e bëra në lidhje me këto shërbime. Ky kompensim do të caktohet nga Bordi i Drejtorëve. Bordi i Drejtorëve mund të vendosë të shpërblejë Drejtorët Shqiptarë dhe jo Drejtorët Amerikanë.

3.12. Veprimi me Marrëveshje. Çdo veprim i kërkuar të jetë, ose i cili mund të jetë, marrë nga Bordi i Drejtorëve ose ndonjë komitet tjetër mund të merret jashtë mbledhjes nëqoftëse gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve ose komiteti përkatës, sipas rastit, bien dakort me shkrim, dhe marrëveshja me shkrim i bashkëngjitet protokollit të Bordit të Drejtorëve ose komitetit përkatës, sipas rastit.

3.13. Mbledhje me Telefon ose Pajisje të Ngjashme Komunikimi. Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, ose të ndonjë komiteti, mund të marrin pjesë në çdo mbledhje të Bordit të Drejtorëve ose të ndonjë komiteti, sipas rastit, me mjete nëpërmjet të cilave të gjithë të



pranishmit mund të dëgjojnë dhe flasin me njëri tjetrin, dhe pjesëmarrja në mbledhje të tillë do të kërkojë praninë në mbledhje personalisht të anëtarit. Kërkesat për njoftim të Seksionit 3.4 të këtij dokumenti do të zbatohen për mbledhjet e zhvilluara sipas Seksionit 3.13 me kusht që gjithë drejtorët që marrin pjesë, mund të dëgjojnë njëri tjetrin dhe me gojë të anullojnë njoftimin në fillim të mbledhjes.

## NENI IV.

### ZYRTARET

4.1. Zyrtarët. Zyrtarët e Shoqërisë do të jenë Presidenti dhe Shefi Ekzekutiv; Zëvendës Presidenti, Shefi i Financave, dhe Personi i Thesarit; Zëvendës Presidenti për Programin e Zhvillimit dhe Sekretari; Zëvendës Presidenti për Investimet; Drejtorët e Menaxhimit të Operacioneve Shqiptare; dhe zyrtarë të tjerë që mund të zgjidhen nga Bordi i Drejtorëve. Një person mund të mbajë dy ose më shumë poste.

4.2. Zgjedhja dhe Kohëzgjatja: Kualifikimet. Gjithë zyrtarët do të zgjidhen nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjen vjetore të përkohshme në seksionin 3.2. në këtë dokument dhe do të shërbejnë deri në mbledhjen e ardhshme vjetore të Bordit të Drejtorëve dhe pas kësaj për atë kohë sa pasardhësit e tyre të jenë zgjedhur dhe kualifikuar ose deri në dorëheqjen ose largimin e tyre nga posti. Në rast të një vendi vakant, zgjedhja për një post të tillë mund të bëhet në kohën dhe rrethanat e përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve.

4.3. Presidenti dhe Shefi Ekzekutiv. Presidenti dhe Shefi Ekzekutiv do të jenë shefi ekzekutiv i Shoqërisë. Subjekt i direktivave dhe mbikëqyrjes së Bordit të Drejtorëve, Kryetarit dhe Nën-Kryetarit, ky zyrtar do të ketë kompetencë të menaxhojë, mbikëqyrë dhe kontrollojë aktivitetet dhe programet e Shoqërisë dhe, në emër të Shoqërisë, të ekzekutojë akte, kontrata, kontrata qeraje, dhe instrumente e dokumente të tjera ligjore dhe të kryejë gjithë detyrat e tjera që mund të vendosë Bordi i Drejtorëve.

4.4. Drejtorët Menaxhues të Operacioneve Shqiptare. Drejtorët Menaxhues të Operacioneve Shqiptare do të jenë zyrtarët e lartë të Shoqërisë në Shqipëri, dhe do të kryejnë detyra të tjera që mund të vendosë Bordi i Drejtorëve.

4.5. Zyrtarë të tjerë. Me rezolutë të Bordit të Drejtorëve mund të zgjidhen zyrtarë të tjerë të cilët do të kenë kompetencat dhe detyrat që mund të vendosë Bordi i Drejtorëve.

4.6. Shpërblimi i Zyrtarëve. Në përputhje me Aktin e MDEL, dhe subjekt i Seksionit 501(c)(3) të Kodit, rroga ose një shpërblim i arësyeshem (që përfshin pa kufizime, bonuse ose shpërblime nxites) për shërbimet e gjithë zyrtarëve të Shoqërisë do të përcaktohet me rezolutë nga Bordi i Drejtorëve, dhe asnjë zyrtar nuk do të pengohet për të marrë këtë kompensim nga fakti që ky zyrtar njëkohësisht shërben si drejtor i Shoqërisë.

4.7. Largimi nga Posti. Çdo zyrtar i zgjedhur nga Bordi i Drejtorëve mund të largohet nga posti në çdo kohë, me ose pa shkak të arësytuar, me rezolutë të Bordit të Drejtorëve. Çdo vend vakant i krijuar në ndonjë zyrë të Shoqërisë mund të plotësohet për periudhën e mbetur me rezolutë të Bordit të Drejtorëve në përputhje me Seksionin 4.2. të këtij dokumenti

## NENI V.

### POLITIKA

5.1. Politika e Përgjithshme. Si çështje e politikës, Shoqëria do të bëjë, japë ose nxjerrë, sipas rastit, hua, ndihma, pjesëmarrje në investime me aksione, studime mundshmërie, asistencë teknike, trajnime, sigurime, garanci dhe masa të tjera ("Asistencë") në masën që veprimet të tilla të jenë në përputhje me Aktin e MDEL, Seksionin 501(c)(3) të Kodit dhe qëllimin e Shoqërisë të përcaktuar në Aktin e Themelimit dhe këtë Statut.

5.2. Politika të Tjera. Bordi i Drejtorëve, Kryetari, Nën-Kryetari dhe zyrtarët e Shoqërisë do të udhëhiqen edhe nga politikat e mëposhtëme:

A. Shoqëria do të marrë parasysh konsiderata të tilla si të drejtat e punonjësve të njohura botërisht dhe të drejta të tjera të njeriut të njohura botërisht, faktorët mjedisorë, efektet ekonomike dhe të punësimit në Shtetet e Bashkuara, dhe mundësinë e besueshmërisë tregtare të aktivitetit të marrjes së Asistencës nga Shoqëria.

B. Shoqëria, para se të disbursojë fondet për qëllimin e lejuar, mund t'i mbajnë fondet në llogari me interes, dhe mund të mbajë për qëllime të tilla interesin e fituar nga depozitime të tilla pa ia kthyer këtë interes Thesarit të Shteteve të Bashkuara dhe ta përdorë pa miratim të mëtejshëm nga Kongresi i Shteteve të Bashkuara.

C. Në përputhje me Seksionin 201(i) të Aktit të MDEL, dhe subjekt i Seksionit 501(c)(3) të Kodit, Shoqëria, direkt ose nëpërmjet një Enti Filial (në kuptimin që i është dhënë këtij termi në këtë dokument) mund të kërkojë, marrë, dhe përdorë kapital për çdo qëllim të ligjshëm investimi që Bordi i Drejtorëve mund të përcaktojë gjatë kryerjes së politikave të tij.

D. Shoqëria do të ndërmarrë gjithë përpjekjet e mundshme për të krijuar instrumente financiare që do të lejojnë individët të investojnë në sektorët privatë të Shqipërisë dhe që do të kenë efektin e shumëfishimit të ndikimit të granteve të Shteteve të Bashkuara të dhëna Shoqërisë.

E. Asnjë pjesë e fondeve të Shoqërisë nuk do të shkojë në përfitim të ndonjë drejtori, zyrtari ose nëpunësi të Shoqërisë, me përjashtim që Shoqëria do të jetë e autorizuar dhe kompetente për të paguar rroga ose shpërblime të arësyeshme (që përfshijnë bonuse ose kompensime nxitëse) për shërbimet e kryera dhe rimburojë shpenzimet e kryera në lidhje me kryerjen e këtyre shërbimeve dhe të bëjë pagesa dhe shpërndarje në ndihmë të qëllimeve të përcaktuara në Seksionin 1.3. të këtij dokumenti.

F. Shoqëria duhet të sigurojë (i) që çdo përfitues i Asistencës nga Shoqëria mban (a) llogari të veçanta lidhur me Ndhimën, (b) të dhëna të tilla si mund të nevojitet në mënyrë të arësyeshme të deklarojnë shumën totale dhe përdorimin nga ky përfitues i parave të dhëna për Asistencë, koston totale të projektit ose sipërmarrjes për të cilën jepet ose përdoret Asistenca dhe shumën dhe natyrën e raportit të koston së projektit ose sipërmarrjes të financuar nga burime të tjera, dhe (c) të dhëna të tjera që mund të lehtësojnë një kontroll efikas, dhe (ii) që Shoqëria, ose ndonjë nga përfaqësuesit e saj të autorizuar si duhet, të ketë akses për qëllimin e

kontrollit financiar dhe këqyrjen e librave, dokumenteve, letrave dhe të dhënave të përfituesit që kanë lidhje me Asistencën.

## NENI VI.

### DEMSPERBLIMI

6.1. Dëmshpërblimi Për Pretendimet e të Tretëve. Shoqëria, në masën më të plotë të lejueshme, dhe në mënyrën e kërkuar, nga legjislacioni i Shtetit Delaware i cili është në fuqi në kohën e miratimit të këtij Neni ose nga ndryshimet që mund të ndodhin herë pas here në legjislacion, do të dëmshpërblejë çdo person i cili është ose ishte drejtor ose zyrtar i Shoqërisë, dhe do të ketë kompetencë të dëmshpërblejë çdo person i cili është ose ishte punonjës ose agjent i Shoqërisë, nëqoftëse ky person është ose ishte bërë palë në, ose është kërcënuar të bëhet palë në një çështje, padi ose procedurë të kërcënuar, të paqartë ose të përfunduar (që përfshin çdo ankim për to), si me natyrë civile, penale, administrative ose hetimore (ose një veprimi nga ose në të drejtën e Shoqërisë), për faktin që ky person është ose ishte drejtor, zyrtar, punonjës ose agjent i Shoqërisë, ose, nëqoftëse në kohën kur ai është ose ishte drejtor, zyrtar, punonjës, ose agjent i Shoqërisë, është ose ishte në shërbim me kërkesën e, ose për të përfaqësuar interesat e, Shoqërisë si drejtor, zyrtar, partner, punonjës ose agjent ("Zyrtar i Varur") i një tjetër shoqërie, ortakërie, ndërmarrjeje të përbashkët, trusti, plani për përfitimin e punonjësit ose ndërmarrje tjetër (një "Agjenci Filial"), kundrejt shpenzimeve (përfshi tarifën e shërbimeve juridike dhe disbursimet), kostove, gjykimeve, gjobave dhe shumave të paguara nga ky person për zgjidhjen e asaj çështjeje, padie ose procedure nëqoftëse ky person veproi në mirëbesim dhe në një mënyrë që ky person me arsye besonte të mbronte ose mos kundërshtonte interesat më të mira të Shoqërisë, dhe, në lidhje me një çështje penale ose procedurë, nuk kishte shkak të besonte që veprimi i tij ishte i paligjshëm; me kusht që Shoqëria nuk do të jetë e detyruar të dëmshpërblejë kundrejt ndonjë shume të paguar në mosmarrëveshje përderisa Shoqëria të ketë pranuar këtë mosmarrëveshje, pranimi i cili nuk do të tërhiqet në mënyrë të paarësyeshme.

6.2. Dëmshpërblimi për Pretendime të Rrjedhura. Shoqëria, në masën më të plotë të lejueshme, dhe në mënyrën e kërkuar, nga legjislacioni i Shtetit Delaware i cili është në fuqi në kohën e miratimit të këtij Neni ose nga ndryshimet që mund të ndodhin herë pas here në legjislacion, do të dëmshpërblejë çdo person i cili është ose ishte drejtor ose zyrtar i Shoqërisë, dhe do të ketë kompetencë të dëmshpërblejë çdo person i cili është ose ishte nëpunës ose agjent i Shoqërisë, nëqoftëse ky person është ose ishte bërë palë në, ose është kërcënuar të bëhet palë në një çështje ose padi kërcënimi, të paqartë ose të përfunduar (që përfshin çdo ankim për to) që çon në të drejtën e Shoqërisë për të bërë një gjykim në favor të saj për faktin që ky person është ose ishte drejtor, zyrtar, punonjës ose agjent i Shoqërisë, ose, nëqoftëse në kohën kur ai është ose ishte drejtor, zyrtar, nëpunës ose agjent i Shoqërisë, është ose ishte në shërbim me kërkesën e, ose për të përfaqësuar interesat e, Shoqërisë si një Nëpunës i Varur i një Enti Filial, kundrejt shpenzimeve (duke përfshirë tarifën e shërbimit juridik, dhe disbursimet) dhe kostot normale të kryera nga ky person në lidhje me atë çështje ose padi nëqoftëse ky person veproi në mirëbesim dhe në një mënyrë që ky person ndershmërisht besonte të mos ishte në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, dhe veç kësaj nuk do të dëmshpërblehet në lidhje me ndonjë pretendim, çështje ose problem për të cilat ky person është gjykuar përgjegjës ndaj Shoqërisë përderisa, dhe përveçse në masën që, Gjykata e

Aksioneve të Shtetit Delaware ose gjykata në të cilën ky gjykim ishte bërë do të përcaktojë që, përveç gjykimit të përgjegjësisë por në pikpamje të gjithë rrethanave të rastit, ky person ka të drejtë të dëmshpërblehet për këto shpenzime dhe kosto që Gjykata e Aksioneve të Shtetit Delaware ose një gjykatë tjetër do të gjykojë të përshtatshme.

6.3. Veprime të Filluara nga Pala e Dëmshpërblyer. Pavarësisht nga ndonjë kundërshti në Seksionin 6.1 dhe Seksionin 6.2. të këtij dokumenti, Shoqëria duhet të dëmshpërblejë një person në lidhje me një procedurë të filluar ndaj këtij personi vetëm nëqoftëse një procedurë e tillë ishte autorizuar nga Bordi i Drejtorëve.

6.4. Përcaktimi i të Drejtës për t'u Dëmshpërblyer. Çdo dëmshpërblim sipas Seksionit 6.1 ose Seksionit 6.2 të këtij dokumenti, (përveçse kur urdhërohet nga një gjykatë) do të bëhet nga Shoqëria vetëm si autorizohet në rastin specifik sipas një përcaktimi që dëmshpërblimi është i i saktë sipas rrethanave sepse ky person ka përmbushur kushtet e përcaktuara në Seksionin 6.1. ose 6.2. të këtij dokumenti. Një përcaktim i tillë do të bëhet nga (i) Bordi i Drejtorëve me shumicë votash të një kuorumi të përbërë nga drejtorë të cilët nuk kanë qënë palë në çështjen, padinë, ose procedurën për të cilat kërkohet dëmshpërblimi ose nga një shumicë votash e anëtarëve të një komiteti të Bordit të Drejtorëve të përbërë të paktën prej tre anëtarësh secili nga të cilët nuk është palë në këtë çështje, padi ose procedurë, ose (ii) nëqoftëse një kuorum i tillë nuk mund të arrihet dhe/ose një komitet i tillë nuk është krijuar ose nuk mund të arrihet, ose, edhe nëqoftëse është i arritshëm, nga avokati i pavarur që e jep mendimin me shkrim, nëqoftëse një kuorum i drejtorëve të paineduar urdhëron të bëhet kështu, ose (iii) nga Anëtarët. Në rast se nga personi i përmendur në Seksionin 6.1. ose Seksionin 6.2. të këtij dokumenti bëhet një kërkesë për dëmshpërblim, Shoqëria duhet të vendosë për ta bërë jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pasi është bërë kërkesa.

6.5. Dëmshpërblimi Sipas Mbrojtjes së Suksesshme. Në masën që një drejtor, zyrtar, nëpunës ose agjent i Shoqërisë ka qënë i suksesshëm në lidhje me një çështje, padi ose procedurë të përmendur në Seksionin 6.1. ose Seksionin 6.2. të këtij dokumenti, ose në mbrojtje të ndonjë pretendimi, çështjeje ose problemi, ky person, në rastin e një drejtori ose zyrtari do të dëmshpërblehet dhe, në rastin e një nëpunësi ose agjenti, mund të dëmshpërblehet kundrejt shpenzimeve (përfshirë tarifën e shërbimit juridik dhe disbursimet) dhe kostot e bëra nga ky person në lidhje me çështjen.

6.6. Parapagim i Shpenzimeve. Shpenzimet dhe kostot e kryera nga një person i përmendur në Seksionin 6.1. ose Seksionin 6.2. të këtij dokumenti, në mbrojtje të një çështjeje, padi ose procedure civile, penale, administrative ose hetimore do të paguhet nga Shoqëria para marrjes së vendimit për këtë çështje, padi ose procedurë në bazë të premtimit nga ose në emër të këtij person për të ripaguar këtë shumë nëqoftëse përfundimisht do të përcaktohet që ai person nuk ka të drejtë të dëmshpërblehet nga Shoqëria si autorizohet nga ky Nen.

6.7. Pasardhësit. E drejta e një personi i cili është ose ishte drejtor, zyrtar, nëpunës ose agjent i Shoqërisë për t'u dëmshpërblyer sipas këtij Neni do të vazhdojë edhe pasi ai ka pushuar së qeni drejtor, zyrtar, nëpunës ose agjent dhe do të kalojë në përfitim të trashëgimtarëve, shpërndarësve, ekzekutorëve, administratorëve dhe përfaqësuesve të tjerë ligjorë të atij personi.

6.8. Sigurimi. Shoqëria do të ketë kompetencë për të blerë dhe mbajtur siguracion në emër të një personi i cili është ose ishte drejtor, zyrtar, nëpunës ose agjent i Shoqërisë, ose është ose ishte në shërbim me kërkesë të, ose për të përfaqësuar interesat e, Shoqërisë si një Zyrtar i Varur i një Agjencie Filial, kundrejt një përgjegjësie të ngarkuar këtij personi dhe të ndodhur ndaj këtij personi në një nga këto pozita, ose të rrjedhura nga statusi i këtij personi si të tillë, pavarësisht nëse Shoqëria do të ketë kompetencë të dëmshpërblejë një person të tillë kundrejt kësaj përgjegjësie sipas dispozitave të këtij Neni ose legjislacionit në fuqi.

6.9. Dëmshpërblimi jo Ekskluziv. Subjekt i dispozitave të Aktit të MDEL, dispozitat e këtij Neni nuk do të kufizojnë ose shtrëngojnë në ndonjë mënyrë kompetencat e Shoqërisë për të dëmshpërblyer ose parapaguar shpenzimet ose kostot e një personi të tillë që në ndonjë mënyrë tjetër lejohet me ligj ose gjykohet ekskluzive për, ose çvleftëson, çdo të drejtë të cilën një person që kërkon dëmshpërblim ose parapagim të shpenzimeve dhe kostove mund ta gëzojë sipas ligjit, ndonjë marrëveshjeje, vote të Anëtarëve ose ndryshe, si në çështjen e këtij personi në cilësinë e zyrtarit, drejtorit, nëpunësit ose agjentit të Shoqërisë ashtu edhe në çështje në çdo cilësi tjetër ndërsa mbajnë një pozitë të tillë.

6.10. Përcaktimet e Disa Termave. (a) Për qëllime të këtij Neni, termi "Shoqëri" përfshin, përveç shoqërisë në fjalë, çdo shoqëri vazhduese (që përfshin çdo përbërës të një përbërësi) të thithur në një konsolidim ose bashkim i cili, nëqoftëse ekzistenca e shoqërisë do të vazhdonte, do të ishte lejuar sipas legjislacionit në fuqi të dëmshpërblente drejtorët, zyrtarët, nëpunësit dhe agjentët e saj, në rast se një person i cili është ose ishte drejtor, zyrtar, nëpunës ose agjent i kësaj shoqërie të përbërë, ose është ose ishte në shërbim me kërkesën, ose përfaqësonte interesat e, kësaj shoqërie të përbërë si drejtor, zyrtar, nëpunës, ose agjent i një Agjencie Filial do të vazhdojë në të njëjtën pozitë sipas dispozitave të këtij Neni në lidhje me zhvillimin ose mbijetesën e korporatës ashtu si ky person do të kishte në lidhje me këtë shoqëri të përbërë sikur ekzistenca e saj si e vetme të kishte vazhduar.

(b) Për qëllime të këtij Neni, termi "gjoba" përfshin çdo taksë aktiviteti të llogaritur për një person në lidhje me një plan të përfitimit të punonjësit; termi "shërbim me kërkesën e Shoqërisë" përfshin çdo shërbim si drejtor, zyrtar, nëpunës, administrator ose agjent i Shoqërisë i cili ngarkon detyra mbi, ose përfshin shërbime nga ky drejtor, zyrtar, administrator, nëpunës ose agjent në lidhje me një plan të përfitimit të punonjësit, pjesëmarrësve ose përfituesve të tij; dhe një person i cili vepronte në mirëbesim dhe në mënyrë që ky person besonte që ishte në interes të pjesëmarrësve dhe përfituesve të një plani të përfitimit të punonjësit do të gjykohet të ketë vepruar në një mënyrë "që nuk kundërshton interesat më të mira të Shoqërisë" si përmendet në këtë Nen.

## NENI VII.

### RAPORTET DHE KONTROLLET FINANCIARE

7.1 Raportet. Në përputhje me Aktin e MDEL, jo më vonë se data 31 Janar e çdo viti, duke filluar nga 1996, Shoqëria do të publikojë një raport vjetor për vitin e mëparshëm fiskal. Ky raport do të përfshijë një deklaratë të gjithanëshme dhe të detajuar të transaksioneve, aktiviteteve, kushteve financiare dhe arritjeve të Shoqërisë për vitin e mëparshëm fiskal.

7.2. Kontrollet Financiare. Llogaritë e Shoqërisë do të kontrollohen çdo vit, në përputhje me standartet e kontabilitetit të pranuar përgjithësisht, nga ekspertë kontabël të pavarur ose ekspertë të pavarur publikë të licencuar nga një autoritet regullator i një shteti ose një nënndarjeje politike tjetër e Shteteve të Bashkuara. Raporti i secilit nga këta ekspertë të pavarur do të përfshihet në raportin vjetor të kërkuar sipas Seksionit 7.1.

## NENI VIII.

### DISPOZITA TE PERGJITHSHME

8.1. Uniformiteti i Periudhës së Qëndrimit në Post: Hyrja në Fuqi e Zgjedhjes. Periudha e qëndrimit në post të gjithë drejtorëve dhe zyrtarëve do të fillojë ose mbarojë, sipas rregullit, me mbajtjen e mbledhjes vjetore të Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, sipas rastit, të mbajtur në vitin fiskal në të cilin këto periudha janë planifikuar të fillojnë ose përfundojnë, me përjashtim të rastit që çdo drejtor ose zyrtar vazhdon të shërbejë pas kësaj mbledhjeje vjetore deri sa pasardhësi i tij të zgjidhet dhe kualifikohet. Periudha e qëndrimit në post të një drejtori ose zyrtari të zgjedhur në fillim të periudhës së rregullt për atë drejtor ose zyrtar do të llogaritet sikur ky drejtor ose zyrtar të ishte zgjedhur në ditën në të cilën kjo periudhë ishte planifikuar të fillonte. Zgjedhja e një drejtori ose zyrtari do të jetë e mjaftueshme për të përcaktuar këtë person si drejtor ose zyrtar dhe nuk kërkohet të ketë pranim të postit.

8.2. Konfliktet e Interesave. (a) Subjekt i kërkesave të Aktit të MDEL, dhe Seksionit 501(c)(3) të Kodit, kur një drejtor ose zyrtar i Shoqërisë, ose bashkëshorti, fëmija, e një drejtori ose zyrtari, është drejtor, ose zyrtar i, ose ka një interes financiar në, ndonjë shoqëri, ortakëri, shoqatë, ose organizatë tjetër me të cilën Shoqëria ka lidhur, ose ka ndërmend të lidhje, kontratë, të japë grante, ose të kryejë ndonjë transaksion tjetër, ky drejtor ose zyrtar do të publikojë me shkrim në Bordin e Drejtorëve gjithë faktet e rëndësishme lidhur me raportet ose interesat e tij ose raportet ose interesat e bashkëshortit ose fëmijës së tij, sipas rastit. Ky drejtor ose zyrtar do të përjashtohet nga çdo pjesëmarrje e Shoqërisë në lidhje me këtë kontratë, grant, ose transaksion tjetër; me kusht që ky drejtor mund të llogaritet në përcaktimin e një kuorumi në një mbledhje të Bordit të Drejtorëve në të cilën kjo kontratë, grant, ose transaksion tjetër do të autorizohet, miratohet ose ratifikohet ose do të jetë objekt diskutimi.

(b) Asnjë drejtor ose zyrtar nuk do të përdorë, për avantazhe financiare ose të një lloji tjetër, informacionin konfidencial të cilin ai ose ajo e kanë mësuar për shkak të pozitës së tij në Shoqëri. Veç kësaj, asnjë zyrtar ose individ tjetër i cili është i punësuar nga Shoqëria nuk do të përdorë, për avantazhe financiare ose të tjera, një informacion në pronësi të Shoqërisë (pavarësisht është ose jo konfidencial).

8.3. Vula e Shoqërisë. Vula e Shoqërisë do të jetë në formën e përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve.

8.4. Zyrat e Regjistruara dhe Kryesore. Në përputhje me Legjislacionin e Përgjithshëm të Shoqërisë, zyra e regjistruar e Shoqërisë do të jetë në Shtetin Delaware. Zyra kryesore e Shoqërisë do të jetë në New York, New York.

8.5. Viti Fiskal. Viti fiskal i Shoqërisë do të fillojë në 1 Tetor dhe do të mbarojë në 30 Shtator.

8.6. Rregullat procedurale. Procedurat sipas Rregullave Robert do të zgjidhin gjithë çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut.

8.7. Kontrolli mbi Statutin. Kompetenca për të ndryshuar ose shfuqizuar këtë Statut dhe për të miratuar një Statut të ri do të ushtrohet me votë të shumicës së gjithë Drejtorëve Amerikanë që Shoqëria do të kishte sikur të mos kishte vende vakante.



Permblyese  
Johanna Velaship  
Kulaga

**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE, TIRANE  
NR. 1089 REP.**

**VERTETIM**

Në Tiranë, sot më datën 9.4.1998, para meje noteres Elida Take, në rrugën Zhan D'ark Tiranë, përkthyesja Mbaresa Veleshnja, e njohur personalisht prej meje nënshkroi dokumentin e mësipërm të përkthyer nga anglishtja në shqip të njëjtë me origjinalin, dhe unë noterja e vërtetoj atë konform ligjit.

**NOTERE**

**ELIDA TAKE**



**REPUBLIC OF ALBANIA  
CHAMBER OF PUBLIC NOTARY, TIRANA  
NO. 1089. REP**

**CERTIFICATION**

In Tirana, today date, 9.4.1998, in my presence, public notary Elida Take, Zhan D'Ark street, Tirana, the translator Mbaresa Veleshnja, recognized personally by me, undersigned the above document translated from english into albanian the same as the original, and I, public notary, certify that conform the law.

**PUBLIC NOTARY**

**ELIDA TAKE**

**PULLE TAKSE**





Zikëtimet  
të drejtuesit  
16/04/2007

Tirane me 16/04/2007

**KERKESE**

KERKUES : Markel Gjon Zviska

OBJEKTI : Terheqje kopje te legalizuar te praktikës se depozituar prane Regjistrin Tregtar te shoqerise tregtar

BAZA LIGJORE : Neni 14/2 I ligjit Nr.7632 dt.04.11.1992; Neni 28 I ligjit Nr.7667 dt.28.12.1993.

**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE  
Zyres se Regjistrin Tregtar  
TIRANE**

Une kerkuesi jam : Aksioner   
Administrator   
Perfaqesues

I shoqerise tregtare American Bank of Albania sh.eg regjistruar me vendimin Nr. 19460 date 19/05/1998 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.  
Per arsyë se :

Praktika  ( kopje në shqip i statutit të Fondit Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve  
Vendimi  depozituar në nomenclurë e regjistruar  
Ekstrat tjetër  si person juridik të Bankës Amerikane të Shqipërisë sh.eg )

I shoqerise nuk disponohet nga ana jone pasi kanim në dispozicion vetem kopjet në anglisht.  
ju lutemi te na vihet ne dispozicion nje kopje e legalizuar e saj.

Bashkangjitur po ju le :

Fotokopje te pasaportes   
Fotokopje te procures   
Autorizim

JU FALEMINDERIT PER MIREKUPTIMIN  
NENSHKRUAN

Markel Gjon Zviska  
Zur. Drejtor : Departamenti i Tregtisë  
Bankës Amerikane të Shqipërisë sh.eg



- 19466 -

# AGJENCIA PER ZHVILLIMIN NDERKOMBETAR

Dominick G. Scaglione  
Drejtor i Bordit te Drejtoreve  
Fondi Shqiptaro Amerikan per Ndermarjet  
14 East 60 Street  
Nju Jork, Nju Jork 10022

Grant Nr. EPE-0010-G-00-5086-00




I dashur Z. Skalione

Duke ju referuar autoritetit qe na jep Akti per Mbeshtetjen e Demokracive ne Europen Lindore te vitit 1989, Agjencia per Zhvillimin Nderkombetar (me poshte e referuar si USAID) i jep nje grant me shumen e \$7,100,000 (Shtate Milion e Njeqind Mije Dollare Amerikane) Fondit Shqiptaro Amerikan per Ndermarjet (te referuar me poshte si Fondi) qe perben kapitalin fillestar me te cilin Fondi do te mundi te permbushi misionin e tij, te shpjeguar me me hollesi ne Aktin e lartpermendur dhe ne Marreveshjen e Grantit.

Pagesa do te kryhet nepermjet nje Letre Krediti nga USAID. Marresi i Grantit do te kerkoje fonde duke dorezuar Formen Standarte 5805, "Kerkese per Fonde", si dhe te informacioneve te kerkuara ne Seksionin C te Kerkesave te Pergjithshme 4 te kesaj Marreveshjeje, te zyres se USAID per Manaxhimin Financiar, Manaxhimin e Parave dhe Divizionin e Pagesave (FM/CMP/LC), Uashington, D.C. 20523. Fondet mund te kerkohen sipas nevojave, per shpenzime te menjehershme, por nuk do te levrohen perderisa Fondi te kete bere disbursimin e plote te sasise se meparshme te parave te akorduara (Shiko proceduren mbi Letren e re te kredise).

Ky Grant hyn ne fuqi ne daten qe mban kjo leter. Marresi i Grantit pranon te vendosi se ku do te perdoren, i gjithë Fondi i dhene ne perputhje me objektivat e programit brenda tre vjeteve nga data e kesaj marreveshjeje, dhe te disbursojë kete fond brenda kater vitesh nga data e kesaj marreveshjeje, duke perjashtuar ketu ndonje marreveshje te dyanshme te Fondit me USAID-in. Shpenzimet per programin, te kryera perpara dates 28 Shkurt 1995, por perpara firmosjes se marreveshjes, jane te autorizuar te rimbursohen nga Granti, por duke argumentuar se keto shpenzime jane shpenzime te ligjshme dhe ne perputhje me qellimin e fondit is dhe te jane te dokumentuara me fatura. Edhe ne rast se te gjitha fondet e dhuruara nga dhuruesi jane shpenzuar, kjo marreveshje do te mbetet ne fuqi deri sa likuidimi i dhuruesit eshte plotesuar ne perputhje me Parashikimet e Pergjithshme 16, te kesaj Marreveshjeje.

Ky Grant, perfaqeson pagesen e pare te Grantit te planifikuar te \$30,000,000 (Tridhjetë milione Dollaresh Amerikane) nga USAID te Dhuruesi. Eshte e kuptueshme qe detyrimet financiare te USAID, ne kete marreveshje Granti, jane te kufizuara ne \$7,100,000 (Shtate milione e njeqind mije Dollare Amerikane). Pagesat e metejshme do



te jene subjekt i fondeve te disponueshme te USAID per qellimet e tij, dhe marreveshja e heshtur e USAID me dhuruesin do te procedohet ne kohen e nje pagese te metejshme. Ky Grant eshte pergatitut nen kushtet qe fondet do te administrohen ne perputhje me termat dhe kushtet e pershkruara ne kete leter, "Perskrim i Programit", (Pasqyra 1) dhe te "Parashikimeve te Pergjithshme" (Pasqyra 2), te cilat te marra se bashku kushtezojne marreveshjen midis paleve (referuar ne Pasqyrat 1 dhe 2 si "Marreveshje", "Marreveshje Granti", ose "Grant").

Ju lutemi firmosni originalin dhe dy kopje te kesaj letre per te bere te mundur faturen e Fondit dhe Marreveshjen sipas termave dhe kushteve te kesaj Marreveshje dhe ktheji te gjitha pervec nje kopjeje te firmosur.

Sinqerisht

Sharon Zavestovski  
Oficer i Grantit  
ENI / EPE  
Zyra e Prokurimit

Bashkengjitur

1. Perskrim i programit
2. Parashikime te pergjithshme

## Te dhena Fiskale

Numri Projektit	180-0010.82
PIO/T Numer	180-0010.82-3-5622211
Kodi i Planit Buxhetor	WAIX-95-32182-KG15
Simboli Shperndarjes	184-62-182-00-69-51
Percaktimi	72X1010
Numri Kontrollit te Fondit	TW441
Shuma e detyruar	\$3,300,000

Numri Projektit	180-0010.82
PIO/T Numer	180-0010.82-3-5622211
Kodi i Planit Buxhetor	WAIX-95-32182-KG15
Simboli Shperndarjes	184-62-182-00-69-51
Percaktimi	72X1010
Numri Kontrollit te Fondit	TW441
Shuma e detyruar	\$3,800,000

Shuma e detyruar deri me tani	\$7,100,000
Shuma e Kostos (Jo-federale)	\$0
Kontribute te tjera (Federale)	\$0
Numri Letres se Kreditit	TBD
CEC Numer	TBD
Zyra e Projekteve te USAID	ENI/ED/EF
Zyra paguese	Agjencia per Zhvillimin Nderkombetar e SHBA M/FM/CMP/CGLC Uashington, DC 20523-0209

Perskrim i Programit  
Fondi Shqiptaro Amerikan per Ndermarjet

**A. Qellimi**

Qellimi i Fondit Shqiptaro Amerikan per Ndermarjet (Fondi) eshte te inkurajoje krijimin dhe zgjerimin e ndermarjeve te vogla e te mesme ne Shqiperi. Ky qellim do te arrihet nepermjet transaksioneve te cilat do te ndihmojne ne fillimin dhe zgjerimin e nje sere ndermarjesh private, te promovojte dhe zbatoje nje sere metodash dhe praktikash perendimore biznesi dhe ti demonstroje investitoreve te tjere te mundshem se ne sektorin privat shqiptar mund te punohet me fitim.

Eshte paramenduar se aktiviteti i Fondit do te ndihmoje ne identifikimin dhe promovimin e reformave politike te nevojshme per inkurajimin dhe zhvillimin e investimeve private.

**B. Koncepti i Fondit te Ndermarjeve**

Fondi Shqiptaro Amrikan i Ndermarjeve eshte hapur ne perputhje me autoritetin e dhene nga Akti i 1989 per Mbeshtetjen e Demokracive ne Europen Lindore, per promovimin e sektorit privat ne vendet e permendura ne akt, nepermjet huave, granteve, investimeve me pjesemarrje ne kapital, plan bizneseve, garantive dhe masave te tjera.

Fondi do te regjistrohet ne Sh.B.A. si nje organizate jo-per-fitim, nuk do te kete aksionere dhe nuk do te shpermdaje dividente. Te ardhurat e gjeneruara nga Fondi do te perdoren per te mbuluar shpenzimet e Fondit dhe per re-investime ne projekte te reja ne Shqiperi. Fondi do te drejtohet nga Bordi i Drejtoreve ("Bordi"), shumica e te cileve do te jene biznesmene Amerikane dhe eksperte shqiptare. Bordi mund te perbehet gjithashtu, nga qytetare shqiptare te mirenjohur dhe eksperte. Fondi ne te njejten kohe inkurajohet te perfshije qytetare shqiptare ne nivelet manaxheriale.

Filozofia operuese e Fondit do te jete me karakter biznesi ne te gjitha investimet e tij, por gjithnje duke ju permbajtur objektive zhvilluese qe permenden ne Seksionin G te kesaj Pasqyre 1. Bordi i Drejtoreve dhe manaxheret egzekutive do te kene fleksibilitet maksimal ne menytrat me te cilat Fondi do te strukturohet si dhe ne vendimet strategjike dhe operuese.

Fondi do te kryeje aktivitetin e tij investues ne Shqiperi duke u mbeshtetur ne gjykime biznesi. Fondi mund to hapi zyre ne Sh.B.A. po ne te njejten kohe pritet qe Fondi te krijojte lehtesira per te kryer aktivitetin e tij ne Shqiperi. Struktura e sakte si dhe kerkesat per marrjen ne pune te stafit do te percaktohen nga Bordi Drejtoreve dhe manaxheret egzekutive.

**C. Disbursimet dhe Dokumentat qe duhet te paraqiten prane USAID**

Sic pershkruhet tek "Parashikime te Pergjithshme" te kesaj marreveshjeje Granti, disbursimet nen grantin duhet te behen nepermjet Letre Krediti nga USAID. Marresi i Grantit mund te kerkoje fonde per te perballuar kostot administrative ne minimume te

mundshme te nevojshme per ti dhene mundesi marresit te Grantit te kryeje ne kohe pagesat si dhe per shpenzime te fillimit te aktivitetit.



Perpara se te kerkoje fonde per investime, huara ose asistence teknike ne perputhje me qellimin e aktivitetit, marresi i Grantit duhet te paraqesi dokumentet e meposhtme per aprovim tek USAID:

1. Pasqyre te politikave dhe procedurave te korporates
2. Politeken e kompensimit te personelit
3. Politikat mbi mbrojtjen e ambientit dhe procedurat si dhe
4. Nje analize te detajuar te objektivave te Fondit, te adoptuara nga Bordi i Drejtoreve, e cila permban percaktimet e grupit te bizneseve te vogla e te mesme ku Fondi do te perqendrohet, si dhe treguesit qe do te perdoren per te matur progresin perkundrejt objektivave te referuara ne Seksionin G me poshte

Pasi te jete marre aprovimi i USAID it per dokumentet e lartpermendura, Fondi mund te kerkoje fonde per investime, huara, ose asistence teknike ne perputhje me qellimet e aktivitetit te tij.

#### **D. Pershkrim i aktiviteve te Fondit Shqiptaro Amerikan per Ndermarjet**

Ky seksion zakonisht pershkruan tipin e aktiviteve ne te cilat Fondi mund te integrohet. Seksioni E tregon politikat e investimit te cilat Fondi do te ndjeki. Seksioni F i referohet kerkesave operacionale te cilat Fondi do te ndjeki.

##### **1. Transaksionet**

Aktiviteti primar i Fondit do te jete hyrja ne nje sere transaksionesh ne sektorin privat ne Shqiperi, ne perputhje me politikat e tija investuese dhe objektivat. Natyra e sakte e ketyre transaksioneve do te percaktohet nga Bordi i Drejtoreve dhe nga manxheret egzekutive te Fondit. Eshte parashikuar qe Fondi te investoje me pjesemarrje ne kapital dhe me hua, si dhe te synoje zhvillimin e sektorit financiar si dhe instrumentave te pershtatshme me kushtet egzistuese te sektorit ekonomik e financiar ne Shqiperi. Manaxheret e Fondit do te zhvillojne politika te sakta, aty ku te jete e mundur, per te dale nga investimet me pjesemarrje ne kapital.

##### **2. Asistenca teknike**

Fondi do te ofroje asistence teknike te drejt per drejte per te suportuar investimet direkte te Fondit dhe investimet e mundshme. Kosto e asistences teknike do te kontabilizohet e shkeputur nga shpenzimet e tjera te Fondit.

##### **3. Politika e Reformave**

Fondi do te perpiqet te jete ne nje pozicion te tille, nepermjet programve te investimeve dhe huave, qe te veri theksin mbi politika te percaktuara dhe procedura midis Shqiperise dhe Shteteve te Bashkuara te Amerikes (ne mungese te ketyre politikave te percaktuara

dhe procedurash) ku te nenvizohen dhe theksohen praktika te suksesshme biznesi. Ky proces mund te formalizohet nepermjet mbledhjesh periodike midis Fondit, USAID, Departamentit te shtetit, dhe qeverise pritese.

## E. Politika Investuese

Fondi do te ndjeki politikat investuese te percaktuara ne kete seksion. Aplikimi i politikave individuale do te bazohet mbi gjykimet e Bordit te Drejtoreve te Fondit si dhe te manaxhereve egzekutive. (Sic u perdor ketu, dhe me poshte, termi "investime" nenkupton investimet me pjesemarrje ne kapital, huate dhe forma te tjera impenjimi financiar, pervec rasteve ku konteksti le te nenkuptosh dicka tjeter.)

### 1. Grupi qe do te fokusohet

Fondi do te fokusojte programin e tij te investimeve ne ndermarjet e vogla dhe te mesme ne Shqiperi.

### 2. Pjesemarrja e Shqiptareve

Ne kushtet qe rrethanat do te lejojne, Fondi do te perpiqet te inkurajoje pjesemarrjen e sektorit privat shqiptar ne ndermarjet ku fondi investon.

### 3. Efekti i Demonstrimit

Transaksionet individuale do te kene nje efekt te vogel kontrollues neqoftese ato nuk kane nje efekt te madh demonstrues ose efekte sistemimi (psh. Ndhimesa e nje banke private ne krijimin e nje programi per zgjidhjen e problemit te strehimit ne Shqiperi). Keshtu qe procesin e zbatimit te programit te tij, Fondi do te studioje mundesite per te bere investime dhe te ofrojte asistencë per to duke synuar mbeshtetjen e reformave ekonomike dhe te procesit te tranzicionit drejt ekonomise se tregut.

### 4. Diversifikimi

- a. Sectoret. Fondi do te synoje te investoje ne nje sere sektoresh ne menyre qe te rrisi efektin e investimeve dhe te minimizojte risqet e investimeve.
- b. Rreziket. Fondi do te perpunojte nje portofol i cili do te perbehet nga investime me risqe te ndryshme, duke permbajtur investime "risk i larte, fitim i larte" si dhe me investime pak te rrezikshme qe do te sherbejne per te gjeneruar para ne menyre qe te mos cenohet situata financiare.

### 5. Pozita ne minoritet

Ne objektivat afatgjate, ne pergjithesi Fondi do te synoje te mbaje pozita ne minoritet tek firmat ku ai investon. Sidoqofte, Fondi mund te zoteroje shumicen e aksioneve te nje biznesi, neqoftese Fondi mendon se eshte me mire te veprojte keshtu. (Per shembull, ne raste te vecanta mund te jete me mire per Fondin te zoteroje shumicen e aksioneve te nje



firmë nëq një zoterim i tillë ndihmon në egzekutimin në sukses të transaksionit ose në mbrojtje të interesave të Fondit.

## 6. Investime me Kapital të perbashket

Që të zhvillimin e transaksioneve me kapital të perbashket, Fondi do të kushtojë vëmendje të vacante investimeve me kapital të perbashket me partnere nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

### F. Kerkesat operacionale

Kerkesat operacionale të percaktuara në këte seksion janë të detyrueshme për Fondin

#### 1. Ndryshim në strukture

Fondi nuk do të krijojë, investojë ose financojë projekte ose filiale të cilat kanë pothuaj të njëjtit drejtore, menaxhere ose punonjës si të Fondit, pa aprovim paraprak nga USAID.

#### 2. Investimet dhe subjektet që ofrojnë shërbime financiare.

Fondi mund të krijojë, investojë ose financojë filiale, ose subjekte të tjera, qëllimi primar i veprimve të të cilave është akordimi i huave dhe financimeve si dhe ofrimi i shërbimeve financiare, duke marrë me parë leje nga USAID. Aprovimi i USAID do të jepet vetëm mbasi të jete studiuar politika dhe procedurat e këtyre subjekteve dhe të jete vënë re se këto politika dhe procedura janë në përputhje me kerkesat e kesaj Marrëveshjeje. Aprovimi paraprak i USAID nuk do të kërkohej në ato raste kur Fondi do të financojë programi financimi për biznese të vogla nëpërmjet institucioneve egzistuese financiare.

#### 3. Ceshtje për tu patur parasysh

Duke bërë investime dhe duke zbatuar detyrat e projektit, Fondi duhet të këte kujdes në respektimin e ceshtjeve të tilla si respektimi i të drejtave të punonjësve, të të drejtave të njeriut, faktoret ekologjike (në përputhje me politikën ekologjike të Fondit), efektet ekonomike dhe të punësimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zhvillimet e mundshme ekonomike dhe rrjedhojat e politikave serioze ekonomike duke ofruar dhe asistencë nga ana e Fondit.

#### 4. Transaksionet e privatizimit

Fondi mund të investojë në ndermarje me kapital shtetëror por duke pasur parasysh që investimi të kryhet në një subjekt ku persona private zoterojnë me shumë se 50% të aksioneve (duke përfshirë në këte përqindje dhe Fondin), ose po kryhet si vazhdim i një transaksioni që do të sjelli zoterimin e me shumë se 50% të aksioneve nga persona e subjekte private.

## 5. Masa e Investimit

Jo me shume se \$3,000,000 (Tre milione Dollare Amerikane) nga shuma e dhene nga USAID per suportimin e programit te Fondit mund te investohet ose jepet hua per nje subjekt ose grup subjektesh, pa aprovim paraprak te USAID.

## 6. Seksioni 547

Fondi nuk do te beje ndonje investim ose kryeje ndonje veprim ne mosperputhje me kriteret e permendura ne Seksionin 547 te Operacioneve te Huaja, Financimin e Eksporteve te Aktit 1994 (ose me akte te ngjashme te legjislacionit te meparshem) ("Seksioni 547"), sic pershkruhen ne Parashikimet e Pergjithshme 9, te kesaj Marreveshjeje Granti.

## 7. Ndermarjet e mbrojtjes

Fondi nuk mund te marri pjese ne ndermarje ushtarake pa aprovim paraprak nga USAID, sic parashikohet ne Parashikime te Pergjithshme 10, te kesaj "Marreveshjeje Granti".

## 8. Asistence teknike

Fondi mund te ofroje ose financoje asistence teknikene ato aktivitete te cilat drejt per drejte ndihmojne investimet egzistuese ose te planifikuara te Fondit, pa qene nevoja per aprovim paraprak nga USAID. Fondi nuk do te implikohet ne ne aktivitete te tjera asistence teknike, pa patur me pare nmiratimin paraprak te USAID. USAID do te japi direktivat, menytrat dhe keshilloje formen e kesaj asistence teknike.

## 9. Politka e kompensimeve

Ne formulimin e politikes se tij te kompensimit, Fondi do te kete parasysh qe rroga e asnjerrit prej punonjesve te fondit ose e punonjesve te subjekteve ku fondi zoteron shumicen e aksioneve, te kaloje shumen e \$150,000 ne vit. Ky kufizim nuk aplikohet ne rastet kur Fondi vihet ne zoterim te nje subjekti, i cili perpara investimit te Fondit i paguante punonjesit kryesore mbi \$150,000 ne vit. Kompensimit ose pjesemarrjet ne fitim qe kalojne shumen e \$150,000 ne vit, do te jepen nga fitimet e mbartura ose te krijuara te kompanise dhe jo nga fondi i akorduar nga USAID.

Parashikime te tjera lidhurme kete ceshtje jepen tek Parashikime te Pergjithshme ne kete Marreveshjeje Granti.

## G. Cfare pritet nga fondi

Perderisa manaxheret e Fondit do te marrin vendimet perfundimtare mbi programin e Fondit, eshte pothuaj e pamundur ne kete kohe, te percaktohen masa sasiore specifike per te matur suksesin e Fondit. Eshte e kuptueshme se jo cdo projekt ose investimi i Fondit

do te jete i sukseshem. Duke u bazuar ne kriterin e permendur me lart, sidoqofte, suksemi i Fondit do te karakterizohet nga kontributi ne:

- Krijimin e sukseshem, fuqizimin e nje sere ndermarjesh e firmash te vogla e te medha ne nje sere sektoresh ekonomik ne tere Shqiperine.
- Hapja e mundesive te reja punesimi ne sektorin privat ne Shqiperi.
- Investime nga kompani te tjera private ne ato ndermarje qe fondi inicion.
- Permbushjen e nje sere transaksionesh qe do te cojne ne zhvillimin dhe fuqizimin e tregjeve financiare ne Shqiperi.
- Ne vazhdimesi te politikesh se fondit, zhvillimi i aktiviteteve ne investime te metejshme ne Shqiperi.

Duke pasur parasysh keto objektiva te pergjithshme, Fondi do te hartoje objektivat specifike dhe ne hartimin e menyrave te vleresimit, ne konsulence me USAID. Keto menyra do te percaktohen e aprovohen ne raportet gjashte mujore te Fondit.

## PARASHIKIME TE PERGJITHSHME

1. KOSTOT E LEJUARA

- A. Marresi i Grantit duhet te perdori fonde nen kete Grant, vetem per programin dhe projektet te cilat jane ne perputhje me Aktin e Mbeshtetjes se Demokracive en Europen Lindore, akt ky qe sic u tha, eshte i detyrueshem per Fondet e Ndermarrjeve.
- B. Fondet e akorduara mund te perdoren per te suportuar kosto te arsyeshme dhe te lejueshme ne perputhje me termat e kesaj marreveshjeje dhe te Procedurave dhe Politikave te Korporatave, sic eshte pranuar bashkerisht ne Marreveshjen e USAID me marresin e Grantit. Ndryshime te mevonshme mund ti behen politikave dhe procedurave te Grantit dhe dokumentave te tjere te bashkengjitur me te.
- C. Marresi i Grantit do te beje maksimum e tij per te parandaluar dhe kontribuar nepermjet fondeve te Grantit dhe fitimeve nga programi per: (1) partite komuniste ose ndonje grupimi tjeter politik i cili pengon dhe nuk respekton proceset demokratike; ose (2) per forcat e mbrojtjes dhe sigurimit te ndonje vendi.

## 2. Kontabiliteti, revizionimi dhe mbajtja e te dhenave.

- A. Mbajtja e te dhenave. Marresi i Grantit duhet te mbaje libra, te dhena, dokumente dhe evidenca te tjera ne perputhje me parimet e pergjithshme te pranuar te kontabilitetit ne menyre qe te mund te percaktoje sakte bilancet e Grantit, bilancet ne libra dhe kontrollin e librave me bilancet. Sistemi i manaxhimit financiar i marresit te Grantit duhet te kryeje veprime te vecanta kontabel per cdo asistence teknike, ne menyre qe te behet e mundur identifikimi i sakte i burimeve dhe perdorimi i fondeve ne kete asistence teknike. Te gjitha raportet periodike financiar dhe (nqs jane pergatitur) raportet e revizionimit per te gjitha subjektet ku Fondi ka investuar ose ku Fondi ka akorduar hua, duhet te ruhen per kontroll nga revizoret dhe per monitorizimin e projekteve.
- B. Hyrja tek te dhenat. Marresi i Grantit duhet te ruaje dhe ti beje te mundur revizoreve te USAID dhe Kontrolloreve te Pergjithshme te Sh.B.A., ose personave te autorizuar, te gjitha te dhenat, derisa Fondi eshte likuiduar plotesisht dhe aktivet e tij jane shperndare, dhe per nje kohe me te gjate perderisa revizioni te jete i plote dhe te gjitha ceshtjet qe kane te bejne shpenzimet e Fondeve. Qeveria e Shteteve te Bashkuara te Amerikes ndjek parimet e pergjithshme te pranuar te kontabilitetit dhe parimet e pergjithshme te standarteve qeveritare te revizionimit ne percaktimin e fakteve nese per fondet e akorduara jane respektuar parime te shendosha kontabiliteti si dhe perdorimin e ketyre fondeve.
- C. Revizioni Marresit i grantit do te kete raporte vjetore revizioni te kryera ne perputhje me parimet e pergjithshme te pranuar te revizionit qeveritar deri ne momentin kur Fondi te likuidohet dhe akitvet e tij te shperndahen. Revizioni do te kryhet nga revizore te njohur publikisht te pavarur ose nga kontabiliste te pavarur te njohur e te licensuar ne Shtetet e Bashkuara. Raportet perfundimtare do ti paraqiten Inspektorit

te Pergjithshem te USAID, ne menyre qe te analizohet cilesia dhe problemet e analizuara ne raport.

D. Nenperfituesit e asistences teknike. Per efekt te ketij seksioni me "Nenperfituesit e asistences teknike" kuptohen Shtetet e Bashkuara, vendi prites, ose subjekte qe perfitojne nga granti, asistenca teknike, trajnimet ose biznes planet e punuara nga marresi i Grantit. Ky seksion nuk aplikohet per ato subjekte te cilat perfitojne nga Fondi vetem ne formen e huave ose investimeve.

Marresi i Grantit duhet te kerkoje qe:

1. Cdo perfitues i asistences teknike te ofruar nga Fondi te mbaje: llogari kontabel te vecanta ne lidhje me kete asistence, llogari ku te jepen sa me saktesisht qe te jete e mundur te dhena te tilla si kosto e plote e projektit ose planit per te cilin asistenca teknike eshte dhene ose perdorur: natyren dhe shumen e koston se projektit si dhe burime te tjera nqs egzistojne; dhe te dhena te tjera te cilat do te lehtesojne kontrollin e revizoreve.

dhe

2. Cdo perfitues i asistences teknike nga Granti duhet te lejoje Fondin, ose ndonje perfaqesues te tij, dhe ku te jete e kerkuar dhe Inspektorin e Pergjithshem, te kete akses per qellime revizioni tek librat, dokumentet, letrat dhe te dhena te tjera ne lidhje me asistencen e ofruar nga marresi i Grantit.

E. Marresi i Investimeve: Marresi i Grantit do te vendosi kerkesa revizionimi per cdo subjekt qe perfiton hua ose investime. Te gjitha marresit e investimeve do te kerkohen te pergatisin raporte periodike financiare, dhe aty ku te jete e nevojshme (nga sasia e investimit) Fondi mund te kerkoje revizione vjetore nga persona te pavarur.

F. Ne shtese te kerkesave te mesiperme, marresi i Grantit pranon te respektojte plotesisht te gjitha nenet e Aktit, dhe shtimet ne to, ne lidhje me kerkesat per revizionim, revizore private dhe menytrat e mbajtjes se llogarive.


### 3. VLERESIMI

Palet rane dakort qe te pakten dy menyra vleresimi do te aplikohen, njera gjate procesit te implementimit te Grantit dhe tjetra pas plotesimit te Grantit. Palet do te bihen dakort mbi kohet specifike qe do te nevojiten per kete vleresim, cka do te permbaje: (a) vleresim te progresit te arritur sipas objektiveve te Grantit, (b) identifikimi dhe vleresimi i problemeve te ndeshura pergjate ketij procesi; (c) vleresim te faktoreve dhe te ketij informacioni per te kaluar keto probleme; (d) vleresim i pergjithshem i impakteve te Grantit.

### 4. PAGESA – LETER KREDIE

A. Pagesat nen kete Grant do te behen nepermjet Letre Krediti nga USAID ne perputhje me termat dhe kushtet e Letrave te Kreditit dhe te instruksioneve te

leshuara nga Zyra e Manaxhimit Financiar te USAID, Manaxhimit te Parave dhe Zyres se Pagesave ("FA/FM/CMP")

- 
- B. Per sa kohe qe Letra e Krediti eshte ne fuqi, termat dhe kushtet e L/C si dhe cdo instruksion i leshuar nga FA/FM/CMP perbejne kushte pagesa sipas ketij Granti, duke qene primar mbi cdo mjet tjeter pagese.
TENTH: The names and mailing addresses of the initial U.S. Directors are set forth in Article Eighteenth hereof. Not later than thirty (30) days prior to the expiration of the terms of the U.S. Directors, and as soon as practicable after the occurrence of any vacancy in the office of a U.S. Director, the Chairman shall request the advice of the President of the United States or his designee (hereinafter referred to as the "President of the United States") with respect to the election of U.S. Directors to serve new terms or an unexpired term in the case of a vacancy. Upon receiving such advice, the Chairman shall forthwith give notice of a meeting of the Members for the purpose of electing successor U.S. Directors, filling any vacancy and for any other appropriate purpose.

ELEVENTH: As soon as practicable after the date hereof, the Members shall elect the initial Albanian Directors after receiving the advice and consultation referred to in this is Article Eleventh. Not later than thirty (30) days prior to the expiration of the terms of the Albanian Directors, and as soon as practicable after the occurrence of any vacancy in the office of an Albanian Director, the Chairman shall request the advice of the President of the

United States with respect to the election of Albanian Directors to serve new terms or an unexpired term in the case of a vacancy. In accordance with the SEED Act, any citizen of the country of Albania who is not committed to respect for democracy and a free market economy shall not serve as a director of the Corporation. Upon receiving such advice, the Chairman shall forthwith give notice of a meeting of the Members for the purpose of electing successor Albanian directors filling any vacancy and for any other appropriate purpose.

**TWELFTH:** Any U.S. Director or Albanian Director may be removed at any time, with or without cause, by a vote of a majority of the Members.

**THIRTEENTH:** Any vacancy on the Board of Directors shall be filled in accordance with the procedures set forth in Article Tenth hereof or Article Eleventh hereof, as the case may be.

**FOURTEENTH:** The provisions for regulation of the internal affairs of the Corporation, except as provided in this Certificate of Incorporation, shall be determined and fixed by the By-laws of the Corporation or as specified by the Board of Directors in accordance with the By-laws.

**FIFTEENTH:** No director shall be personally liable to the Corporation or any Member for monetary damages for breach of fiduciary duty as director except for any matter in respect of which such director (a) shall be liable under Section 174 of the General Corporation Law of the State of Delaware, or any amendment or successor thereto, or (b) shall be liable by reason that, in addition to any and all other requirements for such liability, such director (i) shall have breached the duty of loyalty to the Corporation or its Members, (ii) shall not have acted in good faith or, in failing to act, shall not have acted in good faith, (iii) shall have acted in a manner involving intentional misconduct or a knowing violation of law or, in failing to act, shall have acted in a manner involving intentional misconduct or a knowing violation of law or (iv) shall have derived an improper personal benefit from any transaction. Neither the amendment nor repeal of this Article Fifteenth, nor the adoption of any provision of this Certificate of Incorporation inconsistent with this Article Fifteenth, shall eliminate or reduce the effect of this Article Fifteenth in respect of any matter occurring, or any cause of action, suit or claim that, but for this Article Fifteenth, would accrue or arise, prior to such amendment, repeal or adoption of an inconsistent provision.

**SIXTEENTH:** No part of the net earnings or funds of the Corporation shall inure to the benefit of, or be distributable to, any member of the Board of Directors, Member, officer, employee or other private persons, except that the Corporation shall be authorized and empowered to pay salary or reasonable compensation (including bonus or incentive compensation) for services rendered and to make payments and distributions in furtherance of the purposes set forth in Article Fourth hereof. No substantial part of the activities of the Corporation shall be the carrying on of propaganda, or otherwise attempting to influence legislation, and the Corporation shall not participate in or intervene in (including the publishing or distributing of statements) any political campaign on behalf of or in opposition to any candidate for public office. Notwithstanding any other provision of this Certificate of

Incorporation, the Corporation shall not carry on any activities not permitted to be carried on (i) by a corporation exempt from federal income tax under Section 501(c)(3) of the Code or (ii) by a corporation, contributions to which are deductible under Section 170(c)(2) of the Code.

SEVENTEENTH: Any liquidation, dissolution or winding up of the Corporation and distribution of its assets shall occur no earlier than ten (10) years and no later than fifteen (15) years from the date of the incorporation of the Corporation, unless otherwise mutually agreed in writing between the Members of the Corporation and the President of the United States or his designee after consultation with the Congress. The procedure for any liquidation, dissolution or winding up of the Corporation shall be as follows: (i) after consultation with the Members of the Corporation, the President of the United States or his designee shall notify the Corporation of the scheduled date of termination of the Corporation ("Termination Date") at least twelve months prior to the Termination Date ("Notification"); (ii) after receiving Notification, the Corporation may continue to make only those commitments or investments that were in the process of being considered on the date of Notification, but the Corporation shall not transfer assets of the Corporation to any of its subsidiaries or other persons or entities for the purpose of excluding such assets from any liquidation, dissolution or winding up of the Corporation; (iii) by or before the Termination Date, the Corporation shall commence the winding up of its affairs and sale of its assets on an orderly basis and shall present to the President of the United States or his designee, for his internal review and approval, a termination plan of how, and a target date of when, the orderly sale of the Corporation's assets should be completed ("Termination Plan"); provided, however, that the timeframe of the Termination Plan may be extended by the President of the United States or his designee for portfolio or developmental considerations; (iv) the President of the United States or his designee may either approve the Termination Plan, with or without modifications, or may impose a different Termination Plan; and (v) after the Termination Date, the Corporation shall not make any commitments or investments whatsoever without the prior written consent of the President of the United States or his designee. Assets of the Corporation that are derived from implementation of the Termination Plan or otherwise may be distributed as they become available or after the sale of all of the Corporation's assets, and, in any event, as determined solely by the President of the United States or his designee (although the Corporation may make recommendations) either to (a) a non-profit entity or entities that assist Albania, (b) the United States Government, or (c) some combination of (a) and (b). Notwithstanding the foregoing, the President of the United States or his designee reserves the right to establish the Termination Date at any time for cause or for foreign policy reasons by delivery of written notice to the Corporation, using the language in AID's Grant Agreement as guidance.

EIGHTEENTH: The names and mailing addresses of the initial U.S. Directors who shall serve as directors until their successors are elected and qualified or until their earlier resignation or removal, are:




<u>Name</u>	<u>Address</u>
Domenick G. Scaglione	Chairman and Chief Executive Officer Intercontinental Associates, Inc. 14 East 60th Street New York, NY 10022
Thomas Lambert Cranmer	Vice Chairman US Business Council for South-Eastern Europe 3225 Gallows Road Fairfax, VA 22037
James H. Duffy	116 East 68th Street New York, NY 10021
Michael D. Granoff	President Pomona Capital 605 Third Avenue - 28th Floor New York, NY 10158
Calvin B. Grigsby	President and Chief Executive Officer Grigsby Brandford & Co., Inc. 101 California Street, Suite 2000 San Francisco, CA 94111
Herta Lande Seidman	Chairman Tradenet Corporation 520 Madison Avenue - 38th Floor New York, NY 10022
Rodney B. Wagner	Vice Chairman J.P. Morgan & Co., Inc. 60 Wall Street New York, NY 10260



NINETEENTH: The name and mailing address of the sole incorporator of the Corporation is Domenick G. Scaglione, c/o Intercontinental Associates Inc., 14 East 60th Street, New York, N.Y. 10022.

IN WITNESS WHEREOF, the undersigned has duly executed this Certificate of Incorporation on this 24<sup>th</sup> day of March, 1995.



  
Domenick G. Scaglione  
Sole Incorporator

27 Mars 1995

Zoti Frank Caiazzo  
Cadwalarder Wickersham & Taft  
100 Maiden Lane  
New York, New York 10038

**RE: FONDI SHQIPTARO AMERIKAN I NDERMARRJEVE**

I dashur Zoti Caiazzo:

Sipas udhëzimeve të marra, Akti i Themelimit për këtë shoqëri u dorëzua në zyrën e Sekretarit të Shtetit Delaware në 24 Mars 1995, në orën 4:15 Pasdite, dhe një kopje e vërtetuar e saj u dërgua nga Sekretari i Shtetit në Regjistrin e Dokumenteve në New Castle, Wilmington, Delaware.

Ne kemi mbajtur një kopje të vërtetuar të Aktit të Themelimit për shoqërinë e sipërpërmendur.

Sinqerisht i juaji

Mary Ann Brzoska  
Specialisti

**MAB: nr.**

**Enc.**



*Shteti Delaware*

***Zyra e Sekretarit të Shtetit***

1. EDWARD J. FREEL, SEKRETAR SHTETI I SHTETIT DELAWARE,  
VERTETON KETU SE KOPJA BASHKENGJITUR ESHTË NJË KOPJË E VERTETË  
DHE KORREKTË E AKTIT TE THEMELIMIT TE "FONDIT SHQIPTARO AMERIKAN  
TE NDERMARRJEVE", E DOREZUAR NE KETE ZYRE NE 24 MARS, 1995, NE OREN  
4:15 PASDITE

NJE KOPJE E VERTETUAR E KETIJ AKTI ESHTË DERGUAR NE REGJISTRIN  
E DOKUMENTEVE TE KONTESE NEW CASTLE PER REGJISTRIM.



## AKTI I THEMELIMIT TE FONDIT SHQIPTARO AMERIKAN TE NDERMARRJEVE

FONDI SHQIPTARO AMERIKAN I NDERMARRJEVE, një shoqëri e organizuar dhe që funksionon sipas legjislacionit të Shtetit Delaware, përcaktohet si vijon:

**SE PARI:** Emri i shoqërisë është FONDI SHQIPTARO AMERIKAN I NDERMARRJEVE (“Shoqëria”).


**SE DYTI:** Shoqëria do të ketë kohëzgjatje të pakufizuar.

**SE TRETË:** Adresa e zyrës së regjistruar të Shoqërisë në Shtetin Delaware është 1209 Orange Street, në Qytetin Wilmington, Kontea New Castle. Emri i agjentit të regjistruar të Shoqërisë në këtë adresë është “The Corporation Trust Company”.

**SE KATERTI:** Subjekt i kufizimeve të përcaktuara më poshtë, qëllimi i Shoqërisë është të angazhohet në veprime ose aktivitete të ligjshme për të cilat organizohet një shoqëri sipas legjislacionit të Shtetit Delaware. Qëllimet e veçanta për të cilat Shoqëria është krijuar do të jenë (i) të nxitë zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri, kryesisht në biznesin e vogël dhe të mesëm privat, ndërmarrjet e përbashkëta me pjesëmarrës nga Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria, dhe politikat e praktikave që ndihmojnë zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri, nëpërmjet huave, granteve, pjesëmarrjes me aksione në investime, studimetve të mundshme, asistencës teknike, trajnimit, sigurimit, garancive dhe masave të tjera, dhe (ii) të përmbushë gjithë qëllimet dhe politikat e tjera të Aktit të Mbështetjes së Demokracisë në Europën Lindore të vitit 1989, që do të quhet më poshtë (Akti i MDEL). Pavarësisht nga sa më sipër, Shoqëria nuk do të angazhohet në aktivitete të cilat nuk lejohen të kryhen sipas Aktit të MDEL, ose nga një shoqëri e përjashtuar nga tatimi federal i fitimit sipas Seksionit 501 (c)(3) i Kodit të të Ardhurave të Brendshme të 1986 me gjithë ndryshimet, ose dispozitave koresponduese të legjislacionit shtesë federal të tatimeve (Kodi).

**SE PESTI:** Shoqëria do të jetë një shoqëri me anëtarësim, ajo nuk është organizuar për qëllime fitimi dhe nuk do të ketë kompetencë të emetojë aksione. Anëtarët e Shoqërisë (individualisht “Anëtar” dhe kolektivisht “Anëtarët”) do të jenë Drejtorët Amerikanë (sipas kuptimit që i jepet këtij termi në Nenin e Tetë të këtij dokumenti) që do të mblidhen herë pas here. Nëqoftëse në çdo kohë dhe për çdo lloj arsyeje ndonjë Anëtar do të pushojë së qeni Drejtor Amerikan, ky person do të pushojë njëkohësisht së qeni një Anëtar.

**SE GJASHTI:** Biznesi, prona dhe çështjet e Shoqërisë do të menaxhohen nga ose nën drejtimin e Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë, me kusht që autoriteti dhe kompetencat specifike që vijojnë, të cilat sipas ligjeve në fuqi do t’i përkisnin Bordit të Drejtorëve, nuk do të ushtrohen ose nuk do t’i përkasin Bordit të Drejtorëve por u jepen, do të ushtrohen nga, dhe u përkasin atyre personave të cilët në momentin e dhënë do të jenë Drejtorë Amerikanë: (i) përshtatja, ndryshimi ose shfuqizimi i Statutit të Shoqërisë; (ii) ndryshimi i këtij Akti të Themelimit; dhe (iii) rekomandimi i Anëtarëve për shpërndarjen e Shoqërisë dhe shitjen e aktiveve në përputhje me Aktin e Themelimit, Aktin MELD dhe Kodin. Për qëllime të ushtrimit të ndonjëres nga kompetencat dhe autoritetin e mësipërm, do të kërkohet vota e



shumicës së Drejtorëve Amerikanë që Shoqëria do të kishte në rastin kur asnjë vend nuk është vakant.

**SE SHTATI:** Kërkesat që duhen përmbushur, zgjedhja, numri, koha e zgjatjes së mandatit, kompetencat dhe detyrat e drejtorëve do të jenë si përcaktohen në këtë Akt Themelimi. Përdorimi i frazës “i gjithë Bordi i Drejtorëve” këtu nënkupton numrin e plotë të drejtorëve që Shoqëria do të kishte në raste kur asnjë vend nuk është vakant.

**SE TETI:** Bordi i Drejtorëve të Shoqërisë do të përbëhet nga qytetarë të Shteteve të Bashkuara të zgjedhur sipas Aktit të MDEL dhe Nenit të Dhjetë të këtij dokumenti (Drejtorët Amerikanë) dhe qytetarë të Shqipërisë të zgjedhur sipas Aktit të MDEL dhe Nenit të Njëmbëdhjetë të këtij dokumenti (Drejtorët Shqiptarë). Në përputhje me Aktin e MDEL, gjithë drejtorët duhet të kenë përvojë dhe të jenë profesionistë në ato fusha të zhvillimit të sektorit privat në të cilat Shoqëria do të angazhohet. Numri i përgjithshëm i Drejtorëve Amerikanë dhe i Drejtorëve Shqiptarë që përbëjnë gjithë Bordin e Drejtorëve duhet të jetë një numër tek jo më i vogël se tre (3) dhe jo më i madh se pesëmbëdhjetë (15), si mund të përcaktohet nga votimi i drejtorëve që përbëjnë shumicën e gjithë Bordit të Drejtorëve. Numri i drejtorëve do të ndahet duke pasur të paktën një drejtor më pak të zgjedhur sipas Nenit të Njëmbëdhjetë të këtij dokumenti në krahasim me drejtorët e zgjedhur sipas Nenit të Dhjetë të këtij dokumenti.

**SE NENTI:** Drejtorët do të qëndrojnë në atë post për tre vjet dhe pas kësaj periudhe për aq kohë sa të zgjidhen dhe kualifikohen pasardhësit e tyre ose derisa paraardhësit e tyre të japin dorëheqjen ose të jenë hequr nga posti. Çdo drejtor i zgjedhur për të zëvendësuar një vend bosh në Bordin e Drejtorëve do të shërbejë për aq kohë sa të zgjasë periudha e papërfunduar e postit të drejtorit. Zgjedhja e drejtorëve nuk do të jetë me votë të shkruar.

**SE DHJETI:** Emrat dhe adresat e Drejtorëve të parë Amerikanë janë dhënë në Nenin e Tetëmbëdhjetë të këtij dokumenti. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para datës së përfundimit të mandatit të Drejtorëve Amerikanë, dhe sa më shpejt të jetë e mundur pas largimit të ndonjë nga Drejtorët Amerikanë, Kryetari do të kërkojë këshillën e Presidentit të Shteteve të Bashkuara ose të përcaktuarit të tij (të quajtur në këtë dokument si “Presidenti i Shteteve të Bashkuara”) në lidhje me zgjedhjen e Drejtorëve Amerikanë, për të zgjedhur Drejtorë të rinj ose për të zëvendësuar ndonjë Drejtor të larguar. Sipas këshillës së marrë, Kryetari menjëherë do të njoftojë thirrjen e mbledhjes së Anëtarëve me qëllim për të zgjedhur Drejtorët pasardhës, duke plotësuar gjithë vendet vakante dhe për çdo arësye tjetër.

**SE NJEMBEDHJETI:** Sa më shpejt që të jetë e mundur pas kësaj date, Anëtarët do të zgjedhin Drejtorët e parë Shqiptarë pas marrjes së këshillave dhe konsultimeve të përmendura në Nenin e Njëmbëdhjetë. Jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Drejtorëve Shqiptarë, dhe sa më shpejt të jetë e mundur pas largimit të ndonjë Drejtorit Shqiptar, Kryetari do të kërkojë këshillën e Presidentit të Shteteve të Bashkuara në lidhje me zgjedhjen e Drejtorëve Shqiptarë për të zgjedhur Drejtorë të rinj ose për të zëvendësuar ndonjë Drejtor të larguar. Në përputhje me Aktin e MDEL, çdo qytetar i Shqipërisë i cili nuk është angazhuar për të respektuar demokracinë dhe ekonominë e tregut të lirë nuk mund të jetë drejtor i Shoqërisë. Pas marrjes së kësaj këshille, Kryetari do të thërrasë menjëherë mbledhjen e Anëtarëve për të zgjedhur drejtorët e rinj shqiptarë për të plotësuar çdo vend

vakant dhe për çdo arësye tjetër.

**SE DYMBEDHJETI:** Çdo Drejtor Amerikan ose Drejtor Shqiptar mund të largohet në çdo kohë, me ose pa shkak të arësytuar, me votën e shumicës së Anëtarëve.

**SE TREMBEDHJETI:** Çdo vend vakant në Bordin e Drejtorëve do të plotësohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në Nenin e Dhjetë ose të Njëmbëdhjetë të këtij dokumenti, sipas rastit.

**SE KATERMBEDHJETI:** Dispozitat për rregullimin e çështjeve të brendshme të Shoqërisë, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në këtë Akt Themelimi, do të përcaktohen dhe fiksohen nga Statuti i Shoqërisë ose si specifikohet nga Bordi i Drejtorëve në përputhje me Statutin.

**SE PESEMBEDHJETI:** Asnjë drejtor, ose Anëtar nuk do të jetë personalisht përgjegjës për Shoqërinë për dëme monetare për shkak të shkeljes të detyrës si drejtor me përjashtim të çështjeve për të cilat ky drejtor (a) do të jetë përgjegjës sipas seksionit 174 të Ligjit të Përgjithshëm të Korporatës të Shtetit Delaware, ose ndonjë amendamenti ose pasoje të tij, ose (b) do të jetë përgjegjës për arësye që, përveç ndonjë ose gjithë kërkesave të tjera për këtë përgjegjësi, ky drejtor (i) ka shkelur detyrën e besnikërisë kundrejt Shoqërisë ose Anëtarëve të saj; (ii) nuk ka vepruar në mirëbesim ose, në rast të moskryerjes së veprimit, nuk ka vepruar në mirëbesim; (iii) ka keqdrejtuar me qëllim ose ka shkelur ligjin me dashje ose, në rast të moskryerjes së veprimit, ka keqdrejtuar me qëllim ose ka shkelur ligjin me dashje ose (iv) ka përfutur personalisht pa të drejtë nga ndonjë transaksion. As ndryshimi as shfuqizimi i këtij Neni të Pesëmbëdhjetë, as ndryshimi i ndonjë dispozite të këtij Akti Themelimi të papajtueshme me Nenin e Pesëmbëdhjetë, nuk mund të eliminojë ose të pakësojë efektin e këtij Neni të Pesëmbëdhjetë në lidhje me probleme të ndodhura, ose ndonjë çështje, padi ose ankim që do të konstatohej ose lindte, para ndryshimit, shfuqizimit ose miratimit të një dispozite të tillë të papajtueshme.

**SE GJASHEMBEDHJETI:** Asnjë pjesë e fitimeve neto ose fondeve të Shoqërisë nuk do të shkojë në interes të, ose nuk do të i shpërndahet ndonjë anëtar të Bordit të Drejtorëve, Anëtar, zyrtari, nëpunësi ose personi tjetër privat, me përjashtim që Shoqëria është autorizuar dhe ka të drejtë të paguajë rroga ose kompensime të arësyeshme (duke përfshirë bonuse, ose kompensime nxitëse) për shërbime të kryera dhe për të bërë pagesa dhe shpërndarje në përkrahje të qëllimeve të përcaktuara në Nenin e Katërt të këtij dokumenti. Asnjë pjesë e rëndësishme e aktiviteteve të Shoqërisë nuk do të zhvillojë propagandë, ose do të përpiqet të influencojë legjislacionin, dhe Shoqëria nuk do të marrë pjesë ose nuk do të ndërhyjë në (përfshi botimin ose shpërndarjen e deklaratave) fushata politike në emër të ose kundër ndonjë kandidati për poste të larta publike. Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e këtij Akti Themelimi, Shoqëria nuk do të kryejë aktivitete që nuk lejohen të kryhen (i) nga një shoqëri e përjashtuar nga tatimi federal mbi fitimin sipas Seksionit 501 (c)(3) e Kodit ose (ii) nga një shoqëri, kontributet e së cilës janë të zbritshme sipas Seksionit 170(c)(2) të Kodit.

**SE SHTATEMBEDHJETI:** Çdo likuidim, shpërndarje ose mbyllje e Shoqërisë dhe shpërndarje e pasurive të saj do të ndodhë jo më herët se dhjetë (10) vjetë dhe jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) vjetë nga data e themelimit të Shoqërisë, përderisa, reciprokisht, nuk është

re në dakort ndryshe me shkrim ndërmjet Anëtarëve të Shoqërisë dhe Presidentit të Shteteve të Bashkuara ose të caktuarit të tij pas konsultimit me Kongresin. Procedura për likuidim, shpërndarje ose mbyllje të Shoqërisë do të jetë si vijon: (i) pas konsultimit me Anëtarët e Shoqërisë, Presidenti i Shteteve të Bashkuara ose i caktuari i tij do të njoftojnë Shoqërinë për datën e planifikuar për mbylljen e Shoqërisë ("Data e Mbylljes") të paktën dymbëdhjetë muaj para Datës së Mbylljes ("Njoftimi"); (ii) pas marrjes së Njoftimit, Shoqëria mund të vazhdojë të përmbushë vetëm ato angazhime ose investime që kanë qënë në procesin e shqyrtimit në datën e Njoftimit, por Shoqëria nuk do të transferojë aktivet e Shoqërisë tek ndonjë nga kompanitë e varura prej saj, ose persona fizikë dhe juridikë me qëllim që aktive të tilla të përjashtohen nga likuidimi, shpërndarja ose mbyllja e Shoqërisë; (iii) deri ose para Datës së Mbylljes, Shoqëria do të fillojë mbylljen e punëve dhe shitjen e aktiveve të saj sistematikisht dhe do të paraqesë për shqyrtim dhe miratim tek Presidenti i Shteteve të Bashkuara ose i caktuari i tij planin për mbylljen dhe datën kur shitja sistematike e aktiveve të Shoqërisë do të përfundojë ("Plani i Mbylljes"); me kusht që koha e planifikuar për Planin e Mbylljes të mund të shtyhet nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara ose i caktuari i tij për çështje të portofolit ose zhvillimit; (iv) Presidenti i Shteteve të Bashkuara ose i caktuari i tij mund ose të miratojnë Planin e Mbylljes me ose pa ndryshime, ose mund të përcaktojnë një Plan të ri Mbylljes; dhe (v) pas Datës së Mbylljes, Shoqëria nuk do të ndërmarrë asnjë angazhim ose investim çfarëdoqoftë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Presidentit të Shteteve të Bashkuara ose të caktuarit të tij. Aktivet e Shoqërisë që rrjedhin nga zbatimi i Planit të Mbylljes, kur bëhen të disponueshme ose pas shitjes së investimeve të Shoqërisë, dhe, në çdo rast, si përcaktohet vetëm nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara ose i caktuari i tij (megjithse Shoqëria mund të bëjë rekomandime) mund t'u shpërndahen ose (a) ndonjë agjencie jofitimprurëse ose agjencie që ndihmojnë Shqipërinë, (b) Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, ose (c) kombinimit të të dyjave, (a) dhe (b) Pavarësisht nga sa më sipër, Presidenti i Shteteve të Bashkuara ose i caktuari i tij rezervon të drejtën për të caktuar Datën e Mbylljes në çdo kohë për arsye të politikës së jashtme duke dërguar një njoftim me shkrim në Shoqëri, duke përdorur terminologjinë e Marrëveshjes së Grantit të AID.

SE TETEMBEDHJETI: Emrat dhe adresat e Drejtorëve të parë Amerikanë të cilët do të shërbejnë si drejtorë derisa të zgjidhen dhe kualifikohen pasardhësit e tyre ose deri në dorëheqjen ose largimin e tyre nga posti, janë:

<u>Emri</u>	<u>Adresa</u>
Domenick G. Scaglione	Kryetar dhe Drejtor Ekzekutiv International Associates, Inc. 14 East 60 <sup>th</sup> Street New York, NY 10022
Thomas Lamber Cranmer	Zëvendës Kryetar US Business Council for South-Eastern Europe 3225 Gallows Road Fairfax, VA 22037

James H. Duffy



116 East 68<sup>th</sup> Street  
New York, NY 10021

Michael D. Granoff

President  
Pomona Capital  
605 Third Avenue - 28<sup>th</sup> Floor  
New York, NY 10158

Calvin B. Grigsby

Kryetar dhe Drejtor Ekzekutiv  
Grigsby Brandford & Co., Inc.  
101 California Street, Suite 2000  
San Francisco, CA 94111

Herta Lande Seidman

Kryetare  
Tradenet Corporation  
520 Madison Avenue - 38<sup>th</sup> Floor  
New York, NY 10022

Rodney B. Vagner

Zëvendës Kryetar  
J.P Morgan & Co., Inc.  
60 Wall Street  
New York, NY 10260

SE NENTEMBEDHJETI: Emri dhe adresa e të vetmit themelues të Shoqërisë është  
Domenick G. Scaglione, c/o Intercontinental Associates Inc., 14 East 60<sup>th</sup> Street. New York,  
N.Y. 10022

KU DESHMOHET që, i nënshkruari ka nënshkruar këtë Akt Themelimi në 24 Mars  
1995 konform rregullave.

Domenick G. Scaglione

Themeluesi i vetëm

*Peratijese*

*Muarese Valeshnye*  
*[Signature]*



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE, TIRANE  
NR. 1089 REP.**




**VERTETIM**

Në Tiranë, sot më datën 9.4.1998, para meje noteres Elida Take, në rrugën Zhan D'ark Tiranë, përkthyesja Mbaresa Veleshnja, e njohur personalisht prej meje nënshkroi dokumentin e mësipërm të përkthyer nga anglishtja në shqip të njëjtë me origjinalin, dhe unë noterja e vërtetoj atë konform ligjit.

**NOTERE**

**ELIDA TAKE**




**REPUBLIC OF ALBANIA  
CHAMBER OF PUBLIC NOTARY, TIRANA  
NO. 1089. REP**

**CERTIFICATION**

In Tirana, today date, 9.4.1998, in my presence, public notary Elida Take, Zhan D'Ark street, Tirana, the translator Mbaresa Veleshnja, recognized personally by me, undersigned the above document translated from english into albanian the same as the original, and I, public notary, certify that conform the law.

**PUBLIC NOTARY**

**ELIDA TAKE**



**PULLE TAKSE**



19460/14

Y. M. Doga  
11.12.2003  
11 DHJETOR 2003

**KËRKESË**

**GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË-TIRANË  
SEKSIONIT TREGTAR**



**KËRKUESI:** "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A. e përfaqësuar me autorizim nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Lorenzo Roncari, prej Av. Erinda Ballanca, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, me 29.10.1973, mbajtëse e pasaportës nr. 0368205

**OBJEKTI:** Depozitimi në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A., datë 16.09.2003.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Dispozitat që Rregullojnë Pjesën e Parë të Kodit Tregtar", Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1998 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhet Respektuar nga Shoqëritë Tregtare".

"American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A. është regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare me Vendimin Nr. 19460 të Gjykatës së Parë-Tiranë datë 19.05.1998, dhe ushtron aktivitetet nëpërmjet licensës Nr. 11, datë 10.08.1998, tëshuar nga Banka e Shqipërisë. Aksioneri i Vetëm i Bankës është Fondi Shqiptaro - Amerikan i Ndërmarrjeve. Me vendime të mëtejshme janë bërë ndryshime në strukturën drejtuese të shoqërisë dhe në kapitalin e saj.

- Më datë 16 shtator 2003 është mbajtur Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të Shoqërisë e cila mori vendim të rrisë kapitalin e shoqërisë nga shuma USD 10,000,000 në 15,000,000. Rritja e kapitalit do të kryhet nëpërmjet emetimit të 5,000,000 aksioneve të reja u nënshkruan të gjitha nga aksioneri i vetëm Albanian American Enterprise Fund. Prej këtyre aksioneve gjysma dhe konkretisht 2,500,000 aksione paguhet menjëherë në momentin e nënshkrimit duke transferuar në kapital 2.500.000 Usd nga fitimi neto i shoqërisë dhe pjesa tjetër do të paguhet brenda 5 vjeteve.
- të ndryshohet Neni 6 i Statutit si më poshtë:

**"NENI 6 - KAPITALI**

**Kapitali total aksioner**

6.1 Kapitali total aksioner i Bankës është 15.000.000 USD (pesëmbëdhjetë milion Dollarë Amerikan), dhe numri i aksioneve të autorizuara në të cilat do të ndahet ky kapital është 15.000.000 (pesëmbëdhjetë milion) aksione me vlerë nominale 1 (një) dollar amerikan për çdo aksion. Kapitali i nënshkruar i Bankës i përket tërësisht Aksionerit Themelues.

**Kapitali i paguar**

*je depozituar në...*

1/ Nënshkrimi dt 19/11/2003

2/ Nënshkrimi dt 13/08/03 dt 4/12/2003

4/ Nënshkrimi dt 3-12-2003

17/12/2003

*Y. M. Doga*

*Y. M. Doga*


*Y. M. Doga*

- 6.2 Kapitali i paguar i Bankës është 12.500.000 USD (dymbëdhjetë milion e pesëqind mije Dollarë Amerikan) dhe është kontribut i Aksionerit Themelues”.

Meqënëse vendimet e mësipërme përbëjnë ndryshime në Statutin e Bankës, duke u mbështetur në Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare” si dhe Ligjin Nr. 7638 “Për Shoqëritë Tregtare” i kërkoj Gjykatës së Shkallës së Parë-Tiranë të bëjë depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Bankës, datë 16 shtator 2003, në Regjistrin Tregtar të kësaj gjykate.

Bashkëngjitur po ju paraqesim Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Bankës të datës 16 Shtator 2003, si dhe vërtetimin e kryerjes së pagesës së aksioneve.

**KËRKUESI**

  
Banka Amerikane e Shqipërisë sh.a.  
Përf. me autorizim nga Erinda Ballanca


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
Nr. 2600 Rep.

VËRTETIM

Sot, më datë 11/12/2003, në Zyrën e Noterisë, para meje Noteres J. Hsh, u paraqit personalisht Znj. Erinda Ballanca, e bija e Faikut, lindur në Tiranë, më 29.10.1973, banues në Tiranë, e njohur personalisht prej meje, me zotësi të plotë për të vepruar, e cila më deklaroi se e kanë përpiluar dhe firmosur kërkesën bashkangjitur jashtë Zyrës së Noteres, me vullnetin e saj të lirë, dhe unë noterja e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE

*J. Hsh*  
*J. Hsh*





1 000 BEC -9 A 11: 431

Financial Control Department / AXH  
Nr. Prot. 8865

Tirane, 18 Nentor 2003

Per: Gjykatën e Shkalles së Parë, Tirane

**Lenda :Vertetim për hyrje fondesh për Kapitalin e Bankes Amerikane të Shqipërisë**

Konfirmojmë se në llogaritë e kapitalit të Bankes Amerikane të Shqipërisë është derdhur me datë 17 Nentor 2003 shuma prej USD 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë).

Me respekt,

  
Adela Xhemali  
Drejtoreshë e Kontrollit Financiar



Lorenzo Roncari  
President

1 2003 BEC -5 A 9 361

Protokol No 8828

**Gjykates se Shkalles se Pare  
Tirane**

**Prokure e posacme**

04 Dhjetor 2003

Autorizoj Avokaten Erinda Ballanca, qytetare shqiptare lindur ne Tirane me 29 tetor 1973 me numer license profesionale 618 qe te pergatise, dhe nenshkruaje kerkesen per depozitimin e vendimit e Asamblese se Aksionerit te vetem te Bankes Amerikane te Shqiperise Sh.A. te dates 16 shtator 2003, si dhe te kryeje te gjitha procedurat e kerkuara nga ligji per depozitimin e ketij vendimi.

Te gjitha veprimet e kryera nga avokate Ballanca i konsideroj te mireqena si te isha vete i pranishem.

Lorenzo Roncari  
President dhe Drejtor i Pergjithshem



3 December 2003


I, Page E. Bigelow, Secretary of the Board of the American Bank of Albania, do hereby swear and attest that a the Annual Meeting of the Shareholders was held on Tuesday, September 16, 2003, and that the attached minutes are a true reflection of the actions taken at that meeting.

  
Page E. Bigelow  
Secretary of the Board

State of New York )  
County of Nassau)

**KAREN A MACLEOD**  
Notary Public, State of New York  
No. 01MA6008386  
Qualified in Nassau County  
Commission Expires July 16, 20 06

On this 3<sup>rd</sup> day of December, 2003, before me came Ms. Page E. Bigelow, who being sworn before me, deposes and says that the attached Excerpt from the Minutes of the American Bank of Albania fully reflects the actions of the Board of Directors of said Bank and that she has transcribed the same to the best of her knowledge and belief.

By   
Notary Public



**RESOLUTION OF THE ASSEMBLY OF SHAREHOLDERS OF THE  
AMERICAN BANK OF ALBANIA SH.A.**

American Bank of Albania  
Annual Meeting of the Shareholders  
September 16, 2003

An Extraordinary Meeting of the shareholders of the American Bank of Albania was held at the offices of the Albanian-American Enterprise Fund, 14 East 60<sup>th</sup> Street, in New York, NY, USA, on Tuesday, September 16, 2003, at 1:00 p.m.

**Present in Person**

Michael D. Granoff  
Dianne Blane  
Cafo Boga  
Douglas G. Cariston  
James H. Duffy  
Thomas J. Murtagh  
Domenick G. Scaglione

**By Invitation**

Page E. Bigelow  
Lorenzo Roncari

**Representing the Board of Directors of the Albanian American Enterprise Fund,  
as the sole shareholder, and constituting a quorum.**

**APPROVAL OF THE BALANCE SHEET AND DESTINATION OF PROFITS**

The American bank of Albania closed the first half of the fiscal year on June 30, 2003 with a net profit of US \$5,000,000 (five million dollars), as reflected in the balance sheet.

**Motion:** It was moved the financial statements be approved as presented to the Assembly and to designate the profit as follows:  
1. no dividend will be distributed to the shareholder;  
2. to transfer US \$5,000,000 (five million dollars) into capital;

**Action:** The motion was approved unanimously with all shares being voted in favour.

**INCREASE IN CAPITAL**

**Motion:** It was moved that the capital of the American Bank of Albania be increased from US \$10,000,000 (ten million) to US \$15,000,000 (fifteen million). The increase will be effected by issuing 5,000,000 (five million) new shares which will be totally subscribed by the sole shareholder, Albanian American Enterprise Fund. The shares shall be paid in in two tranches of 2,500,000 (two million five hundred thousand). The first tranche will be paid in at the moment of the subscription. The second tranche will be paid in within a period of five years. Payment for the shares will be made by transferring into capital the ABA's net profits from the reserves as previously resolved.





Action: The motion was approved unanimously with all shares being voted in favour.

**AMENDMENT OF ARTICLE 6 OF THE STATUTE**

Motion: It was moved to amend Article 6 of the statute as follows:

**Article 6 – Capital**

**Total Share Capital**

6.1 The total subscribed share capital of the Bank is USD 15,000,000 (fifteen million), and the number of authorized shares into which such capital stock is to be divided is 15,000,000 (fifteen million) shares having a nominal value of one (1) USD per share. The subscribed share capital of the Bank is wholly attributable to the Founding Shareholder.


**Paid-In Capital**

6.2 The paid-in share capital of the Bank is USD 12,500,000 (fifteen million), and it is contributed by the Founding Shareholder in cash.

Action: The motion was approved unanimously with all shares voting in favour.

There being no further business, the meeting was adjourned at 1:10 p.m.


  
Michael D. Granoff, Chairman of the Board

  
Page E. Bigelow, Secretary



Република e Швейцария?  
Шанс e Нотариус? Бирок  
H2 6409 Rep



Verbeten  
Verbeten  
Супружен.  
H O T E P E  
Сенсус мo' 08.12.2013.  
Министерство  


3 Dhjetor 2003

Une, Page E. Bigelow, Sekretare e Keshillit Drejtues te Bankes Amerikane te Shqiperise, me ane te kesaj deshmoj se mbledhja vjetore e aksionereve u mbajt te marren me date 16 Shtator, 2003 dhe se procesverbali bashkangjitur pasqyron me vertetesi veprimet e ndermarra ne kete mbledhje.


State of New York  
County of New York

KAREN A MACLEOD  
Notere, Shteti, Nju Jork  
Nr: 01MA6008386  
E qualifikuar ne Nassau County  
Komisioni skadon me 8 Qeshor,20,2002

Me date 3 Dhjetor 2003 Znj. Page E. Bigelow deshmoi ne presencen time se Pjesa bashkengjitur e shkeputur nga procesverbali i Bankes Amerikane te Shqiperise pasqyron plotesisht veprimet e Keshillit Drejtues te Bankes se lartpermendur dhe se ajo e deshmon me shkrim nje ge te tille.

Nga \_\_\_\_\_  
Noteri

**REZOLUTA E MBLEDHJES SE AKSIONEREVE TE BANKES AMERIKANE TE SHQIPERISE SH.A**



Banka Amerikane e Shqipërisë  
Mbledhja Vjetore e Aksionerëve  
16 Shtator, 2003

Të Marten, më 16 Shtator 2003, ora 1:00 p.m u mbajt Mbledhja Vjetore e Aksionerëve të Bankës Amerikane të Shqipërisë në zyrat e Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndermarrjeve, 14 East 60<sup>th</sup> Street, NY, USA.

**Te pranishem**

Michael D. Granoff  
Dianne Blane  
Cafo Boga  
Douglas G. Carlston  
James H. Duffy  
Thomas J. Murtagh  
Domenick G. Scaglione

**Te ftuar**

Page E. Bigelow  
Lorenzo Roncari

**Paraqiten Keshillin Drejtues te Fondit Shqiptaro-Amerikan te Ndermarrjeve, si aksioneri i vetem dhe formuan nje kuorum.**

**MIRATIMI I BILANCIT KONTABEL DHE DESTINACIONI I FITIMEVE**

Më 30 Qershor 2003, Banka Amerikane e Shqiperise mbylli gjysmen e pare te vitit fiskal me nje fitim neto prej 5,000,000 USD (pese milion dollare) sic u pasqyrua ne bilancin kontabel.

Propozimi: U propozua qe pasqyrat financiare te miratohen sic u paraqiten ne mbledhje dhe fitimi te paraqitet si me poshte:

1. asnje dividend nuk do t'i shperdahet aksionerit,
2. transferimi i shumes 5,000,000 USD (pese milion dollare) ne kapital.

Veprimi: Propozimi u miratua unanimisht me te gjitha votat ne favor.

**RRITJA NE KAPITAL**

Propozimi: U propozua qe kapitali i Bankes Amerikane te Shqiperise te rritet nga 10.000,000 USD (dhjete milion) ne 15,000,000 USD (pesembedhjete milion). Rritja do te hyje ne fuqi me emetimin e 5,000,000 (pese milion) aksioneve te reja te cilat do te nenshkuhen plotesisht nga aksioneri i vetem, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndermarrjeve. Aksionet do te paguhen ne dy keste prej 2,500,000 (dy million e peseqind



mije). Kesti i pare do te paguhet ne momentin e nenshkrimt. Kesti i dyte do te paguhet brenda nje periudhe prej pese vjetesh. Pagesa per aksionet do te kryhet duke transferuar ne kapital, fitimin neto te ABA's nga rezervat qe u vendosen si me lart.

Veprimi: Propozimi u miratua unanimitisht me te gjitha votat ne favor.

#### **NDRYSHIMI I NENIT 6 NE STATUT**

Propozimi: U propozua qe neni 6 i statutit te ndryshohet si me poshte:

#### ***Neni 6- Kapitali***

#### ***Totali i aksioneve te kapitalit te nenshkuar***

6.1 *Totali i aksioneve te kapitalit te nenshkuar te Bankes eshte 15,000,000 USD (pesembedhjete milion dollare) dhe numri i aksioneve te autorizuar ku ky kapital eshte per t'u ndare eshte 15,000,000 (pesembedhjete milion dollare) aksione me nje vlere nominale prej (1) USD per aksion. Kapitali i nenshkuar i atribuohet plotesisht Aksionerit Themelues.*

#### ***Kapitali i paguar***

6.2 *Kapitali i paguar i Bankes eshte 12,500,000 USD (dy milion e pese qind mije dollare) dhe eshte ofruar ne cash nga Aksioneri Themelues.*

Veprimi: Propozimi u miratua unanimitisht me te gjitha votat ne favor.

Duke mos patur te reja te tjera per diskutim, mbledhja u mbyll ne ora 1:10 p.m.

---

Michael D. Granoff, Kryetar i Keshilli Drejtues

---

Page E. Bigelow, Sekretare

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
Nr. 6494 Rep.



**VERTETIM**

Me anen e te cilit vertetohet firma e perkthyeses Franceska Cepi e njohur prej meje personalisht, e cila perktheu sa me siper nga gjuha Shqipe ne Anglisht njelloj me dokumentin original dhe e nenshkroi ate rregullisht.

Tirane, me 08.12.2003

REPUBLIC OF ALBANIA  
NOTARY CHAMBER OF TIRANA  
Nr. 6494 Rep.




**NOTERE**

**CERTIFICATE**

Whereby it is certified the signature of the translator Franceska Cepi, known by me personally, who have translated the above text from Albanian to English in conformity with the document and duly signed.

Tirana, on 08.12.2003



**NOTARY PUBLIC**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË-TIRANË**  
**Nr. i Vendimit 19460/14**

**VENDIM**  
**I GJYQTARIT TË VETËM**

Sot, më datë 17/12/ 2003, unë gjyqtarja e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Majlinda Dogga, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Shoqëria Aksionere “American Bank of Albania – Banka Amerikane e Shqipërisë” Sh.A., e perfaqesuar me prokure nga Av. Erinda Ballanca, si edhe dokumentet e tjera bashkëngjitur,

**KONSTATOVA:**

“American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë” Sh.A. është shoqëri anonime e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare me Vendimin Nr. 19460, datë 19.05.1998 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe e ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet licensës Nr. 11, datë 10.08.1998, lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Aksioneri i vetëm i Bankës është Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve.

Me Vendimin Nr. 19460/1, datë 17.07.1998 është rritur kapitali i Bankës nga 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milion) Lekë në 500 000 000 (pesëqind milionë) Lekë.

Me Vendimin Nr. 19460/2, datë 7.10.1998 është ndryshuar numri i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Bankës.

Me Vendimin Nr. 19460/3, datë 16.02.1999 është ndryshuar Drejtori i Përgjithshëm i Bankës, duke emëruar Z. Lorenzo Roncari në vend të Z. Piter J. E. Nice si edhe Znj. Lauresha Basha në postin e Zv. Sekretares së Shoqërisë.

Me Vendimin Nr. 19460/4, datë 19.03.1999 janë korrigjuar disa gabime shtypi të një Vendimi të Asamblesë së Aksionerëve.

Me Vendimin Nr. 19460/5, datë 21.10.1999 është rritur Kapitali i Bankës nga 500 000 000 (pesëqind milion) Lekë në 700 000 000 (shtatëqind milion) Lekë.

Me Vendimin Nr. 19460/6, datë 27.04.2000 në bazë të kërkesave të Bankës së Shqipërisë, kapitali i shoqërisë është përcaktuar në dollarë në vlerën 4 767 000 USD (katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë Dollarë Amerikan).

Me Vendimin Nr. 19460/7, datë 30.03.2001, është bërë rritja e Kapitalit të Bankës, në shumën 5 017 000 USD (pesë milion e shtatëmbëdhjetë mijë Dollarë Amerikan).

Me Vendimin Nr. 19460/8, datë 10.07.2001 është ndryshuar Kryetari i Këshillit Drejtues të “American Bank of Albania – Banka Amerikane e Shqipërisë” Sh.A., duke emëruar Z. Michael D. Granoff në vend të Z. Domenick G. Scaglione.

Me Vendimin Nr. 19460/9, datë 5.10.2001 është rritur kapitali i Bankës nga 5 017 000 USD (pesë milion e shtatëmbëdhjetë mijë Dollarë Amerikan) në 5 067 000 USD (pesë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë Dollarë Amerikan).

Me Vendimin Nr. 19460/10, datë 8.05.2002 është rritur kapitali i Bankës nga 5 067 000 USD (pesë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë Dollarë Amerikanë) në 6 500 000 USD (gjashtë milion e pesëqind mijë Dollarë Amerikan).

Me Vendimin Nr. 19460/11, datë 17.09.2002 janë depozituar vendimet e Mbledhjeve të Anëtarëve të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve në lidhje me përbërjen e Bordit të Drejtorëve të Fondit si edhe vendimet e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të “American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë” Sh.A. në lidhje me përbërjen e Këshillit Drejtues të Bankës.

Me Vendimin Nr. 19460/12, datë 15.10.2002 janë korrigjuar disa gabime shtypi në Vendimin e Gjykatës Nr. 19460/9 datë 5.10.2001.

Me vendimin Nr. 19460/13 është vendosur rritja e kapitalit të shoqërisë në USD 10 000 000 (dhjete milion dollare) i gjithi i nënshkruar dhe paguar nga aksioneri i vetem.

Më datë 16 Shtator 2003 është mbledhur Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të Shoqërisë e cila ka marrë këto vendime:

- të rrisë kapitalin e shoqërisë nga USD 10 000 000 (dhjete milion dollarë Amerikanë) në 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion dollare amerikane). Rritja e kapitalit do të kryhet nepermjet emetimit të 5 000 000 (pesë milion) aksioneve të reja të cilat u nënshkruan të gjitha nga aksioneri i vetëm Albanian American Enterprise Fund – Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve. Gjysma, pra  $\frac{1}{2}$  e vleres nominale të aksioneve prej USD 2 500 000 (dymilion e pesëqind mijë dollarë amerikanë) paguhet menjëherë në momentin e nënshkrimit duke transferuar në kapital USD 2,500 ,000 (dymilion e pesëqindmije) nga fitimi neto i shoqërisë dhe pjesa tjetër do të paguhet në një moment të dytë.
- të ndryshohet Neni 6 i Statutit si më poshtë:

#### **“Neni 6 – Kapitali**

##### ***Kapitali total aksioner***

- 6.1 Kapitali total aksioner i Bankës është 15.000.000 USD (pesëmbëdhjetë milion Dollarë Amerikan), dhe numri i aksioneve të autorizuara në të cilat do të ndahet ky kapital është 15.000.000 (pesëmbëdhjetë milion) aksione

me vlerë nominale 1 (një) dollar amerikan për çdo aksion. Kapitali i nënshkruar i Bankës i përket tërësisht Aksionerit Themelues.

### ***Kapitali i paguar***

- 6.2 Kapitali i paguar i Bankës është 12.500.000 USD (dymbëdhjetë milion e pesëqind mije Dollarë Amerikan) dhe është kontribut i Aksionerit Themelues”.

Më 17.11.2003 është bërë edhe pagesa e USD 2,500,000 (dymilion e pesqindmijë dollare amerikanë) ç’ka vertetohet nga vertetimi i Bankes Amerikane te Shqiperise nr. prot. 8805, date 18.11.2003. Kjo shumë përbën pagesen e ½ të vleres nominale të aksioneve e drejtë kjo e parashikuar nga neni 160 i Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Shoqëria ka bere kërkesë për depozitimin e vendimit të Asamblese se Ortakëve të shoqërisë së datës 16.9.2003. Kërkesa eshte e drejtë dhe

### **PËR KËTO ARSYE,**

Në bazë të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992, “Për Shoqëritë Tregtare”, me ndryshimet e bëra, Ligji Nr. 8365, datë 02.07.1998, “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjit 7667 “Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare”,

### **VENDOSA:**

1. Pranimin e Kërkesës;
2. Depozitimin në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Shkallës së Parë - Tiranë të Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të Bankës datë 16.09.2003, për rritjen e kapitalit të shoqërisë nga USD 10 000 000 (dhjetëmilion dollarë amerikanë) në USD 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion dollarë amerikanë) i cili i takon i gjithi aksionerit themelues Albanian American Enterprise Fund - Fondit Shqiptaro Amerikan të Ndermarrjeve dhe për ndryshimin e nenit 6 të Statutit të Shoqërisë për te pasqyruar ndryshimet e mesiperme, si dhe depozitimin e dokumenteve për vërtetimin e pagesës;
3. Të urdhëroj ndryshimet në kolonën nr. \_\_\_\_ dhe nr. rendor \_\_\_\_ në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të kësaj Gjykate, duke u ndarë këto shënime me vizë të kuqe nga njëri-tjetri.

Tiranë, 17/12/2003.

**GJYQTARE**

Majlinda Dogga





18460/16

Z. T. Moxha  
09.11.2006



**KERKESE**

**KERKUES:**

American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise Sh.a, regjistruar si person juridik, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 19460, datë 19 Maj 1998 me seli në Rruga Ismail Qemali no. 27, Tirana, Albania, perfaqesuar nga z. Lorenzo Roncari, qytetar italian, lindur në Bari, Itali, më 8 Dhjetor 1933, mbajtës i pasaportës nr. 815249J, ne cilesine e Presidentit dhe Drejtorit te Pergjithshem Ekzekutiv.

1. "Dokumentet e Bankës" nr. 24.11.2006

**OBJEKTI I KERKESES:** Depozitimim e Vendimit te Bordit Drejtues te Aksionerit te Vetem, date 10.03.2004, Vendimit te Bordit Drejtues te Aksionerit te Vetem date 10.03.2005 dhe te Vendimit te Bordit Drejtues te Aksionerit te Vetem date 16.03.2006, ne Regjistrin Tregtar prane Gjykatës se Rrethit Tirane.

2. Trajtimimi bance ne Bankes Amerikane nr. 066005 dt 10.10.2006

Depozitimim e Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, date 10.10.2006, nepermjet te cilit eshte miratuar zmadhimi i kapitalit me kontributin e aksionerite te vetem, nepermjet rritjes se vleres nominale te aksionit nga USD 1,80 (nje presje tetedhete dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) ne USD 2,2266 (dy presje dymije e dyqind e gjashtedhete e gjashte dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes); si dhe Ndryshimin e Nenit 6 te Statutit i Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a.

3. Bance lidur me vendimin (konfirmim) te Komitetit te Kontrollimit te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, date 10.10.2006

4. Rezoluta e mbledhjes nr. 16.03.2004

**BAZA LIGJORE:**

Ligji Nr. 7632, date 04.11.1992, "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar",  
Ligji Nr. 8365, date 02.07.1998 "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise",  
Nenet 83, 128, 150, 152 Ligji nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare";  
Ligji Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare",  
Si dhe Statuti i Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a.

5. Rezoluta e mbledhjes nr. 10.10.2006  
6. Rezoluta e mbledhjes nr. 10.10.2006

**GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR  
TIRANE**

"American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise sh.a" eshte person juridik i regjistruar ne Regjistrin Tregtar me Vendimin Nr. 19460, date 19.05.1998 te Gjykatës se

*[Handwritten signature and stamp]*

*[Handwritten mark]*

Rrethit Gjyqesor – Tirane dhe e ushtron veprimtarine e saj nepermjet Licenses nr. 11,  
date 10.08.1998 leshuar nga Banka e Shqiperise.

I. Me date 10 Mars 2004; me date 10.03.2005 dhe me date 16.03.2006 eshte thirrur dhe mbajtur rregullisht mbledhja e Asamblese se Zakonshme te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, ku ishin te pranishem te gjitha anetaret e Bordit Drejtues te Aksionerit te Vetem - "Albanian American Enterprise Fund - Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve".

Bordi Drejtues i Aksionerit te Vetem - "Albanian American Enterprise Fund - Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve", pasi mori ne shqyrtim te gjitha ceshtjet e rendit te dites, ne perfundim te diskutimeve:

#### VENDOSI:

1. Me Vendimin e Bordit Drejtues te Aksionerit te Vetem date 10.03.2004, eshte vendosur :

Riemerimi i zj. Diane Blane dhe z. Cafo Boga ne cilesine e anetarit te Keshillit Drejtues te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a per nje periudhe prej 3 vjetesh.

2. Me Vendimin e Bordit Drejtues te Aksionerit te Vetem date 10.03.2005, eshte vendosur :

Riemerimi i z. Douglas G. Carlston dhe z. Thomas J. Murtagh ne cilesine e anetarit te Keshillit Drejtues te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a per nje periudhe prej 3 vjetesh.

3. Me Vendimin e Bordit Drejtues te Aksionerit te Vetem date 16.03.2006 eshte vendosur :

Riemerimi i Michael D. Granoff, Domenick G. Scaglione dhe z. James H. Duffy ne cilesine e anetarit te Keshillit Drejtues te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a per nje periudhe prej 3 vjetesh.

II. Me date 10 Tetor 2006, ne seline e Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a ne Tirane, Rruga "Ismail Qemali", Nr. 27 eshte thirrur dhe mbajtur rregullisht mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, ku ishin te pranishem te gjitha anetaret e Bordit Drejtues te Aksionerit te Vetem - "Albanian American Enterprise Fund - Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve" te cilet pasi moren ne shqyrtim te gjitha pikat e rendit te dites ne perfundim te diskutimeve,

#### VENDOSIEN:

Ne baze te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 “Per Shoqerite Tregtare”, me ndryshimet perkatese si dhe ne baze te Ligjit Nr. 8365, date 02.07.1998 “Per Bankat ne Republiken e Shqiperise”; si dhe Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993, “Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare”.

#### **V E N D O S A**


- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin ne Regjistrin Tregtar te Vendimit (Rezolutes) te Asamblese se Jashtezakonshme te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, date 18 Tetor 2005 se bashku me Vertetimet per kryerjen e pagesave dhe transferimin e fondeve nga llogaria e fitimeve te pashperndara ne llogarine e kapitalit, per zmadhimin e kapitalit themeltar te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a nga USD 15 000 000 (pesembedhjete milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) ne USD 27 000 000 (njezet e shtate milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) nepermjet rritjes se vleres nominale te aksionit nga USD 1 (nje) dollar te Shteteve te Bashkuara te Amerikes ne USD 1.80 (nje pike tetedhjete) dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes, si rrjedhoje e kontributit te Aksionerit te Vetem Themelues “Albanian American Enterprise Fund – Fondi

Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve”, si dhe ndryshimet perkatese te neneve 4 dhe 6 te Statutit, ashtu si percaktohen ne Vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme date 18 Tetor 2005.

- Te urdheroj reflektimin e ndryshimeve perkatese ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor - Tirane.

**GJYQTARE**

**Marjana Dedi**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Marjana Dedi', written over the printed name.



KIB-20811008

1546/15

KERKESE

02 NENTOR 2005

Maniana Jeci  
02 11 2005  
Maku

KERKUES:

Be depozituesit  
Retorica e vendimit  
19.10.05  
autorigjini  
11.05/65

American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë Sh.a, regjistruar si person juridik, me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 19460, datë 19 Maj 1998 me seli në Rruga Ismail Qemali no. 27, Tirana, Albania, perfaqesuar nga Z. Lorenzo Roncari, qytetar Italian, lindur në Bari, Itali, më 8 Dhjetor 1933, mbajtës i pasaportës nr. 815249J, ne cilesine e Presidentit dhe Drejtorit te Pergjithshem Ekzekutiv.

OBJEKTI I KERKESES:

Depozitimi ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, Zyra e Regjistrimit Tregtar te Vendimit te Asamblese se Jutezakonshme te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, date 18.10.2005, lidhur me Ndryshimin e Statutit nenet 4 dhe 6 si dhe Zmadhimi i kapitalit nepermjet kontributit te aksionerit te vetem, duke rritur vleren nominale te aksionit.

BAZA LIGJORE:

Neni 18, 33 te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993, "Per Regjistrimin Tregtar dhe formalizimet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare".  
Nenet 83, 128, 150, 152 Ligji nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

GJYKATES SE SHKALLES SE PARE TIRANE

"American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise sh.a" eshte person juridik i regjistruar ne Regjistrimin Tregtar me Vendimin Nr. 19460, date 19.05.1998 te Gjykares se Shkalles se Pare - Tirane dhe e nshtron veprimtarine e saj nepermjet Licenses nr. 11, date 10.08.1998 leshuar nga Banka e Shqiperise.

Nepermjet Vendimit te Gjykares se Shkalles se Pare - Tirane nr. 19460/14, date 17.12.2003, kapitali themeltar i Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, eshte zmadhuar nepermjet kontributit te aksionerit te vetem themelues - "Albanian American Enterprise Fund - Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve". Per rrjedhoje kapitali themeltar eshte zmadhuar ne vleren USD 15 000 000 (pesembedhjete milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) nepermjet emetimit te aksioneve te reja te cilat jane nenshkruar totalisht nga aksioneri i vetem - "Albanian American Enterprise Fund - Fondi Shqiptaro

Handwritten signature



Amerikan i Ndermarrjeve". Kapitali themeltar i Bankes ndahet ne 15 000 000 (pesembedhjete milion) aksione me vlere nominale te aksionit 1 (nje) dollar te Shteteve te Bashkuara te Amerikes. Te gjitha aksionet ne te cilat ndahet kapitali themeltar jane shlyer totalisht nga aksioneri i vetem.

Me date 18 Tetor 2005 ne seline e Bankes ne Tirane, Rruga "Ismail Qemali", Nr. 27 eshte thirrur dhe mbajtur rregullisht mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, ku ishin te pranishem te gjithë anetaret e Bordit Drejtues te Aksionerit te Vetem - "Albanian American Enterprise Fund - Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve" te cilet pasi moren ne shqyrtim te gjitha pikat e rendit te dites ne perfundim te diskutimeve

#### VENDOSEN,

1. **Te ndryshohet neni 4 i Statutit te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a,** dhe per rjedhoje te shtohet si pike e re ne listen e aktiviteve te autorizuar te Bankes, e drejta per te vepruar si Regjistruer i Letrave me Vlere te Qeverise. Banka Amerikane e Shqiperise sh.a ka te drejte te organizoje dhe administroje Regjistrin e Letrave me Vlere, ne baze te udhezimeve dhe rregulloreve te Komisionit te Letrave me Vlere. Banka Amerikane e Shqiperise sh.a, ofron sherbimin e regjistrimit te Letrave me Vlere te Qeverise dhe Letrave te tjera me Vlere, ne baze te Nenit 2 te Ligjit nr. 8080, date 3 Janar 1996 "Per letrat me Vlere" ne menyre qe te kete te dhena ne cdo kohe per pronesine e Letrave me Vlere dhe kufizimeve per pronesine e Letrave me Vlere dhe kufizimeve te drejtave te pronesise.
2. Gjithashtu Asambleja e Jashtezakonshme vendosi **te zmadhohet kapitali themeltar i Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a nga USD 15 000 000 (pesembedhjete milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) ne USD 27 000 000 (njezet e shtate milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes).** Zmadhimi i kapitalit do te kryhet nepermjet rritjes se vleres nominale te aksionit i cili si rezultat ndryshon nga USD 1 (nje) dollar te Shteteve te Bashkuara te Amerikes, ne USD 1.80 (nje pike tetedhjete) dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes. Zmadhimi i kapitalit kryhet nepermjet shlyerjes se menjehershme, nga ana e aksionerit te vetem "Albanian American Enterprise Fund - Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve", duke u transferuar shumata prej USD 12 000 000 (dymbedhjete milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) nga llogaria e fitimeve te pashperndara.
  - Me qellim reflektimin e zmadhimit te kapitalit ne Statutin e Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, u vendos qe **te ndryshohet neni 6 i tij,** si me poshte vijon:



## “Neni 6 – Kapitali

### Kapitali total aksioner

6.1 Kapitali total aksioner i nenshkruar i Bankes eshte USD 27 000 000 (njezet e shtate milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes), dhe numri i aksioneve te autorizuar ne te cilat do te ndahet ky kapital eshte 15 000 000 (pesembedhjete milion) aksione. Kapitali i nenshkruar i Bankes i perket teresisht Aksionerit Themelues.

### Kapitali i paguar

6.2 Kapitali i paguar i Bankes eshte USD 27 000 000 (njezet e shtate milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) dhe eshte kontribut i Aksionerit Themelues ne para cash.”.

Bazuar ne sa me siper,

## KERKOJME

- Shqyrtimin dhe Pranimin e kerkeses.
- Depozitimn e Rezolutes (Vendimit) te Asamblese se Jashtezakonshme te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, dhe dokumentacionit shoqerues, per zmadhimin e kapitalit themeltar te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a nga USD 15 000 000 (pesembedhjete milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) ne USD 27 000 000 (njezet e shtate milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) nepermjet rritjes se vleres nominale te aksionit nga USD 1 (nje) dollar te Shteteve te Bashkuara te Amerikes ne USD 1.80 (nje pike tetedhjete) dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes si rjedhoje e kontributit te Aksionerit Themelues “Albanian American Enterprise Fund – Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve” nepermjet transferimit te shumes prej USD 12 000 000 (dymbedhjete milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) nga llogaria e fitimeve te pashperndara; si dhe shtimin si pike e re ne aktivitetet e autorizuar te Bankes te se drejtes per te vepruar si Regjistrues i Letrave me Vlere te Qeverise. Ne kete kuader Banka Amerikane e Shqiperise sh.a ka te drejte te organizoje dhe administroje Regjistrin e Letrave me Vlere. Gjithashtu edhe miratimin e ndryshimeve te neneve 4 dhe 6 te Statutit ashtu si paraqiten me siper kesaj kerkese.



- Reflektimin e ndryshimeve ne regjistrin tregtar, kolona 2, shkronja “c”, “ç” dhe kolona 4 shkronja “dh”, “ç”, ne zbatim te Neneve 18, 33 te Ligjit Nr.7667 date 28.01.1993, “Per Regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare”.


Tirane, me 26/10 /2005

## KERKUESI

**AMERICAN BANK OF ALBANIA -  
BANKA AMERIKANE E SHQIPERISE SH.A**

*Perfaqesuar nga*

Lorenzo Roncari  
President dhe Drejtor i Pergjithshem i Ekzekutiv





REPUBLIKA E SHQIPERISE SH.A  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
NR. 3671 REP.  
NR. \_\_\_\_\_ KOL.



## VERTETIM

Sot, me date 28.10.2005, para meje noteres Enkeleida Hoxha, notere e Dhomes se Noterise Tirane, me seli ne Bul: "Bajram Curri", prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane u paraqit personalisht z. Lorenzo Roncari, qytetar Italian, lindur ne Bari, Itali, me 8 Dhjetor 1933, me Pasaporte nr. 815249J, i cili nenshkroi para meje me vullnet te lire dhe te plote Kerkesen e mesiperme, ne prani te perkthyeses Alma Kape dhe une noteria e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTERE

ENKELEIDA HOXHA

NOTERE  
E ENKELEIDA HOXHA  
Tirane 28.10.2005

REPUBLIKAN  
NOMER  
NR. 286

Venditori  
Nxtjerr  
/ / / / /  
/ / / / /  
/ / / / /

REPUBLIKAN SHQIPËRISE  
BANKA E SHQIPËRISE




# LICENCE

Nr. 14 date 10.08.1998

## PER TE VEPRUAR SIBANKEN NE REPUBLIKEN E SHQIPËRISE

Ne mbledhje te Nentit 7 dhe 10 te Ligjit Nr. 3075 datuar 20.03.1996 per Shpërndarjen e Bankave dhe Bankës Shqiptare te Nentit 2 pika 46 te Nentit 12 te Ligjit Nr. 3075 datuar 20.03.1996 per Shpërndarjen e Bankave dhe Bankës Shqiptare dhe me vendim Nr. 105 datuar 10.08.1998 te Komitetit Nacional te Bankave te Shqiperise, detyrohem te informoj qe licencen per te vepruar si banka ne Republiken e Shqiperise i ka marrë z. Miranda Ramaj, e cila ka marrë licencen me numër 14 datuar 10.08.1998. Licenca e marrë nga z. Miranda Ramaj është e vlefshme deri më 31.12.2000. Licenca e marrë nga z. Miranda Ramaj është e vlefshme për të vepruar si banka në Republikën e Shqipërisë. Licenca e marrë nga z. Miranda Ramaj është e vlefshme për të vepruar si banka në Republikën e Shqipërisë. Licenca e marrë nga z. Miranda Ramaj është e vlefshme për të vepruar si banka në Republikën e Shqipërisë.

MIRANDA RAMAJ  
DRETORE E BANKES QYRIS



**REPUBLIC OF ALBANIA  
BANK OF ALBANIA**



# **LICENSE**

**No. 11, dated 10.08.1998**

## **TO EXERCISE BANKING ACTIVITY IN THE REPUBLIC OF ALBANIA**

Based on article 7 and 10 of the Law No. 8075, dated 22.02.1996 "For the Banking System of the Republic of Albania", based on Article 3, item 4.c of the Law No. 8269, dated 23.12.1997 "For the Bank of Albania", and based on Decision No. 105, dated 10.08.1998, of the Supervisory Council of the Bank of Albania, to the American Bank of Albania Sh.A, with the main headquarters in Tirana, is granted the License to act as a Bank in the Republic of Albania in accordance with the Law No. 8075, dated 22.02.1996, "For the Banking System of the Republic of Albania."

The License allows the American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë Sh.A. to exercise the activities provided for in the attached annex. The License is unlimited in time and is not transferable.

The activity starts immediately.

**MIRANDA RAMAJ**  
**HEAD OF SUPERVISORY DEPARTMENT**  
(Signature)

**SHKËLQIM CANI**  
**GUVERNOR**  
(Signature)  
(Seal of the Bank of Albania)



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE

LICENSA NR. 11



## ANEKS

### VEPRIMTARITË QË DO TË KRYEJË BANKA AMERIKANE E SHQIPERISE SHA

Në mbështetje të Nenit 26 të Ligjit Nr. 8075, datë 22.02.1996 "Për Sistemin Bankar në Republikën e Shqipërisë", dhe kapitalit të paguar, Banka Amerikane e Shqipërisë SHA do të kryejë këto veprimtari:

- 1.) Pranimin e depozitave (në formën e depozitave pa afat, depozitave me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes.
- 2.) Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare.
- 3.) Marrje hua të fondeve dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve:
  - a.) Të instrumentave të tregut monetar (duke përfshirë ndër të tjera çeqet, kambialet dhe certifikatat e depozitave).
  - b.) Të letrave me vlerë të borxhit.
  - c.) Të kontratave të "se ardhmes" dhe kontratat "e mundesive", që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit.
  - d.) Të instrumenteve të normës së interesit.
- 4.) Kryerjen e shërbimeve të pagesës.
- 5.) Emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës (duke përfshirë ndër të tjera, pagesat me kartë, me çeqet e udhëtarit dhe çeqet e bankierit).
- 6.) Ndërmjetësim për operacione monetare (duke përfshirë valutat).
- 7.) Lisingu financiar.
- 8.) Kryerja e shërbimeve si agjent financiar ose keshilltar financiar (jo për shërbime të përshkruara në pikën 1 dhe 2).

  
Miranda RAMAJ  
Drejtoresh e Mbiqendrimit



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERËVE TIRANE  
Nr. 1306 Rep. Dt. 12.9.18  
VERTETIM  
Vërtetohet se fotokopja është e  
njëjtë me origjinalin. Dokumenti  
u paraqit nga z. Arben Heta  
Nr. Pasap. 123456789  
NOTERE



  
Shkelqim CANI  
Guvernator



## ANNEX

THE ACTIVITIES THAT WILL BE CARRIED ON BY THE AMERICAN BANK OF ALBANIA-BANKA AMERIKANE E SHQIPERISE SH.A.

Based on Article 26 of the Law No. 8075, dated 22.02.1996 "For the Banking System of the Republic of Albania", and the payment of capital, the American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë Sh.A. will exercise the following activities:

- 1.) Receive deposits (in the form of demand deposits, time deposits or other forms of deposit) whether bearing interest or not.
2. Extend credit, including without limitation consumer and mortgage credit, factoring, and the financing of commercial transactions.
3. Borrow funds and buy and sell for its own account or for the account of its customers:
  - a.) Money market instruments (including without limitation checks, bills of exchange and certificates of deposit).
  - b.) Debt securities.
  - c.) Futures, options and other derivating documents relating to debt securities or interest rates.
  - d.) Interest rate instruments.
- 4.) Provide payment and collection services.
- 5.) Issue and administer means of payment (including without limitation payment cards, traveler's checks and bank drafts).
- 6.) Act as a money broker in domestic and foreign currencies.
- 7.) Engage in financial leasing.
- 8.) Provide services as a financial agent or advisor (excluding the services stated in item 1 and 2).

Miranda RAMAJ  
Head of Supervisory Department  
(Signature)

Shkëlqim CANI  
Governor  
(Signature)  
(Seal of the Bank of Albania)

VËRTETIM I PËRKTHIMIT

Unë vërtetoj se sot, më 12 gusht 1998, deklarova se versioni anglisht i Licensës dhe Aneksit të Licensës bashkëngjitur është një përkthim i saktë i versionit anglisht dhe anasjelltas.



PËRKTHYES

*Erinda Ballanca*

AUTHENTICATION OF TRANSLATION

I certify that today, on August 12, 1998, I declared that the English version of the License and Annex of the License attached is an accurate translation of the Albanian version and vice versa.

TRANSLATOR

*Erinda Ballanca*


REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
NOTERIA TIRANË

Nr. 1307 Rep.

Nr. \_\_\_\_\_ Kol.

VËRTETIM

Vërtetoj se sot më datë 12 gusht 1998, para meje noterit, u paraqit Erinda Ballanca, Nr. Pas. 0368205, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, e cila më deklaroi se e ka përkthyer Licensën dhe Aneksin e Licensës bashkëngjitur nga shqipja në anglisht njëlloj me origjinalin dhe e nënshkroi atë para meje noterit dhe unë e vërtetoj sipas ligjit.



*Erinda Ballanca*

REPUBLIC OF ALBANIA  
NOTARY TIRANA

No. 1307 Rep.

No. \_\_\_\_\_ Col.

CERTIFICATE

I certify that today, on August 12, 1998, in front of me, the notary, came Erinda Ballanca, No. Pass. 0368205, known by me personally, mature, with full capacity to act, who declared that she has translated the attached License and Annex of the License from Albanian in English the same as the original, and she signed the translation in front of me, the notary, and I certify it according to the law.

NOTARY

*Erinda Ballanca*





KIB-20811008

Departamenti i Kontrollit Financiar / AXH  
Nr. Prot. 05/6492

Gjykata e Shkalles se Pare, Tirane


Tirane, 31 Tetor 2005


Lenda: Vertetim per hyrje fondesh per Kapitalin e Bankes Amerikane te Shqiperise

I/E Nderuar

Ju konfirmojme se ne llogarine e kapitalit te Bankes Amerikane te Shqiperise eshte derdhur me date 28 Tetor 2005 shuma prej USD 12,000,000 (dymbedhete milione dollare amerikane).

Me respekt,

  
Adela Xhemali  
Zv President  
Kontrolli Financiar



Banka Amerikane  
e Shqipërisë



American Bank  
of Albania

REF: 1908 0000000000

0000000000  
AMERICAN BANK OF ALBANIA  
MAY 19 1988 10:00 AM

1 000 000

REF: NOV 1988 10:00 AM 0120417401

AMERICAN BANK OF ALBANIA / CREDIT ADVISORY

Kritikë kreditore, ju informojmë se banka juaj ka kryer verifikimin e shtetit të kësaj kompanie dhe se kompania nuk ka pasur asnjë detyrim të rëndësishëm të jashtëm. Në bazë të kësaj informate, banka ju informon se kësaj kompanie i ka miratuar kreditin e kërkuar për llogarinë tuaj.

Shprehim nderim për ju.

Zëvendësues i Komitetit të Kredisë  
Vendosës i Bankës

Two Branches - Tirane - Albania

Capital - 100,000,000,000 Albanian Lek (100,000,000,000)

RESERVE FUND - 100,000,000,000 Albanian Lek (100,000,000,000)

BANKING INFORMATION

Bank of Albania - Tirane

AMERICAN BANK OF ALBANIA - TIRANE - CREDIT HOLD

AMERICAN BANK OF ALBANIA - TIRANE - CREDIT HOLD

Do not hesitate to contact us for any further information regarding our services and products. We are committed to providing the highest quality of service to our customers. Our services are available to all citizens of Albania and to all foreign companies and individuals. We are committed to providing the highest quality of service to our customers. Our services are available to all citizens of Albania and to all foreign companies and individuals.

Please refer to our website for more information and details about our services and products. The American Bank of Albania is a member of the American Bank of Albania Group. We are committed to providing the highest quality of service to our customers. Our services are available to all citizens of Albania and to all foreign companies and individuals.

The American Bank of Albania is a member of the American Bank of Albania Group. We are committed to providing the highest quality of service to our customers. Our services are available to all citizens of Albania and to all foreign companies and individuals. We are committed to providing the highest quality of service to our customers. Our services are available to all citizens of Albania and to all foreign companies and individuals.





KIB-20811008

Departamenti i Kontrollit Financiar / AXH  
Nr. Prot. 051647

Gjykata e Shkalles se Pare, Tirane

Tirane, 31 Tetor 2005


Lenda: Vertetim per hyrje fondesh per Kapitalin e Bankes Amerikane te Shqiperise

I/E Nderuar

Ju konfirmojme se ne llogarine e kapitalit te Bankes Amerikane te Shqiperise eshte derdhur me date 17 Dhjetor 2003 shuma prej USD 2,500,000 (dy milion e peseqind mije dollare amerikane).

Me respekt,

Adela Xhemali  
Zv President  
Kontrolli Financiar





KIB 20811008

888888  
WALK IN CUSTOMER  
WALK IN CUSTOMER

28 00 25

REF No: 000FINT0375310787

INTERNAL CREDIT ADVICE / CREDIT ADVICE

Kemi kënaqerim që ju informojmë që kemi kryer veprimin e nevojshëm në sistemin tuaj:

We are pleased to inform you that we have effected the following transaction on your account:

INTERNAL TRANSFER

Account Number : 577000000  
Value Date : 17/07/2011

By Order Of : ABG

Amount Credited : 300,000,000.00

Details:

TRANSFER AMOUNT : 300,000,000.00

Additional Information:

INCREASING CAPITAL AGENCY SHARE  
HOLDER MEETING DEC 09 2010

Ju lutem të keni parasysh se ky është një vertetim i gjeneruar nga kompjuteri dhe nuk ka nevojë për kontrollim.

Një agjenci e re e Bankës Amerikane e Shqipërisë ka filluar aktivitetin në Qendren Financiare Shqiptare me shërbim ATM 24 orë në ditë.

Please note that this is computer-generated advice, and does not require any signature.

The American Bank of Albania has opened an Agency in the University Shopping Center with ATM service 24hours a day.



KIB-20811008

2005 NOV -1 A 9:35

**GJYKATES SE SHKALLES SE PARE  
TIRANE**

Protokol nr 05/6539

Tirane, me 01.11.2005


**AUTORIZIM**

Me ane te ketij Akti, autorizohet *Av. Ledia Plaku* ne cilesine e Drejtores se Departamentit Juridik, si dhe *z. Markeljan Rriska*, jurist prane "Bankes Amerikane te Shqiperise - American Bank of Albania" Sh.A. (Banka), te cileve te dy se bashku ose vec e vec u jepet e drejte dhe tager e plote te perfaqesojne dhe mbrojne interesat e "Bankes Amerikane te Shqiperise" sh.a, ne gjykimin e Kerkeses drejtuar Gjykates se Shkalles se Pare - Tirane, me objekt: "*Depozitimin ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, Zyra e Regjistrimit Tregtar - te Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, date 18.10.2005, lidhur me Ndryshimin e Statutit nenet 4 dhe 6 si dhe Zmadhimin e kapitalit nepermjet kontributit te aksionerit te vetem, duke rritur vleren nominale te aksionit*".


Perfaqesuesve te posacem u jepet e drejta e perfaqesimit gjyqesor te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, si dhe ne te gjitha shkallet e tjera te gjykimit.

**AMERICAN BANK OF ALBANIA -  
BANKA AMERIKANE E SHQIPERISE SH.A**

Perfaqesuar nga

  
Lorenzo Roncani

President dhe Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv





## **RESOLUTION OF THE ASSEMBLY OF SHAREHOLDERS OF THE AMERICAN BANK OF ALBANIA S.A.**

American Bank of Albania  
Extraordinary Meeting of the Shareholders  
October 18, 2005

An Extraordinary Meeting of the shareholders of the American Bank of Albania was held at the American Bank of Albania, Rruga Ismail Qemali, Nr. 27, in Tirana, Albania, on Tuesday, October 18, 2005, at 1:00 p.m.

### **Present in Person**

Michael D. Granoff  
Dianne Blane  
Cafo Boga  
Douglas G. Carlston  
Thomas J. Murtagh  
Domenick G. Scaglione

### **By Invitation**

Page E. Bigelow  
Lorenzo Roncari  
Jeffrey T. Griffin

**Representing the Board of Directors of the Albanian American Enterprise Fund,  
as the sole shareholder, and constituting a quorum.**

### **AMENDMENT TO CHARTER**

- Motion:** It was moved that the Shareholder agrees to amend Article 4 of the Charter of the American Bank of Albania to add to the list of the ABA's authorized activities the right to act as Government Securities Registrar. The ABA will have the authority to organize and administer the Securities Register according to the instructions and regulations of the Securities Commission. The ABA will offer the service of the registration of government securities and other securities as defined in Article 2 of Law nr. 8080, dated January 3, 1996, "On Securities," in order to provide at any time information about the ownership of the securities and the restrictions imposed on the ownership of the securities and the restrictions imposed on the ownership rights.
- Action:** The motion was approved unanimously with all shares being voted in favour.

### **INCREASE IN CAPITAL**

- Motion:** It was moved that the capital of the American Bank of Albania be increased from USD 15,000,000 (fifteen million) to USD 27,000,000 (twenty-seven million). The increase of the capital shall be made through the increase of the par value of the shares from USD1.00 to

USD1.80. The increase in capital will be effected through transfer of US\$12 million from the retained earnings account.  
Action: The motion was approved unanimously with all shares being voted in favour.

### AMENDMENT OF ARTICLE 6 OF THE STATUTE

Motion: It was moved to amend Article 6 of the statute as follows:

#### Article 6 - Capital

##### Total Share Capital


6.1 The total subscribed share capital of the Bank is USD 27,000,000 (twenty-seven million), and the number of authorized shares into which such capital stock is to be divided is 15,000,000 (fifteen million) shares. The subscribed share capital of the Bank is wholly attributable to the Founding Shareholder.


##### Paid-In Capital

6.2 The paid-in share capital of the Bank is USD 27,000,000 (twenty-seven million), and it is contributed by the Founding Shareholder in cash.

Action: The motion was approved unanimously with all shares voting in favour.

There being no further business, the meeting was adjourned at 1:30 p.m.

  
Michael D. Granoff, Chairman

  
Page E. Bigelow, Secretary

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

Nr. 3647 Rep.

Dt 26.10.2005

VERTETIM

Vertetohet njesia me origjinalin


Nxjerrje nga \_\_\_\_\_

U paraqit nga \_\_\_\_\_

Saenime \_\_\_\_\_

NOTERE  
ENKELEIDA HOXHA





REPUBLIC OF ALBANIA  
TIRANA NOTARY CHAMBER  
REP. NO. 3645  
COL. NO. \_\_\_\_\_

**AUTHENTICATION**

Today on 26.10.2005, before me Notary Public, Enkeleida Hoxha member of Tirana Notary Chamber, with registered office in Tirana, Bul: "Bajram Curri", near Tirana District Court were presented personally the above-mentioned parties, for whose identity I the notary am certain based on their personal documents. The parties, in the presence of the translator Alma Kape signed the Resolution with their full and free will and I, the notary certify it according to the law.

**PUBLIC NOTARY**

**ENKELEIDA HOXHA**



NOTE PE  
ENKELEIDA HOXHA  
Tirane 26/10/2005

A large, stylized handwritten signature of Enkeleida Hoxha, written in black ink. The signature is enclosed within a large, hand-drawn oval shape.

**REZOLUTE E MBLEDHJES SE AKSIONEREVE TE  
BANKES AMERIKANE TE SHQIPERISE SH.A**

**Banka Amerikane e Shqipërisë  
Takim i Jashtëzakonshëm i Aksionerëve  
18 Tetor 2005**

Të Martën , më datën 18 Tetor, 2005, ora 1:00 p.m, në ambjentet Bankës Amerikane të Shqipërisë, Rruga Ismail Qemali, Nr. 27, Tiranë, Albania, u zhvillua takimi i jashtëzakonshëm i aksionerëve të Bankës Amerikane të Shqipërisë.

**Të pranishëm**

Michael G. Granoff  
Dianne Blane  
Cafo Boga  
Douglas G. Carlston  
Thomas J. Murtagh  
Domenick G. Scaglione

**Të ftuar**

Page E. Bigelow  
Lorenzo Roncari  
Jeffrey T. Griffin

Përfaqësues të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptaro – Amerikan të Sipërmarrjeve, si aksioneri i vetëm, formuan një kuorum

**AMENDIM I STATUTIT**

**Propozimi:** U propozua që Aksioneri të pranojë amendimin e nenit 4 të Statutit të Bankës Amerikane të Shqipërisë për t'i shtuar të drejtën për të vepruar si Regjistruer i Letrave me Vlerë të Qeverisë listës së aktiviteteve të autorizuara të BASH. BASH ka të drejtë të organizojë dhe administrojë Regjistrin e Letrave me Vlerë në bazë të udhëzimeve dhe rregulloreve të Komisionit të Letrave me Vlerë. BASH ofron shërbimin e regjistrimit të letrave me vlerë të qeverisë dhe letrave të tjera me vlerë në bazë të nenit 2 të ligjit nr. 8080, datë 3 Janar, 1996 "Për Letrat me Vlerë" në mënyrë që të ketë të dhëna në çdo kohë për pronësinë e letrave me vlerë dhe kufizimeve për pronësinë e letrave me vlerë dhe kufizimeve të të drejtave të pronësisë.

**Veprimi:** Propozimi u miratua unanimisht

**RRITJA E KAPITALIT**

**Propozimi;** U propozua rritja e kapitalit të Bankës Amerikane të Shqipërisë nga USD 15,000,000 (pesëmbëdhjetë million) në USD 27,000,000 (njëzet e shtatë million). Rritja e kapitalit do të bëhet nëpërmjet rritjes së vlerës nominale të aksioneve nga USD 1 në USD 1.80. Rritja e kapitalit do të realizohet nëpërmjet transfertës së USD 12 milion nga llogaria e të ardhurave të pashpërndara.

**Veprimi:** Propozimi u miratua unanimisht

## AMENDIMI I NENIT 6 TE STATUTIT

Propozimi: U propozua amendimi i Nenit 6 të Statutit si më poshtë:

### **Neni 6 – Kapitali**

#### **Totali i Kapitalit Aksioner**

6.1 Totali i kapitalit aksioner të nënshkruar është USD 27,000,000 (njëzet e shtatë milion) dhe numri i aksioneve të autorizuara, mbi bazën e të cilit do të ndahet rezerva e kapitalit është 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milion) aksione. Kapitali i nënshkruar i Bankës i atribuohet Aksionerit Themelues të Bankës.

#### **Kapitali i Paguar**

6.2 Kapitali aksioner i paguar i Bankës është USD 27,000,000 (njëzet e shtatë milion) i cili është kontribut i Aksionerit Themelues në cash

Veprimi: Propozimi u miratua unanimisht me të gjitha votat pro.

Nuk ka të reja të tjera, mbledhja u shtye për në orën 1:30 p.m

\_\_\_\_\_  
Michael D. Granoff  
Kryetar

\_\_\_\_\_  
Page E. Bigelow, Sekretare



REPUBLIKA E SHQIPERISE SH.A  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE  
NR. 3695 REP.  
NR.        KOL.



### VERTETIM

Sot, me date 26.10.2005, para meje noteres Enkeleida Hoxha, notere e Dhomes se Noterise Tirane, me seli ne Bul: "Bajram Curri", prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane u paraqiten personalisht personat e mesiperme, per identitetin e te cileve u sigurova nga dokumentat personale te tyre, te cilet nenshkruan para meje me vullnet te lire dhe te plote Rezoluten e mesiperme, ne prani te perkthyeses dhe une noteria e vertetoj ate sipas ligjit.

### NOTERE

**ENKELEIDA HOXHA**  
Nenshkrimi, Vula

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 3646 Rep.



### VERTETIM

Me anen e te cilit vertetohet firma e perkthyeses Alma Kape e njohur prej meje personalisht, e cila perktheu sa me siper nga gjuha Angleze ne Shqip njelloj me dokumentin original dhe e nenshkroi ate tregullisht.

Tirane, me

26 7 2005

### NOTERE

NOTERE  
E K. E. T. 11  
Mare 1973

A handwritten signature in black ink, enclosed within a circular stamp. The signature is stylized and appears to be "Alma Kape". The circular stamp is partially obscured by the signature.



KIB-20811008

Departamenti i Kontrollit Financiar / AXH  
Nr. Prot. 05/667

2005 NOV -8 P 3 00

Gjykata e Shkalles se Pare, Tirane

Tirane, 31 Tetor 2005

Lenda: Vertetim per hyrje fondesh per Kapitalin e Bankes Amerikane te Shqiperise

I/E Nderuar

Ju konfirmojme se ne llogarine e kapitalit te Bankes Amerikane te Shqiperise eshte derdhur me date 17 Dhjetor 2003 shuma prej USD 2,500,000 (dy milion e peseqind mije dollare amerikane). Kjo shume eshte derdhur ne baze te vendimit te mbledhjes se Jashtezakonshme te Aksionereve te dates 16 shtator 2003.

Me respekt,

Adela Xhemali  
Zv President  
Kontrolli Financiar



KIB-20811008

Departamenti i Kontrollit Financiar / AXH  
Nr. Prot. 02/6670

2005 NGV -8 P 2: 59

Gjykata e Shkalles se Pare, Tirane

Tirane, 31 Tetor 2005

Lenda: Vertetim per hyrje fondesh per Kapitalin e Bankes Amerikane te Shqiperise

I/E Nderuar

Ju konfirmojme se ne llogarine e kapitalit te Bankes Amerikane te Shqiperise eshte derdhur me date 28 Tetor 2005 shuma prej USD 12,000,000 (dymbedhete milione dollare amerikane). Kjo shume eshte derdhur ne baze te vendimit te mbledhjes se Jashtezakonshme te Aksionereve te dates 18 Tetor 2005.

Me respekt,



Adela Xhemali  
Zv President  
Kontrolli Financiar

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**  
**TIRANE**

**Nr. i Vendimit 19460/16**

**VENDIM**  
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot, me daten ~~14~~/11/2006, une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor – Tirane, Teuta Hoxha, pasi studiova kerkesen e paraqitur nga z. Lorenzo Roncari ne cilesine e Presidentit dhe Drejtorit te Pergjithshem Ekzekutiv te Shoqerise Aksionere “American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqiperise” Sh.a, si dhe dokumentat e tjerë bashkengjitur:

**K O N S T A T O V A**

Shoqeria Aksionere “American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqiperise” Sh.a eshte regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregtar nepermjet Vendimit te Gjykates se Rrethit – Tirane, nr. 19460, date 19.05.1998 dhe e ushtron veprimtarine e saj nepermjet Licenses nr. 11, date 10.08.1998, leshuar nga Banka e Shqiperise. Aksioneri i vetem themelues i Bankes eshte “Albanian American Enterprise Fund -- Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermartjeve”.

Me Vendimin Nr. 19460/1, date 17.07.1998 eshte zmadhuar kapitali i Bankes nga 350 000 000 (treqind e pesedhete milion) Leke ne 500 000 000 (peseqind milion) Leke nepermjet emetimit te aksioneve te reja. Gjithashtu nepermjet ketij Vendimi eshte ndryshuar edhe selia e bankes ne adresen: Rruga “Ismail Qemali” Nr. 27, Tirane.

Me Vendimin Nr. 19460/2, date 07.10.1998 eshte ndryshuar neni 8.1 i statutit dhe neni 5 i Aktit te Themelimit te Bankes, sipas Vendimit te Asamblese date 08.09.1998, duke u disponuar ndryshimi i numrit te anetareve te Bordit Drejtues te Bankes.

Me Vendimin Nr. 19460/3, date 16.02.1999 eshte pranuar doreheqja e Z. Piter J. E. Nice nga pozicioni i Drejtorit te Pergjithshem, duke u emeruar ne vend te tij, si Drejtori i Pergjithshem i Bankes Z. Lorenzo Roncari si dhe emerimi i Zj. Lauresha Basha ne postin e Zv. Sekretares se shoqerise.

Me Vendimin nr. 19460/4, date 19.03.1999 jane korrigjuar disa gabime shtypi te nje Vendimi te Asamblese se Aksionereve.

Me Vendimin Nr. 19460/5, date 21.10.1999 eshte zmadhuar kapitali i Bankes nga 500 000 000 (peseqind milion) Leke ne 700 000 000 (shtateqind milion) Leke, nepermjet kontributit te Aksionerit te Vetem Themelues.

dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) ne USD 2,2266 (dy presje dymije e dyqind e gjashtedhete e gjashte dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes). Zmadhimi i kapitalit kryhet nepermjet shlyerjes se menjehershme te vleres totale prej USD 6 400 000 (gjashte milion e katerqind mije dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) nga ana e aksionerit te vetem "Albanian American Enterprise Fund - Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndermarrjeve"; shume kjo e cila perbehet respektivisht nga shuma prej USD 2 300 000 (dy milion e treqind mije dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) qe transferohet nga llogaria e fitimeve te pashperndara dhe shuma prej LEKE 404 225 270 (katerqind e kater milion e dyqind e njezet e pese mije e dyqind e shtatedhete Leke) nga fitimi neto per muajin Qershor 2006.

Nepermjet dokumentacionit shoqerues te kerkeses vertetohet se me date 31.10.2006, eshte derdhur ne llogarine e kapitalit te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, shuma prej USD 6 400 000 (gjashte milion e katerqind mije dollare te Shteteve te Bashkura te Amerikes) ne zbatim te Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve te Bankes date 10 Tetor 2006.

Gjithashtu ne mbledhjen e Asamblese se dates 10 Tetor 2006 eshte vendosur me qellim reflektimin e zmadhimit te kapitalit ne Statutin e Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, qe te ndryshohet Neni 6 i tij, si me poshte vijon:

#### **"Neni 6 – Kapitali**

##### **Kapitali total aksioner**

6.1 *Kapitali total aksioner i nenshkruar i Bankes eshte USD 33 400 000 (tridhete e tre milion e katerqind mije dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) dhe numri i aksioneve te autorizuar ne te cilat do te ndahet ky kapital eshte 15 000 000 (pesembedhete milion) aksione, me vlere nominale USD 2,2266 (dy presje dymije e dyqind e gjashtedhete e gjashte dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) per cdo aksioner. Kapitali i nenshkruar i Bankes i perket teresisht Aksionerit Themelues.*

##### **Kapitali i paguar**

6.2 *Kapitali i paguar i Bankes eshte USD 33 400 000 (tridhete e tre milion e katerqind mije dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) dhe eshte kontribut i Aksionerit Themelues ne para cash."*

Shoqeria ka bere kerkese per depozitimin e Vendimeve te Asamblese se Aksionereve te dates 10 Mars 2004; date 10.03.2005; date 16.03.2006 dhe date 10 Tetor 2006 si dhe te dokumentacionit shoqerues.

Kerkesa eshte e drejte dhe ne perputhje me ligjin dhe,

#### **PER KETO ARSYE**

Ne baze te Ligjit Nr. 7632, date 04.11.1992, "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar"; Ligjit Nr. 8365, date 02.07.1998 "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise"; Nenet 83, 128, 150, 152 te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"; Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 "Per Regjistrin Tregtar dhe

Formalitetet qe Duhet Respektuar nga Shoqerite Tregtare”, si dhe Statutit i Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a

## V E N D O S A

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitim ne Regjistrin Tregtar te Vendimeve te Bordit Drejtues te Aksionerit Themelues respektivisht: Vendimit te dates 10 Mars 2004 me ane te te cilit eshte riemeruar zj. Diane Blane dhe z. Cafo Boga ne cilesine e anetarit te Keshillit Drejtues te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a per nje periudhe prej 3 vjetesh; Vendimit te dates 10.03.2005 me ane te te cilit eshte riemeruar z. Douglas G. Carlston dhe z. Thomas J. Murtagh ne cilesine e anetarit te Keshillit Drejtues te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a per nje periudhe prej 3 vjetesh; dhe Vendimit te dates 16.03.2006 me ane te te cilit eshte riemeruar z. Michael D. Granoff, z. Domenick G. Scaglione dhe z. James H. Duffy ne cilesine e anetarit te Keshillit Drejtues te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a per nje periudhe prej 3 vjetesh.
- Depozitim ne Regjistrin Tregtar te Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Bankes Amerikane te Shqiperise Sh.a, te dates 10 Tetor 2006 se bashku me Vertetimet perkatese per transferimin e vleres prej USD 6 400 000 (gjashte milion e katerqind mije dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes), ne llogarine e kapitalit, per zmadhimin e kapitalit themeltar te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a nga USD 27 000 000 (njezet e shtate milion dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) ne USD 33 400 000 (tridhete e tre milion e katerqind mije dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) zmadhim ky i cili kryhet nepermjet rritjes se vleres nominale te aksionit nga USD 1,80 (nje presje tetedhete dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes) ne USD 2,2266 (dy presje dymije e dyqind e gjashtedhete e gjashte dollare te Shteteve te Bashkuara te Amerikes); si dhe ndryshimin e nenit 6 te Statutit me qellim reflektimin e ketij zmadhimi, ashtu sikunder percaktohet ne Vendimin e Asamblese se dates 10 Tetor 2006.
- Te urdheroj pasqyrimin e ndryshimeve perkatese ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor - Tirane.

GJYQTARE  
TEUTA HOXHA

veud 19460/1  
dy 5526

**KËRKESË**

**GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË  
SEKSIONIT TREGTAR**

**KËRKUESI:** Peter Nice, lindur më datë 3 July 1934, në Danham, Mbretëria e Bashkuar, dhe me numër pasaporte angleze B 379298.

**OBJEKTI:** Depozitim në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë ShA."

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992 'Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar', Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhën Respektuar nga Shoqëritë Tregtare" dhe Ligji Nr. 8075 "Për Sistemin Bankar të Republikës së Shqipërisë", datë 22.02.1996

*Be*  
*depozitimi*  
*17-07-98*  
*22.02.1996*

Sot më datë, 17/07/1998, Unë Peter Nice, me cilësinë e Sekretarit dhe Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.a duke u mbwshtetur në Nenin 33 të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare" si dhe Ligjin Nr. 7638 "Pwr Shoqwrirtw Tregtare" i kërkoj Gjykatës së Rrethit Tiranë të bëjë depozitim në Regjistrin Tregtar të kësaj gjykate të vendimeve të asamblesë së jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë Sh.a., vendime këto të cilat përbëjnë ndryshime në Statutin dhe në Aktin e Themelimit të kësaj Shoqërie. Asabmleja e jashtëzakonshme e aksionerëve e cila është mbledhur në datën 24 Qeshor, 1998 në orën 12.00 paradite në selinë e Shoqërisë "Studio Legale Tonucci" ku ishin të pranishëm Domenick G. Scaglione, Thoams L. Cranmer, Michael D. Granoff, James H. Duffy, të cilët përbëjnë quorumin, morri këto vcdime:

- Rritjen e kapitalin të Shoqërisë "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.a.nga 350,000.000 Lek në 500,000,000 Lek.
- Ndryshimin e adresën së "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.a. në adresën e mëposhtëme "Ismail Qemali" Nr.27, Tiranë.
- Rritjen e Aksioneve të Kapitalit shoqëror të "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.a nga 150,000 deri në 500,000,000 Lek

Bashkangjitur po ju paraqesim Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve e cila është mbledhur në datën 24 Qeshor, 1998.

*Peter Nice*

PETER NICE



Nr. 1010 Rep.  
Nr. - Col.

### VËRTETIM

Sot, më datë 17/07/1998, në Zyrën e Noterisë, para meje Notes, u paraqit personalisht Z. Peter Nice, Qytetar Anglez me Nr. Pas. B379298, me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u binda pasi verifikova letërnjoftim e tij, i cili më deklaroi se e ka përpiluar këtë Kërkesë jashtë Zyrës së Noteres, me vullnetin e tij të lirë, Kërkesë të cilën e nënshkroi përpara meje, dhe unë e vërtetoj atë sipas kërkesave të ligjit.

Notere



*Pauline M...*  
*M...*

**VENDIM I ASAMBLESË SË JASHTËZAKONSHME TE ORTAKËVE TE**

**AMERICAN BANK OF ALBANIA  
BANKA AMERIKANE E SHQIPERISE Sh.A.**

Rruga Ismail Qemali, Pall. 14 kate, Kati II, P.O. 8219, Tirana, Albania  
Tel: 355 42 21966; Fax: 355 42 41967 (phone/fax)

Asambleja e jashtëzakonshme e Aksionerëve të Bankës Amerikane të Shqipërisë u mbledh ditën e Mërkurë më datë 24 Qeshor 1998, në orën 12.00 paradite në selinë e Shoqërisë "Studio Legale Tonucci".

**Janë të pranishëm Personalisht**

Domenick G. Scaglione  
Thomas L. Cranmer  
Michael D. Granoff  
James H. Duffy-

**Të ftuar**

Charles L. Marinaccio  
Peter J.E. Nice



të cilët përbëjnë quorumin

**APROVIM I PROCESVERBALIT TË DATËS 20 PRILL 1998**

Propozim: U bë propozim të miratohet procesverbali i mbledhjes së datës 20 Prill, 1998.

Përgjigje: Propozimi u miratua në mënyrë unanime.

**PROPOZIM DREJTUAR GJYKATËS PËR TË NDRYSHUAR STATUTIN NË MËNYRË QË TË NDRYSHOHET KAPITALI SHOQËROR NGA 350,000,000 LEK DERI NË 500,000,000 LEK**

Propozim: U propozuar që Gjykata të bëjë ndryshimin e Statutit për të rritur kapitalin e shoqërisë nga 350,000,000 Lek në 500,000,000 Lek.

Përgjigje: Propozimi u miratua në mënyrë unanime.

**PROPOZIM DREJTUAR GJYKATËS PËR TË NDRYSHUAR AKTIN E THEMELIMIT PËR TË NDRYSHUAR ADRESËN E BANKËS**

Propozim: U propozuar që Gjykata të bëjë ndryshimin e Aktit të Themelimit për të ndryshura adresën e Bankës në "Ismail Qemali" Nr.27, Tiranë.

Përgjigje: Propozimi u miratua në mënyrë unanime.

**PROPOZIM DREJTUAR GJYKATËS PËR TË RRIJEN NUMRIN E AKSIONEVE NGA 150,000 NË KOHËN QË GJYKATA MUND TË MIRATOJË RRIJEN E KAPITALIT SHOQËROR DERI NË 500,000,000 LEK.**

Propozim: U propozuar që Gjykata të bëjë rritjen e Aksioneve nga 150,000 në kohën që Gjykata miraton kërkesën për Rritjen e Kapitalit shoqëror deri në 500,000,000 Lek

Përgjigje: Propozimi u miratua në mënyrë unanime.

REPUBLIKË E SHQIPËRIE

DREJTORIA E KËRKIMET DHE


NR 1057 EP

NR 302 UL

SHKËRIM

miratohet nga Gjykata e 17.7.1990 (nëntëdhjetë tetë) për të bërë të mundur  
Liqinjtë e aksionit, të cilët janë të përbërë nga personat e shprehur më poshtë:  
i identifikojnë me të njëjtë emrin personat, të cilët kanë marrë pjesë në  
përbërjen e vendit të shprehur më poshtë, të cilët i kanë marrë aksionet e  
përbërjen e aksionit të shprehur më poshtë, në prani të përfaqësues të tyre të cilët  
kërkuan të miratohet kjo rritje.

ACTE NË



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT TIRANË**  
Nr. i Vendimit 19460/1

5526

**VENDIM**

Sot, më datë 19.07 1998, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, M. Dea pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Z. Peter Nice me cilësinë e Sekretarit dhe drejtorit ekzekutiv të Shoqërisë Aksionere "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A. (më poshtë "Banka"), si dhe dokumentat e tjera bashkangjitur,

**KONSTATOVA:**

Shoqëria Aksionere "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A është regjistruar me Vendim Nr. 19460, në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në datën 19 Maj 1998 dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 12.1992, "Për Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet e bëra nga Ligji Nr. 8075, datë 22.02.1996, "Për Sistemin Bankar të Republikës së Shqipërisë". Kjo shoqëri zhvillon aktivitet për një kohëzgjatje të pakufizuar dhe kapitali total i Bankës është treqind e pesëdhjetë milion (350,000,000) lek, dhe numri i aksioneve të autorizuara në të cilën do të ndahet ky kapital është tre milionë e pesëqind mijë (3,500,000) aksione me një vlerë nominale prej njëqind (100) lek për aksion.

Gjithashtu konstatoj se Z. Peter Nice me cilësinë e Sekretarit dhe Drejtorit Ekzekutiv të Shoqërisë "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë Sh.A" i ka bërë kërkesë Gjykatës së Rrethit Tiranë për depozitim në Regjistrin Tregtar të kësaj gjykate të vendimeve të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A., vendime këto të cilat përbëjnë ndryshime në Statutin dhe në Aktin e Themelimit të kësaj Shoqërie. Asambleja e jashtëzakonshme e aksionerëve e cila është mbledhur në datën 24 Qeshor, ka marrë këto vendime:

1. Rritjen e kapitalin të Shoqërisë "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A nga 350,000,000 Lek në 500,000,000 Lek.
2. Ndryshimin e adresën së "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A. në adresën e mëposhtëme "Ismail Qemali" Nr.27, Tiranë.
3. Rritjen e Aksioneve të Kapitalit shoqëror të "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A nga 150,000 deri në 500,000,000 Lek

**PER KËTO ARSYE,**

Meqënëse janë paraqitur të gjitha dokumentat e nevojshme dhe meqënëse unë i gjej ato të bazuara në ligj,

## VENDOSA:

Të pranoj kërkesën e bërë nga Z. Peter Nice, lindur më datë 3 Korrik 1934, në Dagenham, Mbretëria e Bashkuar dhe me numër pasaporte B379298, dhe të urdhëroj depozitimin në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të Vendimeve të Asamblesë së jashtëzakonshme të Aksionerëve të Shoqërisë “American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë” Sh.A.

17/07/1998.

**GJYQTARE**

*Margaret Deane*  
*Art Dera*



BANKA E SHQIPËRIE  
AMERICAN BANK OF ALBANIA

-Departamenti i Operacioneve Monetare-

Nr. 2263

Tirane, me 20 Korrik 1998

L e n d a : Konfirmim per hyrje fondesh

**AMERICAN BANK OF ALBANIA**  
**BANKES AMERIKANE TE SHQIPERISE Sh.A**  
**P.O Box 8319**

**T I R A N E**

Ju konfirmojme se ne favorin tuaj eshte derdhur shuma totale prej 3,000,000.00 (tremilione) USD (dollare amerikane), shume per te cilen eshte kredituar llogaria juaj ne USD prane nesh nr.2252055 dhe ce perfaqeson derchjen e kapitalit te American Bank of Albania-(Bankes Amerikane te Shqiperise Sh.A).

DREJTORI  
Marian GJERMENI



19460/2  
5759

**KËRKESË**

Gj. Akti No. 208/84  
dt. 1.10.93  
Haxhi

**GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË  
SEKSIONIT TREGTAR**

- KËRKUESI:** Z. Peter Nice, lindur më datë 03.07.1934, në Danham, Mbretëria e Bashkuar, dhe me numër pasaporte angleze B 379298, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A. (më poshtë referuar si "Banka").
- OBJEKTI:** Depozitim në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të kësaj Gjykate të Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Bankës.
- BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992, "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar", Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhën Respektuar nga Shoqëritë Tregtare"

Banka është shoqëri anonime e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare me Vendim Nr. 19460, datë 19.05.1998, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe ka marrë licensën e ushtrimit të veprimtarisë si Bankë me Vendim Nr. 11, datë 10.08.1998 lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Aksioneri i vetëm i Bankës është Fondi i Investimeve Shqiptaro-Amerikan. Më datë 08.09.1998 është mbajtur Mbledhja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të Bankës dhe në këtë mbledhje është marrë vendim të ndryshohet Seksionin 8.1 i Statutit dhe Neni 5 i Aktit të Themelimit të saj. Sot, më datë 28.09.1998, Unë Peter Nice, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Bankës, duke u mbështetur në Nenin 33 të Ligjit Nr. 7667, datë 28.01.1993, "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare" si dhe Ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1998, "Për Shoqëritë Tregtare", i kërkoj Gjykatës së Rrethit Tiranë të bëjë depozitim në Regjistrin Tregtar të kësaj gjykate të Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Bankës të datës 08.09.1998. Bashkëngjitur keni një kopje të Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve Bankës.

*Handwritten notes:*  
Në depozitimet  
të bankës  
7-10.93  
Gjykatës  
Dok. Haxhi

**PETER NICE**

*Handwritten signature:*  
Peter Nice

Nr. 2334 Rep.  
Nr. 144 Kol.

**VËRTETIM**

Sot, më datë 28.09.1998, në Zyrën e Noterisë, para meje Noteres, u paraqit personalisht Z. Peter Nice, qytetar anglez me Pas. Nr. B379298, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A., me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u binda pasi verifikova pasaportën e tij, i cili më deklaroi se e ka përpiluar këtë Kërkesë jashtë Zyrës së Noteres, me vullnetin e tij të lirë, Kërkesë, të cilën e nënshkroi përpara meje Noteres, dhe unë e vërtetoj atë sipas kërkesave të ligjit.



Notere  
**NOTERË  
DOLORES ZALOSHNIJA**



**AMERICAN BANK OF ALBANIA**  
**BANKA AMERIKANE e SHQUIPËRISË Sh.A**  
Rruga Ismail Qemali, Pall. 14 Kete, Kati II, P.O. 8219, Tirana, Albania  
Tel: 355 42 41966; 355 42 41967 (phone/fax)

September 22, 1998

exch rate BOA 27/9/99		
# = 134.81 Lek		
	\$	1.167.000

Prepared by *[Signature]*

Checked by *[Signature]* 28/9



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT TIRANË**  
Nr. i Vendimit 19460/5

8226

**VENDIM**

**I GJYQTARIT TË VETËM**

Sot, më datë ...10.1999, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, Altina Xhoxhaj, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga Z. Lorenzo Roncari me cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të Shoqërisë Aksionere "American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A. (më poshtë "Banka"), si dhe dokumentat e tjera bashkëngjitur,

**KONSTATOVA:**

Banka është regjistruar me Vendim Nr. 19460, datë 19.05.1998, në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë, dhe zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me Ligjin Nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet e bëra nga Ligji Nr. 8365, datë 02.07.1998, "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë". Ajo është lincensuar nga Banka e Shqipërisë me licensë nr. 11, datë 11 gusht 1998.

Më datë 27 prill 1999, është mbajtur një mbledhje e Asamblesë së Aksionerëve të Bankës në cilën janë marrë këto vendime që përbëjnë edhe ndryshime në statutin e Bankës:

1. Rritja e kapitalit të Bankës Amerikane të Shqipërisë nga 500,000,000 (pesëqind milionë) lek në 700,000,000 (shtatëqind milionë) lek;
3. Rritja e kapitalit do të bëhet nëpërmjet emetimit të 2,000,000 (dy milionë aksioneve të reja) me vlerë 100 (njëqind) lek për aksion secila prej të cilave 1,573,350 aksione janë paguar nga aksioneri në para dhe pjesa tjetër janë nënshkruar dhe do të paguhet në përputhje me dispozitat e statutit të Bankës Amerikane të Shqipërisë.

Më datë 16.7.1999, Lorenzo Roncari me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës i ka bërë kërkesë Gjykatës së Rrethit Tiranë për depozitim në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të kësaj gjykate të vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme Aksionerëve të Bankës të datës 127.04.1999

**PËR KËTO ARSYE,**

Në bazë të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet e bëra Ligji Nr. 8365, datë 02.07.1998, "Për Bankat në Republikës së Shqipërisë" dhe Ligjit 7667 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhet të plotësohen nga Shoqëritë Tregtare",

**VENDOSA:**


1. Të pranoj kërkesën e bërë nga Z. Lorenzo Roncari, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës;
2. Depozitimën në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë të Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të Bankës datë 27 prill 1999;
3. Të urdhëroj ndryshimet në kolonën nr. 1.5..., dhe nr. rendor 2...f...g... në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të kësaj Gjykate, duke u ndarë këto shënime me vizë të kuqe nga njëri-tjetri.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në shkallë të dytë.

U shpall në Tiranë sot, më datë 21...10.1999.

**GJYQTARE**

ALTINA XHOXHAJ





19460/6  
KËRKESË  
21.09.2000

21 M. D. g. g. g.  
25 APR. 2000  
[Signature]

GJYKATËS SË RRETHIT TIRANË  
SEKSIONIT TREGTAR

**KËRKUESI:** "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Z Lorenzo Roncari, qytetar italian, lindur më datë 08.12.1933, në Bari, Itali, dhe me numër pasaporte italiane 815249J (më poshtë "Banka").

**OBJEKTI:** Depozitim në Regjistrin Tregtar të kësaj Gjykate të vendimit datë 21 dhjetor 1999 të Asamblesë së Aksionerëve të Shoqërisë "American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë" Sh.A.

**BAZA LIGJORE:** Ligji Nr. 7632, datë 04.11.1992 "Për Pjesën e Parë të Kodit Tregtar", Ligji Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që Duhën Respektuar nga Shoqëritë Tregtare" dhe Ligji Nr. 8365, datë 02.07.1998, "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".  
*Te depozitohet kërkesa me anemë un 27/4/2000*

Banka është shoqëri anonime e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 19460, datë 19.05.1998, dhe ushtron aktivitet nëpërmjet licensës Nr. 11, datë 10.08.1998, lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Aksioneri vetëm i Bankës është Fondi i Ndërmarrjeve Shqiptaro-Amerikan.  
*[Signatures]*

Me vendim nr. 19460/1, datë 17.7.1998 është rritur kapitali i Bankës nga 350,000,000 (treqind e pesëdhjetë milion) lekë në 500,000,000 (pesëqind milionë lekë). Me vendim nr. 19460/2 datë 7.10.1998 është ndryshuar numri i anëtarëve të Bordit të drejtorëve të Bankës. Me vendim 19460/3, 16.02.199 është ndryshuar drejtori i përgjithshëm i Bankës dhe në vend të Z. Piter J. E. Nice është caktuar Z. Lorenzo Roncari dhe është emëruar Zv. Sekretarë e Shoqërisë Znj. Lauresha Basha. Me vendim nr. 19460/34, datë 19.03.1999 janë korigjuar disa gabime shtypi të një vendimi të asamblesë së ortakëve. Me vendim nr. 19460/5 datë 21.10.1999 është rritur kapitali i Bankës nga 500,000,000 pesëqind milionë lekë në 700,000,000 shtatëqind milionë lekë.  
*shprehur nga aksionerëve 21.12.99*  
*[Signatures]*

Rregullorja nr. 173, datë 02.12.1998, "Mbi procedurat për dhënie e licensës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë" parashikon se:

"Pagesa e shumës minimale të kapitalit fillestar mund të bëhet në monedhë shqiptare (lek) ose në dollarë amerikanë që përbën kundërvleftën e kapitalit të shprehur në lek, vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit të ditës USD/lek, të llogaritur nga Banka e Shqipërisë në datën e pagimit të licensës. Pasqyrimi i tij në kontabilitet bëhet në monedhën e paguar".

Në bazë të kësaj rregulloreje që nga ky moment Banka Amerikane e Shqipërisë e ka mbajtur gjithnjë në USD kapitalin e saj. Banka e Shqipërisë i ka kërkuar Bankës Amerikane që ta shprehë kapitalin dhe aksionet e saj në dokumentat themelore të saj në USD përderisa edhe në realitet kapitali mbahet në USD. Më datë 21 Dhjetor 1999 është mbajtur mbledhja e jashtëzakonshme e aksionerëve të Bankës Amerikane të Shqipërisë në të cilën është vendosur:

“Të shprehet kapitali aksioner dhe aksionet në të cilën ai është ndarë në USD me kusht që një e tillë të jetë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të pranohet nga gjykata e Tiranës.”

Në të njëjtën mbledhje është vendosur edhe ndryshimi i nenit 6.1 dhe 6.2 i Statutit të Shoqërisë si më poshtë vijon:

**Kapitali Total Aksioner**

6.1 Kapitali total aksioner i nënshkruar i Bankës është katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë USD (\$4,767,000) dhe numri i aksioneve të autorizuara në të cilët duhet ndarë ky kapital është katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë (4,767,000) aksione me vlerë nominale një USD (\$1) për aksion. Kapitali aksioner i kontribuar i Bankës i takon tërësisht nga Aksioneri Themelues.

**Kapitali Fillestar i Paguar**

6.2 Pjesa fillestare e paguar e kapitalit aksioner të kontribuar të Bankës është pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatë dhe 56 cent USD (\$551,007.56), dhe jepet nga Aksioneri Themeltar në kesh. Shuma që mbetet nga kapitali aksioner i kontribuar mund të paguhet në një ose më shumë këste, sipas vendimit të Këshillit të Drejtuesve.

Sot më datë 3.4.2000, unë Lorenzo Roncari, me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës duke u mbështetur në Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 “Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhen Respektuar nga Shoqëritë Tregtare” si dhe Ligjin Nr. 7638 “Për Shoqëritë Tregtare” i kërkoj Gjykatës së Rrethit Tiranë të bëjë depozitim në regjistrin e shoqërive tregtare të kësaj gjykate të vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Bankës vendim i cili bën ndryshime në Statutin e Bankës.


Bashkëngjitur po ju paraqesim Vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të Aksionerëve të Bankës datë 21 dhjetor 1999, si dhe dokumentat e tjerë shoqëruese.

Z. Lorenzo Roncari  
Drejtor i Përgjithshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
Nr. Rep. 618

**VËRTETIM**

Sot, më datë 3.4.2000, para meje Noteres Lindita Lleshi, u paraqit personalisht Z. Lorenzo Roncari, qytetar italian, lindur më datë 08.12.1933, në Bari, Itali, dhe me numër pasaporte italiane 815249J në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të shoqërisë “American Bank of Albania- Banka Amerikane e Shqipërisë” Sh.A., me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u binda pasi verifikova letërnjoftim e tij, i cili më deklaroi se e ka përpiluar këtë Kërkesë jashtë Zyrës së Noteres, me vullnetin e tij të lirë, Kërkesë të cilën e nënshkroi përpara meje, dhe unë e vërtetoj atë sipas kërkesave të ligjit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

NOTERIA TIRANË

Venteshetorësisht

me numër nën

NR 1803/99 DT. 04.04.2000

PULLE TAKSE



25 March 2000

I, Page E. Bigelow, Corporate Secretary of the American Bank of Albania, do hereby swear and attest that an Extraordinary Meeting of the shareholders of the American Bank of Albania was held on Tuesday, December 21, 1999, and that the attached minutes reflect the actions taken by the shareholder.

By Page E. Bigelow

Page E. Bigelow, Secretary of the Board of Directors

State of New York)  
County of New York)

On this 25<sup>th</sup> day of March 2000, before me came Ms Page E. Bigelow, who being sworn before me, deposes and says that the attached minutes fully reflect the resolutions of the shareholder of said Bank and that she has transcribed the same to the best of her knowledge and belief.

By Elizabeth Hernandez  
Notary Public

ELIZABETH HERNANDEZ  
Notary Public, State of New York  
No. 01HE5047225  
Qualified in Bronx County  
Commission Expires 7/31/01





**American Bank of Albania  
Extraordinary Meeting of the Shareholders  
Minutes—December 21, 1999**

An Extraordinary Meeting of the shareholders of the American Bank of Albania was held at 14 East 60<sup>th</sup> Street, Suite 407, in New York, New York, on Tuesday, December 21, 1999 at 5:30 p.m.

**Present In Person**

Domenick G. Scaglione  
Cafo Boga  
Thomas L. Cranmer  
James H. Duffy  
Michael D. Granoff

**By Invitation**

Page E. Bigelow

representing the Shareholder and constituting a quorum.

**PROPOSAL TO DENOMINATE THE SHARE CAPITAL IN USD**

- Motion: It was moved that the Shareholders approve the proposal to denominate the share capital of the American Bank of Albania and the shares in USD, subject to the condition that such denomination is allowed by the Albanian legislation in force and is accepted by the court of Tirana.
- Action: The motion was unanimously approved with all shares being voted in favour.

**AMENDMENT OF ARTICLE 6.1 OF THE CHARTER**

- Motion: It was moved that clauses 6.1 and 6.2 of the Charter of the American Bank of Albania be amended as follows:

***Total Share Capital***

6.1 *The total subscribed share capital of the Bank is USD four million, seven hundred sixty-seven thousand (\$4,767,000) and the number of authorized shares into which such capital stock is to be divided is four million, seven hundred sixty-seven thousand (4,767,000) shares having a nominal value of USD one (\$1) per share. The subscribed share capital of the Bank is wholly attributable to the Founding Shareholder.*

***Initial Paid-In Capital***

6.2 *The initial paid-in portion of the subscribed share capital of the Bank is USD five hundred fifty-one thousand seven and 56 cents (\$551,007.56), and it is contributed by the Founding Shareholder in cash. The remaining amount of the*





subscribed share capital may be paid in one or more installments, according to the decision of the Board of Directors.


Action: The motion was unanimously approved with all shares being voted in favour.


There being no further business, the meeting was adjourned at 5:45 p.m.


Respectfully submitted,


  
Page E. Bigelow, Secretary


  
Domenick G. Scaglione, Chairman

  
Cafo Bogal, Director

  
James H. Duffy, Director

  
Thomas L. Cranmer, Director

  
Michael D. Granoff, Director



NOTERE'  
GJOLIKU  
RANE  
by

NOT  
FBI

*Letra me kokë e Bankës Amerikane të Shqipërisë Sh.A.*

25 mars 2000

Unë, Page E. Bigelow, Sekretare e Shoqërisë American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë deklaroj dhe vërtetoj se të martën, më datë 21 dhjetor 1999 është mbajtur një mbledhje e asamblesë së aksionerëve të American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë dhe se procesverbali i bashkëngjitur pasqyron propozimet e bëra dhe vendimet e marra prej aksionerit.

Prej (nënshkrimi)

Page E Bigelow, Sekretare e Shoqërisë

Shteti New York  
Distrikti New York

Sot më datë 25 mars 2000, para meje u paraqit Znj. Page E. Bigelow, e njohur prej meje të jetë Sekretarja e Shoqërisë American Bank of Albania - Banka Amerikane e Shqipërisë, e cila duke u betuar më deklaroi dhe tha se dokumenti i bashkëngjitur reflekton plotësisht vendimet e Asamblesë së Aksionerëve të Bankës së mësipërme dhe se ajo i ka zbardhur ato me mënyrën më të mirë të mundshme.

Prej (nënshkrimi)

Elizabeth Hernandez, Notere Publike

MYRIAM CAMERINI  
Notere Publike Shteti New York  
Nr. 0111E5047225  
E licensuar në kountin Bronx  
Licensa Skadon më 31.07.2000



**Banka Amerikane e Shqipërisë  
Mbledhje e Jashtëzakonshme e Aksionerëve  
Procesverbal-21 Dhjetor 1999**

Të martën, më 21 Dhjetor 1999 ora 17:30 u mbajt një Mbledhje e Jashtëzakonshme e Aksionerëve të Bankës Amerikane të Shqipërisë në 14 East 60<sup>th</sup> Street, Suite 407, New York

**Të Pranishëm Personalisht**

**Të Ftuar**

Domenick G. Scaglione  
Cafo Boga  
Thomas L. Cranmer  
James H. Duffy  
Michael D. Granoff

Page E. Bigelow

Që përfaqësojnë Aksionerin dhe përbëjnë quorumin

**PROPOZIM PËR TË EMËRTUAR KAPITALIN AKSIONER NË USD**

Propozimi: U kërkua që Aksionerët të miratojnë propozimin e emërimit të kapitalit aksioner të Bankës Amerikane dhe aksioneve në USD, me kusht që ky emërtim të lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe të pranohet nga gjykata e Tiranës.

Veprimi: Propozimi u miratua unanimitisht me të gjitha votat "pro".

**NDRYSHIMI I NENIT 6.1 TË STATUTIT**

Propozim.

U propozua që klauzolat 6.1 dhe 6.2 të Statutit të Bankës Amerikane të Shqipërisë të ndryshohen si më poshtë:

**Kapitali Total Aksioner**

6.1 Kapitali total aksioner i nënshkruar i Bankës është katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë USD (\$4,767,000) dhe numri i aksioneve të autorizuara në të cilët duhet ndarë ky kapital është (4,767,000) katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë aksione me vlerë nominale një USD (\$1) për aksion. Kapitali aksioner i kontribuar i Bankës i takon tërësisht nga Aksioneri Themelues.

**Kapitali Fillestar i Paguar**

6.2 Pjesa fillestare e paguar e kapitalit aksioner të kontribuar të Bankës është USD (\$551,007.56) pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatë dhe 56 cent, dhe kontribuohet nga Aksioneri Themeltar në kesh. Shuma që mbetet nga kapitali aksioner i kontribuar mund të paguhet në një ose më shumë këste, sipas vendimit të Këshillit të Drejtuesve.



Veprimi:

Propozimi u miratua unanimsisht me të gjitha votat "pro".

Meqenëse nuk kishte më çështje të tjera për të diskutuar mbledhja u mbylli në ora 17:45.

Me respekt firmosur nga,

Page E. Bigelow, Sekretare

Domenick G. Scaglione, Kryetar

Cafo Boga, Drejtor

James H. Duffy, Drejtor

Thomas L. Cranmer, Drejtor

Michael D. Granoff, Drejtor



### VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot, më 4.4.2000, deklarova se versioni shqip i dokumentit është një përkthim i saktë i versionit anglisht dhe anasjelltas.

*Xhexhi*  
PËRKTHYESE  
Entela Xhexhi

REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANË  
Nr. ...*1800*... Rep.

### VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot më 4.4.2000, përpara meje, noteres, Liri Gjoliku me zyrë noterie në Tiranë, u paraqit Entela Xhexhi, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, e cila më deklaroi se ka përkthyer dokumentin e mësipërm nga anglishtja në shqip, njëlloj me origjinalin, dhe e nënshkroi atë përpara meje, noteres, dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.



# Letimi Zyrtar

JAN 27 1998 14:01:11 RCVD

**Banka e Shqipërisë**

## Përmbajtje

1. Rregullore për dhënie e licencës për të ushtruar veprimtari bankare  
në Republikën e Shqipërisë.....  
(Miratuar me vendim Nr.173, datë 02.12.98 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

RREGULLORE  
PËR  
DHËNIEN E LICENCËS  
PËR TË USHTRUAR VEPRIMTARI BANKARE  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

(Miratuar me vendimin nr.173, datë 02.12.1998 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

- 1.1. Në këtë rregullore përcaktohen kushtet, afatet dhe procedurat e dhënies së licencës për të vepruar si bankë, degë e bankës së huaj, dhe zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë.
- 1.2. Bazën ligjore të kësaj rregulloreje e përbëjnë : ligji nr. 8269 datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", neni 3, pika 4.c dhe neni 12, ligji nr.8365, datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", kreu i dytë, dhe ligji nr. 7538 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare", si dhe të gjitha aktet nënligjore të nxjerra nga Banka e Shqipërisë.
- 1.3. Banka e Shqipërisë është i vetmi autoritet që leshon licensën si akt administrativ për autorizimin e të drejtës së ushtrimit të veprimtarisë bankare, në mbështetje të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë"
- 1.4. Shuma minimale e kapitalit fillestar të kërkuar, të paguar për kontributin në para, për një bankë është jo më pak se 700 milionë lekë.
- 1.5. Shuma e dhuruar e kapitalit fillestar për një degë të një banke të huaj është 700 milionë lekë.
- 1.6. Për efekt të zbatimit të kësaj rregulloreje termat e perdorura në të do të kenë të njëjtin kuptim si ato të shprehura në nenin 2 të ligjit "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".
- 1.7. Termat vijues të kësaj rregulloreje kanë këto domethënie :
  - a) "Kapitali Fillestar Minimal", përfaqëson shumën minimale të kapitalit të kërkuar nga Banka e Shqipërisë për marrjen e licencës për të vepruar si bankë në Republikën e Shqipërisë.
  - b) " Kapitali Fillestar i Paguar", përfaqëson kapitalin që ka paguar banka për të filluar aktivitetin .



## Neni 2

### **Kapitali fillestar dhe burimet e tij:**

2.1. Pagesa e shumës minimale të kapitalit fillestar mund të bëhet në monedhë shqiptare (Lekë), ose në dollarë amerikanë që përbëjnë kundrvleftën e kapitalit në Lekë, sipas pikës 3.1, vlerësuar me kursin mesatar ditor USD/Lek, të llogaritur nga Banka e Shqipërisë në ditën e pageses së licencës. Pasqyrimi i tij në kontabilitet bëhet me monedhën e paguar.

2.2. Banka e Shqipërisë përcakton ndryshimin e shumës së kapitalit fillestar minimal për bankat, nga një periudhë në tjetrën, dhe e publikon në buletin zyrtar të saj.

2.3. Kapitali fillestar i bankës do të depozitohet në Bankën e Shqipërisë në një llogari depozitë e marrë si garanci (llogari pa interes). Depozitimi do të bëhet me xhirim në llogari dhe jo në *cash*.

2.4. Kur kapitali i nënshkruar i bankës së propozuar është mbi nivelin e shumës së kapitalit minimal fillestar, atëherë si fillim, aksionerët e bankës duhet të paguajnë jo më pak se 1/4 e pjesës së nënshkruar prej tyre, por jo më pak se shumën minimale e kapitalit fillestar. Pjesa e mbetur paguhet me këste ose plotësisht sipas vendimit të këshillit drejtues.

2.5. Shuma e kapitalit fillestar, të paguar, me të cilin banka do të fillojë aktivitetin e saj, do të përcaktojë veprimtarinë financiare të lejuara për bankën, në mbështetje të nenit 26 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

2.6. Burim për kapitalin fillestar aksioner, për krijimin e bankës, nuk mund të jenë hua, kredi, paradhënie nga subjekte të treta.

2.7. Pagesat ose shpenzimet për blerjen ose marrjen me qera të lokaleve të bankës dhe të pajisjeve të punës nuk përfshihen në shumën minimale të kapitalit fillestar të paguar.

## Neni 3

### **Kërkesa për marrjen e licencës**

3.1. Kërkesa për marrjen e licencës për të vepruar si bankë, bëhet me shkrim dhe i paraqitet Bankës së Shqipërisë. Në këtë kërkesë do të deklarohet edhe angazhimi për zbatimin e legjislacionit shqiptar, gjatë veprimtarisë së bankës së propozuar.

3.2. Kërkesa për marrjen e licencës për të vepruar si bankë do të shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për Bankat në

Republikën e Shqipërisë" dhe atë sipas kësaj rregulloreje dhe formularët bashkëngjitur.

3.3. Dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe në dy kopje. Dokumentacioni origjinal në gjuhën e huaj, ose fotokopje e noteruar i tij, të jetë i vërtetuar edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme të vendit ku është lëshuar dokumenti. Ky dokumentacion do të jetë i shoqëruar nga përkthimi në gjuhën shqipe dhe i noteruar.

#### Neni 4

Dokumentacioni i kërkuar do të përfshijë:

#### 4.1. Për kapitalin dhe burimin e tij:

a) Dokumentin që vërteton pagesën e shumës së kapitalit fillestar të nënshkruar.

b) Deklaratën, në të cilën deklarohej që burimi për kapitalin fillestar të bankës nuk është hua, kredi, paradhënie nga subjekte të treta.

#### 4.2. Për themeluesit e bankës:

##### 4.2.1 Kur themeluesit janë persona juridikë :

a) listën e të gjithë themeluesve të bankës, numrin e aksioneve të propozuara për çdo aksioner, vendqëndrimin ose selinë ekzistuese, kombësinë e tyre;

b) të dhënat për veprimtarinë tregtare ose profesionale për 7 vitet e fundit të çdo personi, që propozon të zotërojë, vetë ose së bashku me personat juridikë të lidhur, pjesëmarrjen influencuese të bankës së propozuar, shumën e propozuar për zotërim si dhe bilancet kontabël, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë dhe gjendjen e *cash flow* për aktivitetet e biznesit të tyre në 3 vitet e fundit. Dokumentet e mësipërme të jenë të vërtetuara nga ekspertët e pavarur kontabël ose nga një shoqëri auditimi që ka bërë kontrollin e shoqërisë;

c) të dhëna për reputacionin e themeluesve në komunitetin e biznesit, si dhe të dhëna për lidhje familiare midis tyre;

d) vërtetim nga autoritetet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve të tatimit taksave nga themeluesit e bankës për 3 vitet e fundit të aktivitetit të tyre;

Nëse një bankë të huaj, propozon të zotërojë më shumë se 10 për qind të kapitalit të nënshkruar të një banke, për këtë pjesëmarrje duhet të ketë dhënë pëlqimin autoriteti kompetent, që mbikëqyr veprimtarinë financiare të drejtorisë qendrore të bankës së huaj të interesuar, si dhe, kjo e fundit, të jetë e

autorizuar nga autoritetet përkatëse në vendin e saj për të kryer veprime të pranimit dhe grumbullimit të depozitave në para ose fonde të tjera të ripagueshme në vendin ku drejtorja e saj qendrore ka selinë.

#### **4.2.2. Kur themeluesit janë persona fizikë ose individë:**

- a) Të dhëna për pjesëmarrjen e themeluesve në bordet drejtuese, këshillat mbikëqyrës dhe në organe drejtuese të shoqërive ose të organizatave të biznesit;
- b) Të dhëna për lidhjet që mendohet të ketë midis biznesit të tyre dhe bankës së propozuar;
- c) Dëshmi penaliteti për 3 vitet e fundit;
- ç) Deklaratë personale e secilit prej tyre, ku të deklarohet se nuk egziston rreziku që ndaj tij të ndërmerren në të ardhmen masa penale që mund të kenë ndikim në gjendjen financiare të themeluesve të bankës;
- d) Të dhëna mbi llogaritë bankare që ka çdo themelues (duke dhënë referenca në lidhje me to);
- e) Lista e bizneseve në të cilat themeluesit e bankës kanë pjesëmarrje influencuese, si dhe përqindja e aksioneve që disponon, akti i regjistrimit, numri në regjistrin tregtar, numri i identifikimit të personit në lidhje me pagimin e taksave, të dhëna mbi ndonjë rast falimentimi të tyre;
- f) Lista e të gjithë themeluesve të bankës, së bashku me numrin e aksioneve të propozuara për çdo aksioner, vendqëndrimin ose selinë egzistuese, kombësinë dhe shtetësinë e tyre;
- g) Të dhëna për veprimtaritë tregtare ose profesionale për 7 vitet e fundit të çdo personi fizik ose individ, që propozon të zotërojë pjesëmarrjen influencuese të bankës së propozuar, si dhe shumën e propozuar për zotërim si dhe bilancet kontabël, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë dhe gjendjen e *cash flow* të tyre për 3 vitet e fundit ;
- gj) Të dhëna për reputacionin e personit fizik ose individit themelues të bankës në komunitetin e biznesit, si dhe të dhëna për lidhje familiare midis tyre;
- i) Vërtetim, nga autoritetet përkatëse, për shlyerjen e detyrimeve të tatim taksave nga personi fizik ose individ për 3 vitet e fundit.

#### **4.3.Për administratorët e bankës**

- a) Lista e bizneseve ku ata marrin pjesë, duke përfshirë ato biznese ku zotërojnë aksione ose kanë lidhje biznesi të shoqëruara me informacionin përkatës me të dhënat për veprimtarinë e tyre tregtare ose profesionale për 7 vitet e fundit;

- b) Lista e bizneseve ku ata kryejnë funksione drejtuese;
- c) Raportet financiare aktuale të bizneseve ku kanë pjesëmarrje influencuese apo në të cilat ata kanë funksione drejtuese;
- ç) Informacion për kualifikimin, reputacionin dhe përvojën e administratorëve që propozohen së bashku me emrat e personave rekomandues të tyre me të cilët do të kontaktojnë Banka e Shqipërisë;
- d) Kopje të vendimit të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues të bankës së propozuar, si dhe për dy drejtuesit ekzekutiv.
- e) Deklaratë që vërteton që, asnjë nga faktorët skualifikues të nenit 21 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", nuk vërtetohet tek administratorët e ardhshëm;
- f) Përveç të dhënave të mësipërme, për administratorët e bankës do të kihen parasysh të gjitha kërkesat e parashtruara në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për kërkesat që duhet të plotësojnë administratorët e bankave dhe degëve të bankave të huaja".

**4.4. Planbiznesi i bankës së propozuar.** Themeluesit e bankës së propozuar do të paraqesin planin e veprimtarisë bankare për 3 vitet e para të saj ku të përfshihen:

- a) Vlerësimi : sistemit bankar, konkurrentët, karakteristikat e tregut dhe tendencat e zhvillimit të tij;
- b) Strategjia e bankës së propozuar, objektivat dhe pozicioni i saj në treg;
- c) Veprimtaritë bankare dhe financiare që propozon të kryejë dhe objektivat për të ardhmen;
- ç) Struktura e organizimit të bankës së propozuar. Ajo të jetë e ndërtuar në mënyrë të tillë që të mos pengojë mbikëqyrjen e bankës nga Banka e Shqipërisë, në mënyrë të vetme ose të konsoliduar, dhe që mbikëqyrësi të ketë mundësi të marrë informacionin e duhur;
- d) Parashikimi e gjendjes financiare të bankës së propozuar, për 3 vitet e para të aktivitetit të saj (bilancet kontabël, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, *cash flow*, plani i amortizimit të shpenzimeve paraoperacionale, plani i shpërndarjes së fitimit ose mbulimit të humbjeve, etj.);
- e) Deklaratat financiare dhe parimet mbi të cilat ato janë përgatitur.

Në planin e biznesit dhe në llogaritjen e treguesve të tij duhet të kihen parasysh kërkesat e neneve nr. 30 dhe 31 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.98, "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

## Neni 5

### **Kërkesa shtesë për licencimin e degës së bankës së huaj**

5.1. Një bankë e huaj që kërkon të marrë licencë për të kryer veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet një dege të saj, i dërgon Bankës së Shqipërisë një kërkesë me shkrim të shoqëruar, me dokumentacionin e përmendur në nenin 4 (me përjashtim të paragrafit 4.2.1. dhe 4.2.3.) të këtij neni. Përveç sa më sipër do të paraqitet dhe dokumentacioni i mëposhtëm në lidhje me bankën mëmë:

5.1.1. Leja e ushtrimit të veprimtarisë bankare të dhënë nga autoritetet përkatëse dhe të licencimit, në vendin ku ndodhet selia e saj.

5.1.2. Akti i themelimit dhe statuti i bankës, duke përfshirë të dhënat për adresën e saktë të selisë, përshkrimin e veprimtarisë, shumën e kapitalit, listën e aksionerëve, formën e drejtimit të bankës dhe administratorët e saj.

5.1.3. Llogaritë dhe raportin vjetor, llogaritë dhe raportin vjetor të konsoliduar, si dhe opinionin e ekspertit kontabël të autorizuar, për kontrollin e llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara, për 3 vitet e fundit.

5.1.4. Pëlqimi për hapjen e degës së bankës së huaj në Republikën e Shqipërisë, i dhënë nga autoritetet përkatëse të licencimit dhe mbikëqyrjes në vendin ku banka ka selinë e saj.

5.1.5. Shuma e dhuruar e kapitalit fillestar, e përcaktuar me vendimin e këshillit drejtues të bankës mëmë, por jo më pak se ajo e përcaktuar në nenin 1 pika 1.5.

5.1.6. Dega e bankës së huaj zgjedh dhe emëron të paktën dy administratorë rezidentë për drejtimin e degës së bankës së huaj. Me rezident do të kuptojmë individin, shtetas shqiptar ose shtetas i huaj që vendoset ose është i pranishëm në Republikën e Shqipërisë për një periudhë mbi 183 ditë, pavarësisht nëse kjo periudhë është në vazhdimësi apo me ndërprerje, brenda një viti kalendarik.

5.1.7. (Të paraqesë) Rregullat dhe marrëdhëniet reciproke midis bankës mëmë dhe degës së bankës.

5.2. Degës së bankës së huaj të licencuar nuk i lejohet ushtrimi i veprimtarisë bankare, që nuk kryhet nga banka mëmë.

5.3. Veprimtaritë bankare dhe financiare që do të kryjë dega e bankës së huaj përcaktohen në mbështetje të nenit 26 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" mbi bazën e kapitalit të dhuruar e të paguar nga banka e huaj.

## Neni 6

### Verifikimi i dokumenteve dhe afatet

6.1. Banka e Shqipërisë bën verifikimin e plotësimit të dokumentave të paraqitura në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

6.2. Data e pranimit të kërkesës për licensë, konsiderohet data kur kërkuesi ka plotësuar të gjitha kërkesat, sipas kësaj rregulloreje. Kjo datë i njoftohet me shkrim, nga Departamenti i Mbikëqyrjes, kërkuetit dhe që nga ky moment fillon llogaritja e afatit tremujor të përcaktuar në nenin 10, pika 1 të ligjit nr. 8365 datë 2.7.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

6.3. Banka e Shqipërisë, brenda tre muajve nga data e pranimit të kërkesës për licensë, jep ose refuzon miratimin paraprak për licensë dhe njofton me shkrim kërkuetin për vendimin e saj.

6.4. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, nuk përmbush kërkesat e ligjit nr. 8365 datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore, Banka e Shqipërisë do të dërgojë një njoftim për mangësitë, konfliktet me ligjin si dhe kërkesa për informacion shtesë.

6.5. Mangësitë dhe vërejtjet e tjera të konstatuara në dokumentacionin e paraqitur sipas kësaj rregulloreje, të mënjanohen brenda një muaji nga data e njoftimit të tyre. Në rast të kundërt dokumentet e paraqitura i kthehen për veprim personit që ka paraqitur kërkesën.

## Neni 7

### Miratimi paraprak apo refuzimi i kërkesës për licensë

7.1. Vendimi për dhënie ose refuzimin e miratimit paraprak për licensë merret nga Këshilli i Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 10, pika 2 e ligjit nr 8365, datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

7.2. Dhënia e miratimit paraprak të licensës, ose refuzimi për ta dhënë atë, së bashku me arsyet e këtij refuzimi, i bëhet e njohur me shkrim kërkuetit nga Banka e Shqipërisë brenda pesëmbëdhjetë ditëve pune, pas marrjes së vendimit përkatës.

7.3. Në vendimin e miratimit paraprak për licensë, Banka e Shqipërisë ka të drejtë të përcaktojë kërkesa dhe kushte të arsyetuara shtesë, që duhet të plotësojë banka për të marrë licensën për fillimin e veprimtarisë së saj.

## Neni 8

### Dhënia e licencës

8.1. Banka, dega e bankës së huaj të cilës i është dhënë miratimi paraprak, brenda intervalit kohor njëvjeçar që fillon nga data e dhënies së miratimit paraprak do t'i kërkojë me shkrim, Bankës së Shqipërisë dhënien e licencës përfundimtare, duke paraqitur edhe dokumentacionin e mëposhtëm :

8.1.1. Dokumentin bankar që vërteton kryerjen e pagesës së kapitalit fillestar, apo transferimin efektiv të kapitalit të dhuruar degës së bankës së huaj.

8.1.2 Aktin e regjistrimit si person juridik të bankës ose të degës së bankës së huaj.

8.1.3. Statutin e bankës, aktin e themelimit, shoqëruar me politikat, procedurat dhe rregulloret e brendshme të miratuara nga këshilli i drejtuesve të bankës, të cilat duhet të jenë në përputhje me statutin e saj dhe rregulloret e nxjerra nga Banka e Shqipërisë.

8.1.4. Kopje të vendimit të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve dhe të këshillit drejtues të bankës për marrjen në punë të administratorëve të saj, dhe një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tyre së bashku me specimenet dhe limitet e nënshkrimit për secilin prej tyre.

8.1.5. Aktin e pronësisë ose kontratën qerasë, për lokalet ku do të kryhen operacionet bankare.

8.1.6. Dokumentet e blerjes ose kontratat e qerasë dhe të dhëna të detajuara për pajisjet që do të përdoren për kryerjen e operacioneve bankare (kompjuterat, programe, swift, telekse, telefona, fakse, etj.), për shkallën e automatizimit të proceseve të veprimtarisë, mundësinë e kontrollit dhe standardizimi i informacionit që i jepet drejtuesve të bankës dhe Bankës së Shqipërisë për operacionet e bankës.

8.1.7. Vendimi i këshillit drejtues të bankës ose degës së bankës së huaj për emërimin e ekspertit kontabël të autorizuar dhe kontrata e lidhur me të si dhe të dhëna për emrin, mbiemrin, emërtimin e shoqërisë, adresën, numrin dhe datën e licencës si dhe organin ligjor që e ka lëshuar.

8.1.8. Dokumente të tjera të lëshuara nga organet kompetente, ku të tregohet nëse lokalet e bankës i plotësojnë kërkesat për siguri dhe mbrojtje, si dhe lehtësi të tjera komunikuese dhe mbrojtjeje.

8.1.9. Një vërtetim mbi sigurimin nga zjarri të lokaleve të bankës, të lëshuar nga organet kompetente për parandalimin e zjarreve.

8.2. Banka e Shqipërisë, para dhënies së licensës organizon një verifikim në vend të kushteve në të cilat banka do të zhvillojë aktivitetin, për të përcaktuar nëse janë kryer përgatitjet e nevojshme për fillimin e aktivitetit. Verifikimi përqendrohet nëse banka

ose dega e bankës së huaj ka krijuar kushte për ruajtjen e fondeve, disponon materialet e printuara të nevojshme për kryerjen e aktivitetit bankar si dhe në se janë krijuar kushte për shërbimin ndaj klientit, e të tjera.

8.3. Nëse Banka, brenda një viti nga data e marrjes të vendimit për miratimin paraprak të kërkesës për licencë, nuk plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 8.1 për marrjen e licencës, miratimi paraprak i kërkesës për licencë bëhet i pavlefshëm, me përjashtim të rasteve kur ky afat është shtyrë me vendim të Bankës së Shqipërisë. Në rast se banka edhe pas shtyrjes së afatit nuk i plotëson kërkesat e mësipërme humbet të drejtën për marrjen e licensës.

8.4. Nëse kushtet e përcaktuara në pikën 8.1 të kësaj rregulloreje plotësohen dhe nëse nga verifikimi në vënd, Banka e Shqipërisë bindet se ekzistojnë kushte për të vepruar si bankë, atëherë kjo e fundit me vendim të Këshillit Mbikëqyrës jep licencën për të vepruar si bankë.

## Neni 9

### Publikimi

9.1. Dhënia e licencës, për të vepruar si bankë, publikohet në buletin zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në një ose më shumë nga gazetatat kryesore të vendit me tirazh më të madh.

## Neni 10

### Informacion për fakte të tjera

10.1. Faktet e reja e rrethanat e konstatuara pas dhënies së miratimit paraprak si dhe ndryshimet që ato sjellin në dokumentet e paraqitura të cilat kanë shërbyer si bazë për miratimin paraprak do t'i njoftohen me shkrim Bankës së Shqipërisë nga ana e kërkuesit.

10.2. Njoftimi sipas paragrafit 10.1 do të bëhet brenda 15 ditëve, pas ndodhjes së faktit ose konstatimit të rrethanave përkatëse.

## Neni 11

### Revokimi i licencës

11.1. Licenca e bankës ose e degës së bankës revokohet vetëm me vendim të Bankës së Shqipërisë kur:

- a) kërkohet nga vetë banka e licencuar ose dega e bankës së huaj;



b) ka shkelje të nenit 44, pika 2 dhe nenit 13, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

11.2. Banka e Shqipërisë vendos revokimin e licencës së bankës ose degës së bankës sipas pikës 11.1. shkronjat a dhe b, brenda 30 ditëve pas marrjes së kërkesës me shkrim nga banka ose dega e bankës së huaj, ose konstatimit të shkeljeve të përmendura në pikën 11.1 shkronja b.

11.3. Vendimi për revokimin e licencës i komunikohet menjëherë, me shkrim, bankës përkatëse ose degës së bankës së huaj, duke parashtruar edhe arsyet e revokimit.

11.4. Vendimi për revokimin e licencës publikohet në buletin zyrtar të Bankës së Shqipërisë, dhe në një ose më shumë nga gazetat kryesore të vendit me tirazh më të madh. Vendimi i revokimit hyn në fuqi në datën e përcaktuar nga Banka e Shqipërisë .

11.5. Banka ndalohet të angazhohet në veprimtari bankare e financiare pas hyrjes në fuqi të vendimit të revokimit të licencës dhe detyrohet të likujdojë sa më parë që të jetë e mundur aktivet e saj, të zgjidhë marrdhëniet kontraktore mbi depozitat pa afat dhe të shlyejë detyrimet e saj. Gjatë kësaj kohe banka vazhdon të jetë subjekt i Ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", njësoj sikur të ishte e licensuar.

## Neni 12

### **Regjistrimi në Bankën e Shqipërisë**

12.1. Në mbështetje të nenit 12 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" Departamenti i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë mban një regjistër për konsultim nga publiku, ku regjistrohen të gjitha licencat bankare të dhëna sipas kësaj rregulloreje.

12.2. Në këtë regjistër regjistrohen emri, adresat e selise dhe të degëve, duke përfshirë emrat dhe adresat e administratorëve dhe aksionerëve me pjesëmarrje influencuese, si dhe kopjet aktuale të dokumenteve të renditura në nenin 18 të ligjit nr. 8365, datë 2.7.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

12.3 Një kopje e këtij regjistri mbahet për konsultim publik në çdo përfaqësi rajonale të Bankës së Shqipërisë.

12.4. Me revokimin e licencës bëhet dhe çregjistrimi nga regjistri i bankës ose i degës së bankës. Një listë e licensave të revokuara mbahet në një fletë të veçantë.

## Neni 13

### Kërkesat për zgjerimin ose pakësimin e rrjetit të bankës

13.1. Në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", banka ka të drejtë të hapë degë, agjenci ose zyra përfaqësimi jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vetëm me miratim të Bankës së Shqipërisë.

Për këtë, banka duhet t'i paraqesë një kërkesë me shkrim Bankës së Shqipërisë, duke e shoqëruar kërkesën me këto të dhëna:

- a) Vendndodhja dhe zona e veprimtarisë së degës, agjencisë ose zyrës së përfaqësimit të propozuar;
- b) Një kopje të rregullores së degës, agjencisë ose zyrës së përfaqësimit të propozuar për funksionet, detyrat dhe llojet e operacioneve bankare që do të kryhen;
- c) Një përshkrim të shkurtër të kompetencave të drejtuesit kryesor;
- d) Planin e veprimtarisë së degës, agjencisë ose zyrës bankare, duke pasqyruar në mënyrë të veçantë parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, bilanci kontabël dhe *cash flow* për vitin në vazhdim dhe për dy vitet e ardhshme.

13.2. Banka ka të drejtë të zgjerojë ose të pakësojë numrin e degëve, agjensive e zyrave të përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë, duke njoftuar paraprakisht Bankën e Shqipërisë, e cila ka të drejtë të kundërshtojë zgjerimin e numrit të degëve të bankës, kur ky zgjerim kërcënoni pozitën organizative, financiare dhe mbikëqyrjen e bankës. Dokumentacioni, që do të paraqitet në këtë rast, të jetë ai i kërkuar në pikën 13.1 të kësaj rregulloreje.

13.3. Banka ka të drejtë të hapë filial, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, vetëm me miratim të Bankës së Shqipërisë duke dërguar tërë dokumentacionin e kërkuar në pikën 13.1. si dhe listën e aksionerëve të tjerë në përbërje të këtij filiali.

13.4. Miratimi ose refuzimi i kërkesës sipas pikave 13.1, 13.2 dhe 13.3 të kësaj rregulloreje, jepet nga Banka e Shqipërisë, brenda një muaji nga data e paraqitjes së plotë të kërkesës.

## Neni 14

### **Komisionet**

Banka e Shqipërisë në mbështetje të nenit 11, pika 4 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" vendos komisionet e mëposhtme:

14.1. Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit, kërkuesi paguan në Bankën e Shqipërisë një komision prej 300.000 lekë.

14.2. Në momentin e dhënies së licencës kërkuesi paguan në Bankën e Shqipërisë një komision, prej 200.000 lekë.

14.3. Për blerjen e paketës së licencimit (përfshirë ligjet) paguhet shuma 10.000 lekë.

14.4. Këto komisione nuk rimbursohen, pavarësisht në se miratohet ose jo kërkesa për dhënie licence.

## Neni 15

### **Bashkimi, shkrirja, ndarja dhe shitja e aktiveve të bankës**

15.1. Në rast se një bankë kërkon të bashkojë, të shkrijë, të ndajë ose të shesë aktivet e saj duhet t'i drejtojë një kërkesë me shkrim Bankës së Shqipërisë ku të sqarohen arsyet e bashkimit, shkrirjes, ndarjes, ose të shitjes. Vetëm pas marrjes së këtij pëlqimi nga Banka e Shqipërisë, banka lejohet të fillojë procedurat për të marrë vendimet e nevojshme lidhur me bashkimin, shkrirjen, ndarjen, ose shitjen.

15.2. Vendimi i marrë për bashkimin, shkrirjen, ndarjen dhe shitjen në një masë të konsiderueshme të aktiveve të bankës, hyn në fuqi pas miratimit nga Banka e Shqipërisë. Vendimi bazohet në kriteret e parashikuara në nenet 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje, si në rastin e një licencimi të ri. Kërkesa për miratimin e këtij vendimi duhet të përmbajë edhe :

- a) Marrëveshjen (kontratën) e bashkimit, shkrirjes, ndarjes dhe shitje së aktiveve të bankës;
- b) Raportin e ekspertit kontabël lidhur me vendimin për bashkimin, shkrirjen, ndarjen dhe shitjen e aktiveve të bankës, si dhe për zbatimin e marrëveshjes së nënshkruar për këtë qëllim;
- c) Përshkrimin e përparësive të organizimit të ri me theks të vecantë në rezultatet e aktivitetit.

15.3. Për rastet kur bashkimet, ndarjet dhe shkrirjet çojnë në krijimin edhe të një banke të re, kjo e fundit do të nënshtrohet të gjitha rregullave për licensimin si e tillë në bazë të neneve 9 dhe 10 të ligjit nr.8365, datë 02.07.1998 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe të dispozitave përkatëse të kësaj rregulloreje.

15.4. Banka e Shqipërisë do të miratojë ato bashkime, shkrirje, ndarje dhe shitje në një masë të konsiderueshme të aktiveve të bankës, që veç të tjerash, nuk vendosin strukturat monopoliste të tregut bankar dhe nuk rrezikojnë pozicionin e depozituesit.

15.5. Afati maksimal, për shqyrtimin e dokumentacionit dhe për miratimin ose refuzimin e bashkimit, shkrirjes, ndarjes dhe shitjes në një masë të konsiderueshme të aktiveve të bankës, është tre muaj nga plotësimi i dokumentacionit.

## Neni 16

### Kërkesat për licencë për zyrë përfaqësimi

16.1. Bankat e huaja, që duan të hapin zyrë përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë, do të marrin paraprakisht një miratim nga Banka e Shqipërisë. Për të hapur një zyrë përfaqësimi, kërkuesi duhet të paraqesë në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a). Lejen e ushtrimit të veprimtarisë bankare të dhënë nga autoritetet përkatëse në vendin ku ndodhet selia e bankës;
- b). Aktin e themelimit dhe statutin e bankës, duke përfshirë të dhënat për adresën e saktë të selisë, përshkrimin e veprimtarisë, dokumentin ligjor që vërteton shumën e fundit të kapitalit, listën e aksionerëve, formën e drejtimit të bankës dhe administratorët e saj;
- c). Kohëzgjatjen e parashikuar të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë, emërtimin e zyrës që do të hapet, adresën e saj dhe numrin e telefonit;
- ç). Qëllimin e krijimit të saj;
- d). Emrin e personave të propozuar për drejtues të zyrës së përfaqësimit dhe *curriculum vitae* të tyre (arsimin, profesionin, eksperiencën, etj) dhe numrin e punonjësve të zyrës;
- e). Aktin e regjistrimit të zyrës së përfaqësimit në Republikën e Shqipërisë;
- f). Vendimin e këshillit drejtues të bankës për hapjen e një zyre përfaqësimi në Republikën e Shqipërisë.

16.2. Emërtimi i përdorur nga zyra e përfaqësimit e një banke të huaj duhet të korrespondojë me emrin e bankës mëmë duke shtuar fjalët "zyrë përfaqësimi në Shqipëri".

16.3. Afati maksimal i shqyrtimit të këtij dokumentacioni dhe dhënia e miratimit ose jo nga Banka e Shqipërisë do të jetë brenda dy muajve nga data e paraqitjes së kërkesës dhe plotësimit të dokumentacionit konform pikës 16.1 të këtij neni.

### Neni 17

#### **Ndryshimi i titullit të pronësisë të bankës**

17.1. Kur një person kërkon të blejë aksione në masën në ose mbi 10 përqind të kapitalit aksioner të një banke në Republikën e Shqipërisë, pas miratimit nga asambleja e aksionerëve të bankës, banka që do të shesë aksione të saj duhet të marrë miratimin nga Banka e Shqipërisë për transferimin e titullit të pronësisë mbi këto aksione.

17.2. Personi që kërkon të sigurojë pjesëmarrje në kapitalin aksioner të një banke duhet të deklarojë se do të ruajë interesat e klientëve të saj dhe që fondet e destinuara për këtë qëllim nuk burojnë nga hua, kredi dhe paradhënie nga burime të tjera.

17.3. Personi, i cili aplikon për marrjen e miratimit për të qenë aksioner i bankës, do të paraqesë dokumentacionin e kërkuar në pikën 4.2.1. dhe 4.2.3. të kësaj rregulloreje.

17.4. Banka e Shqipërisë jep miratimin ose refuzon transferimin e titullit të pronësisë mbi aksionet jo më vonë se dy muaj nga data kur dokumentacioni është paraqitur i plotë.

### Neni 18

#### **Dispozita përfundimtare**

18.1. Pjesë e pandarë e kësaj rregulloreje janë formularët bashkëlidhur që do të plotësohen sipas kësaj rregulloreje.

18.2. Rregullorja e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë miratuar me vendimin nr.15, datë 28.06.1996 si dhe amendamentet e miratuara me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 43, datë 31.03.1998, shfuc izohen.

18.3. Kjo rregullore hyn në fuqi më 1.1.1999.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT TIRANË  
Nr. i Vendimit 19460/6

**VENDIM**  
**I GJYQTARIT TË VETËM**

Sot, më datë 27.04.2000, unë gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Tiranë, M. Dugg, pasi studiova kërkesën e paraqitur nga shoqëria aksionere American Bank of Albania-Banka Amerikane e Shqipërisë” Sh.A (më poshtë “Banka”), e përfaqësuar prej drejtorit të përgjithshëm Z. Lorenzo Roncari si dhe dokumentat e tjera bashkëngjitur,

**KONSTATOVA:**

Banka është shoqëri anonime e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare me Vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr. 19460, datë 19.05.1998, dhe ushtron aktivitetet nëpërmjet licensës Nr. 11, datë 10.08.1998, lëshuar nga Banka e Shqipërisë. Aksioneri i vetëm i Bankës është Fondi i Ndërmarrjeve Shqiptaro-Amerikan.

Me vendim nr. 19460/1, datë 17.7.1998 është rritur kapitali i Bankës nga 350,000,000 (treqind e pesëdhjetë milion) lekë në 500,000,000 (pesëqind milionë lekë). Me vendim nr. 19460/2 datë 7.10.1998 është ndryshuar numri i anëtarëve të Bordit të drejtorëve të Bankës. Me vendim 19460/3, 16.02.199 është ndryshuar drejtori i përgjithshëm i Bankës dhe në vend të Z. Piter J. E. Nice është caktuar Z. Lorenzo Roncari dhe është emëruar Zv. Sekretare e Shoqërisë Znj. Lauresha Basha. Me vendim nr. 19460/34, datë 19.03.1999 janë korrigjuar disa gabime shtypi të një vendimi të asamblesë së ortakëve. Me vendim nr. 19460/5 datë 21.10.1999 është rritur kapitali i Bankës nga 500,000,000 pesëqind milionë lekë në 700,000,000 shtatëqind milionë lekë.

Rregullorja nr. 173, datë 02.12.1998, “Mbi procedurat për dhënien e licensës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë” parashikon se:

“Pagesa e shumës minimale të kapitalit fillestar mund të bëhet në monedhë shqiptare (lek) ose në dollarë amerikanë që përbën kundërvleftën e kapitalit të shprehur në lek, vlerësuar me kursin mesatar të këmbimit të ditës USD/lek, të llogaritur nga Banka e Shqipërisë në datën e pagimit të licensës. Pasqyrimi i tij në kontabilitet bëhet në monedhën e paguar”.

Në bazë të kësaj rregulloreje që nga ky moment Banka Amerikane e Shqipërisë e ka mbajtur gjithnjë në USD kapitalin e saj. Banka e Shqipërisë i ka kërkuar Bankës Amerikane që ta shprehë kapitalin dhe aksionet e saj në dokumentat themelore të saj në USD përderisa edhe në realitet kapitali mbahet në USD

Më datë 21 Dhjetor 1999 është mbajtur mbledhja e jashtëzakonshme e aksionerëve të Bankës Amerikane të Shqipërisë në të cilën është vendosur:

1. "Të shprehet kapitali aksioner dhe aksionet në të cilën ai është ndarë në USD me kusht që një e tillë të jetë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të pranohet nga gjykata e Tiranës."
2. Të ndryshohet neni 6.1 dhe 6.2 i Statutit të Bankës si më poshtë vijon:

**Kapitali Total Aksioner**

6.1 Kapitali total aksioner i nënshkruar i Bankës është USD 4,767,000 (katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) dollarë amerikanë dhe numri i aksioneve të autorizuara në të cilët duhet ndarë ky kapital është 4,767,000 (katër milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë) aksione me vlerë nominale një USD (\$1) për aksion. Kapitali aksioner i kontribuar i Bankës i takon tërësisht nga Aksioneri Themelues.

**Kapitali Fillestar i Paguar**

6.2. Pjesa fillestare e paguar e kapitalit aksioner të kontribuar të Bankës është USD 551,007.56 (pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatë dhe pesëdhjetë e gjashtë, dhe jepet nga Aksioneri Themelues në kesh. Shuma që mbetet nga kapitali aksioner i kontribuar mund të paguhet në një ose më shumë këste, sipas vendimit të Këshillit të Drejtuesve."

Më datë 3.4.2000, Lorenzo Roncari me cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës i ka bërë kërkesë Gjykatës së Rrethit Tiranë për depozitim në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të kësaj gjykate të vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme Aksionerëve të Bankës të datës 21.12.1999


**PËR KËTO ARSYE,**

Në bazë të Ligjit Nr. 7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare", me ndryshimet e bëra Ligji Nr. 8365, datë 02.07.1998, "Për Bankat në Republikës së Shqipërisë" dhe Ligjit 7667 "Për Regjistrin Tregtar dhe Formalitetet që duhet të plotësohen nga Shoqëritë Tregtare", dhe në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë nr. 173, datë 02.12.1998, "Mbi procedurat për dhënien e licencës për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë"

**VENDOSA:**

1. Të pranoj kërkesën e bërë nga Banka Amerikane e Shqipërisë;
2. Depozitimim në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë të Vendimit të Asamblesë së Aksionerëve të Bankës datë 21 dhjetor 2000;
La presente copia, composta di n. 19  
pag. è conforme all'originale depositato  
presso l'Ufficio di Registro di Torino.  
Torino, il 19-1-2006  
Il Funzionario




Il Conservatore  
**Ezio Carlo CORAZZINI**  
CATEGORIA C



EMBASSY OF REPUBLIC OF ALBANIA  
ROME

No. 1988  
Hereby is certified the authenticity of signing of Mrs./Mr  
Bujar BAKRAMA  
in the capacity/ren. funktion  
Official seal / dhe vula zyrtare  
ROMA 25.01.2006  
BUJAR BAKRAMA  
ROMA 25.01.2006





**SANPAOLO IMI**

**STATUT**

**SANPAOLO IMI S.p.A.**

Shoqëri e regjistruar në Regjistrin e Bankave

Drejtuese e Grupit Bankar ~~SANPAOLO IMI~~

i regjistruar në Regjistrin e Grupeve Bankare

me Seli në Torino, Piazza San Carlo nr. 156

Kapitali themeltar Euro 5.236.973.940,80 tërësisht i derdhur

Kodi Fiskal, NIPT-i dhe numëri i regjistrimit

pranë Regjistrit Tregtar të Torinos: 06210280019

Kodi ABI 1025-6

Anëtare e Fondit Ndërbankar për Mbrojtjen e Depozitave

PËRMBAJTJA

KREU I	THEMELIMI - SELIA - KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI I SHOQËRISË	f. 4
KREU II	KAPITALI I THEMELTAR DHE AKSIONET	f. 5
KREU III	ASAMBLEJA E AKSIONARËVE	f. 6
KREU IV	ADMINISTRIMI DHE DREJTIMI	f. 8
KREU V	DREJTORI I PËRGJITHSHËM	f. 12
KREU VI	KOMITETI I KONTROLLIT DHE KONTROLLI I SHOQËRISË	f. 13
KREU VII	PËRFAQËSIMI LIGJOR	f. 15
KREU VIII	LLOGARITË VJETORE DHE SHPËRNDARJA E FITIMIT	f. 16
KREU IX	ORGANET STATUTORE	f. 17
KREU X	TËRHEQJA NGA SHOQËRIA	f. 17
KREU XI	PRISHJA E SHOQËRISË	f. 17



**KREU I**  
**THEMELIMI – SELIA – KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI I**  
**SHOQËRISË**

**NENI 1**

Emërtimi i Shoqërisë është "SANPAOLO IMI S.p.A.". Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë anonime.

Shoqëria është Bankë në kuptimin e Dekretit Legjislativ nr. 385, datë 1 shtator 1993.

**NENI 2**

- 2.1 Shoqëria e ka selinë në Torino. Ajo ka gjithashtu degë në Romë dhe Bolonjë.
- 2.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Shoqëria mund të hapë ose mbyllë degë, agjenci dhe përfaqësi në Itali dhe jashtë saj.

**NENI 3**

- 3.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është caktuar deri më 31.12.2050.
- 3.2 Zgjatja e afatit të Shoqërisë bëhet nga Asambleja e jashtëzakonshme e aksionarëve e cila vendos me shumicën e parashikuar në ligj.

**NENI 4**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt pranimin dhe grumbullimin e depozitave nga publiku si dhe ushtrimin e kredisë, në format e saj më të ndryshme, në Itali dhe jashtë saj.
- 4.2 Brenda kufijve të lejuara nga dispozitat në fuqi, Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet dhe shërbimet bankare e financiare, si dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm apo megjithatë të lidhur me përmbushjen e objektit të saj.
- 4.3 Shoqëria – në cilësinë e Drejtueses së Grupit Bankar SANPAOLO IMI, sipas nenit 61 të Dekretit Legjislativ nr. 385, datë 1 shtator 1993 – në ushtrimin e aktivitetit drejtues dhe bashkërendues, nxjerr urdhëra për anëtarët e Grupit në lidhje me zbatimin e udhëzimeve të dhëna nga Autoritetet Mbikqyrëse në interes të qëndrueshmërisë së vetë Grupit.

**NENI 5**

5.1 Në përputhje me dispozitat në fuqi, Shoqëria mund të emetojë obligacione dhe tituj të tjerë.

**KREU II  
KAPITALI I THEMELTAR DHE AKSIONET**

**NENI 6**



Kapitali themeltar është caktuar në Euro 5.236.973.940,80 tërësisht i derdhur, i ndarë në 1.482.013.818 aksione nominative të zakonshme dhe 388.334.018 aksione nominative me përparësi me vlerë nominale 2,80 Euro seicili. Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe nëpërmjet emetimit të aksioneve që japin të drejta të ndryshme nga ato të mbartura nga aksionet e emetuara më parë.

6.2 Aksionet emetohen në mënyrë jomateriale.

6.3 Aksionet me përparësi janë përqëndruar në një ose më shumë depozita të administruara pranë Shoqërisë dhe Shoqëria është depozituesja e vetme e autorizuar. Tjetërsimi i aksioneve me përparësi i komunikohet pa vonesë Shoqërisë nga aksionari shitës dhe përbën konvertimin automatik të aksioneve me përparësi në aksione të zakonshme, përveç rastit kur shitja i bëhet një subjekti që zotëron të gjithë kapitalin. Më datë 1 korrik 2012 aksionet me përparësi do të shndërrohen në aksione të zakonshme me të njëjtat karakteristika me aksionet e zakonshme në qarkullim në atë moment.

6.4 Në rast zmadhimi të kapitalit me para në dorë për të cilin nuk është përjashtuar apo kufizuar e drejta e opsionit, zotëruesit e aksioneve me përparësi kanë të drejtën e opsionit mbi aksionet me përparësi me të njëjtat karakteristika, ose, në mungesë apo për pjesën e mbetur, sipas rendit, mbi aksionet me përparësi me karakteristika të ndryshme, mbi aksionet e kursimit apo aksionet e zakonshme.

6.5 Sipas mandatit të dhënë nga Asambleja më datë 30 prill 2002, Këshilli Drejtues ka të drejtë të zmadhojë me para në dorë kapitalin themeltar, edhe më shumë se një herë, për një vlerë nominale maksimale Euro 51.440.648,00 (pesëdhjetë e një milionë e katërqind e dyzetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) duke emetuar aksione të zakonshme të cilat duhet t'i rezervohen për nënshkrim, sipas nenit 2441, paragrafi tetë, i Kodit Civil dhe nenit 134 të Dekretit Legjislativ nr. 58, datë 24 shkurt 1998, nëpunësve të Shoqërisë ose dhe nëpunësve të shoqërive të kontrolluara në kuptimin e nenit 2359 të Kodit Civil pjesëmarrës në plane të nxitjes aksionare të miratuar nga po ky Këshill. E drejta e mësipërme mund të ushtrohet brenda datës 27 prill 2007.





6.6 Në vijim të vendimeve të marra nga Këshilli Drejtues më datë 18 dhjetor 2001, mbi bazën e mandatit të dhënë nga Asambleja më datë 31 korrik 1998, dhe më datë 17 dhjetor 2002, mbi bazën e mandatit të dhënë nga Asambleja e datës 30 prill 2002, kapitali themeltar mund të zmadhohet për një vlerë nominale maksimale Euro 15.845.200,00 (pesëmbëdhjetë milionë e tetëqind e dyzetë e pesë mijë e dyqind).

#### NENI 7

- 7.1 Në rast të zmadhimit të kapitalit themeltar, të vendosur nga Asambleja, rregullat dhe kushtet që lidhen me emetimin e kapitalit të ri, datat dhe modalitetet e derdhjes përcaktohen nga Këshilli Drejtues.
- 7.2 Mbi pagesat e vonuara llogariten, me të drejta të plota, interesat vjetore në masën që do të vendoset nga Këshilli Drejtues, që megjithatë nuk e kalojnë me më shumë se 3% përqindjen zyrtare të referencës, duke mos e shkarkuar aksionarin që nuk kryen pagesën e shumave të caktuara nga pasojat ligjore dhe duke mos kufizuar përgjegjësinë e kaluesit dhe xhiruesit të aksioneve të pa çliruara.
- 7.3 Kontributet mund të kenë si objekt edhe sende të ndryshme nga paraaja.
- 7.4 Shoqëria mund të riblejë aksionet e veta brenda kufijve dhe sipas modaliteteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

### KREU III ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

#### NENI 8

- 8.1 Asambleja e aksionarëve është e zakonshme ose e jashtëzakonshme sipas ligjit dhe mund të mbledhet në Itali edhe jashtë selisë së Shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e zakonshme thirret të paktën një herë në vit brenda njëqind e njëzetë ditësh nga mbyllja e vitit financiar. Në rastet e lejuara nga ligji, Asambleja mund të thirret brenda njëqind e tetëdhjetë ditëve.
- 8.3 Asambleja e jashtëzakonshme thirret për të vendosur mbi çështje që i asaj i janë rezervuar nga ligji.
- 8.4 Për sa nuk cënohen tagrat e thirrjes të parashikuara nga dispozita të posaçme ligjore, Asambleja thirret nga Kryetari i Këshillit Drejtues ose nga zëvendësuesi i tij sipas afateve dhe modaliteteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

NENI 9

9.1 Kanë të drejtë të marrin pjesë në Asamble aksionarët me të drejtë vote që paraqesin çerfikatat e posaçme të pjesëmarrjes në sistemin e administrimit të përqëndruar të aksioneve. Për të marrë pjesë në Asamble nuk kërkohet depozitimi paraprak i parashikuar në nenin 2370 të Kodit Civil.

Aksionarët mund të përfaqësohen në mbledhjet e Asamblesë sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 10

10.1 Çdo aksion i jep zotëruesit të drejtën e një vote. Zotëruesit e aksioneve me përparësi nuk kanë të drejtë vote në Asambletë e zakonshme.

NENI 11

11.1 Asambleja e zakonshme dhe Asambleja e jashtëzakonshme janë të vlefshme, si në mbledhjen e parë ashtu edhe në mbledhjen e dyte, dhe për sa i përket Asamblesë së jashtëzakonshme në mbledhjen e tretë, si dhe vendimet përkatëse janë të vlefshme, nëse respektohen dispozitat ligjore në fuqi.

11.2 Për emërimet në organet e Shoqërisë Asembleja mund të vendosë me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm apo të përfaqësuar. Në rast barazie votash konsiderohet i zgjedhur kandidati në moshë më të madhe. Për emërimin e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit zbatohen dispozitat e parashikuara në nenin 20.

NENI 12

12.1 Asembleja, funksionimi i së cilës rregullohet nga ligji dhe nga Rregullorja përkatëse e miratuar nga mbledhja e saj e zakonshme, kryesohet nga Kryetari i Këshillit Drejtues ose nga zëvendëzuesi i tij.

12.2 Nëse konsiderohet e nevojshme, Asambleja me propozim të Kryetarit emëron dy ose më shumë shqyrtues votash dhe një Sekretar të cilët mund edhe të mos jenë aksionarë.

12.3 Prania e Sekretarit nuk është e nevojshme nëse procesverbali i Asamblesë redaktohet nga një Noter. Noteri caktohet nga Kryetari i Asamblesë.

12.4 Kryetari i Asamblesë verifikon rregullsinë e mbledhjes, sigurohet për identitetin e të drejtën për të marrë pjesë, rregullon zhvillimin dhe

garanton rezultatet e votimeve. Për të përmbushur detyrat e mësipërme Kryetari mund të kërkojë ndihmën e disa të ngarkuarve të posaçëm.

12. Në rasti se nuk arrihet të shqyrtohen në një ditë të vetme të gjitha çështjet përcaaktuara në rendin e ditës, Asambleja mund të vendosë që t'a vazhdojë mbledhjen e saj ditën e punës që vijon.

#### NENI 13

- 13.1 Vendimet e Asamblesë duhet të rezultojë nga një procesverbal i nënshkruar nga Kryetari, shqyrtuesit e votave, nëse janë emëruar të tillë dhe nga Sekretari apo nga Noteri.
- 13.2 Kopjet dhe estraktet e procesverbaleve, nëse nuk redaktohen nga Noteri, do të vërtetohen nga një deklaratë njehsimi me origjinalin, e nënshkruar nga Kryetari dhe Sekretari.

### KREU IV ADMINISTRIMI DHE DREJTIMI

#### NENI 14

- 14.1 Shoqëria administrohet nga një Këshill Drejtues i përbërë nga 7 deri në 20 anëtarë, sipas përcaktimit të bërë nga Asambleja. Asambleja gjithashtu emëron midis tyre Kryetarin e Këshillit Drejtues.
- 14.2 Anëtarët e Këshillit Drejtues qëndrojnë në këtë detyrë tre vite financiare dhe janë të rizgjedhshëm.
- 14.3 Shkarkimi, zëvendësimi, përfundimi i mandatit dhe dorëheqja e anëtarëve të Këshillit Drejtues rregullohen nga legjislacioni në fuqi.
- 14.4 Nëse për shkak të dorëheqjes apo arsyeve të tjera mungon shumica e anëtarëve të Këshillit Drejtues të zgjedhur nga Asambleja, të gjithë anëtarëve të Këshillit Drejtues i përfundon mandati dhe anëtarët e mbetur në detyrë duhet të thërresin pa vonesë Asamblesë për emërimin e Këshillit të ri Drejtues.

#### NENI 15

- 15.1 Këshilli Drejtues mund të emërojë, midis anëtarëve të tij, një apo më shumë Zëvendës Kryetarë.
- 15.2 Këshilli Drejtues emëron, duke i përcaktuar kompetencat, një apo më shumë Administratorë të Deleguar, si dhe Komitetin Ekzekutiv, duke i përcaktuar numërin e anëtarëve, detyrat, kohëzgjatjen, rregullat e

funkcionimit dhe tagrat. Në Komitetin Ekzekutiv bëjnë pjesë për shkak të detyrës Kryetari, Zëvendës Kryetari/ët, si dhe Administratori/ët i/e Deleguar.

15.3 Këshilli Drejtues gjithashtu mund të themelojë, midis anëtarëve të tij, Komitete Teknike të posaçëm, me funksione këshillimore, hetimore dhe kontrolli.

- 15.4 Këshilli Drejtues mund të emërojë një Drejtor të Përgjithshëm duke i përcaktuar kohëzgjatjen e mandatit, tagrat, kompetencat dhe shpërblimin. Nëse nevojitet, Këshilli Drejtues vendos edhe për heqjen e tij.
- 15.5 Drejtori i Përgjithshëm merr pjesë me funksione këshillimore në mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe të Komitetit Ekzekutiv dhe ka të drejtë të propozojë në përputhje me sa parashikohet në Statut.
- 15.6 Me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm Këshilli Drejtues mund të emërojë, një apo më shumë Zëvendës Drejtorë të Përgjithshëm si dhe Drejtuesit Qëndrorë duke i përcaktuar tagrat dhe kompetencat.
- 15.7 Për lloje të caktuara aktesh dhe veprimesh, gjithashtu mund t'u delegohen tagra, sipas procedurave të parashikuara në ligj, Drejtuesve, drejtorëve të agjencive dhe personelit, duke përcaktuar kufijtë dhe modalitetet e ushtrimit të tyre dhe me parashikimin që përfaqësuesit të mund të veprojnë veçmas apo së bashku në komitete.
- 15.8 Për sa i përket aktiviteteve të kreditimit të posaçëm dhe/ose me kushte lehtësuese të parashikuara në dispozita të posaçme edhe mund t'u delegohen tagra vendimarrëse dhe shpërndarje enteve kredituese të Grupit, brenda kufijve dhe sipas kritereve që do të jenë objekt marrëveshje midis palëve.
- 15.9 Këshilli Drejtues do të përcaktojë modalitetet se si do t'i njoftohen vetë atij vendimet e marra nga të deleguarit.
- 15.10 Organet e Deleguara dhe Drejtori i Përgjithshëm kujdesen që struktura organizative, administrative dhe kontabël të jetë e përshtatshme dhe që të raportojë çdo tre muaj pranë Këshillit Drejtues dhe Komitetit të Kontrollit, mbi administrimin e përgjithshëm e mbi zhvillimet e parashikuara, si dhe mbi veprimet e një rëndësie të madhe të realizuara nga Shoqëria dhe nga të kontrolluarat e saj.
- 15.11 Anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të Komitetit Ekzekutiv i përket një shpërblim vjetor i përcaktuar nga Asambleja, pjesërisht në masë fikse dhe pjesërisht në masë të ndryshueshme.

15.12 Asambleja mund t'i shtojë shpërblimit të mësipërm pagesën e një shume fikse ndaj secilit Anëtar për çdo pjesëmarrje në mbledhje; Anëtarët kanë gjithashtu të drejtë t'u rimbursohen shpenzimet e lidhura me detyrën dhe t'u paguhet dietat në masën e vendosur nga Asambleja.

15.13 Shpërblimi i administratorëve të ngarkuar, në përputhje me Statutin, me detyra të posaçme përcaktohet nga Këshilli Drejtues pas këshillimit me Komitetin e Kontrollit.

#### NENI 16

16.1 Këshilli Drejtues ka të gjitha tagrat e nevojshme për të administruar Shoqërinë.

16.2 Janë në kompetencë ekskluzive të Këshillit Drejtues:

- përcaktimi i objektivave, strategjive dhe të linjave të zhvillimit të zonave ku vepron Grupi;
- vendimet që lidhen me administrimin e përgjithshëm, miratimin dhe ndryshimin e normave me karakter të përgjithshëm që lidhen me punësimin, blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjeve që ndryshojnë përbërjen e Grupit Bankar, emërimin në detyrat e parashikuara në nenin 15;
- miratimi i rregulloreve të brendshme si dhe vlerësimi i strukturës organizative, administrative dhe kontabël të Shoqërisë, veçanërisht në lidhje me sistemin e kontrollit të rreziqeve dhe të kontrolleve të brendshme;
- përcaktimi i kriterëve për bashkërendimin dhe drejtimin e Shoqërive pjesë e Grupit dhe për zbatimin e udhëzimeve të dhëna nga Banka e Italisë.

16.3 Këshilli Drejtues, përveç kompetencave ekskluzive sipas paragrafit 2 më sipër, është gjithashtu kompetent për të marrë vendimet që kanë të bëjnë me:

- bashkimin dhe ndarjen, në rastet dhe modalitetet e parashikuara nga legjisllacioni në fuqi;
- hapjen dhe mbylljen e degëve;
- zvogëlimin e kapitalit në rast tërheqje të aksionarit;
- përshtatjet e Statutit me dispozitat ligjore.

#### NENI 17

17.1 Këshilli Drejtues thirret sa herë që Kryetari e konsideron të nevojshme apo të arsyeshme dhe si rregull çdo dy muaj. Në periudha të paktën tremujore anëtarët, me mbledhjen e Këshillit Drejtues ose me një relacion të posaçëm, i raportojnë Komitetit të Kontrollit mbi aktivitetin e

zhvilluar dhe mbi veprimet e një rëndësie të madhe ekonomike, financiare dhe pasurore, të kryera nga Shoqëria dhe/ose nga shoqëri të kontrolluara. Për sa nuk cënohen dispozitat e legjislacionit të posaçëm, Anëtarët e Këshillit Drejtues raportojnë veçanërisht mbi operacionet në të cilat kanë një interes për llogari të tyre apo për llogari të të tjerëve.

- 17.2 Për sa nuk cënohen tagrat të cilat i rezervohen nga ligji Anëtarëve të Komitetit të Kontrollit, thirrja e Këshillit Drejtues duhet të bëhet, gjithashtu, me kërkesën e motivuar me shkrim të tre Këshilltarëve apo të një Administratori të Deleguar drejtuar Kryetarit.
- 17.3 Mbledhjet e Këshillit Drejtues si rregull mbahen pranë selisë së Shoqërisë. Këshilli Drejtues mund të mbledhet, gjithashtu, në çdo vend tjetër, në Itali ose jashtë saj.
- 17.4 Njoftimi i thirrjes, i cili përmban shkurtimisht çështjet që do të trajtohen, duhet t'i dërgohet Këshilltarëve dhe Anëtarëve të Komitetit të Kontrollit në detyrë të paktën 5 ditë përpara mbledhjes me letër rekomande, telegram, teleks, faks ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër telematik që siguron provë të mbërritjes. Në raste veçanta urgjence, thirrja mund të bëhet nëpërmjet një paralajmërimi të thjeshtë 24 orë përpara mbledhjes, me çfarëdo lloj mjeti për këtë qëllim.
- 17.5 Mbledhjet e Këshillit Drejtues mund të mbahen rregullisht edhe nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit, me kusht që të garantohet si identifikimi ekzakt i personave të legjitimuar për të marrë pjesë, ashtu edhe mundësia e të gjithë pjesëmarrësve për të ndërhyrë, në kohë reale, në të gjitha çështjet e për të parë, marrë dhe transmetuar dokumenta. Megjithatë, të paktën Kryetari dhe Sekretari duhet të jenë të pranishëm në vendin e thirrjes së Këshillit, ku ky i fundit konsiderohet i mbajtur.
- 17.6 Për vlefshmërinë e vendimeve të Këshillit është e nevojshme që në mbledhje të jenë të pranishëm shumica e Këshilltarëve në detyrë. Vendimet merren me shumicën absolute të votave të Këshilltarëve të pranishëm. Vendimet në lidhje me emërimin e Zëvendës Kryetarit/ëve, të Komitetit Ekzekutiv, Administratorit/ëve të Deleguar dhe të Drejtorit të Përgjithshëm janë të vlefshme nëse merren me shumicën e votave të Këshilltarëve në detyrë. Në rast votash të barabarta, ajo e kryesuesit është përcaktuese.
- 17.7 Procesverbalet e vendimeve të Këshillit Drejtues redaktohen dhe transkriptohen në regjistrin e procesverbaleve nën kujdesin e një Sekretari të caktuar nga Këshilli.



17.8 Kopjet dhe estraktet e procesverbaleve, nëse këto të fundit nuk janë redaktuar nga Noteri, vërtetohen me një deklaratë njësisht me origjinalin, e nënshkruar nga Kryetari dhe nga Sekretari.

17.9 Mbledhjet që Këshilli vendos t'i mbajë të rezervuara, funksionet e Sekretarit i besohen Këshilltarit të pranishëm më të ri në moshë.

17.10 Projekt-vendimet që i paraqiten Këshillit Drejtues dhe Komitetit Ekzekutiv formulohen nga Administratori/ët i/e Deleguar, mbi bazën e mandateve që i janë dhënë, si dhe nga Drejtori i Përgjithshëm për çështjet në kompetencë të tij.

## NENI 18

18.1 Kryetari:

- a) kryeson mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe të Komitetit Ekzekutiv, duke i bashkërenduar punimet;
- b) vendos rendin e ditës për mbledhjet e Këshillit Drejtues dhe të Komitetit Ekzekutiv, duke pasur parasysh edhe projekt-vendimet e formuluar nga Administratori/ët i/e Deleguar dhe nga Drejtori i Përgjithshëm dhe kujdeset që informacionet e duhura mbi çështjet në diskutim t'u vihen në dispozicion të gjithë Këshilltarëve;
- c) autorizon çdo lloj kërkesë gjyqore, administrative dhe ekzekutive pranë çdo organi kompetent dhe në çdo shkallë gjykimi me të drejtë për t'u tërhequr nga aktet e nga kërkesat dhe për të pranuar tërheqje të ngjashme apo heqje dorë nga palët e tjera, me të gjitha të drejtat që rrjedhin dhe me detyrimin për të raportuar mbi vendimet e marra pranë Komitetit Ekzekutiv;
- d) në marrëveshje me Administrorin e Deleguar, ose nëse ekziston më shumë se një i tillë me atë përkatësisht kompetent, ose në mungesë të tyre, me Drejtorin e Përgjithshëm, merr çdo vendim me karakter urgjent në interes të Shoqërisë, duke raportuar në mbledhjen e parë pranë Këshillit Drejtues ose pranë Komitetit Ekzekutiv;
- e) bashkërendon aktivitetin e Shoqërisë.

18.2 Në rast mungese apo pamundësie të Kryetarit, tagrat e tij i kalojnë Zëvendës Kryetarit, ose nëse janë emëruar më shumë të tillë, pasardhësit sipas renditjes së përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

18.3 Nëse të gjithë Zëvendës Kryetarët mungojnë apo janë të pamundur, tagrat e Kryetarit i kalojnë Administratorit/ëve të Deleguar ose, nëse edhe këto mungojnë apo janë të pamundur, Këshilltarëve të tjerë, sipas renditjes së përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

## KREU V

### DREJTORI I PËRGJITHSHËM

## NENI 19

- 19.1 Drejtori i Përgjithshëm drejton strukturën operative dhe ekzekutive të Shoqërisë në bazë dhe në kuadër të tagrave të deleguara nga Këshilli Drejtues Drejtorit i Përgjithshëm:
- ka të drejtë të propozojë në lidhje me çështjet e administrimit të kredisë dhe të personelit; i paraqet gjithashtu propozime Organeve administrative për çështjet e deleguara atij;
  - kryen veprimet dhe të gjitha aktet e administrimit të zakonshëm;
  - kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të Këshillit Drejtues, Komitetit Ekzekutiv, apo Administratorit/ëve të Deleguar dhe për bashkërendimin operativ të aktivitetit të shoqërive të kontrolluara pjesë e Grupit, duke respektuar ato kritere dhe drejtime të përgjithshëm të përcaktuar nga Këshilli Drejtues;
  - bashkërendon, mbikqyr dhe realizon administrimin e marrëdhënieve të punës me punëmarrësit;
  - për të përmbushur funksionet dhe për të ushtruar kompetencat e veta apo të deleguara, u jep tagra përfaqësimi nëpunësve.
- 19.2 Në rast mungese apo pamundësie Drejtori i Përgjithshëm zëvendësohet nga Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm, ose nëse janë emëruar më shumë të tillë, nga ai që, midis tyre, është kompetent në lidhje me çështjen objekt mandati. Në rast se nuk është emëruar Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm, Drejtori i Përgjithshëm zëvendësohet nga Drejtuesit Qëndrorë sipas çështjeve dhe kompetencave përkatëse.
- 19.3 Nëse për çfarëdo arsye posti i Drejtorit të Përgjithshëm mbetet vakant këto funksione ushtrohen nga Administratori i Deleguar. Në rast se ekziston më shumë se një Administrator i Deleguar këto ushtrojnë funksionet sipas ndarjes së përcaktuar nga Këshilli Drejtues.

**KREU VI**  
**KOMITETI I KONTROLLIT DHE**  
**KONTROLLI I SHOQËRISË**

## NENI 20

- 20.1 Asambleja zgjedh Komitetin e Kontrollit i cili përbëhet nga 5 anëtarë në detyrë dhe nga 2 anëtarë zëvendësues.
- 20.2 Anëtarët e Komitetit të Kontrollit qëndrojnë në detyrë për tre vite financiare dhe janë të rizgjedhshëm. Përfundimi i mandatit të tyre rregullohet legjisllacionit në fuqi.



- 20.3 Të paktën dy nga Anëtarët në detyrë dhe të paktën një nga Anëtarët zëvendësues zgjidhen midis ekspertëve kontabël të autorizuar që kanë kryer sipas ligjit kontroll kontabël për jo më pak se tre vjet.
- 20.4 Anëtarët që nuk plotësojnë kushtin sipas paragrafit të mësipërm zgjidhen midis personave që kanë një eksperiencë të paktën tre vjeçare në:
- 1) aktivitete administrimi apo kontrolli ose detyra drejtuese pranë shoqërive tregtare kapitali themeltar i së cilave nuk është nën dy milionë Euro, apo
  - 2) aktivitete profesionale ose në arsimin universitar në lëndë juridike, ekonomike, financiare, të kreditimit, të sigurimeve ose megjithatë funksionale me aktivitetin e bankës, apo
  - 3) funksione drejtuese pranë enteve ose administratave publike që operojnë në sektorin kreditimit, financës dhe të sigurimeve.
- 20.5 I gjithë Komiteti i Kontrollit emërohet në bazë të listave të paraqitura nga Aksionarët, ku kandidatët duhet të jenë renditur me një numër progresiv.
- 20.6 Me qëllim për të zbatuar sa parashikohet në paragrafët tre dhe dymbëdhjetë të këtij neni, nëse lista përbëhet nga katër ose më shumë kandidatë, kandidati i katërt dhe të paktën një nga tre të parët duhet të plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e tretë më sipër; nëse lista përbëhet nga një numër kandidatësh më të vogël se katër të paktën kandidati i parë duhet t'i plotësojë këto kushte.
- 20.7 Listat duhet të depozitohen pranë selisë së Shoqërisë dhe të publikohen në të paktën dy gazeta italiane me shpërndarje kombëtare, nga të cilat njëra me karakter ekonomik, të paktën 10 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë në thirrjen e saj të parë.
- 20.8 Çdo Aksionar mund të paraqesë apo mbështesë paraqitjen e një liste të vetme dhe çdo kandidat mund të paraqitet vetëm në një listë, në rast të kundërt nuk mund të zgjidhet.
- 20.9 Kanë të drejtë të paraqesin lista vetëm Aksionarët që vetë apo sëbashku me Aksionarë të tjerë përfaqësojnë të paktën 1% të aksioneve me të drejtë vote në Asamblenë e zakonshme. Për të provuar zotërimin e aksioneve të nevojshme për paraqitjen e listave, Aksionarët duhet të paraqesin njëkohësisht, pranë selisë së Shoqërisë, çertifikatat që vërtetojnë pjesëmarrjen në sistemin e administrimit të përqëndruar të instrumentave financiarë.
- 20.10 Sëbashku me çdo listë, brenda afatit të depozitimit të saj, pranë selisë së Shoqërisë, duhet të depozitohen jetëshkrimet e nënshkruar për çdo kandidat dhe deklaratat nëpërmjet të cilave secili pranon kandidaturën dhe deklaron, nën përgjegjësinë e tij, që nuk ekziston ndonjë shkak

pazgjedhshmëri dhe mospërputhje, si dhe që plotëson kushtet sipas normave në fuqi për detyrën e anëtarit të Komitetit të Kontrollit.

- 20.11 Çdo Aksionar që ka të drejtë vote mund të votojë vetëm një listë.
- 20.12 Në zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit të Kontrollit procedohet si më poshtë:
- nga lista që ka siguruar shumicën e votave të dhëna nga Aksionarët nxirren, sipas rendit progresiv të renditjes në po atë listë, 3 Anëtarë në detyrë dhe 1 Anëtar zëvendësues;
  - dy Anëtarët në detyrë dhe Anëtari zëvendësues që mbeten për t'u zgjedhur nxirren nga listat e tjera; për këtë qëllim, votat e marra nga këto lista ndahen më vonë për një, dy dhe tre. Përqindjet e përfutuara në këtë mënyrë i jepen në mënyrë progresive kandidatëve të secilës prej listave, përkatësisht sipas rendit të parashikuar nga vetë ato. Përqindjet e dhëna në këtë mënyrë për kandidatët e listave të ndryshme renditen në një listë të vetme: zgjidhen Anëtarë në detyrë dy kandidatët që kanë përqindjet më të larta dhe Anëtar zëvendësues ai që ka përqindjen e tretë më të lartë. Në rast se rezultojnë kandidatë më përqindje të njëjtë, zgjidhet kandidati i listës nga e cila nuk është zgjedhur ende asnjë Anëtar i Komitetit të Kontrollit; në rast se nga asnjë nga këto lista nuk është zgjedhur ende një Anëtar i Komitetit të Kontrollit, procedohet me votim të ri të të gjithë Asamblesë, e cila zgjedh kandidatin që merr shumicën e thjeshtë të votave.
- 20.13 Për emërimin e Anëtarëve të Komitetit të Kontrollit që për çfarëdo arsye nuk janë zgjedhur sipas procedurave të parashikuara në paragrafët e mësipërm, Asambleja vendos me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm apo të përfaqësuar.
- 20.14 Kryesimi i Komitetit të Kontrollit i përket personit që është renditur i pari në listën që ka marrë shumicën e votave. Në rast zëvendësimi kryesimi i përket, deri në përfundim të mandatit të Komitetit, personit që është renditur menjëherë pas tij në po atë listë.
- 20.15 Anëtari i Komitetit të Kontrollit që ka dalë nga lista që ka marrë shumicën e votave të dhëna nga Aksionarët zëvendësohet nga zëvendësuesi që i përket po asaj liste; Anëtari i Komitetit të Kontrollit që ka dalë nga listat e tjera zëvendësohet nga zëvendësuesi i zgjedhur sipas modaliteteve të pikës b) të këtij neni. Nëse kërkohet për të ruajtur numrin minimal të Anëtarëve të Komitetit të Kontrollit në detyrë që plotësojnë kushtet sipas paragrafit të tretë të këtij neni, zëvendësimi bëhet kurdoherë nga zëvendësuesi që i plotëson këto kushte.

- 20.16 Emërimi i Anëtarëve për plotësimin e Komitetit të Kontrollit sipas nenit 2401 të Kodit Civil bëhet nga Asambleja që vendos me shumicën e votave që zotërojnë aksionarët e pranishëm apo të përfaqësuar.
- 20.17 Anëtarëve të Komitetit të Kontrollit i takon një shpërblim i caktuar nga Asambleja, e cila mund të shtojë, për secilin Anëtar, një shumë fikse për çdo pjesëmarrje në mbledhje; Anëtarët e Komitetit të Kontrollit kanë të drejtë t'u rimbursohen shpenzimet që lidhen me detyrën dhe t'u jepen dietat sipas masës së vendosur nga Asambleja.
- 20.18 Anëtarët e Komitetit të Kontrollit nuk mund të jenë në detyrë në më shumë se 5 Komitete të Kontrollit të shoqërive të tjera të kuotuar në bursë, me përjashtim të shoqërive të kontrolluara nga SANPAOLO IMI S.p.A.
- 20.19 Mbledhjet e Komitetit të Kontrollit mbahen rregullisht edhe nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit, me kusht që të garantohet si identifikimi ekzakt i personave të legjitimuar për të marrë pjesë, ashtu edhe mundësia e të gjithë pjesëmarrësve për të ndërhyrë, në kohë reale, në të gjitha çështjet e për të parë, marrë dhe transmetuar dokumenta. Mbledhjet konsiderohen të mbajtura në vendin e thirrjes së Komitetit ku duhet të jetë gjithashtu i pranishëm të paktën një Anëtar i tij.

#### NENI 21

- 21.1 Kontrolli kontabël i Shoqërisë ushtrohet nga shoqëri ekspertimi kontabël të cilat plotësojnë kriteret ligjore. Për emërimin, detyrat, tagrat dhe përgjegjësitë e tyre zbatohen dispozitat përkatëse ligjore.

### KREU VII PËRFAQËSIMI LIGJOR

#### NENI 22

- 22.1 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë, në marrëdhënie me të tretët e në gjykim, dhe e drejta për të nënshkruar në emër të saj ushtrohen nga Kryetari dhe, në mungesë apo pamundësi të tij, nga Zëvendës Kryetari që sipas rendit përcaktuar nga Këshilli Drejtues ka të drejtë që t'a zëvendësojë, dhe, në mungesë edhe të tyre, nga Administratori/rët e Deleguar veç e veç.
- 22.2 Për sa nuk çënohet paragrafi i mësipërm përfaqësimi ligjor i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët e në gjykim dhe e drejta për të nënshkruar në emër të saj ushtrohen gjithashtu nga Administratori/ët i/e Deleguar, në lidhje me çështje të deleguara atyre nga Këshilli Drejtues.
- 22.3 Për sa nuk çënohen paragrafët e mësipërm, për kategori të caktuara aktesh dhe veprimesh, Këshilli Drejtues mund t'u japë tagra përfaqësimi,

sipas procedurave ligjore, me të drejtën përkatëse për të nënshkruar në emër të Shoqërisë Këshilltarëve veç e veç, Drejtorit të Përgjithshëm, Zëvendës Drejtorit/ëve të Përgjithshëm, Drejtuesve dhe nëpunësve të tjerë të Shoqërisë duke i përcaktuar kufijtë dhe modalitetet e përdorimit të këtyre të drejtave. Gjithashtu Drejtori i Përgjithshëm, në kuadrin e tagrave që i janë dhënë, mund t'u japë të drejtën për të nënshkruar Zëvendës Drejtorit/ëve të Përgjithshëm, Drejtuesve dhe nëpunësve të tjerë të Shoqërisë, duke i përcaktuar kufijtë dhe modalitetet përdorimit të saj.

- 22.4 Në rastet kur për shkak të mungesës apo pamundësisë ky Statut lejon zëvendësime, paraqitja e zëvendësuesit përbën kundrejt të tretëve provë të zëvendësimit.

### KREU VIII

#### LLOGARITË VJETORE DHE SHPËRNDARJA E FITIMIT

##### NENI 23

- 23.1 Viti financiar mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
- 23.2 Nga fitimet neto që rezultojnë nga llogaritë vjetore, një shumë e barabartë me 10% do të lihet mënjanë për formimin e rezervës së domosdoshme deri sa kjo e fundit të arrijë një të pestën e kapitalit themeltar.
- 23.3 Një kuotë tjetër, deri në arritjet e 5% të vlerës nominale të aksioneve me përparësi, do t'u shpërndahet zotëruesve të këtyre aksioneve.
- 23.4 Asambleja, me propozim të Këshillit Drejtues, vendos për përdorimin e fitimit që rezulton pas heqjes së shumave për t'u kaluar në rezervë dhe shpërndarjes ndaj zotëruesve të aksioneve me përparësi.
- 23.5 Dividenti i shpërndahet, deri në arritjen e një shume të barabartë me atë të shpërndarë zotëruesve të aksioneve me përparësi, zotëruesve të aksioneve të zakoshme dhe, më pas në mënyrë të barabartë, zotëruesve të të gjitha aksioneve.
- 23.6 Nëse në një vit financiar zotëruesve të aksioneve me përparësi i është shpërndarë një dividend më i vogël se 5% e vlerës nominale të aksioneve të tyre, pjesa e mbetur do t'u llogaritet në zmadhimin e dividendit me përparësi në dy vitet financiare që vijojnë.
- 23.7 Dividentet që nuk janë marrë brenda pesë vitesh nga data që janë bërë të kërkueshme, parashkruhen në favor të Shoqërisë dhe kalojnë në fondin rezervë.

- 23.8 Këshilli Drejtues mund të vendosë mbi shpërndarjen e paradhënieve mbi dividendët në rastet, sipas modaliteteve dhe brenda kufijve të lejuara nga dispozitat në fuqi.

## KREU IX ORGANET STATUTORE

### NENI 24

- 24.1 Në lidhje kualifikimin, përvojën, reputacionin dhe pavarësinë e Organeve të parashikuara nga ky Statut zbatohen normat ligjore, rregulluese dhe Mbikqyrëse në fuqi.

## KREU X TËRHEQJA NGA SHOQËRIA

### NENI 25

- 25.1 E drejta për t'u tërhequr lejohet vetëm në rastet e parashikuara në mënyrë të pakundërshtueshme nga ligji. Përfshihet e drejta e tërheqjes për aksionarët që nuk kanë miratuar vendimet që lidhen me:
- zgjatjen e afatit të Shoqërisë;
  - futjen apo heqjen e kufijve në qarkullimin e aksioneve.
- 25.2 Afatet e modalitetet për ushtrimin e të drejtës për t'u tërhequr, kriteret e përcaktimit të vlerës së aksioneve dhe procedura përkatëse e likuidimit rregullohen nga ligji.

## KAPITULLI XI PRISHJA E SHOQËRISË

### NENI 26

- 26.1 Për sa nuk çenohen dispozitat e ndryshme ligjore, nëse verifikohet një nga shkaqet e prishjes së Shoqërisë, Asambleja do të vendosë modalitetet e likuidimit, duke emëruar një ose më shumë likuidues.
- 26.2 Në rast prishje të Shoqërisë dhe likuidimi, zotëruesve të aksioneve me përparësi do t'i përkasë përparësia në rimbursimin e kapitalit për të gjithë vlerën nominale të aksioneve të tyre.

I nënshkruari Alfonso Iozzo  
Në cilësinë e Administratorit të Deleguar  
San Paolo Imi S.p.a.

## Deklaron

Se statuti i parashiturar është i njëjtë me Statutin e shoqërisë si më lart, ndryshar në paragrafin e parë të nenit 6 në bazë të transformimit të aksioneve të privileguara në aksione të zakonshme.

Alfonso Iozzo  
Firma

Kjo kopje e mbartur në suport informatik, sipas nenit 20 të Dekretit n. 445 datë 28 dhjetor 2000 e përbërë nga nëntëmbëdhjetë faqe, është e njëjtë me originalin në suport letre, i cili u pa prej meje noterit. Kopja lëshohet prej meje Z. Ettore Morone, Noter me banim në Torino, për dërgimin në rrugë telematike d.m.th. paraqitjen në suport informatik pranë zyrës së Regjistrit Tregtar.

Torino më njëzet e tre dhjetor dymijë e pesë.

Taksë pulla do të shlyhet në momentin e dërgimit në rrugë telematike d.m.th. me paraqitjen në suport informatik pranë zyrës së Regjistrit Tregtar, sipas nenit 1, paragrafi 1/3 i Tarifës - Pjesa I bashkangjitur Dekretit n. 642 datë 26 tetor 1972.

\*\*\*\*\*

Ministria e punëve të brendshme

Prefektura e Torino

Vërtetim: për vërtetimin e firmës

Së, Z. Ezio Carlo Corazzini

Për konservatorin C.C.I.A.A. - Torino

Torino më 25 janar 2006

Funksionari

Eiora Renata

Firma

Kopja e përbërë prej n. 19 faqe është e njëjtë me dokumentin e depozituar pranë këtij Regjistri Tregtar.

Torino më 12.01.2006

Funksionari, firma

Për Konservatorin


Z. Ezio Carlo Corazzino

Categoria C

Ambasada e Republikës së Shqipërisë

VËRTETIM

Sot, më datë 15.02 2006, unë e nënshkruara, Znj. Gentiana Koduzi, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë më 03.07.1980, banuese në Tiranë, Rr. Kavajës, me pasaportë nr. Z 1347741, vërtetoj se, deklarova se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i njëjtë me originalin të kësaj kopje italisht dhe anasjelltas.




PËRKTHYESE  
*Gentiana Koduzi*  
Gentiana Koduzi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
Nr. 201 Rep.

VËRTETIM

Unë vërtetoj se sot më datë 15.02 2006, në Zyrën e Noterisë, para meje Noteres Natasha Koloneci, u paraqit personalisht Znj. Gentiana Koduzi, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë më 03.07.1980, banuese në Tiranë, Rr. Kavajës, me pasaportë nr. Z 1347741, e njohur personalisht prej meje, madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilës u binda pasi verifikova pasaportën e saj, e cila më deklaroi se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i njëjtë me originalin i versionit italisht dhe anasjelltas, vërtetim të cilin e nënshkroi përpara meje noteres, me vullnetin e saj të plotë dhe të lirë, dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE



NOTERE  
NATASHA KOLONECI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA NOTERËVE TIRANË  
NR 207 REP DY 15.02.06  
Vërtetohet se fotokopia  
është e njëjtë me originalin  
NOTERE  
NATASHA KOLONECI



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
NR. 1176/3 REP.

### VËRTETIM I NJESISE ME ORIGJINALIN


Sot me date 10/04/2007(shtate) para meje noteres Lindita LLeshi, me zyre ne Bul B.Curri, pallatet 1 maj, shkalla 8,ap 7, u paraqit

Iilir Johollari, prane SLTonucci kerkoj te vertetoj se kopja e dokumentit, bashkalidhur, eshte e njejte me origjinalin.

Une noterja pasi krahasoj dokumentin origjinal me fotokopjen vertetoj se eshte I njejte me origjinalin.

Dokumenti nuk ka korigjime apo fshirje.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te ligjit 7829 date 01/06/1994"Per Noterine"(I ndryshuar) dhe udhezimit te Ministrise nr 6291 date 17.08/2005, pika 3, 4 e 7).



NOTERE  
LINDITA LLESHI



STUDIO NOTARILE MORONE

Via Mercantini n. 5  
10121 TORINO

Repertorio n. 109.563

Raccolta n. 17.118

Atto di fusione della "SANPAOLO IMI S.p.A." nella "BANCA INTESA S.p.A.".

Repubblica Italiana

Il ventotto dicembre duemilasei,


in Torino, presso la sede della SANPAOLO IMI S.p.A., piazza San Carlo n. 156.

Avanti me, dott. Ettore MORONE,

Notaio iscritto al Collegio Notarile dei Distretti Riuniti di Torino e Pinerolo, con residenza in Torino, sono personalmente comparsi i signori:

- Giovanni BAZOLI, nato a Brescia il 18 dicembre 1932, domiciliato per la carica a Milano, piazza Paolo Ferrari n. 10, nella sua qualità di presidente del consiglio di amministrazione della "BANCA INTESA S.p.A.", con sede in Milano, piazza Paolo Ferrari n. 10, col capitale sociale di euro 3.613.001.195,96, iscritta nel registro delle imprese - ufficio di Milano al n. 00799960158,

banca iscritta nell'albo di cui all'articolo 13 del decreto legislativo 385/93 e capogruppo del Gruppo Intesa iscritto nell'albo di cui all'ar-



Registrato a Torino  
3° Ufficio delle Entrate  
il 2 gennaio 2007  
con euro 168,00



articolo 64 del medesimo decreto legislativo,  
in esecuzione della delibera assunta in sede  
straordinaria dall'assemblea tenutasi in data 1°  
dicembre 2006 il cui verbale, redatto dal notaio  
Piergaetano MARCHETTI, repertorio n.  
18.306/5.846, è stato registrato a Milano - 1°  
ufficio delle entrate in data 19 dicembre 2006  
ed iscritto nel registro delle imprese - ufficio  
di Milano in data 12 dicembre 2006,  
- Enrico SALZA, nato a Torino il 25 maggio 1937,  
domiciliato per la carica a Torino, piazza San  
Carlo n. 156,  
nella sua qualità di presidente del consiglio di  
amministrazione della  
"SANPAOLO IMI S.p.A.", con sede in Torino, piaz-  
za San Carlo n. 156, col capitale sociale di eu-  
ro 5.400.253.255,68, iscritta nel registro delle  
imprese - ufficio di Torino al n. 06210280019,  
banca iscritta nell'albo di cui all'articolo 13  
del decreto legislativo 385/93 e capogruppo del  
Gruppo Bancario SANPAOLO IMI iscritto nell'albo  
di cui all'articolo 64 del medesimo decreto le-  
gislativo,  
in esecuzione della delibera dell'assemblea  
straordinaria tenutasi in data 1° dicembre 2006

il cui verbale, redatto da me notaio Ettore MORONE, repertorio n. 109.452/17.046, è stato registrato a Torino - 3° ufficio delle entrate in data 7 dicembre 2006 ed iscritto nel registro delle imprese - ufficio di Torino in data 7 dicembre 2006.

Detti signori comparenti, della identità personale dei quali sono certo,

premettono e attestano che

A) in sede straordinaria l'assemblea della BANCA INTESA S.p.A., richiamata in comparizione, ha approvato il progetto di fusione per incorporazione nella stessa della SANPAOLO IMI S.p.A., sulla base delle rispettive situazioni patrimoniali al 30 giugno 2006, che comporta, tra l'altro, l'emissione di massime n. 5.841.113.544 (cinquemiliardiottozeroquarantunomilioneicentotredicimilacinquecentoquarantaquattro) azioni ordinarie della società incorporante da nominali euro 0,52 (zero virgola cinquantadue), aventi godimento regolare, da assegnare in cambio agli azionisti della società incorporanda in ragione di 3,115 (tre virgola centoquindici) azioni ordinarie della società incorporante ogni azione ordinaria o privilegiata della società incorpo-



randa da nominali euro 2,88 (due virgola ottantotto) e all'uopo:

. ha approvato l'aumento del capitale sociale al servizio della fusione per massimi euro 3.037.379.042,88 (tremiliarditrentasettemilioni-trecentosettantanovemilaquarantadue virgola ottantotto),

. ha approvato un ulteriore aumento del capitale sociale per un importo massimo di euro 15.835.003,08 (quindicimilioniottocentotrentacinquemilatre virgola zero otto) mediante emissione di massime n. 30.451.929 (trentamilioni-quattrocentocinquantunomilanovecentoventinove) azioni ordinarie da nominali euro 0,52 (zero virgola cinquantadue) al servizio dei piani di stock option già deliberati dal consiglio di amministrazione della società incorporanda in data 17 dicembre 2002 e 14 novembre 2005 in esecuzione della delega conferitagli dall'assemblea del 30 aprile 2002, confermando i regolamenti dei suddetti piani pure approvati dalla società incorporanda con conseguente mandato al consiglio di gestione di apportarvi le occorrenti modifiche,

. ha approvato il nuovo testo dello statuto so-

ciale allegato al progetto di fusione, connota-  
to, fra l'altro, dall'adozione del sistema di  
amministrazione e controllo dualistico e che  
comporta anche l'adozione per la società incor-  
porante della nuova denominazione "Intesa San-  
paolo S.p.A.", il trasferimento della sede lega-  
le in Torino, piazza San Carlo n. 156, e l'isti-  
tuzione della sede secondaria in Milano, via  
Monte di Pietà n. 8, con efficacia dalla data di  
decorrenza giuridica della fusione, fatta salva  
l'immediata efficacia, nel rispetto comunque di  
quanto disposto dall'articolo 2436 del codice  
civile, dell'articolo 34 ("Prime nomine");

B) l'assemblea straordinaria della SANPAOLO IMI  
S.p.A., anch'essa richiamata in comparizione, ha  
correlativamente approvato il predetto progetto  
di fusione;

C) l'assemblea speciale degli azionisti titolari  
di azioni privilegiate della stessa SANPAOLO IMI  
S.p.A. tenutasi in data 1° dicembre 2006, il cui  
verbale è stato redatto dal notaio Giuseppina  
MORONE repertorio n. 353.023/19.798, registrato  
a Torino - 3° ufficio delle entrate in data 7  
dicembre 2006, ha approvato, per quanto di com-  
petenza, le deliberazioni assunte dalla predetta



assemblea straordinaria della SANPAOLO IMI S.p.A. contenute nell'ordine del giorno deliberativo approvato da quest'ultima;

D) la fusione è divenuta eseguibile essendo trascorso il termine di quindici giorni di cui all'articolo 57 del decreto legislativo 385/93 e non risultando in essere opposizioni da parte di creditori anteriori alla iscrizione del progetto di fusione di cui sopra;

E) l'attuale capitale sociale della SANPAOLO IMI S.p.A. è ripartito in complessive n. 1.875.087.936 (unmiliardottocentosettantacinquemilioniottantasettemilanovecentotrentasei) azioni, di cui n. 1.590.903.918 (unmiliardocinquacentonovantamilioninovecentotremilanovecentodiciotto) ordinarie e n. 284.184.018 (duecentotantaquattromilionicentottantaquattromiladiciotto) privilegiate;

F) la BANCA INTESA S.p.A. non possiede azioni ordinarie della SANPAOLO IMI S.p.A. la quale detiene n. 2.365.919 (duemilionitrecentosessantacinquemilanovecentodiciannove) proprie azioni ordinarie e non detiene azioni della BANCA INTESA S.p.A.;

G) la fusione non può dar luogo ad alcuna delle

ipotesi di diritto di recesso ex articolo 2437 del codice civile;

H) la Banca d'Italia ha autorizzato ai sensi dell'articolo 57 del decreto legislativo 385/93 la fusione in oggetto con provvedimento in data 25 ottobre 2006;

I) con provvedimento in data 20 dicembre 2006 n. C 8027 l'Autorità Garante della Concorrenza e del Mercato ha autorizzato la fusione prescrivendo, ai sensi dell'articolo 6, comma 2, della legge 287/90, l'adozione di una serie di misure da parte delle società partecipanti alla fusione stessa.

Tutto ciò premesso

e dedotto come parte integrante e sostanziale del presente atto, essi signori comparenti convergono e stipulano quanto segue:

- 1 -

La BANCA INTESA S.p.A., di seguito denominata semplicemente "società incorporante", incorpora la SANPAOLO IMI S.p.A., di seguito denominata semplicemente "società incorporata", secondo le modalità indicate nel progetto di fusione di cui in premessa.

Le parti stabiliscono che, in conformità a quan-



to previsto dal progetto di fusione stesso:

. gli effetti della fusione nei confronti dei terzi, ai sensi dell'articolo 2504 bis, comma 2 del codice civile, decorreranno dal 1° gennaio 2007,

. le operazioni effettuate dalla società incorporata saranno imputate al bilancio della società incorporante, anche ai fini fiscali ai sensi del nono comma dell'articolo 172 del D.P.R. 917/86, a decorrere dal 1° gennaio 2007.

- 2 -

In dipendenza della fusione la società incorporante subentrerà alla società incorporata in tutti i rapporti giuridici attivi e passivi in essere od in fieri, sia in Italia, sia all'estero, dovendosi pertanto volturare in capo alla società incorporante tutti i beni, diritti e rapporti di qualsiasi natura della società incorporata, e così in particolare le concessioni, autorizzazioni e licenze di qualsiasi natura e specie, i nomi commerciali, la ditta, le insegne, i segni distintivi, i contratti di locazione, attivi e passivi, anche ultranovennali, assicurazione, approvvigionamento, fornitura, appalto, prestazione d'opera, servizio e sommini-



strazione di qualsiasi genere, anche se non ancora perfezionati, inclusi ordini in corso od in corso di esecuzione, i crediti, i debiti, i depositi di qualunque natura e presso chiunque costituiti, i diritti e gli impegni, le pratiche, vertenze, azioni legali, giudiziarie, amministrative, fiscali e tributarie e, più in generale, ogni entità, attività e diritto mobiliare o immobiliare, materiale o immateriale, principale od accessorio, senza eccezioni o limitazioni di sorta, che siano o che vengano ad essere di spettanza della società incorporata.

In relazione ai debiti ed alle passività in genere della società incorporata trasferiti a seguito della fusione, la società incorporante, in persona del suo rappresentante, dà atto che gli stessi, a tutti gli effetti di legge, sono ad essa accollati e che provvederà al pagamento dei medesimi nei termini e con le modalità contenute nei rispettivi contratti o stabiliti dalla legge mantenendo, ove esistenti, le relative garanzie. La società incorporante subentrerà in particolare:

- in tutti i mandati conferiti alla società incorporata nonché in tutti i mandati rilasciati



dalla stessa e nei correlati poteri attribuiti alla medesima o dalla stessa conferiti;

- in tutti gli atti in generale della società incorporata attributivi di facoltà (incluse quelle di firma, di spesa nonché di concessione e di gestione del credito) e di poteri, nonché nelle relative procure, ivi comprese quelle per la rappresentanza processuale e sostanziale.

Per quanto possa occorrere, vengono altresì confermati:

- tutti i mandati conferiti alla società incorporante nonché tutti i mandati rilasciati dalla stessa ed i correlati poteri attribuiti alla medesima o dalla stessa conferiti;

- tutti i poteri e le facoltà (incluse quelle di firma, di spesa nonché di concessione e di gestione del credito) già attribuiti dalla società incorporante e le procure dalla stessa conferite, ivi comprese quelle per la rappresentanza processuale e sostanziale.

La società incorporante subentrerà inoltre nei diritti, nelle attribuzioni e nelle situazioni giuridiche dei quali la società incorporata è titolare in forza di leggi o di provvedimenti amministrativi; i privilegi e le garanzie di

qualsiasi tipo, da chiunque prestate o comunque esistenti a favore della società incorporata, conserveranno la loro validità e il loro grado, senza bisogno di alcuna formalità o annotazione, a favore della società incorporante, ai sensi dell'articolo 57, ultimo comma, del decreto legislativo 385/93.

Tutte le trascrizioni, iscrizioni, intestazioni e annotazioni relative alla società incorporata dovranno intendersi ad ogni effetto di legge a nome della società incorporante.

Le parti precisano che rimangono salvi i poteri di stipulare e sottoscrivere, anche unilateralmente da parte della società incorporante successivamente all'effetto della fusione ed anche in sede di successivi trasferimenti, qualsiasi atto, anche rettificativo, ricognitivo, precisativo od integrativo, necessario od opportuno, per perfezionare il trasferimento e/o la voltura di qualsivoglia bene, diritto, concessione, autorizzazione, contratto, credito, rapporto e altro delle società incorporata ed incorporante.

- 3 -

Considerato quanto riportato alle lettere E) e F) delle premesse, la società incorporante, alla



data di effetto della fusione, darà esecuzione all'aumento del proprio capitale da euro 3.613.001.195,96 (tremiliardiseicentotredicimilioni millecentonovantacinque virgola novantasei) a euro 6.646.436.318,60 (seimiliardiseicentoquarantaseimilioni quattrocentotrentaseimilatrecen-  
todiciotto virgola sessanta), e cioè di euro 3.033.435.122,64 (tremiliarditrentatremilioni quattrocentotrentacinquemilacentoveitidue virgola sessantaquattro), mediante emissione, in regime di dematerializzazione, di n. 5.833.529.082 (cinquemiliardiottocentotrentatremilionicinquecentoventinovemilaottantadue) nuove azioni da nominali euro 0,52 (zero virgola cinquantadue) cadauna, con godimento regolare, da assegnare agli azionisti della società incorporata diversi dalla stessa nel rapporto di n. 3,115 (tre virgola centoquindici) azioni ordinarie della società incorporante ogni azione ordinaria o privilegiata della società incorporata, senza conguagli in denaro.

Le parti danno atto che la Compagnia di San Paolo, azionista della società incorporata, ha comunicato la propria rinuncia al concambio della frazione di azione (0,955) necessaria per assi-

curare la quadratura dell'operazione.

Le parti danno inoltre atto che a disposizione degli azionisti della società incorporata verrà messo un servizio per il trattamento delle eventuali frazioni di azioni, a prezzi di mercato, senza aggravio di ulteriori oneri per spese, bolli o commissioni.

## **Neni 19. Këshilltari i Deleguar**

19.1 Këshilli Drejtues, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, do të zgjidhi midis anëtarëve të tij një Këshilltar të Deleguar me shumicën e kualifikuar sipas nenit 16.5.

19.2 Këshilltari i Deleguar është dhe Kryetari i Ekzekutivit dhe përgjegjës për drejtimin e ndërmarrjes në limitet e kompetencave që i janë dhënë sipas udhëzimeve të përgjithshme programatike dhe strategjike të përcaktuar nga organet e Shoqërisë.

Ai është përgjegjës për personelin, përcakton dhe jep direktivat ekzekutive. Si rregull ka të drejtë të bëjë propozime për Këshillin Drejtues dhe ushtron sipas normave përkatëse kompetencën për propozime për kredi. Kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të Këshillit Drejtues.



**19.3** Këshilltari i Deleguar kujdeset që sistemi organizativ, administrativ dhe kontabël të jetë i përshtatshëm për natyrën dhe madhësinë e ndërmarrjes dhe i komunikon Këshillit Drejtues, të paktën një herë në tre muaj, ecurinë e përgjithshme të drejtimit të Shoqërisë dhe zhvillimin e ardhshëm të saj, gjithashtu i komunikon operacionet më të rëndësishme të kryera nga Shoqëria dhe nga Shoqëritë e kontrolluara. Periodikisht, të paktën një herë në muaj, i komunikohen Këshillit Drejtues të dhënat kryesore në lidhje me ecurinë e drejtimit për një periudhë të caktuar dhe në lidhje me sistemin.

## **Neni 20. Funksonari përgjegjës për hartimin e dokumenteve kontabël të shoqërisë**

**20.1** Këshilli Drejtues me miratimin e Këshillit Mbikëqyrës, emëron dhe revokon me shumicë të kualifikuar, sipas nenit 16.5 funksionarin përgjegjës për hartimin e dokumenteve kontabël të shoqërisë sipas dispozitave të nenit 154 bis të Dekretit Legjislativ 24 shkurt 1998 n. 58 duke përcaktuar kompetencat, strumentet dhe shpërblimet.

**20.2** Këshilltari i Deleguar dhe Funksonari përgjegjës për hartimin e dokumenteve kontabël të shoqërisë certifikojnë informacionet në lidhje me pasurinë, ekonomike dhe financiare të parashikuara nga ligji.

## **Neni 21 Përfaqësimi. Firma e shoqërisë.**

**21.1** Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë, para të tretëve dhe në gjykim dhe firma e Shoqërisë është ajo e Kryetarit të Këshillit Drejtues dhe në rast mungese ose pamundësie dhe ajo e nënKryetarit sipas vjetërsisë në detyrë, në bazë të parashikimeve të nenit 18.3 të Statutit dhe në rast vjetërsie të njëjtë në detyrë, sipas vjetërsisë në moshë, në mungesë edhe të këtij të fundit përfaqësimi i përket Këshilltarit të Deleguar. Kundrejt të tretëve firma që zëvendëson Kryetarin vërteton edhe mungesën ose pamundësinë e tij.

**21.2** Përveç sa më lart, përfaqësimi ligjor i Shoqërisë, para të tretëve dhe në gjykim dhe firma e Shoqërisë është gjithashtu dhe ajo e Këshilltarit të Deleguar në lëndet që i janë deleguar nga Këshilli Drejtues.

**21.3** Drejtuesit e Përgjithshëm janë përfaqësuesit dhe kanë të drejtën e firmës për Shoqërinë në lidhje me aktet, kontratat, dokumentet dhe korrespondencën në përgjithësi, në limitet e kompetencave që u janë dhënë; në rast mungese ose pamundësie të Drejtuesve të Përgjithshëm përfaqësimi dhe e drejta e firmës të Shoqërisë i përket zëvendësuesve të tyre sipas parashikimeve në aktin e emërimit të tyre.

21.4 Këshilli Drejtues, për akte të veçanta ose kategori aktesh, ka të drejtë të japi kompetenca me të drejtën përkatëse të firmës edhe të tretëve.

21.5 Këshilli Drejtues ka të drejtë të autorizojë punëmarrësit e Shoqërisë për të nënshkruar, si rregull bashkërisht ose, për kategori aktesh të përcaktuara nga vet Këshilli edhe veçmas.

21.6 Kryetari i Këshillit Drejtues ka të drejtë të lëshojë prokura të veçanta edhe në favor të të tretëve, për nënshkrimin e akteve të veçanta ose kategori aktesh, kontrata e dokumente që kanë të bëjnë përgjithësisht me operacione të vendosura nga Organet kompetente të Shoqërisë.

Këtë të drejtë, në kuadrin e kompetencave të dhëna e ka edhe Këshilltari i Deleguar dhe Drejtorët e Përgjithshëm për sa i përket kompetencave dhe funksioneve të tyre.

## *Seksioni II – Këshilli Mbikëqyrës*

### Neni 22 - Këshilli Mbikëqyrës.

#### 22.1 Përbërja

Këshilli Mbikëqyrës përbëhet prej jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) anëtar dhe jo më shumë se 21 anëtar, edhe jo ortak, të emëruar nga asamblea.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës duhet të paraqesin profesionalizëm, ndershmëri, dhe paanshmëri të parashikuara nga normat ligjore dhe rregulloret.

Gjithashtu të paktën tre Këshilltar duhet të regjistrohen në Regjistrin e Ekspertëve kontabël të autorizuar pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe të kenë ushtruar aktivitetin e kontrollit të llogarive të parashikuar nga ligji për të paktën tre vjet, gjithashtu të paktën tre prej anëtarëve duhet të plotësojnë kriterin për paanshmëri sipas Kodit për Rregullimin e brendshëm të mbështetur nga Borsa Italia S.p.A.

Kriteret për regjistrim në regjistrin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe kriteri i paanshmëri sipas Kodit për Rregullimin e brendshëm të mbështetur nga Borsa Italia S.p.A. mund të përmbushen nga i njëjti person.

#### 22.2 Integrimet

Nëse numri i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është më i vogël se maksimumi i parashikuar, asambleja do të integrojë anëtarët gjatë periudhës që ata janë në detyrë. Anëtarët e rinj janë emëruar nga asambleja e zakonshme sipas parashikimeve të nenit 23 të Statutit.

#### 22.3 Kohëzgjatja

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës qëndrojnë në detyrë për tre periudha ushtrimore dhe përfundojnë mandatin e tyre në datën e mbledhjes së asamblesë në vijim sipas paragrafit II neni 2364 – bis K.C. dhe janë të rizgjedhshëm.

## 23. Zgjedhja e Këshillit Mbikëqyrës

### 23.1 Listat e kandidatëve

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës do të bëhet në bazë të listave të paraqitura para ortakëve sipas procedurave në vijim:

- a) Ortakët që përfaqësojnë të paktën 1% të aksioneve të zakonshme të Shoqërisë kanë të drejtë të paraqesin një listë kandidatësh të renditur me numër progresivë. Lista duhet të depozitohet pranë selisë së Shoqërisë të paktën pesëmbëdhjetë ditë para datës së përcaktuar për asamblenë në mbledhjen e saj të parë dhe duhet të publikohet të paktën në dy gazeta kombëtare, prej të cilave të paktën njëra duhet të jetë gazetë ekonomike, në të kundërt e drejta bie. Për të vërtetuar zotërimin e numrit të nevojshëm të aksioneve për paraqitjen e një liste, ortakët duhet që në të njëjtën kohë të paraqesin edhe kopje të certifikatave që vërtetojnë pjesëmarrjen në sistemin e drejtimit të centralizuar të strumenteve financiare;
- b) Secili ortak ka të drejtë të paraqes dhe të votojë vetëm një listë kandidatësh dhe çdo kandidat mund të kandidojë në një listë, në të kundërt ai është i pazgjedhshëm;
- c) Bashkë me secilën listë, brenda afateve për depozitimin e saj, pranë selisë së shoqërisë duhet të depozitohen deklaratat në të cilat çdo kandidat konfirmon kandidaturën dhe vërteton, nën përgjegjësinë e tij, se nuk ekzistojnë shkaqe që pengojnë zgjedhjen e tij dhe se zotëron të gjitha kërkesat e përcaktuar, për të gjithë ose për disa prej Këshilltarëve, të përcaktuara nga normat ligjore, rregulloret dhe statuti për detyrën e Këshilltarit Mbikëqyrës.

### 23.2 Votimi

Për zgjedhjen e Këshillit Mbikëqyrës do të procedohet si në vijim:

Anëtarët do të përcaktohen proporcionalisht nga listat e votuara; Për këtë qëllim votat e marra nga secila listë do të pjesëtohen me një, dy, tre, katër e vazhdim, sipas numrit të anëtarëve që duhet të zgjidhen. Rezultati i marr në këtë mënyrë do tu aplikohet progresivisht kandidatëve të çdo liste sipas rendit të përcaktuar në lista. Votat e llogaritura si më lart për çdo kandidatë të secilës listë do të përmbliidhen në një listë të vetme sipas rezultateve: do të konsiderohen të zgjedhur si anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës ata që kanë marrë rezultatet më të larta.

### 23.3 Barazi votash dhe balotazh

Në rastin kur disa kandidatë kanë marrë të njëjtin numër votash sipas llogaritjeve përkatëse do të konsiderohet i zgjedhur kandidati i listës nga e cila nuk është zgjedhur asnjë Këshilltar ose është zgjedhur numri më i vogël i Këshilltarëve. Në rastin kur prej këtyre listave nuk është zgjedhur asnjë Këshilltar ose është zgjedhur prej listave i njëjti numër Këshilltarësh, do të zgjidhet kandidati që në këto lista ka marrë numrin më të madh të votave. Në rast barazie votash të llogaritura

dhe barazi votash në secilën listë do të zhvillohet balotazhi me një votim të ri të asamblesë duke shpallur fitues kandidatin që ka marrë shumicën e thjeshtë të votave.

#### **23.4 Mekanizmi plotësues**

Nëse në përfundim të votimit nuk është zgjedhur numër i mjaftueshëm i Këshilltarëve të cilët respektojnë kriterin e paanshmërisë së tyre sipas Kodit për Rregullimin e brendshëm të mbështetur nga Borsa Italia S.p.A. dhe/ose kriteret e parashikuara nga neni 22.1, paragrafi tre, të Statutit do të përjashtohet kandidati që ka marrë më pak vota të llogaritura dhe nuk ka asnjë prej kërkesave të parashikuara më lart. Kandidati i përjashtuar do të zëvendësohet nga kandidati pasardhës i të njëjtës listë që plotëson kërkesat e parashikuara. Kjo procedurë, nëse e nevojshme, do të përsëritet deri në plotësimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Në rastin kur, sipas kriterëve më lart nuk arrihet plotësimi i numrit të Këshilltarëve, këta të fundit do të zgjidhen nga asambleja me shumicë të thjeshtë, sipas propozimit të ortakëve të pranishëm.

#### **23.5 Lista e vetme**

Në rastin e paraqitjes së një liste kandidatësh, anëtarët e Këshillit do të zgjidhen nga kjo listë, me garimin e kandidatëve të përfshirë në këtë listë.

#### **23.6 Këshilltari i emëruar nga minoranca**

Këshilltari i minoracës është emëruar sipas dispozitave të ligjit dhe rregulloreve, përveç parashikimeve të nenit 34 të Statutit.

#### **23.7 Mungesa e listave**

Në rastin kur asnjë listë nuk është paraqitur në afatet e përcaktuara do të vendosi asambleja me shumicën e ortakëve të pranishëm në asamble. Nëse disa kandidatë marrin të njëjtin numër votash do të zhvillohet një votim i ri me balotazh.


#### **23.8 Zgjedhja e Kryetarit dhe Zv/Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës**

Kryetari dhe Zv/Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga asambleja e zakonshme me shumicë relative.

#### **23.9 Zëvendësime**

Në rastin kur për çdo arsye verifikohet mungesa e njërit prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ky i fundit do të zëvendësohet prej personit të parë të pazgjedhur të listës ku bënte pjesë anëtari që do të zëvendësohet ose personi i dytë i pazgjedhur të listës ku bënte pjesë anëtari që do të zëvendësohet në rastin kur i pari nuk përmbush kërkesat e ligjit, rregulloreve dhe statutit. Nëse sa më lart nuk arrihet, anëtari i Këshillit Mbikëqyrës do të zëvendësohet nga asambleja e zakonshme me vendim të marrë me shumicë të thjeshtë dhe me propozim të Ortakëve të pranishëm.

#### **23.10 Papajftueshmëri**



Nuk mund të zgjidhen anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës dhe nëse emërohen do të shkarkohen, personat që kanë marrë më shumë se pesë herë detyra administrimi ose detyra revizionimi në shoqëri të tjera që marrin pjesë në Bursë ose shoqëri kontrolluese ose të kontrolluara (disa detyra deri në jo më shumë se pesë brenda të njëjtit grup janë të barabarta me një; më shumë se pesë detyra të marra janë të barabarta me dy). Do të aplikohen gjithashtu shkaqet për përgjegjëshmërinë dhe shkarkimin e parashikuar nga ligji, rregulloret dhe statuti.

### **23.11 Simul Stabunt Simul Cadent**

Nëse gjatë aktiviteti të Shoqërisë do të mungojnë, për çdo arsye, më shumë se gjysma e Këshilltarëve të Këshillit Mbikëqyrës, ky i fundit përfundon mandatin e tij dhe do të zgjidhet nga data e emërimit të anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikëqyrës. Për emërimin e Këshillit të ri Mbikëqyrës do të thirret menjëherë asambleja sipas nenit 8.

### **23.12 Revokimi**

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës mund të revokohen nga asambleja në çdo kohë me shumicën që përfaqëson një të pestën e kapitalit të Shoqërisë, përveç të drejtës së Këshilltarit të deleguar për dëmshpërblim nëse revokimi është bërë pa shkak të drejtë.

### **23.13 Shpërblimet**

Këshilltarët e Këshillit Mbikëqyrës përveç rimbursimit të shpenzimeve të kryera për shkak të detyrës së tyre kanë të drejtë për të marrë një shpërblim për detyrën e kryer, i cili përcaktohet nga asambleja në momentin e emërimit të tyre dhe për gjithë kohëzgjatjen e mandatit të tyre. Këshilli Mbikëqyrës pasi ka dëgjuar Komitetin e Shpërblimeve përcakton shpërblimet për Kryetarin, nënKryetarin dhe për Këshilltarët e Këshillit Mbikëqyrës të cilëve iu janë dhënë detyra të veçanta, kompetenca apo funksione nga Statuti ose nga Këshilli Mbikëqyrës.

## **Neni 24. Mbledhjet dhe vendimet e Këshillit Mbikëqyrës.**

### **24.1 Thirrja e mbledhjeve**


Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës thërret me iniciativën e tij dhe gjithsesi në rastet e parashikuara nga ligji ose Statuti dhe kryeson mbledhjet e Këshillit, përcakton rendin e ditës dhe kujdeset që tu komunikohen Këshilltarëve të Këshillit Mbikëqyrës informacionet e përshtatshme në lidhje me çështjet në rendin e ditës.

### **24.2 Periudhat e Mbledhjeve**

Këshilli Mbikëqyrës do të mbledhet, sipas rregullit, çdo muaj.

### **24.3 Kërkesa për thirrjen mbledhjes**





Kryetari do të thërras Këshillin Mbikëqyrës kur i kërkohet nga një prej anëtarëve duke përcaktuar rendin e ditës.

#### **24.4 Vendi i mbledhjes**

Mbledhjet e Këshillit Drejtues do të mbahen sipas rregullit në selinë e Shoqërisë ose alternativisht pranë selisë dytësore të shoqërisë dhe në raste të veçanta në një vend tjetër brenda territorit italian.

#### **24.5 Njoftimi për mbledhjen**

Njoftimi i dërgohet secilit prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe që mundësojnë vërtetimin e marrjes së njoftimit, të paktën katër ditë para mbledhjes. Në rast urgjence, njoftimi do të bëhet me lajmërim të thjeshtë të paktën njëzetë e katër orë përpara. Njoftimi gjithashtu mund të përmbajë përcaktimin e vendeve prej të cilave do të merret pjesë nëpërmjet përdorimit të sistemeve të ndërlidhjes në distancë, sipas nenit 24.6.

#### **24.6 Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës**

Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mund të mbahen në mënyrë të vlefshme edhe nëpërmjet përdorimit të sistemeve të ndërlidhjes në distancë vetëm nëse sigurohen identifikimi i saktë i personave të autorizuar për të marrë pjesë në mbledhje si dhe mundësia për të gjithë pjesëmarrësit, të ndërhyjnë menjëherë gjatë trajtimit të gjithë çështjeve dhe të shikojnë, marrin dhe transferojnë dokumente. Të paktën Kryetari dhe Sekretari duhen gjithashtu të jenë të pranishëm në vendin e mbledhjes së Këshillit, ose ndryshe do të konsiderohet si e mbajtur.

#### **24.7. Vlefshmëria dhe shumica.**

Për vlefshmërinë e vendimeve të Këshillit të Mbikëqyrjes është e nevojshme që në mbledhje të jenë të pranishëm shumica e anëtarëve në detyrë. Vendimet merren me shumicë absolute të të pranishmëve; në rast barazimi, mbizotëron vota e atij që kryeson.

#### **24.8. Vendimet me shumicë të kualifikuar.**

Kërkohet gjithashtu shumica e anëtarëve në detyrë të Këshillit të Mbikëqyrjes për vendimet që lidhen me emërimin e Kryetarit dhe të një ose dy Nën-Kryetarëve të Këshillit të Administrimit.

#### **24.9. Verbale dhe kopje.**

Verbalet e vendimeve të Këshillit të Mbikëqyrjes hartohen dhe shënohen në regjistrin e verbaleve nën kujdesin e një Sekretari emëruar nga Këshilli, kur verbali nuk është hartuar nga një Noter sipas ligjit.


Kopje dhe ekstrakte të verbaleve, kur nuk janë të hartuara nga Noteri, vërtetohen me deklaratë njësimi të nënshkruar nga Kryetari dhe Sekretari.

## Neni 25. Kompetenca e Këshillit të Mbikëqyrjes

### 25.1. – Lëndët e kompetencës.

Këshilli i Mbikëqyrjes:

- a) me propozim të Komitetit për Emërimet, emëron dhe revokon anëtarët e Këshillit të Administrimit, Kryetarin dhe një ose dy Nën-Kryetarë të Këshillit të Administrimit dhe përcakton shpërblimin, pas dëgjimit të Komiteti për Shpërblimet;  
përcakton gjithashtu, pasi ka dëgjuar Komitetin për Shpërblimet, shpërblimet për Këshilltarin e Deleguar dhe për Këshilltarët e Administrimit të ngarkuar me detyra të veçanta, detyra ose delegime ose që janë caktuar në Komitete ose Komisione sipas Nenit 15;
- b) aprovon bilancin e ushtrimit dhe bilancin e konsoliduar;
- c) ushtron funksionet e mbikëqyrjes të parashikuara nga neni 149, presja e parë dhe e tretë të D.Lgs. 24 shkurt 1998, nr. 58;
- d) nxit ushtrimin e padisë së përgjegjësive kundrejt anëtarëve të Këshillit të Administrimit;
- e) paraqet deklarinimin pranë Bankës së Italisë sipas nenit 70, presja e shtatë, D.Lgs. i 1 shtator 1993, nr. 385;
- f) i raporton me shkrim Asamblesë së thirrur sipas nenit 2364-bis të kodit civil, mbi aktivitetin e mbikëqyrjes së kryer, mbi mangësitë ose shkeljet për të cilat është vënë në dijeni, me rastin e çdo Asambleje tjetër të mbledhur me mbledhje të zakonshme apo të jashtëzakonshme, për sa i përket argumenteve që konsideron se bëjnë pjesë në sferën e kompetencave të tij;
- g) informon pa humbur kohë, Bankën e Italisë për të gjitha aktet ose faktet, për të cilat vihet në dijeni në ushtrimin e detyrave të tij, që mund të përbëjnë parregullsi në administrimin ose shkelje të normave që rregullojnë aktivitetin bankar;
- h) i tregon Këshillit të Administrimit, Këshilltarin e Deleguar dhe shpreh mendimin e detyrueshëm në lidhje me Drejtuesin kompetent në hartimin e dokumenteve të kontabilitetit të shoqërisë për të cilat neni 154-bis i D.Lgs. 24 shkurt 1998, nr. 58;
- i) vendos në lidhje me iniciativat kulturore të Shoqërisë dhe të Grupit, duke ju referuar në mënyrë të veçantë vlerësimit të pasurive historike, arkeologjike, artistike dhe të administrimit të “Fondit të Bamirësisë e të veprave me karakter social e kulturor”, duke verifikuar konvergjencën e iniciativave të programuara me objektivat e marra përsipër;
- l) me propozim të Këshillit të Administrimit, vendos në lidhje me drejtimet e përgjithshme programuese dhe strategjike të Shoqërisë e të grupit; aprovon planet industriale dhe/ose financiare e buxhetet e Shoqërisë dhe të grupit të ngritur nga Këshilli i Administrimit, ndal në çdo rast përgjegjësinë e këtij për aktet e kryera; autorizon operacionet strategjike. Në mënyrë të veçantë, përveç, autorizon:

- 
- (i) propozimet e Këshillit të Administrimit për të përcaktuar Asamblesë në lidhje me operacionet mbi kapitalin, emetimin e detyrimeve të konvertueshme dhe *cum warrant* në titujt e Shoqërisë, bashkime dhe ndarje si edhe ndryshime statutore, duke pasur parasysh kompetencat e propozimit të Ortakëve të parashikuara nga ligji;
- (ii) blerje ose shitje nga ana e Shoqërisë të shoqërive të kontrolluara, të pjesëmarrjeve të kontrollit në shoqëri me vlerë të rëndësishme strategjike ose me vlerë më të madhe përgjithësisht se 6% e pasurisë së mbikëqyrjes së konsoliduar, si edhe blerjen ose shitjen e sipërmarrjeve, raporteve në bashkësi, degë të sipërmarrjeve me vlerë strategjike të rëndësishme;
- (iii) investime ose dizinvestime të rëndësishme strategjike dhe/ose që sjellin detyrime për Shoqërinë, shuma e përgjithshme e të cilave është më e madhe, për çdo operacion, se 6% e pasurisë së mbikëqyrjes së konsoliduar;
- (iv) nënshkrimi të marrëveshjeve tregtare, të bashkëpunimit, para-shoqërore të rëndësishme strategjike;
- m) aprovon orientimet strategjike dhe politike të administrimit të riskut, vlerëson nivelin e efikasitetit dhe të përshtatshmërisë së sistemit të kontroleve të brendshme, me kujdes të veçantë ndaj kontrollit të reziqeve, funksionimit të internal audit dhe të sistemit informativ kontabël; verifikon gjithashtu ushtrimin e drejtë të aktivitetit të kontrollit strategjik e administrues kryer nga Shoqëria në krye të grupit mbi shoqëritë e grupit;
- n) ushtron çdo kompetencë tjetër të parashikuar nga normativa në fuqi pro tempore ose nga Statuti.
- Këshilli i Mbikëqyrjes mund të tregojë kriteret e identifikimit të operacioneve strategjike që i nënshtrohen autorizimit të tij.

### 25.2. Lëndë të tjera në kompetencë.

Këshilli i Mbikëqyrjes i jepen në kompetencë gjithashtu, në përputhje me nenin 2436 të kodit civil, vendimet që lidhen me:

- themelimin ose prishjen e selive sekondare;
- uljen e kapitalit themeltar në rast dalje nga shoqëria të Ortakut;
- përshtatja e Statutit me dispozitat normative.

### 25.3. Kompetencat e mbikëqyrjes.

Këshilli i Mbikëqyrjes dhe anëtarët e tij ushtrojnë kompetencat për të cilat neni 151-bis i D.Lgs. 24 shkurt 1998, nr. 58, sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në të.

#### **25.4. Komiteti i Emërimeve. Komiteti i Shpërblimeve dhe Komiteti për Kontrollin.**

Këshilli i Mbikëqyrjes themelon brenda tij një Komitet Emërimesh, të përbërë nga 5 (pesë) Këshilltarë, ndërmjet të cilëve Kryetari i Këshillit të Mbikëqyrjes që e kryeson. Komiteti i Emërimeve do të ketë funksione zgjedhëse dhe propozuese në lidhje me emërimet e anëtarëve të Këshillit të Administrimit.

Krijon një Komitet Shpërblimesh, përbërë nga 3 (tre) Këshilltarë, që do të ketë funksione propozuese dhe këshilluese në lidhje me shpërblimet sipas ligjit dhe Statutit, duke përcaktuar rregulloren e funksionimit.

Krijon, me qëllim lehtësimin e ushtrimit të funksionit të kontrollit dhe të mbikëqyrjes që i përkasin, një Komitet të posaçëm për Kontrollin, të përbërë nga 3 (tre) Këshilltarë, duke përcaktuar kompetencat, mjetet dhe rregulloren e funksionimit, si edhe mënyrat dhe afatet e informacionit që do t'i jepet Këshillit të Mbikëqyrjes.

Përveç aplikimit të normave specifike të rregulloreve dhe/ose të mbikëqyrjes, anëtarët e Komitetit të Kontrollit zgjidhen midis anëtarëve të Këshillit të Mbikëqyrjes që plotësojnë kërkesat e pavarësisë parashikuar nga Kodi i Autodisiplinës i promovuar nga Bursa Italiane S.p.A. dhe të paktën dy prej tyre duhet të jenë të regjistruar në regjistrin e revizorëve kontabël dhe të kenë ushtruar aktivitetin e kontrollit ligjor të llogarive për një periudhë kohore jo më pak se 3 vjet.

Komiteti për Kontrollin, në veçanti, ka funksione propozuese, konsultuese dhe hetuese mbi sistemin e kontrolleve të brendshme, mbi administrimin e rreziqeve dhe mbi sistemin informativ kontabël. Komiteti, duke përdorur strukturat e shoqërisë të vëna në përdorim, mund të procedojë në çdo moment me akte inspektimi dhe kontrolli si edhe të shkëmbejë informacione me organet e kontrollit të shoqërisë të Grupit në lidhje me sistemet e administrimit dhe të kontrollit dhe të ecurisë së përgjithshme të aktiviteteve të shoqërisë. Anëtarët e Komitetit marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Administrimit.

#### **25.5. Komitete të tjera.**


Këshilli i Mbikëqyrjes ka aftësinë të krijojë Komitete Teknike dhe Komisione me funksione këshilluese.

#### **Neni 26. Kryetari i Këshillit të Mbikëqyrjes.**

**26.1.-** Përveç sa parashikohet nga Nenet 10.1 dhe 24.1, Kryetari i Këshillit të Mbikëqyrjes, në mënyrë funksionale me ushtrimin e kompetencave të vetë Këshillit:

- RISE  
11
- a) koordinon punimet e Këshillit të Mbikëqyrjes;
  - b) merr propozimet e Këshillit të Mbikëqyrjes që lidhen me lëndët që do t'i nënshtrohen për aprovim Këshillit të Mbikëqyrjes, përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me strategjitë dhe drejtimit e përgjithshme të Shoqërisë dhe të grupit, duke formuluar propozimet në fjalë;
  - c) i formulon Këshillit të Mbikëqyrjes propozimet që lidhen me aktivitetin e kontrollit të administrimit të Shoqërisë, me kujdes të veçantë për koherencën me strategjitë dhe drejtimit e përgjithshme aprovuar nga Këshilli i Mbikëqyrjes;
  - d) ushtron funksionin e mbikëqyrjes dhe të aktivimit të organeve shoqërore, të procedurave dhe të sistemeve të kontrollit mbi aktivitetin e Shoqërisë dhe të grupit, edhe duke kërkuar e marrë informacione nga Drejtuesit përkatës për hartimin e dokumenteve kontabël të shoqërisë dhe nga subjektet kompetente për funksionet e ndryshme që lidhen me to;
  - e) aktivon instrumentet informative të nevojshme për të monitoruar korrektesën dhe përshtatshmërinë e strukturës organizative dhe të sistemit administrativ kontabël të adoptuar nga Shoqëria dhe grupi;
  - f) mbikëqyr, duke verifikuar korrektesinë, administrimin e raporteve me Ortakët, në marrëveshje me Kryetarin e Këshillit të Administrimit dhe me Këshilltarin e Deleguar;
  - g) kujdeset për raportet me Autoritetet e Mbikëqyrjes në kuadrin dhe për qëllime të aktivitetit të kontrollit dhe të mbikëqyrjes të Këshillit të Mbikëqyrjes;
  - h) mban raportet e nevojshme dhe të mundshme me Këshillin e Administrimit dhe në veçanti me Kryetarin e tij dhe/ose Këshilltarin e Deleguar;
  - i) kërkon dhe merr informacione mbi aspekte specifike të administrimit të Shoqërisë dhe të grupit e mbi ecurinë e përgjithshme, edhe në perspektivë, të administrimit vetë;
  - l) me qëllim, për të cilin Neni 25.1, mbikëqyr administrimin e komunikimit të jashtëm të informacioneve që lidhen me Shoqërinë, në marrëveshje me Kryetarin e Këshillit të Administrimit dhe me Këshilltarin e Deleguar;
  - m) projekton, pasi ka dëgjuar Kryetarin e Këshillit të Administrimit dhe Këshilltarin e Deleguar, dhe përgatit realizimin e iniciativave kulturore të Shoqërisë dhe të grupit, për t'ju paraqitur Këshillit të Mbikëqyrjes, me kujdes të veçantë në vlerësimin e pasurive historike, arkeologjike, artistike dhe të administrimit të "Fondit të Bamirësisë dhe të veprave me karakter shoqëror e kulturor";
  - n) ushtron të gjitha kompetencat e tjera funksionale për ushtrimin e detyrës të tij.

**26.2.** – Në rast mungese ose pengese të Kryetarit të Këshillit të Mbikëqyrjes, Zëvendëskryetari i Këshillit të Mbikëqyrjes më i vjetër në detyrë, duke nënkuptuar atë që mban detyrën për një kohë sa më të gjatë pa ndërprerje, ose, në raste kur ka vjetërsi në detyrë të njëjtë, sipas vjetërsisë në moshë, përmbush funksionet; në rastin e mungesës ose të pengesës të tij, funksionet ushtrohen



nga Zëvendëskryetari tjetër, ose, në rast mungese ose pengese, nga anëtar i Këshillit të Mbikëqyrjes më i vjetër në detyrë i pranishëm dhe në rast vjetërsie të njëjtë në detyrë, nga më i madhi në moshë.

#### **Neni 27. Drejtorët e Përgjithshëm.**

Këshilli i Administrimit, me propozim të Këshilltarit të Deleguar dhe pasi ka dëgjuar mendimin e Këshillit të Mbikëqyrjes, emëron, revokon dhe përcakton kompetencat dhe shpërblimet e një ose më shumë Drejtorëve të Përgjithshëm – nga të cilët njëri me funksione përfaqësimi, me përjashtim të funksioneve të pa derogueshme të lidhura me detyrën e Këshilltarit të Deleguar – që i jepen Këshilltarit të Deleguar sipas funksioneve dhe kompetencave përkatëse.

### **TITULLI VI**

#### **BILANCI – FITIMET – AKSIONET E KURSIMIT**

#### **Neni 28. Bilanci dhe fitimet.**

**28.1.** – Ushtrimi i shoqërisë mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

**28.2.** – Këshilli i Administrimit harton projektin e bilancit të ushtrimit dhe projektin e bilancit të konsoliduar, duke respektuar normat e ligjit.

**28.3.** – Fitimi neto që rezulton nga bilanci, duke zbritur kuotën që do të destinohet për rezervën ligjore dhe kuotën jo të disponueshme si zbatim i normave të ligjit, ndahet si më poshtë:

a) aksioneve të kursimit jo të konvertueshme, një dividend deri në 5% të vlerës nominale të aksionit.

Në rast se në një ushtrim është përcaktuar për aksionet e kursimit jo të konvertueshme një dividend më i ulët se 5% e vlerës nominale, diferenca llogaritet në rritje të dividendit të privilegjuar në dy ushtrimet e mëpasshme;

b) fitimet që mbeten, për të cilat Asambleja vendos për shpërndarjen, ndahen në të gjitha aksionet në mënyrë që aksionet e kursimit jo të konvertueshme t'ju përkasë një dividend i përgjithshëm më i madh, kundrejt atij të aksioneve të zakonshme, në masë të barabartë me 2% të vlerës nominale të aksionit;

c) mbetja e mundshme e rezervës së jashtëzakonshme ose të fondeve të tjera rezervë, duke pasur në konsideratë mundësinë e destinimit të një kuote të kësaj mbetje bamiërisë dhe mbështetjes së veprave më karakter shoqëror dhe kulturor, nëpërmjet ngritjes së një fondi të veçantë.

28.4. – Dividendët e pavjelur dhe të parashkruar, derdhen në favor të Shoqërisë dhe kalohen në rezervën e jashtëzakonshme.

#### **Neni 29. Aksionet e kursimit.**

29.1. – Aksionet e kursimit, që mund të jenë të pagueshme ndaj prurësit, i japin të drejtën e ndërhyrjes dhe të votës në Asamblenë speciale të mbajtësve të aksioneve të kursimit.

29.2. – Aksioneve të kursimit ju përket dividendi i privilegjuar për të cilin nenin 28.3.

29.3. – Në rast shpërndarjeje të rezervave aksionet e kursimit kanë të njëjtat të drejta me aksionet e tjera.

29.4. – Me prishjen e Shoqërisë, aksionet e kursimit kanë përparësi në kthimin e kapitalit për të gjithë vlerën nominale.

Ulja e kapitalit për humbje nuk sjell reduktimin e vlerës nominale të aksioneve të kursimit më tepër sesa pjesa e humbjes që tejkalon vlerën nominale të përgjithshme të aksioneve të tjera.

29.5. – Në rast përjashtimi nga negociatat në tregjet e rregulluara të aksioneve të zakonshme dhe të kursimit të Shoqërisë, aksionet e kursimit ruajnë të njëjtat të drejta dhe karakteristika, deri sa nuk ka vendim të ndryshëm të Asamblesë së jashtëzakonshme dhe të asaj speciale.

29.6. – Përfaqësuesi i përbashkët i aksionarëve të kursimit zgjat në detyrë për tre ushtrime.

Shpërblimi i Përfaqësuesit së përbashkët është i përcaktuar në masën 10% (dhjetë për qind) të shpërblimit përkatës mbi bazën e Tarifës Profesionale të Doktorëve Komercialistë për detyrën e kryetarit të kolegjit sindikal.

Shpërblimi është në ngarkim të Shoqërisë.

Asambleja speciale mund të vendosë një shpërblim të mëtejshëm që do të rëndojë mbi fondin e krijuar për shpenzimet e nevojshme për mbrojtjen e interesave të përbashkëta.

29.7. – Përfaqësuesi i përbashkët ka detyrimet dhe kompetencat e parashikuara nga dispozitat në fuqi të ligjit. Kryetari i Këshillit të Administrimit informon pa vonesë, nëpërmjet dërgimit të komunikimeve të duhura, Përfaqësuesin e përbashkët për operacionet e shoqërisë që mund të influencojnë ecurinë e kuotimit të aksioneve të kursimit dhe në veçanti mbi propozimet që Këshilli i Administrimit ka vendosur t'i paraqesë Asamblesë në fushën e veprimeve mbi kapitalin, shkrijen dhe ndarjen.

## TITULLI VII

### KONTROLLI KONTABËL – DORËHEQJA – SHKRIRJA – PËRCAKTIMI SIPAS LIGJIT

#### **Neni 30- Kontrolli Kontabël**

Kontrolli kontabël ushtrohet nga një shoqëri revizioni që përmbush kërkesat sipas ligjit. Dhënia dhe revokimi i caktimit të detyrës, detyrat, kompetencat dhe përgjegjësitë rregullohen nga ligji.

Këshilli i Mbikëqyrjes shpreh mendimin e tij për dhënien e revokimin e detyrës të shoqërisë së revizionit.

#### **Neni 31 – Dorëheqja.**

**31.1.** E drejta e dorëheqjes pranohet në rastet e vetme të parashikuara detyrimisht nga ligji. Është e përjashtur e drejta e dorëheqjes për Ortakët që nuk kanë marrë pjesë në miratimin e vendimeve në lidhje me:

- shtyrjen e afatit të kohëzgjatjes së Shoqërisë;
- vendosjen ose heqjen e pengesave ndaj qarkullimit të aksioneve.

**31.2.** Afatet dhe mënyrat e ushtrimit të të drejtës së dorëheqjes, kriteret e përcaktimit të vlerës së aksioneve dhe procedimi përkatës i likuidimit rregullohet nga ligji.

#### **Neni 32. Prishja.**

Përveç çdo dispozite tjetër të ligjit, në qoftë se verifikohet një shkak prishjeje, Asambleja do të vendosë mënyrat e likuidimit, duke emëruar një ose më shumë likuidatorë.

#### **Neni 33. Përcaktimi sipas normave të ligjit.**

Për gjithçka që nuk është parashikuar në Statut aplikohen dispozitat e ligjit.

## TITULLI VIII NORMA TË PËRKOHSHME

#### **Neni 34. Emërimet e para.**



Edhe me derogim me Statutin që do të jetë në fuqi me vlefshmërinë e bashkimit midis Banca Intesa S.p.A. dhe Sanpaolo IMI S.p.A., Këshilltarët e Mbikëqyrjes në numër 19 do të emërohen për herën të parë, për kohëzgjatjen prej tre vitesh ushtrimorë, nga Asambleja e zakonshme e Shoqërisë Përthithëse duke aplikuar dispozitat sipas kësaj norme të përkohshme.

Aksionistët do të jenë të ftuar të depozitojnë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga asambleja e zakonshme e Bankës Intesa S.p.A., listat të kandidatëve që përmbushin kërkesat e parashikuara nga ligji dhe nga ky Nen. Në veçanti, kandidati i radhitur në numrin 2 të secilës listë, duhet të plotësojë kërkesat e pavarësisë të parashikuara nga Kodi i Autodisiplinës promovuar nga Bursa Italiana S.p.A. dhe të jetë i regjistruar në regjistrin e revizorëve kontabël dhe të ketë ushtruar aktivitetin e kontrollit ligjor të llogarive për të paktën një trevjeçar. Për kandidatët në vijim të çdo liste, të paktën tre prej tyre duhet të zotërojnë kërkesat e pavarësisë të parashikuara nga Kodi i Autodisiplinës të sipërthënë dhe dy të jenë regjistruar në Rregjistrin e revizorëve të llogarive dhe të kenë ushtruar aktivitetin e kontrollit ligjor të llogarive për të paktën një trevjeçar.

Për kufirin e zotërimit aksionar të nevojshëm për prezantimin e listave dhe për çdo mënyrë tjetër dhe kërkesë për prezantimin e listave respektohen për sa të aplikueshme dispozitat e nenit 23 të statutit të Bankës Intesa S.p.A. në fuqi në momentin e Asamblesë së jashtëzakonshme thirrur për të miratuar projektin e bashkimit.

Do të rezultojnë të zgjedhur 18 kandidatët e parë të marrë nga lista që kanë fituar numrin më të madh të votave dhe kandidati i parë marrë nga lista që ka fituar numrin e dytë më të madh të votave. Në rast paraqitjeje të një liste të vetme të gjithë 19 përbërësit e Këshillit të Mbikëqyrjes do të merren nga kjo listë.

Kryetari dhe dy Zv. Kryetarët do të emërohen nga Asambleja e zakonshme me vendime të posaçme me shumicë relative.

Emërimi i 19 Këshilltarëve të Mbikëqyrjes të sipërpërmendur do të jetë e vlefshme nga momenti i vlefshmërisë së bashkimit. Këshilli i Mbikëqyrjes në detyrë emëron pa humbur kohë Këshillin e Administrimit.

Pas vlefshmërisë së bashkimit, me qëllim që të lejojë përhapjen e pjesëmarrjes për përzgjedhjen e dy Këshilltarëve të tjerë, do të mbledhet një asamble e zakonshme thirrur për të vendosur për dy Këshilltarët e Mbikëqyrjes të tjerë, të cilët do të qëndrojnë në detyrë për 3 vite ushtrimore (përveç pjesës së ushtrimit të që përfshihet midis vlefshmërisë së bashkimit dhe vlefshmërisë së emërimit të tyre), dhe do të mbarojnë mandatin bashkë me 19 Këshilltarët e mësipërm. Emërimi i 2 Këshilltarëve të tjerë të Mbikëqyrjes do të kryhet me procedurën e votimit të listës, siç është e rregulluar nga statuti atëherë në fuqi, duke paralajmëruar se:

- (i) kandidatët duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e parashikuara për të gjithë dhe secilin nga Këshilltarët e Mbikëqyrjes, dhe

- (ii) përqindja e pjesëmarrjes aksionere kërkuar për paraqitjen e listës do të jetë të paktën 1 %, por nuk mund të kalojë 3% të kapitalit të shoqërisë.

### **Neni 35. Kërkesa statutore të ndershmërisë, profesionalizmit dhe pavarësisë.**

#### **35.1. – Dispozitë e përkohshme.**

Deri në shpalljen e një disipline të re mbikëqyrjeje dhe/ose rregullimi në lidhje me kërkesat që duhet të plotësojnë anëtarët e organeve të shoqërisë në sistemin dualist, mbetet në fuqi aplikimi i parashikimeve të mëposhtme.

#### **35.2. Kërkesa të ndershmërisë**

Anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrjes dhe anëtarët e Këshillit të Administrimit duhet të plotësojnë kërkesat e ndershmërisë të vendosura për eksponentët e bankave nga Rregullorja e adoptuar me Dekret të Ministerial të datës 18 mars 1998, nr. 161, si dhe ato të parashikuara për anëtarët e kolegjit sindakal të shoqërive të kuotuar nga Rregullorja adoptuar me Dekret të Ministerial nr. 162, datë 30 mars 2000.

#### **35.3.- Kërkesat e profesionalizmit për Këshilltarët e Mbikëqyrjes.**

Anëtarët e Këshillit të Mbikëqyrjes duhet të plotësojnë kërkesat e profesionalitetit të vendosura për Këshilltarët e administrimit të bankave në bazë të Rregullores së përcaktuar me Dekret Ministerial të datës 18 mars 1998, nr. 161, si edhe ato të parashikuara për anëtarët e kolegji sindakal të shoqërive të kuotuar nga Rregullorja adoptuar me Dekret Ministerial të datës 30 mars 2000, nr. 162. Kryetari i Këshillit të Mbikëqyrjes duhet të plotësojë edhe kriteret e profesionalizmit përcaktuar për Kryetarin e Këshillit të Administrimit të bankave nga Rregullorja e mësipërme.

#### **35.4. - Kërkesat e profesionalizmit për Këshilltarët e Administrimit.**

Anëtarët e Këshillit të Administrimit, Kryetari i Këshillit të Administrimit dhe Këshilltari i Deleguar duhet të plotësojnë kërkesat e profesionalitetit respektivisht të përcaktuara për eksponentët e bankave nga Rregullorja e adoptuar me Dekretin Ministerial të 18 marsit 1998, nr. 161.

### **Neni 36. Elementë të Rëndësishëm të Planit të Integritit.**

Elementët e Rëndësishëm të Planit të Integritit, kështu siç janë përcaktuar në projektin e bashkimit me përthithje ndërmjet Bankës Intesa S.p.A. dhe Sanpaolo IMI S.p.A., mund të ndryshohen vetëm me vendimin e Këshillit të Administrimit marrë me shumicën e dy të tretave të anëtarëve në detyrë, me autorizimin e Këshillit të Mbikëqyrjes vendosur me shumicë të kualifikuar të dy të tretave të anëtarëve në detyrë, për kohëzgjatjen e mandatit të parë të Këshillit të Mbikëqyrjes.

**TITULLI IX**  
**DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 37. Dispozitat përfundimtare.**

Në aplikim të normës kalimtare të përmbajtur në Nenin 34 të Statutit, Këshilltarët e parë të Mbikëqyrjes janë emëruar për afatin e tre ushtrimeve nga Asambleja e zakonshme e përhithëses Banka Intesa mbajtur në datë 01.12.2006 dhe kanë marrë detyrën në datën e vlefshme të bashkimit me përhithje në Banka Intesa S.p.A. të Sanpaolo IMI S.p.A. dhe të vlefshmërisë korresponduese të Statutit.

Unë i nënshkruari Ing. Enrico Salza  
Në cilësinë e kryetarit të këshillit administrativ të Intesa Sanpaolo S.p.A. deklaron se sa më lartë është statuti i shoqërisë së lartpërmendur bashkëngjitur projektit të bashkimit me përhithje të Sanpaolo IMI S.p.A. në Banka Intesa S.p.A., miratuar nga asambleja e jashtëzakonshme e 1 dhjetorit 2006 dhe me nenet 5 dhe 37.

Statuti si më lart ka hyrë në fuqi më 1 Janar 2007.

Ing. Enrico Salza

Zyra Noteriale Morone

Ky dokument, i përbërë prej tetëmbëdhjetë faqesh është i njëjtë me originalin pasi më është treguar dhe i është kthyer të interesuarit dhe jepet prej meje Z. Ettore Morone Noter me banim në Torino për përdorimet e lejuara nga ligji

Torino më 18.01.2007

**VULË APOSTILE**  
(Konventa e Hagës e 5 tetorit 1961)

Republika Italiane  
Akti publik në fjalë është nënshkruar nga .....  
Në cilësinë e .....  
Sipas tregimit të shënimit/vulës.....  
Certifikuar në Torino më .....  
Nga Prokurori i Republikës pranë Gjykatës Torino  
Me numrin 839

Vula dhe nënshkrimi i Prokurorit të Republikës Italiane  
Dott. Antonio Malagnino

Vula e Prokurorisë së Republikës Italiane pranë Gjykatës së Torinos




**VËRTETIM**

Sot, më datë 10.04.2007, unë i nënshkruari, Z. Ilir Johollari, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 09.07.1978, banues në Tiranë, Rr. M. Gjollësia, me pasaportë nr. Z 1685292, vërtetoj se, deklarova se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i njëjtë me originalin e versionit italisht dhe anasjelltas.

PËRKTHYES

**Ilir Johollari**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
Nr. 11771 Rep.

**VËRTETIM**

Unë vërtetoj se sot më datë 10.04.2007, në Zyrën e Noterisë, para meje Noteres L. Jllka, u paraqit personalisht Z. Ilir Johollari, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 09.07.1978, banues në Tiranë, Rr. M. Gjollësia, me pasaportë nr. Z 1685292, i njohur personalisht prej meje, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u binda pasi verifikova pasaportën e tij, i cili më deklaroi se versioni shqip i dokumentit bashkëngjitur është një përkthim i njëjtë me originalin e versionit italisht dhe anasjelltas, vërtetim të cilin e nënshkroi përpara meje noterës, me vullnetin e tij të plotë dhe të lirë, dhe unë e vërtetoj atë sipas ligjit.

NOTERE



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
NR. 1178/REP.



### VËRTETIM I NJESISE ME ORIGJINALIN

Sot me date 10/04/2007(shtate) para meje noteres Lindita LLeshi, me zyre ne Bul B.Curri, pallatet 1 maj, shkalla 8,ap 7, u paraqit

Ilir Johollari, prane SLTonucci kerkoj te vertetoj se kopja e dokumentit, bashkalidhur, eshte e njejte me origjinalin.

Une noterja pasi krahasoj dokumentin origjinal me fotokopjen vertetoj se eshte I njejte me origjinalin.

Dokumenti nuk ka korigjime apo fshirje.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te ligjit 7829 date 01/06/1994"Per Noterine"(I ndryshuar) dhe udhezimit te Ministrise nr 6291 date 17.08/2005, pika 3, 4 e 7).



NOTERE  
LINDITA LLESHI

**SHARE PURCHASE AGREEMENT**

Dated as of December 20 – 21, 2006

Between

**SANPAOLO IMI S.p.A**, a company incorporated under the laws of Italy with registered office at Piazza San Carlo No. 156, Turin, Italy, registered with the Enterprises' Register of Turin, Tax Code and VAT Identification No. 06210280019, represented by Mr. Giuseppe Cuccurese duly empowered for the purposes hereof by power of attorney dated October 10, 2006, granted by Mr. Alfonso Iozzo in his capacity as Chief Executive Officer of Sanpaolo IMI S.p.A (hereinafter, the **'Purchaser'**)

- on one side -

and

**ALBANIAN-AMERICAN ENTERPRISE FUND**, a non for profit corporation organized and registered at Delaware State USA, incorporated under the laws of the State of Delaware, USA, with registered office at 14 East 60-th Street, Suite 407., New York, NY 10022 U.S.A., Tax Code No. 13/3826249, represented by Mr. Michael Granoff in his capacity as Chairman of the board of directors of the Albanian-American Enterprise Fund, duly empowered for the purposes hereof by the board of directors' resolution dated December 18, 2006(hereinafter, the **'Seller'**)

- on the other side -

(the Purchaser and the Seller are also collectively referred to as the **'Parties'** and, each individually, the **"Party"**)

**WHEREAS**

- (A) The Seller is the owner of 100% (one hundred percent) of the entire issued capital of "American Bank of Albania – Banka Amerikane e Shqiperise Sh.A." (hereinafter, the **"Bank"**), a company incorporated under the laws of Albania, with headquarters in Rruga Ismail Qemali No. 27, Tirana, Albania, corporate capital, as of October 31, 2006, of USD 33,400,000 (thirty-three million four hundred thousand) divided into No.



15,000,000 (fifteen million) shares with a nominal value of USD 2.2266 (two point two thousand two-hundred and sixty-six) per share, registered with the Commercial Companies' Register under No. 19460 dated 19 May 1998.

- (B) The Seller intends to sell to the Purchaser, which intends to purchase from the Seller 12,000,000 (twelve million) shares of the Bank, equal to an equity stake of 80% (eighty percent) of the entire issued capital of the Bank (hereinafter, the "Participation") upon the terms and subject to the conditions of this Agreement.

NOW, THEREFORE, upon the terms and subject to the conditions hereinafter set forth, the Parties agree as follows:

## **SECTION I - RECITALS; DEFINITIONS; INTERPRETATION**


### **1.1 Recitals and Annexes**

All the foregoing recitals, as well as all the Annexes hereto, represent an integral and material part of this Agreement.

### **1.2 Definitions**

For the purposes of this Agreement, capitalized terms shall have the following meaning:

- "AAS" means Albanian Accounting Standards;
- "Accounting Principles" has the meaning ascribed to it under Section 7.8;
- "Aggregate Deductible" has the meaning ascribed to it under Section 9.2.1(ii);
- "Agreement" means this share purchase agreement, including all its recitals and Annexes, as well as any amendment thereof;
- "Amended Employee Option Plan" means the Employee Stock Option Plan, as amended effective as of the Closing Date, a form of which is attached hereto as Annex 1.2.A;
- "Auditor" means KPMG Albania Sh.p.k.;
- "Authority" means any public authority, including, but not limited to, local or governmental authorities, courts, arbitrators and public agencies or any other regulatory authority of competent jurisdiction;



*ML*



- **“Authorizations”** means any authorization, license, permit, exemption, certificate, approval, consent issued by the competent Authority;
- **“Bank”** has the meaning ascribed to it under the whereas clause (A);
- **“Bank’s Authorizations”** has the meaning ascribed to it under Section 7.6;
- **“Business Day”** means any day other than a Saturday, a Sunday, a national holiday in Albania, in Italy or in New York, USA, or a day on which banks in Tirana, Albania, Turin, Italy or New York, USA, are authorized to be closed;
- **“Charges”** has the meaning ascribed to it under Section 13.7.2;
- **“Claim of Indemnity”** has the meaning ascribed to it under Section 11.1;
- **“Closing”** has the meaning ascribed to it under Section 2.2;
- **“Closing Balance Sheet”** has the meaning ascribed to it under Section 3.3.2;
- **“Closing Date”** has the meaning ascribed to it under Section 2.2;
- **“Closing Declaration”** has the meaning ascribed to it under Section 6.1(ix);
- **“Closing Net Worth”** has the meaning ascribed to it under the Section 3.3.2;
- **“Commitment”** has the meaning ascribed to it under Section 5.1.3;
- **“Deciding Auditor”** has the meaning ascribed to it under Section 3.3.4;
- **“Dedicated Amount”** has the meaning ascribed to it under Section 3.2.2 (b);
- **“Direct Claim”** has the meaning ascribed to it under Section 11.1;
- **“Downward Adjustment”** has the meaning ascribed to it under Section 3.3.5;
- **“Employee Stock Option Plan”** means the American Bank of Albania 2004 Stock Option Plan, pursuant to which up to 2,250,000 shares of the Bank are available for grant to officers and employees of the Bank a form of which is attached hereto as Annex 1.2.B;
- **“Estimated Net Worth”** means the estimated net worth of the Bank as of December 31, 2006 equal to USD 43,000,000 (forty-three million) as set forth in the Bank’s Budget for 2007 attached as Annex 1.2.C;
- **“Euro”** or **“€”** means the lawful currency of the member states of the European Union that have adopted the currency in accordance with the Treaty establishing the European Community, as amended by the Treaty on the European Union;
- **“Execution Date”** means the date on which the Parties have signed this Agreement;

- **“Financial Statements”** means the audited financial statements of the Bank as of June 30, 2006;
- **“Greek Branches”** means the two branches of the Bank established under the laws of the Republic of Greece, located in Athens and Thessaloniki respectively;
- **“Indemnified Party”** has the meaning ascribed to it under Section 11.1;
- **“Indemnifying Party”** has the meaning ascribed to it under Section 11.1;
- **“Knowledge of the Seller”** with respect to the representations and warranties of the Seller means the actual knowledge of the members of the Board of Directors of the Seller or the President and CEO of the Seller;
- **“Law”** means any law, statute, ordinance, rule, regulation, order, judgment or decree, arbitrators’ award, treaty, regulation, directive enforceable towards the Parties and/or the Bank;
- **“Lien”** means any lien, pledge, usufruct, encumbrance, obligation, privilege, claim or right of third parties, option, burden or prejudicial encumbrance, defects of title or restriction of any kind, including, without limitation, any restriction on the voting, transfer or income distribution of securities;
- **“LIBOR”** means, in respect of any interest period, the interest rate for deposits in that currency for the applicable period as specified herein, which appears on the screen display designated as “page 3750” on the Telerate Service (or such other screen display or service as may replace it for the purpose of displaying British Bankers’ Association Libor rates for deposits in that currency in the London interbank market) as of 11.00 a.m. on the second Business Day prior to the commencement of the such interest period;
- **“Loss”** has the meaning ascribed to it under Section 9.1(i);
- **“Notice of Claim”** has the meaning ascribed to it under Section 11.1;
- **“Operational Licenses”** means the license issued to the Bank by the Central Bank of Albania on July 10, 1998, authorizing the Bank to perform the activities listed in Article 26, paragraphs 3 and 4 of Albanian Law No. 8365, dated July 2, 1998;
- **“Option Plan Participants”** means all employees and officers of the Bank holding, as of the date hereof, option to acquire No. 1,797,425 Shares under the Employee Stock Option Plan;

- **“Ordinary Course of Business”** means the conduct by the Bank of its regular business activities on an arm’s length basis, in compliance with applicable Law, Bank’s internal regulations and the conduct that the Bank normally engaged in its past practices;
- **“Participation”** has the meaning ascribed to it under the whereas clause (B);
- **“Price”** has the meaning ascribed to it under Section 3.1;
- **“Price Adjustment”** means the Upward Adjustment or the Downward Adjustment, as applicable;
- **“Purchaser”** means SANPAOLO IMI S.p.A.;
- **“Real Properties”** has the meaning ascribed to it under Section 7.10.1;
- **“Seller”** means ALBANIAN-AMERICAN ENTERPRISE FUND;
- **“Shareholders’ Agreement”** has the meaning ascribed to it under Section 6.1 (viii);
- **“Single Deductible”** has the meaning ascribed to it under Section 9.2.1(i);
- **“Taxes”** means any and all taxes, charges, fees, levies, assessments, stamp duties or other amounts payable to any federal, state, local or foreign taxing authority or agency, including, without limitation, (i) income, franchise, profits, gross receipts, minimum, alternative minimum, estimated, *ad valorem*, value added, sales, use, service, real or personal property, capital stock, license, payroll, withholding, disability, employment, social security, workers compensation, unemployment compensation, utility, severance, excise, stamp, windfall profits, transfer and gains taxes, (ii) customs, duties, imposts, charges, levies or other similar assessments of any kind, and (iii) interest, penalties and additions to tax imposed with respect thereto;
- **“Tax Returns”** has the meaning ascribed to it under Section 7.11;
Numri i anëtarëve të Bordit Drejtues të Bankës aktualisht në detyrë është 8 (tetë). Anëtarët aktualisht në detyrë dhe të mëparshëm të Bordit Drejtues të Bankës, janë dhe kanë patur plotësisht të drejtë, që të kryejnë aktivitetet dhe detyrat si dhe të marrin vendimet që lidhen me funksionin e tyre, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit Shqiptar.

### 7.17 Polica e Sigurimit



Politikat e policës së sigurimit nëpërmjet të cilave Banka dhe/ose Degët në Greqi sigurohen ndaj riskut të mospagimit të kredive janë të vlefshme, efektive dhe të pagueshme sipas dispozitave përkatëse të ligjit që rregullojnë këto politika.

#### 7.18 Dispozitat që qëndrojnë në fuqi

Përvec deklaratave dhe garancive në Seksionin 7.9, 7.11 dhe 7.12 që do mbeten në fuqi dhe pas Datës së Mbylljes deri në mbarimin e afatit të periudhave kufizuese statutores që zbatohet për veprime nga ku lind detyrimi për dëmshpërblim sipas Seksionit IX më poshtë, deklaratat dhe garancitë e Shitësit sipas Seksioneve VII.A dhe VII.B do mbeten në fuqi dhe 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj pas Datës së Mbylljes. Pas kësaj periudhe, nuk mund të ngrihet asnjë pretendim për shkelje të kontratës ose sipërmarrjeve apo pretendim për dëmshpërblim.

#### 7.19 Zgjidhja si shkak i Njoftimit të Pretendimit

Nëse, para mbarimit të afatit të zbatueshën për dispozitat që mbeten në fuqi sic parashikohet në Seksionin 7.18 më sipër, Njoftimi për Pretendim (sic përkufizohet më poshtë) jepet në mirëbesim nga Blerësi sipas Seksionit 11.1, lidhur me shkeljen e deklaratave dhe garancive të Shitësit sipas Seksioneve VII.A dhe VII.B, si rrjedhojë deklaratat e garancitë, objekt i Njoftimit për Pretendim si më lart, do vazhdojnë të mbeten në fuqi vetëm për qëllimin e këtij Njoftimi për Pretendim dhe përtej afateve që përcaktohen në Seksionin 7.18 më lart deri në mbarimin e afatit të Deklaratës përkatëse për Dëmshpërblim (sic përcaktohet më poshtë) në përputhje me Seksionin XI ose Seksionin XII të kësaj Marrëveshjeje, dhe sipas rastit.

#### 7.20 Due Diligence: .....; Vlerësimi i lirë

Blerësi njihet dhe deklaron se ai ka hartuar Due Diligence kërkimore për Bankën në lidhje me çështjet financiare, ekonomike, taksat, çështjet ligjore dhe të tjera. Blerësi, më tej njihet dhe pranon se asnjë zotim, deklaratë apo garanci (e shprehur apo e pashprehur) për korrektesinë, cilësinë, saktësinë, rëndësinë, tërësinë apo mjaftueshmërinë, për qëllimet e Blerësit, të informacionit dhe dokumenteve, që i janë siguruar apo vënë në dispozicion të Blerësit apo këshilltarëve të tij, gjatë hetimit të tyre, është kryer apo u krye nga Shitësi, Banka apo punojësit, drejtorët, nëpunësit, menaxherët, agjentët apo këshilltarët e saj përkatës. Kuptohet që një deklaratë e tillë e Blerësit, nuk kufizon deklaratat dhe garancitë e Shitësit për Blerësin, në këtë Marrëveshjeje.

### SEKSIONI VIII – DEKLARATA DHE GARANCI TË BLERËSIT

Blerësi lëshon vetëm për Shitësin deklarata dhe garanci në Seksionin VIII. Shitësi njihet dhe pranon se Blerësi nuk do lëshojë deklaratë apo garanci tjetër, qoftë e shprehur apo e pa shprehur, në ndonjë Seksion ose klauzolë tjetër të kësaj

Marrëveshje ose kudo tjetër dhe që deklaratat dhe garancitë e dhëna Shitësit në këtë marrëveshje zëvendësojnë çdo deklaratë ose garanci tjetër shtesë ose garanci të çdo lloji që parashikohen nga Ligji i zbatueshëm. Deklaratat dhe garancitë që lëshohen nga Blerësi si më poshtë janë të vërteta dhe të sakta në Datën e Ekzekutimit dhe në Datën e Mbylljes.

### 8.1 Fuqia Ligjore; Autorizimi; Zbatimi

Blerësi është një shoqëri themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas Ligjeve të Italisë dhe ka fuqi dhe autoritet të plotë për të: (i) ekzekutuar dhe zbatuar këtë Marrëveshje; (ii) përmbushur detyrimet e saj si më poshtë (përfshirë, pa kufizime, pagesën e Cmimit) dhe (iii) të përfundojë transaksionet që përcaktohen më poshtë. Blerësi nuk është deklaruar, dhe nuk është, i paaftë të paguajë dhe nuk është subjekt i procedurave të falimentimit ose të tjera të ngjashme me to. Ekzekutimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshje dhe i çdo marrëveshje tjetër për tu zbatuar nën ose në lidhje me, dhe aty ku është e zbatueshme, kryerja e transaksioneve që parashikohen këtu janë autorizuar rregullisht dhe janë miratuar nga organet kompetente të Blerësit. Kjo Marrëveshje përbën një detyrim të vlefshëm ekzekutiv për Blerësin, të ekzekutueshëm ndaj tij në përputhje me afatet që përcaktohen këtu, subjekt i dispozitave urdhëruese sipas Ligjit të zbatueshëm. Përveç kësaj, Blerësi deklaron dhe garanton se nëse realizohet shkëmbimi që parashikohet për Blerësin në Banca Intesa S.p.A, kjo e fundit do trashëgojë të gjitha cilësitë kontraktuale dhe ligjore të Blerësit, përfshirë këtu dhe të gjitha detyrimet, të drejtat dhe detyrat që parashikohen e rrjedhin nga kjo Marrëveshje.

### 8.2 Mjetet Financiare

Blerësi zotëron mjetet financiare e nevojshme për përmbushjen e çdo dhe të gjitha detyrimeve financiare si më poshtë, dhe sidomos për pagesën e Cmimit dhe të çdo Takse të detyrueshme në lidhje me transaksionet që parashikohen këtu.

### 8.3 Dispozitat që mbeten në fuqi

Deklaratat dhe garancitë e Blerësit sipas këtij Seksioni VIII do mbeten në fuqi dhe për 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj pas Datës së Mbylljes dhe nuk mund të jenë shkak për pretendime për shkelje të kontratës ose pretendim për dëmshpërblim pas periudhës së lartpërmendur.

## SEKSIONI IX – DËMSHPËRBLIMI NGA ANA E SHITËSIT

### 9.1 Dëmshpërblimi nga Shitësi

Sipas Seksioneve 7.18 dhe 9.2, nga dhe pas Datës së Mbylljes, Shitësi bie dakord të dëmshpërblejë Blerësin nga dhe për 80% (tetëdhjetë për qind) të:

- (i) cdo humbjeje reale, dëm, kosto ose shpenzim, me përjashtim të humbjeve mbi fitimet ose humbjeve a dëmeve indirekt ose si rrjedhojë ("Humbja"), që pësohen ose shkaktohen nga vetë Blerësi ose Banka si pasojë e shkeljes, jo vërtetësisë ose e pasaktësisë të një prej deklaratave ose garancive që parashikohen në Seksionet VII.A dhe VII.B, e që lindin dhe varen nga akte, fakte, ngjarje ose rrethana që janë krijuar apo që kanë ndodhur në ose para Datës së Mbylljes, edhe pse Humbja rezulton pas një date të tillë; ose
- (ii) cdo Humbje që pësohet apo ndodh në mënyrë direkte nga Blerësi dhe/ose Banka si rezultat i ndonjë shkelje të detyrimeve të Shitësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

## 9.2 Përjashtime dhe Kufizime të përgjegjësisë të Blerësit

Pavarësisht nëse parashikohet ndryshe nga Ligji i zbatueshëm, Blerësi pranon dhe bie dakord si më poshtë:

9.2.1 Shitësi nuk do jetë përgjegjës ndaj Blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Blerësi nuk ka të drejtë për asnjë dëmshpërblim për sa më poshtë:

- (i) nëse shuma që duhet të paguhet për cdo akt, nga i cili lind një detyrim sipas kësaj Marrëveshjeje, të mos kalojë vlerën prej 20,000 Euro (njëzet mijë) (në vijim si "Shuma e vetme e Zbritshme."); dhe
- (ii) vetëm nëse totali i shumave të pagueshme sipas Seksionit 9.1 (me përjashtim të shumave jo të pagueshme sipas paragrafit (i) të mësipërm) kalon shumën prej 300,000 Euro (treqind mijë) (në vijim si "**Totali i Zbritshëm**"), e me kusht që, nëse kalohet ky kufi, Blerësi ka të drejtë të pretendojë vetëm për tepricat.

9.2.2 Për më tepër për sa parashikohet në Seksionin 9.2.1 më sipër, totali maksimal i përgjegjësisë së Shitësit në këtë Marrëveshjeje nuk do të tejkalojë 100% (njëqind për qind) të Cmimit që Shitësi do të marrë në bazë të Seksionit III të mësipërm.

9.2.3 Në rastin kur dhe deri në masën që Humbja, për të cilën kërkohet dëmshpërblim ndaj Shitësit sipas kësaj Marrëveshjeje, është e zbritshme nga Blerësi ose Banka për qëllime tatimore ose përcakton humbje tatimore të cdo viti tatimor, si rrjedhojë e kësaj, në këtë rast dhe në këto kufij, shuma e cdo Humbjeje e dëmshpërblyeshme nga Shitësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të zbritet me një përqindje të barabartë me përqindjen tatimore përkatëse të aplikueshme ndaj të ardhurave të Blerësit ose të Bankës.

9.2.4 Pa çenuar sa parashikohet në Seksionet 9.2.2 dhe 9.2.3 si më sipër, shuma për të gjitha dëmshpërblimet e pagueshme nga Shitësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të ulët më tej, si shkak i:

- (i) shumës së sigurimive shoqërore ose pagesave të ngjashme që Blerësi ose Banka do të marrin në lidhje me rastin që bëhet shkak për dëmshpërblim;
- (ii) shumës së dëmshpërblimit që Blerësi ose që Banka do të marrë nga palët e treta në lidhje me rastin që bëhet shkak për dëmshpërblim; dhe

- (iii) shumës së cdo rezerve ose fondi disponibël në Deklaratat Financiare për mbulimin e shkakut të dëmshpërblimit.

9.2.5 Kur llogaritja e taksave është rezultat i ndryshimit të barrës tatimore nga një vit fiskal në tjetrin, dëmshpërblimi që lidhet me të, do kufizohet në rjetin aktual dhe në koston përfundimtare në para të Blerësit.

## **SECTION X – DËMSPËRBLIMI NGA BLERËSI**

### **10.1 Dëmshpërblimi nga Blerësi**

Sipas Seksioneve 8.3 dhe 10.2, nga dhe pas Datës së Mbylljes, Blerësi bie dakort të dëmshpërblejë Shitësin nga dhe kundrejt cdo Humbjeje që Shitësi ka pësuar ose është shkaktuar, si rezultat i:

- (i) cdo shkelje, jo vërtetësie ose pasaktësie në deklaratat dhe garancitë e dhëna nga Blerësi në bazë të Seksionit VIII më sipër; ose
- (ii) mospërmbushjes të detyrimeve të Blerësit në këtë Marrëveshje.

### **10.2 Përjashtime dhe Kufizime të përgjegjësisë të Blerësit**

Përvec sa parashikohet ndryshe në Ligjin e aplikueshëm, Shitësi njih dhe bie dakort si më poshtë:

10.2.1 Në rastin kur dhe deri në masën që Humbja, për të cilën kërkohet dëmshpërblim ndaj Blerësit sipas kësaj Marrëveshje, do zbritet nga Shitësi për qëllime tatimore ose përcakton humbjet tatimore të vitit tatimor, si rrjedhojë e kësaj, në këtë rast dhe në këto kufij, shumën e cdo Humbjeje që do t'i dëmshpërblehet Shitësit nga Blerësi sipas kësaj Marrëveshje do zbritet me një përqindje të barabartë me përqindjen tatimore përkatëse të aplikueshme ndaj të ardhurave të Shitësit.

10.2.2 Pa cënuar sa parashikohet në Seksionin 10.2.1 të sipërmendur, shumën për të gjitha dëmshpërblimet e pagueshme nga Blerësi tek Shitësi sipas Seksionin 10.1 do ulet si shkak i:


- (i) shumës së sigurimeve shoqërore ose pagesave të ngjashme që Shitësi merr lidhur me rastin që bëhet shkak për dëmshpërblim;
- (ii) shumës së dëmshpërblimit që Shitësi merr nga palët e treta në lidhje me rastin që bëhet shkak për dëmshpërblim; dhe

## **SEKSIONI XI – PROCEDURA E DËMSPËRBLIMIT**

### **11.1 Pretendimi për Dëmshpërblim**

Në rast se një nga Palët (në vijim si "Pala e Dëmshpërblyer") vihet në dijeni për ndonjë pretendim, procedim ose tjetër ("Pretendimi për Dëmshpërblim") në





lidhje me të cilën Pala tjetër (kjo Palë në vijim si "Pala e Dëmspërblyer") ka rënë dakort të dëmspërblejë Palën e Dëmspërblyer sipas kësaj Marrëveshje, kjo e fundit do të njoftojë me shkrim ("Njoftimi i Ankimit") Palën Dëmspërblyese brenda 20 (njëzet) ditëve Punë nga momenti që bëhet me dije për Pretendimin për Dëmspërblim. Pas mbarimit të këtij afati, Pretendimi për Dëmspërblim do të konsiderohet i parashkruar. Në rastin kur afati i fundit për të apeluar, për të kundërshtuar ose për të kryer një veprim tjetër lidhur me Pretendimin për Dëmspërblim është më pak se 20 (njëzetë) Ditë Punë, Pala e Dëmspërblyer do t'i komunikojë Njoftimin e Pretendimit Palës Dëmspërblyese brenda këtij afati të shkurtër sipas rrethanave më të përshtatshme për të bërë të mundur depozitimin e apelimit, kundërshtimit apo të një veprimi të tillë. Në kuptimin e kësaj dispozite, njoftimi i Bankës do quhet dhe njoftim i Blerësit. Njoftimi i Pretendimit do specifikojë nëse Pretendimi për Dëmspërblim është rezultat i pretendimeve të palëve të treta kundrejt Palës së Dëmspërblyer ("Pretendim i Palëve të Treta") ose ndryshe ("Pretendim i Drejtpërdrejtë"), si dhe do specifikojë më tej bazën e fakteve të detajuara në mënyrë të arsyeshme të Pretendimit për Dëmspërblim (sa lejon informacioni që disponon) dhe shumën e Pretendimit për Dëmspërblim, nëse dihet, si edhe deklaratat specifike, garancitë ose dispozitat e kësaj Marrëveshje për të cilat Blerësi pretendon se janë shkelur.

### 11.2 Pretendimet e Drejtpërdrejta

Në lidhje me Pretendimet e Drejtpërdrejta, Pala Dëmspërblyese pas marrjes së Njoftimit për Pretendim nga Pala e Dëmspërblyer, do ketë 30 (tridhjetë) Ditë Punë kohë për të hetuar për Pretendimin për Dëmspërblim nëse e quan të nevojshëm ose dëshiron kështu; lidhur me këtë, Pala e Dëmspërblyer vë në dispozicion të Palës Dëmspërblyese regjistrat, personelin dhe këshilltarët e saj dhe të Bankës për të mundësuar që Pala Dëmspërblyese të kryejë një hetim të plotë. Përveç rastit kur Pala e Dëmspërblyer dhe Pala Dëmspërblyese bien dakort, në ose para afatit prej 30 (tridhjetë) Ditë Punë, mbi vlefshmërinë dhe shumën e Pretendimit për Dëmspërblim, e si rrjedhojë e kësaj Pala Dëmspërblyese do t'i paguajë menjëherë Palës së Dëmspërblyer shumën e plotë për të cilën është rënë dakort të Pretendimit për Dëmspërblim, Pretendimi i Drejtpërdrejtë përkatës do t'i referohet arbitrazhit detyrues për palët siç parashikohet në Seksionin XII.

### 11.3 Pretendimet e Palëve të Treta

Lidhur me Pretendimet e Palëve të Treta, pavarësisht nëse Pala Dëmspërblyese ka rënë dakord të dëmspërblejë Pretendimin për Dëmspërblim, kjo ka të drejtë, që me shpenzimet e veta, të marrë pjesë dhe të pretendojë kontrollin e negociatave, zgjidhjes dhe mbrojtjen e pretendimit. Nëse Pala Dëmspërblyese vendos të pretendojë për këtë kontroll, Pala e Dëmspërblyer (i) do sigurojë dhe do mundësojë që Banka t'i sigurojë Palës Dëmspërblyese informacionin dhe dokumentat që mund të duhen për të mbrojtur Bankën nga Pretendimet e Palëve të Treta, pa shpenzime nga Pala Dëmspërblyese, dhe se cdo informacion e

dokumentacion i tillë do jetë konfidencial; (ii) do mundësojë që Banka të informojë rregullisht dhe në kohë Palën Dëmshpërblyese në cdo kohë për komunikimet, njoftimet apo informacion tjetër që ajo merr lidhur me çështjet subjekt të këtij pretendimi; (iii) do veprojë në kohë, në përputhje me dhe do mundësojë që Banka të veprojë në kohë në përputhje me udhëzimet e arsyeshme të Shitësit në veprimet për çështjet ligjore dhe/ose negociatat për zgjidhjen e tyre dhe/ose veprimet e tjera që lidhen me to. Pala e Dëmshpërblyer ka të drejtë të marrë pjesë në negociata, në zgjidhjen e tyre apo në mbrojtjen e Pretendimeve të Palëve të Treta si dhe të punësojë një avokat, me shpenzimet e veta, që të veprojë për llogari të saj. Nëse Pala Dëmshpërblyese, që ka vendosur të pretendojë këtë kontroll, nuk mbron brenda një kohe të arsyeshme Pretendimin e Palëve të Treta, Pala e Dëmshpërblyer do të ketë të drejtë të pretendojë për këtë kontroll, dhe Pala Dëmshpërblyese është e detyruar të pranojë rezultatet lidhur me Pretendimin e Palëve të Treta që nxjerr Pala e Dëmshpërblyer. Në rast se Pala Dëmshpërblyese vendos që të mos kryejë këtë kontroll, si rrjedhojë Pala e Dëmshpërblyer duhet të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën Dëmshpërblyese lidhur me avokatin që kjo apo Banka do punësojë, sipas rastit, për të mbrojtur Pretendimin e Palëve të Treta dhe se Pala e Dëmshpërblyer duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim, në lidhje me sa më lart, të Palës Dëmshpërblyese e cila nuk do ta refuzojë pa shkak. Pala e Dëmshpërblyer do mbrojë në mënyrën e duhur dhe me përpikmëri si dhe do mundësojë që Banka të veprojë në të njëjtën mënyrë për të mbrojtur cdo Pretendim të Palëve të Treta dhe do njoftojë Palën Dëmshpërblyese menjëherë e për të gjitha nismat dhe veprimet që lidhen me sa më lart. Pala e Dëmshpërblyer nuk do pranojë asnjë përgjegjësi, dhe nuk do pranojë asnjë zgjidhje lidhur me Pretendimin e Palëve të Treta pa miratimin paraprak me shkrim të Palës Dëmshpërblyese, me kuptimin që (i) cdo zgjidhje që propozohet duhet të sigurojë që pala e tretë që ngre Pretendimin përkatës së Palës së Tretë nuk do ngrejë asnjë pretendim në të ardhmen përveç kësaj dhe se zgjidhja e propozuar si më lart do jetë përfundimtare dhe e detyrueshme për palët e treta, (ii) miratimi i Palës së Dëmshpërblyese nuk do refuzohet pa shkak, dhe (iii) pranimi i zgjidhjes nga Pala e Dëmshpërblyer të Pretendimit të Palëve të Treta pa miratimin paraprak të Palës Dëmshpërblyese do quhet nga kjo e fundit si ç'liberim nga detyrimi i saj për dëmshpërblim të Palës së Dëmshpërblyer në lidhje me këtë Pretendim, përveç rastit (a) kur Pala Dëmshpërblyese nuk shpreh mendimin e saj, lidhur me zgjidhjen e propozuar, brenda 10 Ditë Pune nga marrja e kërkesës së Palës së Dëmshpërblyer ose (b) zgjidhja sjell si pasojë uljen e Humbjeve.

#### **11.4. Zbutja e Humbjeve**

- Pala e Dëmshpërblyer do përpiqet maksimalisht (përfshirë këtu kundërshtimin e pretendimeve përkatëse) për uljen e humbjeve dhe do mundësojë që Banka të veprojë në të njëjtën mënyrë për cdo Humbje që do dëmshpërblehet sipas Seksionit XI, para dhe pas Njoftimit për Pretendim, si dhe do njoftojë në kohë dhe për të gjitha Shitësin, në lidhje me këto nisma apo veprime. Është e kuptueshme dhe Palët kanë rënë dakord që në rast se Blerësi nuk përmbush dispozitat e Seksionit 11.4 Shitësi lirohet nga detyrimi i tij që të dëmshpërblejë Blerësin për

Pretendimin përkatës për Dëmshpërblim në masën që mospërmbushja cënon Shitësin.

### 11.5 Pagesa

Pagesa e gjithë shumave që Pala Dëmshpërbllyese ka si detyrim sipas Seksionit XI do kryhet në përputhje me Seksionin 13.7 menjëherë pas përcaktimit të shumës që do dëmshpërblehet, por jo më vonë se 10 (dhjetë) Ditë Pune/pas datës së përcaktimit. Në rastin e Pretendimit të Palëve të Treta (përfshirë këtu dhe pretendimin nga një autoritet publik), cdo dëmshpërblim që do kryhet nga Pala Dëmshpërbllyese tek Pala e Dëmshpërbllyer, si këtu më poshtë, bëhet i detyrueshëm dhe i pagueshëm vetëm kur pretendimi përkatës bëhet përfundimtar dhe nuk është subjekt i asnjë apelimi në të ardhmen apo të mëparshëm, dhe në rastin e një vendimi gjyqësor ekzekutiv apo kur cdo vendim tjetër administrative merr fuqi ligjore dhe detyron Palën e Dëmshpërbllyer të kryejë pagesën (me kusht që, nëse pretendimi është subjekt apelimi apo kundërshtimi në të ardhmen, dhe këto ulin apo c'lirojnë nga përgjegjësia Bankën apo Blerësin, cdo shumë tepri që fillimisht është dëmshpërbllyer nga Shitësi do t'i kthehet menjëherë këtij).

## SEKSIONI XII – ARBITRAZH I DHE VENDI I ARBITRAZHIT

Cdo konflikt, mosmarrëveshje apo pretendim që lind apo lidhet me këtë Marrëveshje, apo cdo shkelje, përfundim apo pavlefshmëri e kësaj, do zgjidhet me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit UNCITRAL në fuqi. Do caktohen tre arbitra, dy prej të cilëve do caktohen nga secila prej Palëve dhe arbitri i tretë, i cili do veprojë në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues të arbitrazhit, do caktohet nga arbitrat e cdo Pale, dhe në rast se Palët nuk bien dakord brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga caktimi i dy arbitrave, arbitri i tretë do caktohet nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Londrës. Selia dhe vendi i arbitrazhit është Londër, Angli dhe gjuha angleze do përdoret në të gjitha çështjet gjyqësore. Palët heqin dorë nga cdo e drejtë sipas Aktit të Arbitrazhit 1996 apo nga apelimi i vendimit të arbitrazhit, apo nga kërkesa për të zgjidhur çështjen nga gjykatat e Italisë ose Shqipërisë. Gjykata e Arbitrazhit nuk është e autorizuar që të marrë apo të sigurojë, dhe Palët bien dakord që nuk do kërkojnë nga asnjë autoritet gjyqësor, masa të përkohshme për mbrojtjeje apo masa lehtësuese para gjykimit përkundrejt palës tjetër, pavarësisht nga dispozitat e Rregullave të Arbitrazhit UNCITRAL.

## SEKSIONI XIII – TË NDRYSHME

### 13.1 Njoftimet

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera që do kryhen apo do jepen në përputhje me sa parashikohet këtu, do jenë me shkrim dhe në Anglisht, do quhen se i janë komunikuar Palëve me marrjen e njoftimit të dorëzimit në se dorazi, të postuar përkundrejt postës të regjistruar apo me vërtetim (postë e


parapaguar me kthim përgjigje) në adresat e mëposhtme (ose në adresat që Palët i komunikojnë njëra-tjetrës me shkrim) ose të dërguar me fax apo mënyrë elektronike në numrat e faksit apo adresat elektronike që përcaktohen më poshtë (konfirmimi i dërgimit të faksit dhe i hapjes së postës elektronike përbëjnë provë të vlefshme për marrjen e faksit dhe të komunikimit me postë elektronike);

- Për Blerësin  
Në vëmendje të: Drejtorit të Rrjetit të Huaj  
San Paolo IMI  
Piazza San Carlo, 156  
10121 Torino, Italy  
Tel.: + 39 011 555 7892  
Nr. Fax.: + 39 011 555 2141  
E-mail: [giuseppe.cuccurese@sanpaoloimi.com](mailto:giuseppe.cuccurese@sanpaoloimi.com)

Një kopie për:  
Në vëmendje të: Drejtorit të Departamentit të Aksionarëve  
San Paolo IMI  
Piazza San Carlo, 156  
10121 Torino, Italy  
Tel.: + 39 011 555 3474  
E-mail: + 39 011 555 6668  
E-mail: [flavio.gianetti@sanpaoloimi.com](mailto:flavio.gianetti@sanpaoloimi.com)

- Për Shitësin:  
Në vëmendje të: z. Jeffrey Griffin  
President dhe Drejtor Ekzekutiv i Fondit Shqiptari-Amerikan të Ndërmarrjeve  
Rr: "Dëshmorët e 4 Shkurtit"  
Kompleksi "Green Park"  
Kulla 2, Kati 12  
Tiranë, Shqipëri  
Tel.: + 355 4 222 408  
Nr. Fax.: + 355 4 271 952  
E-mail: [j.griffin@aaef.com](mailto:j.griffin@aaef.com)

Një kopie për:  
z. Michael D. Granoff  
Kryetari i Fondit Shqiptari-Amerikan të Ndërmarrjeve  
Care of Pomona Capital  
780 Third Avenue, 44<sup>th</sup> floor  
Neë York, NY 10017 - 7076  
USA  
Tel: 001 212 5930727



Nr. Fax.: 001 212 593 3987  
E-mail: [mgranoff@pomonacapital.com](mailto:mgranoff@pomonacapital.com)

dhe

Z. Roberto Casati  
Cleary Gottlieb Steen & Hamilton LLP  
Via San Paolo 7  
20121 Milan, Italy  
Tel: + 39 02 726081  
Nr. Fax.: +39 02 86984440  
E-mail: [rcasati@cgsh.com](mailto:rcasati@cgsh.com)



Secila Palë mund të ndryshojë në cdo kohë adresën e saj të shërbimit dhe njofton Palën tjetër në përputhje me këtë Seksion 13.1.

### **13.2 Tërësia e Marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje (bashkë me Shtojcat e saj) përbën tërësinë e Marrëveshjes për Palët dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet paraprake dhe angazhimet, me shkrim e me gojë, të Palëve, lidhur me çështjet subjekt të Marrëveshjes.

### **13.3 Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve**

Kjo Marrëveshje dhe cdo dispozitë e saj nuk do transferohet, sipas ligjit apo ndryshe, nëse Palët nuk bien dakord me shkrim.

### **13.4 Ndryshimet**

Kjo Marrëveshje do ndryshohet vetëm me dokument me shkrim të nënshkruar nga Palët.

### **13.5 Heqja dorë**

Heqja dorë nga e drejta, shkelja apo mospërbushja si këtu më poshtë do quhet e vlefshme vetëm me dokument me shkrim të Palës që heq dorë, dhe kjo nuk do quhet si heqje dorë nga një shkelje apo mospërbushje, qoftë kjo e njëjtë apo e ngjashme.

### **13.6 Tarifat, Shpenzimet dhe Pagesa të tjera**

13.6.1 Cdo dhe të gjitha Taksat, shpenzimet noteriale dhe tarifatat e tjera zyrtare e shpenzimet që do kryhen për shitjen dhe transferimin e Pjesëmarrjes do mbulohen nga Blerësi.

13.6.2 Pa çënuar dispozitat e Seksionit 13.6.1 si më lart, Blerësi dhe Shitësi do mbulojnë kostot dhe shpenzimet e tyre përkatëse lidhur me këtë Marrëveshje dhe me transaksionet që parashikohen po në këtë Marrëveshje. Shitësi do mbulojë të gjitha kostot, shpenzimet apo tarifatat e pagueshme për këshilltarët financiarë, avokatët, ekonomistët apo përfaqësuesit e tjerë që janë punësuar nga Shitësi për transaksionet që parashikohen në Marrëveshje. Blerësi do mbulojë të gjitha kostot, shpenzimet apo tarifatat e pagueshme për këshilltarët financiarë, avokatët, ekonomistët apo përfaqësuesit e tjerë të punësuar nga Blerësi në lidhje me transaksionet që parashikohen në Marrëveshje.

### **13.7 Kryerja e Pagesave**

13.7.1 Përyecse kur përcaktohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, cdo dhe të gjitha pagesat që do kryhen nga njëra Palë tek Pala tjetër do kryhen si pagesa të lira, në datën e caktuar për kryerjen e tyre, e me transfertë në llogarinë bankare që Pala e cila merr pagesën i komunikon Palës paguese – së paku 5 (pesë) Ditë Pune para datës së caktuar për kryerjen e pagesës.

13.7.2 Cdo pagesë që do kryhet sipas kësaj Marrëveshjeje, është shumë neto pa asnjë zbitje, Taksën në burim apo të ndryshme, tarifatat apo shpenzimet bankare apo kosto të tjera (së bashku, "Tarifat"). Në cdo rast tarifa do zbatohet sipas Ligjit të zbatueshëm, dhe Pala që është debitor do paguajë Palës tjetër një shumë shtesë në mënyrë që pas pagimit të Tarifës Pala të marrë shumën neto që përcaktohet në këtë Marrëveshje.

### **13.8 Kopjet**

Kjo Marrëveshje mund të hartohet në shumë kopje, dhe nga secila Palë në kopje të vecanta, të cilat kur zbatohen quhen të njëjta me origjinalin e të gjitha së bashku përbëjnë një dhe Marrëveshjen e vetme.

### **13.9 Legjislacioni i zbatueshëm**

Kjo Marrëveshje dhe cdo dispozitë e saj rregullohet, interpretohet dhe është hartuar në përputhje me legjislacionin Shqiptar por pa çënuar dispozitat që rregullojnë konfliktin midis ligjeve.

SAN PAOLO IMI S.P.A

FONDI SHQIPTARO-AMERIKAN I NDERRMARJEVE

Përfaqësuar nga: Giuseppe Cuccurese

Përfaqësuar nga: Michael D. Granoff



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1559 Rep.



VERTETIM

Me anen e te cilit vertetohet firma e perkthyeses Alma Kape e njohur prej meje personalisht, e cila perkthecu sa me siper nga gjuha Angleze ne Shqip njelloj me dokumentin origjinal dhe e nenshkroi ate rregullisht.

Tirane, me 10.05.2004



NOTERE

NOTERE  
ENKETA 44  
EPOKË 10/713-02







KIB-20811008

Departmenti Juridik  
Nr 0760103 Prot.

Tirane, me 25.05. 2007

**Lenda: VERETIM**

Nepermjet kesaj shkrese, une i nenshkruari Lorenzo Roncari, ne cilesine e Presidentit dhe Drejtorit te Pergjithshem Ekzekutiv te Bankes Amerikane te Shqiperise sh.a, vertetoj se Z. Giuseppe Cuccurese ka nenshkruar Kontraten e Shitjes se Aksioneve date 20 - 21 Dhjetor 2006 duke vepruar ne emer dhe per llogari te "Sanpaolo IMI" S.p.A, sipas tagrave te dhena atij me ane te Prokures se Posacme date 10 Tetor 2006 bashkengjitur. Ieshuar nga Z. Alfonso Iozzo ne cilesine tij si Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv i "Sanpaolo IMI" S.p.A.

Prokura e Posacme bashkengjitur kesaj shkrese mund te perdoret ne cdo institucion apo autoritet publik, i cili mund te kete nevoje dhe kerkoje nje dokument te tille ne kuader vleresimit teresor te Kontrates se Shitjes se Aksioneve dhe/ose perfundimit te transaksionit.

Me respekt,

Lorenzo Roncari  
President & Drejtor i Pergjithshem Ekzekutiv



Legal Department  
Prot. No. 0768/03

Tirana, on 27. 07 2007

**Ref: CERTIFICATION**

Through this letter, I, Lorenzo Roncari in the quality of President and Chief Executive Officer of the "American Bank of Albania", do hereby certify that Mr. Giuseppe Cuccurese signed the Share Purchase Agreement dated December 20 - 21, 2006 acting in the name and behalf of "Sanpaolo IMI" S.p.A, based on the entitlement granted to him through the attached Power of Attorney dated October 10, 2006 issued by Mr. Alfonso Iozzo in his capacity as Chief Executive Officer of "Sanpaolo IMI" S.p.A.

The Power of Attorney attached hereto may be submitted to any institution or public authority, which may need and ask such document for the overall estimation of the Share Purchase Agreement and/or the completion of the transaction.

Best Regards,

Lorenzo Roncari  
President & Chief Executive Officer

# SANPAOLO IMI

## DELEGA

Il sottoscritto **Alfonso Iozzo**, nato a Torre di Ruggiero (CZ) il 31 Agosto 1942 e domiciliato, per la carica, in Torino, Piazza San Carlo n. 156 nella sua qualità di Amministratore Delegato della Società "SANPAOLO IMI S.p.A." con sede in Torino, Piazza San Carlo n. 156, capitale sociale di Euro 5.399.586.247,68 interamente versato, codice fiscale e numero di iscrizione presso il Registro delle Imprese di Torino 06210280019, Banca iscritta nell'Albo di cui all'articolo 13 del Decreto Legislativo n. 385/1993 e Capogruppo del Gruppo Bancario SANPAOLO IMI (Albo Gruppi Bancari n. 01025.6), iscritta all'Albo di cui all'articolo 64 del medesimo Decreto Legislativo al n. 5084.9.8, a quanto infra facoltizzato dal vigente Statuto Sociale e della Delibera del Consiglio di Amministrazione del 6 ottobre 2006, agendo nella sua predetta qualità,

### nomina e costituisce

**Giuseppe CUCCURESE**, nato a Genova il 7 aprile 1955, quale procuratore speciale e per quanto infra generale, del SANPAOLO IMI S.p.A., conferendo a lui il potere di compiere, in nome e per conto del SANPAOLO IMI S.p.A., qualsiasi atto necessario a presentare un'offerta vincolante, e più in generale a perfezionare l'operazione complessiva che prevede l'acquisto, dall'American Albanian Enterprise Fund ("AAEF"), di una partecipazione pari all'80,00% ed un impegno/facoltà di acquisto del residuo 20,00% del capitale sociale di American Bank of Albania, società di diritto albanese con sede in Tirana, Rruga Ismail Temali, 27.

Tale procura speciale conferisce, in caso di selezione del SANPAOLO IMI S.p.A. quale miglior offerente, ogni necessario e più ampio potere da esercitare al fine di perfezionare l'acquisto e il trasferimento a favore di SANPAOLO IMI S.p.A. della partecipazione menzionata (ivi compresa, in via esemplificativa, la sottoscrizione del contratto di compravendita con il venditore ed un accordo put/call e la presentazione delle istanze alle competenti autorità di vigilanza).

Autorizza pertanto il costituito procuratore a porre in essere ogni adempimento a tal fine utile o necessario ai sensi della normativa applicabile al trasferimento delle azioni, nulla escluso onde non possa essere eccepita al costituito procuratore carenza o indeterminatezza di poteri.

Con promessa fin d'ora de rato et valido.

Torino, 10 ottobre 2006

  
Alfonso Iozzo

SANPAOLO IMI

PROKURE

I nenshkruaji Alfonso Iozzo lindur ne Torre di Ruggiero (CZ), me 31 Gusht 1942, rezident, per detyren, ne Torino, Piazza San Carlo nr. 156, ne cilesine e Drejtorit te Pergjithshem Ekzekutiv te Shoqerise "SANPAOLO IMI S.p.A", me seli ligjore ne Torino, Piazza San Carlo nr. 156, me kapital 5.399.586.247,68 Euro, i investuar teresisht, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Torinos, Kod Fiskal dhe Nr. NIPT 06210280019, Banke e regjistruar ne Buletin e Grupeve Bankare, ku ne baze te nenit 13 te Dekretit Legjislativ nr. 385/1993 eshte shoqeri holding e Grupit Bankar SANPAOLO IMI (Buletini i Grupeve Bankare nr. 01025.6), regjistruar ne Buletin e Grupeve Bankare ku ne baze te nenit 64 te te njejtit Dekret Legjislativ nr. 5084.9.8 dhe Statutit ne fuqi te Shoqerise, ne menyre te vullnetshme dhe ne baze te Takimit te Keshillit Administrativ, zhvilluar ne daten 6 Tetor 2006, duke vepruar ne cilesine e siperpermendur.

Emeron dhe cakton

Giuseppe CUCCURESE lindur me date 7 Prill 1955, ne Genova, si perfaqesues te posaçem dhe te pergjithshem te shoqerise SANPAOLO IMI S.p.A duke i transferuar nepermjet kesaj prokure te drejten per te vepruar dhe ndermarre ne emer dhe per llogari te SANPAOLO IMI S.p.A, çdo veprim te nevojshem per te paraqitur nje oferte te plote per realizimin teresisht te transakcionit qe parashikon blerjen nga Fondi Shqiptar Amerikan i Ndermarrjeve "FSHAN" te nje pjesemarrje prej 80.00% dhe te drejte blerje te 20.00% te kapitalit te shoqesire se Bankes Amerikane te Shqiperise, shoqeri e themeluar ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, me seli ligjore ne Tirane, Rruga Ismail Qemali, nr. 27.

Ne rastin e perzgjedhjes se SANPAOLO IMI S.p.A si ofruesi me i mire, kjo prokure e posaçme eshte e vlefshme per ushtrimin e te gjitha kompetencave per realizimin e blerjes dhe transferimit te pjesemarrjes se lartpermendur ne favor te SANPAOLO IMI S.p.A (duke perfshire ketu si shembull nenshkrimin e kontrates se shitblerjes me shitesin, marrevshjen put/call dhe perfaqesimin e autoritetve kompetente mbikqyrese).

Per rrjedhoje autorizon nepermjet kesaj prokure te posaçme perfaqesuesin e caktuar te ushtroje plotesisht te gjitha kompetencat e nevojshme sipas akteve normative te zbatueshme ne lidhje me transferimin e aksioneve, azgje nuk perjashtohet per te shmangur keqkuptimet lidhur me kompetencat e perfaqesuesit te Shoqerise.

Me premtimin se tani kjo prokure e posaçme eshte e drejte dhe e vlefshme.

Torino 10 Tetor 2006.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1556 Rep.



PULLE TAKSE



**VERTETIM**

Me anen e ~~te~~ cilit vertetohet firma e perkthyeses Alma Kape e njohur prej meje personalisht, e cila perktheu sa me siper nga gjuha Angleze ne Shqip njelloj me dokumentin origjinal dhe e nenshkroi ate rregullisht.

Tirane, me 10.05.2007

NOTERE  
NOTERE  
E... 44  
2007... 20





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**

Sheshi "Skenderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568

• Fax: ++355 4 223558 • Website: www.bankofalbania.org • E-mail: public@bankofalbania.org

DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES

Sektori i Licensimit, Rregullimit dhe Standarteve

Nr. 30271 Prot.

Tiranë, më 21.06.2007



Për: Banken Amerikane te Shqipërisë, sh.a  
Tiranë


Në vëmendje të ; Z.Lorenzo Roncari  
President & Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Lënda: Mbi dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e ndryshimeve në statut.

Referuar shkresës Tuaj nr.07/6320 datë 05.06.2007, po ju dërgojmë bashkëlidhur Urdhërin e Zëvendësguvernatorit të Parë të Bankes se Shqipërisë "Për miratimin e disa ndryshimeve të propozuara në statutin e Bankës Amerikane të Shqipërisë".

Me respekt,

p/ Klodion Shehu  
Drejtor

  
BANKA SHQIPËRISË  
ZËVENDËSGUVERNATORI I PARË

Nr. Prot. 393

Date: 21.06.2007

**URDHËR**

Për miratimin e disa ndryshimeve në statutin e Bankës Amerikane të Shqipërisë sh.a.

---

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 4 të Ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë"; nenit 24, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", pasi u njoha me kërkesën e Bankës Amerikane të Shqipërisë sh.a. të datës 05.06.2007,



**URDHËROJ:**

1. Miratimin e disa ndryshimeve në statutin e Bankës Amerikane të Shqipërisë sh.a,  
sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Fatos IBRAHIMI

Zëvendësguvernator i Parë

  
Ndryshimet në statutin e Bankës Amerikane të Shqipërisë sh.a, miratuar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr.19460 datë 19.05.1998, i ndryshuar, janë si vijon: 

1. Neni 1, ndryshon në:

*"Banka përfshihet në grupin bankar Intesa Sanpaolo. Banka detyrohet të zbatojë të gjithë direktivat të cilat Intesa Sanpaolo S.p.A si kreu i grupit bankar Intesa Sanpaolo dhe si shoqëri e listuar adopton me qëllim përputhjen me dispozitat urdhëruese që lidhen me mbikëqyrjen mbi baza të konsoliduara dhe detyrimet e publikimit për sa i përket tregut, të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar i aplikueshëm."*

2. Neni 6.1, ndryshon në:

*"Kapitali i paguar i Bankës është USD 33,400,000 dhe numri i aksioneve të nënshkruara dhe të paguara tërësisht është 15,000,000 aksione, me vlerë nominale USD 2,2266 për cdo aksion."*

3. Neni 6.2, shfuqizohet.

4. Neni 8.1, fjalia e parë dhe e dytë zëvendësohet me:

*"Punët dhe biznesi i Bankës drejtohet nga Këshilli Drejtues, i cili përbëhet nga një numër tek anëtarësh, jo më pak se pesë dhe jo më shumë se nëntë persona. Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjidhen nga Asambleja e Aksionerëve për një periudhë jo më të gjatë se katër vjet nga secili anëtar ka të drejtë të zgjidhet për të njëjtin mandat pa kufizim."*

5. Neni 8.4, ndryshon në:

*"Vendimet e Këshillit Drejtues të Bankës janë të vlefshme kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm, përveç kur ligji parashikon ndryshe. Në rast se quorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes nuk arrihet, anëtarët e pranishëm mund ta shtyjnë mbledhjen pa njoftim deri sa të arrihet quorumi."*



REPUBLICA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE  
Nr. ....Rep

2228

Tirane me, 25.06.2007

**VERTETIM**

Vertetoj se fotokopja bashkengjitur eshte e njejte me origjinalin.

Shtetesi li'studua nga Beaudouin P

shqiperiazat dat 21.06.2007


Dokumenti eshte paraqitur nga A. Dohy I njohur .....

Dokumenti nuk ka fshirje, korrigjime apo veprime te tjera mbi te qe vijne ne kundërshtim me ligjin.

Vertetimi sa me siper behet konform ligjit nr. 7928, date 01.06.1994 "Per noretine" dhe udhezimit te Ministrise se Drejtesise nr. 6291, date 17.08.2005.

**NOTERE**

Vjollca Skendo



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE

Nr. ....Rep

2046

Tirane me, 15.06.2007

### VERTETIM

Vertetohet se fotokopja bashkengjitur eshte e njejte me origjinalin.

Vendimin M 30 dat 06-06-2007 i Bordës së  
Juriprosedi m'atë shkruara përgjithësisht dat 19.6.2007

Dokumenti eshte paraqitur nga A. Doka I njohur .....

Dokumenti nuk ka fshirje, korrigjime apo veprime te tjera mbi te qe vijne ne kundërshtim me ligjin.

Vertetimi sa me sipër behet konform ligjit nr. 7928, date 01.06.1994 "Përnoretine" dhe udhezimit te Ministrise se Drejtesise nr. 6291, date 17.08.2005.



NOTERE

Vjollca Skendo

Protocol No 07/6542



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**

Sheshi "Skënderbej", No. 1, Tirana - Albania • Tel: ++355 4 222230; 222750; 235568  
• Fax: ++355 4 223558 • Website www.bankofalbania.org • E-mail: public@bankofalbania.org

DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES  
Sektori i Licensimit, Rregullimit dhe Standarteve  
Nr. 3269 Prot.

Tiranë, më 14.06.2007

Për: Bankën Amerikane të Shqipërisë  
Tiranë

Në vëmendje të ; Z.Lorenzo Roncari  
Drejtor i Përgjithshëm

Lënda: Mbi dhënien e miratimit për transferimin e aksioneve te  
Bankës Amerikane të Shqipërisë

I nderuar Z.Roncari,

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me Vendim nr.30, datë 06.06.2007 miratoi transferimin e pronesisë së 80 për qind të aksioneve në kapitalin aksioner të Bankës Amerikane të Shqipërisë sh.a, nga Fondi Shqiptaro Amerikan i Ndërmarrjeve tek Intesa Sanpaolo S.p.A Itali.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë nje kopje të Vendimit.

Me respekt,

Klodion Shehu  
Drejtor





**REPUBLIC OF ALBANIA  
BANK OF ALBANIA**

**SUPERVISION DEPARTMENT**  
Licensing, Regulation and Standards Sector

Prot. no. 3269

Tirana 14.06.2007

To: American Bank of Albania  
Tirana

Attention: Mr. Lorenzo Roncari  
Chief Executive Officer

Subject: On granting the approval of the transfer of ABA shares

Dear Mr. Roncari,

The supervising Council of Bank of Albania approved by decision no. 30, dated 06.06.2007 the transfer of the ownership of 80 percent of the shares of the shareholder equity of American Bank of Albania sh.a from Albanian American Enterprise Fund to Intesa Sanpaolo S.p.A Italy.

Attached we are sending you a copy of this decision.

Respectfully,

Klodion Shehu  
Director



**REPUBLIC OF ALBANIA  
BANK OF ALBANIA  
SUPERVISING COUNCIL**

**DECISION**

**No. 30, dated 06.06.2007**

**ON**

**APPROVAL OF THE OWNERSHIP TRANSFER OF 80 PERCENT OF THE SHARES  
OF THE SHAREHOLDER EQUITY OF AMERICAN BANK OF ALBANIA SH.A FROM  
ALBANIAN AMERICAN ENTERPRISE FUND TO INTESA SANPAOLO S.P.A ITALY**

Based on and pursuant to article 43, letter "e" of Law no. 8269, dated 23.12.1997 "On Bank of Albania" and regulation "On granting the license for conducting banking activity in the Republic of Albania" with the proposal of the Supervision Department, the Supervising Council of Bank of Albania

**DECIDED:**

1. Approve the transfer of the ownership of 80 percent of the shares of the shareholder equity of American Bank of Albania sh.a from Albanian American Enterprise Fund to Intesa Sanpaolo S.p.A, Italy.
2. Supervising Department is in charge of the implementation of this decision.
3. Department of Foreign Affair, European Integration and Communication are in charge of the publication of this decision.

This decision becomes immediately effective.

**SECRETARY**

Ylli Memisha

**HEAD**

Ardian Fullani

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
No. .... of Repertori.



VERTETIM

Vertetoj firmen e perkthyeses, **Alma Kapaj**, e njohur personalisht prej meje, e cila perktheu dokumentin bashkangjitur. Ky dokument u perkthye nga gjuha **Shqipe** ne gjuhen **Angleze** ne perputhje me origjinalin dhe u nenshkrua rregullisht.

Tirane, me 18. 06. 2007

NOTERE

REPUBLIC OF ALBANIA  
NOTARY OFFICE OF TIRANA  
No. .... of Repertory  
206A

CERTIFICATE

I certify the signature of the translator **Alma Kapaj**, who translated the above mentioned document. This document was translated from the **Albanian** language into the **English** language, according to the original and was signed regularly.

Tirana, on 18. 06. 2007

NOTARY  
(Name, Surname)  
(signature, seal, stamp)

VIGILANZA CREDITIZIA E FINANZIARIA  
SERVIZIO VIGILANZA SUGLI ENTI CREDITIZI (8-10)  
DIVISIONE ANALISI E INTERVENTI

SUGLI ENTI CREDITIZI II (017)

N. 498913 del 17-05-2007

Fascicolo W2

Fascicolo Fascicolo  
Sottoclassificazione  
SOTTOCLASS

Sottoclassificazione BZ03069 IE0010



Oggetto: Autorizzazione all'acquisizione da parte di Intesa Sanpaolo della American Bank of Albania.

In data 29 dicembre 2006, Intesa Sanpaolo ha presentato istanza di autorizzazione all'acquisizione dell'80% del capitale sociale di "American Bank of Albania Sh.A.", società per azioni avente sede in Tirana (Albania). L'operazione comporterà per l'acquirente un esborso massimo di 125,5 mln di USD.

In proposito, atteso che, ai sensi dell'art. 53, co. 1, lettera c) del D.Lgs. n. 385/93 e del Titolo IV, Cap. 9, Sez. III delle vigenti II.VV.:

- l'iniziativa risulta coerente con le linee di sviluppo enunciate da Intesa Sanpaolo in relazione all'espansione nell'area dell'Europa centro-orientale;
- l'analisi degli effetti che l'operazione in discorso avrebbe sulla complessiva situazione tecnica del Gruppo Intesa Sanpaolo evidenzia un impatto contenuto sui coefficienti di vigilanza prudenziale;
- la struttura organizzativa del medesimo gruppo appare in grado di sostenere l'acquisizione di ABA;
- la locale Autorità di vigilanza ha espresso una valutazione favorevole sull'entità in via di acquisizione,

si autorizza Intesa Sanpaolo a dar corso all'operazione nei termini e nelle condizioni prospettate.

Resta inteso che ogni valutazione relativa a profili diversi da quelli di Vigilanza è rimessa alla piena ed esclusiva responsabilità dei competenti organi aziendali.

M. DRAGHI

IL DIRETTORE

(M. Draghi)

Per copie contronote

MBIKQYRJA KREDITORE DHE FINANCIARE  
SHËRBIMI I MBIKQYRJES  
MBI ENTET KREDITORE (840)  
DIVIZIONI I ANALIZAVE DHE NDËRHYRJEVE  
MBI ENTET KREDITORE II (017)

Dosja  
Nënklasifikimi  
Sottoclass

Dosja W2

Nënklasifikimi BZ03069 IE0010

NIS 498913 i datës 17 - 05 - 2007

Lënda: Autorizim për blerjen e Bankës Amerikane të Shqipërisë nga Intesa Sanpaolo

Më datë 29 dhjetor 2006, Intesa Sanpaolo ka paraqitur kërkesë për autorizimin për blerjen e 80% të kapitalit themelues të "Banka Amerikane e Shqipërisë Sh.A.", shoqëri anonime me seli në Tiranë (Shqipëri).  
Operacioni në fjalë për blerësin do të përbëjë një shpenzim maksimal prej 125,5 milion USD.

Për këtë arsye, duke patur parasysh se, sipas nenit 53, paragrafi 1, gërma c) të D.Lgs. nr. 385/93 dhe të Titullit IV, Kap. 9, Seksioni III në fuqi II.VV.:

- iniciativa rezulton në përputhje me linjat e zhvillimit të paraqitura nga Intesa Sanpaolo në lidhje me zgjerimin në zonën e Europës qendrore – lindore;
- analiza e pasojave që operacioni në fjalë do të kishte mbi situatën teknike të përgjithshme të Grupit Intesa Sanpaolo është brenda kufijve të koeficientëve të mbikqyrjes së kujdesshme;
- struktura organizative e grupit në fjalë paraqitet në gjendje për të përballuar blerjen e ABA;
- Autoriteti lokal i Mbikqyrjes ka shprehur një vlerësim të favorshëm mbi shoqërinë që do të blihet.

autorizohet Intesa Sanpaolo të fillojë operacionin në përputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara.

Nënkuptohet se çdo vlerësim në lidhje me profile të ndryshme nga ato të Mbikqyrjes, i nënshtrohet përgjegjësisë së plotë dhe të vetme të organeve kompetente të shoqërisë.


M. Draghi

DREJTOR  
(A.M. CEPPI)  
Nënshkrimi përkatës

Kopje e njëjtë me origjinalin



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
NR. 167 REP.



### VËRTETIM I NJESISE ME ORIGINALIN

Sot me date 22/05/2007(shtate) para meje noteres Lindita Lleshi, me zyre ne Bul B.Curri, pallatet I maj, shkalla 8,ap 7, u paraqit Ilir Johollari, i cili kerkoj te vertetoj se fotokopja e dokumentit bashkalidhur, Banka Italia ne italisht dhe e perkthyer, eshte e njejte me origjinalin.

Une noterja pasi krahasova origjinalin me fotokopjen e tij e vertetoj si te njejte.

Dokumenti nuk ka korigjime apo fshirje.

Vertetimi u be ne baze te nenit 56 te ligjit 7829 date 01/06/1994"Per Noterine"(I ndryshuar) dhe udhezimit te Ministrise nr 6291 date 17.08/2005, pika 3, 4 e 7).



NOTERE  
LINDITA LLESHI



Tirane me 22.05.2007

**VERTETIM**

*Vërtetohet se fotokopja bashkëngjitur është e njëjte me origjinalin  
dokumentat N. 18.05.2007, italisht-shqip*

Dokumenti u paraqit nga ARBEN QOKU i njohur .  
Dokumenti nuk ka fshirje , korrigjime apo veprime te tjera mbi te qe  
vijne e ne kundërshtim me ligjin.  
Vërtetimi sa me sipër behet konform ligjit nr 7928 date 01.06.1994  
“ Për Noterinë “ dhe udhëzimit te Ministrit te Drejtësisë nr 6291 date  
17.08.2005 .

Notere

VJOLLCA SKENDO





CREDIT AND FINANCIAL SUPERVISION

SERVICE OF SUPERVISION  
ON THE FINANCIAL INSTITUTION (840)

DIVISION OF ANALYSIS AND INTERVENTIONS  
ON FINANCIAL INSTITUTION

No. 498913 dated May 17, 2007

File  
Sub Classification  
Sottoclass

File W2  
Sub Classification BZ03069 IE0010

Ref: Authorization for the acquisition of American Bank of Albania by Intesa Sanpaolo

On December 29, 2006, Intesa Sanpaolo has represented a request for the authorization of the acquisition of 80 % of the paid in capital of "American Bank of Albania Sh.A", a joint stock Company with Legal Seat in Tirana (Albania).

This transaction shall constitute an utmost expense of USD 125,500,000 (one hundred twenty five million and five hundred thousand United States dollars) for the purchaser.

With regard to the aforesaid, and considering that following the provisions of Article 53, Par. 1 C of D.Lgs. No. 385/93 and Title IV, Cap. 9, Section III in force II.VV:

- The initiative is in compliance with the development plan represented by Intesa Sanpaolo related to the expansion in the Central and Eastern Europe;
- The analysis of the impact of this operation in the overall technical situation of Intesa Sanpaolo Group is within limits of the rates of cautious Supervision.
- The organization structure of the Group is able to sustain the purchase of "American Bank of Albania".
- The local Supervision Authority has expressed the favorable evaluation on the entity that shall be purchased.

Intesa Sanpaolo is authorized to initiate the operation in compliance with the anticipated terms and conditions

It is understood that any evaluation with different profiles from the one of the Supervision Authority is a full responsibility of the competent authority of the Company.

M. Draghi

Manager  
(A.M.Ceppi)  
Proper Signature



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 2295 Rep.

PULLE TAKSE



### VERTETIM

Me anen e te cilit vertetohet firma e perkthyesit Julian Aliaj, i njohur prej meje personalisht, i cili perktheu sa me siper nga gjuha Italiane ne Anglisht njelloj me dokumentin original dhe e nenshkroi ate rregullisht.

Tirane, me 28.06.2007

*Julian Aliaj*  
*Aliaj*

**NOTERE**

**Vjollca Skendo**

*Vjollca Skendo*

REPUBLIC OF ALBANIA  
NOTARY CHAMBER OF TIRANA

Nr. 2295 Rep.

### CERTIFICATE

Whereby it is certified the signature of the translator Julian Aliaj, known by me personally, who have translated the above text from Italian to English in conformity with the document and duly signed.

Tirana, on 28.06.2007

*Julian Aliaj*  
*Aliaj*

**NOTARY PUBLIC**

**Vjollca Skendo**

*Vjollca Skendo*

Tirane më 20.06.2007

**V E R T E T I M**

*Vërtetohet se fotokopja bashkëngjitur është e njëjte me originalin*

Vendim nr 51 date 09.05.2007 i Autoritetit të Konkurrencës .

Dokumenti u paraqit nga Arben Qoku i njohur .

Dokumenti nuk ka fshirje , korigjime apo veprime të tjera mbi të që vijë e në kundërshtim me ligjin.

Vërtetimi sa me sipër behet konform ligjit nr 7928 date 01.06.1994

“ Për Noterinë “ dhe udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr 6291 date 17.08.2005 .

Notere

VJOLLCA SKENDO

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës .05 .2007, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Njoftimi për përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes të 80% të aksioneve nga BAA tek Intesa Sanpaolo S.p.a.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimin të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimin dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimin”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimin,

**V E R E N S E:**

1. Intesa Sanpaolo S.p.a, me seli në Torino dhe Milano, Itali, njoftuesi/blerësi i pjesës prej 80% të aksioneve të Bankës Amerikane të




Shqipërisë (BAA), është shoqëri anonime, që ushtron veprimtari bankare dhe sigurimesh në tregun ndërkombëtar dhe kombëtar.

2. Në tregun kombëtar, kjo shoqëri ushtron veprimtari bankare sipas licensës së lëshuar nga Banka e Shqipërisë Nr 1/1996, datë 17.7.1998, nëpërmjet Bankës Italo-Shqiptare (BIA), ku zotëron 76.12% të kapitalit aksioner të barabartë me 118 aksione. Tregu kombëtar gjeografik i Bankës Italo Shqiptare Sh.A, përbëhet nga degët në 4 qytete Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë. Indirekt Intesa San Paolo është e pranishme në tregun kombëtar, nëpërmjet Credit Agricole që zotëron 71.97% të aksioneve në Emporiki Bank dhe në degët e saj në Tiranë, Vlorë dhe Sarandë.
